



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerë”

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“AUDITIM I PËRPUTHSHMËRISË”

Tiranë, Korrik 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2-8
1.	Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit	2-3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-6
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6-8
II.	HYRJA	8-12
1	Objektivat dhe qëllimi	8
2	Identifikimi i çështjes	8-9
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
4	Përgjegjësitë e audituesve	9-10
5	Kriteret e vlerësimit	10-11
6	Standardet e auditimit	11
7	Metodat e auditimit	11-12
8	Dokumentimi i auditimit	12
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12-126
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12-13
2	Rezultatet e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	13-126
2.1	Veprimtaria dhe vendimmarrja e Drejtorit dhe Këshillit Mbikëqyrës të AMGKP-së	13-22
2.2	Zbatimi i procedurave për ndjekjen dhe mbledhjen e kredive, si dhe aplikimi i masave shtrënguese	22-57
2.3	Administrimi i kolateraleve të kaluara në pronësi të AMGKP-së, si dhe zbatimi i procedurave të shitjes së tyre	57-78
2.4	Saktësia dhe plotësia e dokumentimit të dosjeve të kredive, inventarizimi dhe arkivimi i tyre	78-89
2.5	Zbatimi i procedurave në planifikimin dhe realizimin e treguesve ekonomikë/buxheti. Përputhshmëria me dispozitat ligjore e nënligjore në kryerjen e shpenzimeve. Rakordimi dhe derdhja e të ardhurave nga arkëtimet e kredive	89-104
2.6	Përgatitja e pasqyrave financiare, miratimi dhe raportimi në organin drejtues	105-121
2.7	Zbatimi i procedurave të inventarizimit nga AMGKP	121-122
2.8	Të tjera	122-126
IV	REKOMANDIME	127-142

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i objektit të auditimit

Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerë është person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrit Përgjegjës për Financat dhe ushtron kompetencat bazuar në ligjin nr. 55/2023, datë 13.07.2023, “Për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyerë” dhe përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Nisur nga përcaktimet e pikës 3, nenit 17 të këtij ligji “Agjencia vijon të organizohet dhe të funksionojë sipas ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, i ndryshuar, deri në ristrukturimin e saj sipas nenit 3 të këtij ligji”, i cili përfundon brenda datës 01.01.2024”.

Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi 2021-2023, kjo agjenci ka vepruar si person juridik publik, në varësi të Ministrit të Financave, në zbatim të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar (këtu e në vijim Agjencia). Organet Drejtuese të Agjencisë kanë qenë Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria, duke patur për objekt: “trajtimin e kredive dhe asetëve të tjera, të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror... Agjencia e Trajtimit të Kredive, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë ligj, trajton edhe portofolin e investimeve të kryera në banesa nga shoqëria INSIG SHA, si dhe të asetëve të tjera, të transferuara me ligje të veçanta.”

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij

Rëndësia e auditimit të përputhshmërisë të Agjencisë për periudhën e aktivitetit 2021-2023, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, nisur nga roli i veçantë që kjo agjenci ka në fushën e trajtimit të kredive, asetëve të tjera, të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror, vlerësimin e portofolit të investimeve të kryera në banesa nga shoqëria INSIG SHA, si dhe të asetëve të tjera, të transferuara me ligje të veçanta.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi nivelin e përputhshmërisë të veprimtarisë së Agjencisë me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2021- 31.12.2023.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

-Veprimtaria dhe vendimmarrja e Drejtorit dhe Këshillit Mbikëqyrës të AMGKP-së.

-Zbatimi i procedurave për ndjekjen dhe mbledhjen e kredive, si dhe aplikimi i masave shtrënguese.

-Administrimi i kolateraleve të kaluara në pronësi të AMGKP-së, si dhe zbatimi i procedurave të shitjes së tyre.

-Saktësia dhe plotësia e dokumentimit të dosjeve të kredive, inventarizimi dhe arkivimi i tyre.

-Zbatimi i procedurave në planifikimin dhe realizimin e treguesve ekonomikë/buxheti. Përputhshmëria me dispozitat ligjore e nënligjore në kryerjen e shpenzimeve. Rakordimi dhe derdhja e të ardhurave nga arkëtimet e kredive.

-Përgatitja e pasqyrave financiare, miratimi dhe raportimi në organin drejtues.

-Zbatimi i procedurave të inventarizimit nga AMGKP.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut.

Në këtë auditim janë përzgjedhur metoda, metodologji apo teknika auditimi dhe shtrirje të procedurave të auditimit, për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

-*Intervistimi* - duke komunikuar dhe marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

-*Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;

-*Verifikimi në sistemet e Agjencisë* - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

-*Teknikat me ndihmën e kompjuterit* - për procedura të programuara, për të bërë testimet ose për nxjerrjen të të dhënave për testim të mëtejshëm;

-*Verifikim transaksionesh* – me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

-*Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

e. Paraqitja e gjetjeve kryesore

1. Katër nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës (përveç Kryetarit) kanë ushtruar këtë funksion 7 vite, pra 3 vite në tejkalim të afatit të përcaktuar ligjor. Nga Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë nuk janë bërë përpjekje për të përmbyllur procesin e kontrollit të llogarive vjetore të Agjencisë, por është mjaftuar vetëm me miratimin e zërit të shpenzimeve për audituesit të pavarur. Për periudhën objekt auditimi rezulton se llogaritë financiare janë audituar nga audituesi i pavarur me vonesë dhe për të tre vitet, prej tyre është refuzuar dhënia e opinionit. Këshilli nuk ka mbikëqyrur e kontrolluar përdorimin e fondeve financiare për shpenzimet operative dhe nuk ka raportuar asnjëherë pranë Këshillit të Ministrave. Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë nuk ka monitoruar në mënyrë efektive dhe as nuk ka vlerësuar risqet në lidhje me veprimtarinë e Agjencisë.

2. Sistemi elektronik i Kreditit nuk ofron një pasqyrim të saktë të kredive të trajtuara nga Agjencia, për shkak të mangësive në të dhëna të plotësuar ndër vite, prej mospërputhjeve të konstatuara me inventarizimin e vitit 2014 dhe mospërputhjeve në numër dhe vlerë të kredive; mangësi të trashëguara ndër vite nisur që nga momenti i marrjes në dorëzim.

3. Evidentohen 7,167 rekorde klienti pa asnjë të dhënë përveç emrit në fushën “*Emërtimi*” dhe Kodit të Klientit, pra rrjedhimisht pa asnjë të dhënë identifikuese (vendlindje, datëlindje dhe adresë), me pasoja në mundësinë e rikuperimit të huasë. Sistemi nuk ofron një pasqyrë të kolateraleve të debitorëve, më qëllim analizimin e tyre dhe marrjen e masave përkatëse nga Agjencia.

4. Veprimet lidhur me arkëtimet e debitorëve përpara vendosjes në punë të Sistemit, nuk janë të reflektuara në Sistem, por janë mbajtur në një dokument Excel. Kreditë e transferuara nga Banka

Bujqësore për Zhvillim nuk rezultojnë të pasqyruara në Sistemin e Kreditit, por mbahen në llogari më vete në format Excel ku evidentohen 1,462 raste kredie në vlerën 16,382,187 lekë.

5. Agjencia nuk disponon një listë me të dhëna për pasuritë e lëna si kolateral në momentin e marrjes së kredisë, për të evidentuar vlerën e tyre dhe ndryshimet gjatë viteve.

6. Ekzistojnë sëpaku 12 pasuri të paluajtshme¹ për të cilat mungon certifikata e pronësisë dhe si urdhri i kontabilizimit, rrjedhimisht përfaqësojnë pasuri të paluajtshme të pakontabilizuara.

7. Për 21 prona të kontabilizuara nuk disponohet certifikatë pronësie nga Agjencia, duke ndikuar potencialisht në tjetërsimin e pronës dhe duke pamundësuar shitjen e pronës në ankand.

8. Nga Agjencia nuk janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me të gjitha institucionet e përcaktuara në pikën 1, neni 10, të ligjit nr. 8894/2022, i ndryshuar. Në lidhje me marrëveshjet e lidhura me BSH, DPT, Zyra Qendrore e Pasurive të Paluajtshme nuk janë ezauruar plotësisht përcaktimet e klauzolave të tyre të lidhura kryesisht me trajtimin e listës së plotë të debitorëve dhe si rrjedhojë nuk kanë dhënë efektet pozitive të pritshme;

9. Llogaria “të drejta të arkëtueshme”, nuk paraqitet në mënyrë analitike, për rrjedhojë paraqitja e të drejtave të arkëtueshme në kontabilitet është jo i plotë dhe nuk përmbush pohimet e “saktësisë”, “plotësisë”, “klasifikimit dhe identifikimit”.

10. Detyrimet ndaj KFŴ zënë 99% të totalit të detyrimeve dhe gjendja në fund e tij, nga viti 2021 deri në vitin 2023 ka pësuar rritje të konsiderueshme përkatësisht, në vitin 2021 paraqitet në shumën 1,809,242 Euro, në vitin 2022 paraqitet në shumën 2,013,983 Euro dhe në vitin 2023 paraqitet në shumën 2,210,455 Euro.

11. Kalimi i kompetencave te Agjencia *“për ndjekjen dhe administrimin e garancisë shtetërore të huasë me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve që tregtojnë me shumicë produkte ushqimore bazë për të mundësuar financimin e nevojshme për mbajtjen e rezervave”*, përpara miratimit të ligjit nr. 55/2023 datë 13.07.2023, është në kundërshtim me nenin 40 të ligjit nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar dhe ligjin nr. 8894 datë 14.05.2002 i ndryshuar.

12. Gjatë aktivitetit të saj për tre vitet objekt auditimi Agjencia nuk ka zbatuar nenin 22, pika 2 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2022 *“Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”*, i ndryshuar, pasi ka mbajtur në llogaritë e veta fonde më shumë se ¼ e buxhetit operativ vjetor të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës. Nga të dhënat rezulton se për vitin 2021 Agjencia ka derdhur në buxhetin e shtetit vlerën prej 20,457 mijë lekë dhe ka mbajtur për përdorim 74% të arkëtimit vjetor; për vitin 2022 ka derdhur në buxhetin e shtetit vlerën prej 31,871 mijë lekë dhe ka mbajtur për përdorim 49%, si dhe për vitin 2023 ka derdhur në buxhetin e shtetit vlerën prej 29,835 mijë lekë dhe ka mbajtur për përdorim 62%, duke ndikuar ndjeshëm në nivelin e arkëtimit në buxhet.

f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore

1. Nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë, në kuadër të ndryshimeve ligjore që ka pësuar Agjencia, të vlerësohen problematikat e evidentuara dhe të merren masa me qëllim shmangien e këtyre mangësive, në funksion të përmirësimit të punës në të ardhmen.

2. Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera të marrë masa për ngritjen e një grupi pune i cili të analizojë mospërputhjet e evidentuara në Sistemin e Kreditit, si dhe të saktësojë këto të dhëna, duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse si ASHK/Gjendja Civile dhe kryqëzuar me dosjet fizike, me qëllim pasqyrimin e të dhënave të plota dhe të sakta, në funksion të përmirësimit të punës në vjeljen e kredive.

¹ Për 9 pasuri të paluajtshme disponohet Vendimi i Kalimit të Pronësisë duke përcaktuar dhe vlerë të pronës referuar ankandit të fundit, ndërsa për 3 prona të tjera, nuk disponohet Vendimi apo vlera e tyre.

3. Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, i cili të konfirmojë dhe plotësojë të dhënat e munguara në Sistemin e Kreditit, përfshirë dhe ato që mbahen jashtë sistemit, duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse si ASHK/Gjendja Civile/Banka e Shqipërisë etj., me qëllim pasqyrimin e të dhënave të plota dhe të sakta, në funksion të rritjes së efektivitetit të saj në vjeljen e detyrimeve debitore.

4. Drejtori i Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim (i) evidentimin e pasurive të lëna si kolateral përmes informacionit që disponon Agjencia ndër vite dhe bashkëpunimit institucional me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, si dhe (ii) zhvillimin e një analize kosto-përfitim për vlerësimin e këtyre kolateraleve, me qëllim rritjen e nivelit të rikuperimit të kredive.

5. Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera të marrë masa për nxjerrjen e certifikatave të pronësisë në ASHK dhe të urdhrave të kontabilizimit për 12 pasuritë e paluajtshme të cituara në këtë auditim, me qëllim pasqyrimin e tyre në llogaritë e pasqyrave financiare të Agjencisë dhe më pas ndjekjen e procedurave të mundshme të ankandit.

6. Nga ana e Sektorit të Financës në AMGKP në bashkëpunim me strukturat përkatëse, të merren masa për verifikimin e gjendjes reale dhe statusin e pronave dhe asetëve të mbajtura për shitje, të kryejë inventarizimin si edhe regjistrimin e të gjitha pronave në ASHK, duke përgatitur të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor, më pas vlerësimin e tyre, kontabilizimin në vlerë të plotë dhe pasqyrimin në aktivet e pasqyrave financiare.

7. Drejtorja e Menaxhimit të Garancive Shtetërore, huave dhe nënhuave dhe trajtimit të kredive të marrë masa për përditësimin e të dhënave mbi SHPK që rezultojnë debitore, për personat që kanë ndërruar jetë dhe vlerësimin rast pas rasti mbi mundësitë e arkëtimit nga shpallja e falimentit dhe çelja e trashëgimisë.

8. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera të marrë masa për rishikimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve ekzistuese si dhe me të gjitha institucionet e tjera që lehtësojnë marrjen e informacionit, me qëllim rritjen e bashkëpunimit në menaxhimin e garancive dhe rritjen e arkëtimit nga kreditë e pakthyera.

9. Nga ana e Sektorit të Financës, të merren masa për evidentimin dhe pasqyrimin e plotë dhe regjistrimin kontabël të të gjithë debitorëve mbi të cilët ka lindur detyrimi ndaj AMGKP-së, ku të përshkruhen në mënyrë të detajuar, principali i detyrimit, interesat e akumuluar përgjatë viteve si edhe çdo shpenzim tjetër, në mënyrë të tillë që të plotësohen parimet e saktësisë, plotësisë, klasifikimit dhe identifikimit.

10. -Nga ana e Sektorit të Financës në AMGKP, të merren masa për riklasifikimin e detyrimit që ka Agjencia ndaj KFÛ si detyrim afatgjatë në Pasqyrat Financiare si dhe të merren masa që shuma e plotë e detyrimit ndaj KFÛ të regjistrohet në Klasën e Pasiveve Afatgjata llogaria “Huatë Afatgjata”.

-Nga ana e Sektorit të Financës dhe Strukturave Drejtuese në AMGKP, të merren masat e nevojshme për shlyerjen e detyrimit ndaj MFE-së sipas kushteve dhe afateve të marrëveshjeve me KFÛ-në, duke paguar principalin dhe interesat në kohën e maturimit të tyre me qëllim shmangien e fenomenit të pagesave pjesore të detyrimit.

11. -Ministria e Financave, të marrë masa për vlerësimin e problematikave të konstatuara në lidhje me VKM nr. 349, datë 26.05.2022 dhe kalimin e kompetencave Agjencisë, me qëllim shmangien e riskut për detyrime të mundshme në të ardhmen.

-Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të marrin masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim identifikimin dhe raportimin e përfituesve të garancisë që rezultojnë jo të rregullt në likuidimin e detyrimeve.

12. Nga Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerë të analizohen dhe të nxirren përgjegjësitë për mos realizimin e të ardhurave përgjatë tre viteve si dhe mos derdhjen e tyre në Buxhetin e Shtetit në masën e përcaktuar në ligj.

Konkluzion dhe Opinioni i auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerë (këtu dhe në vijim “Agjencia”), për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve mbi të cilat kjo strukturë realizon misionin e saj. Gjatë auditimit në terren janë marrë të dhëna, dokumentacion dhe evidenca të mjaftueshme, të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kundërt mbi auditimin e përputhshmërisë²

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion, në veprimtarinë e Agjencisë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale cilësore dhe të përhapura që justifikojnë dhënien e një opinionit të kundërt.

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë

Nga evidencat e marra dhe të shqyrtuara për veprimtarinë e Agjencisë për periudhën 01.01.2021-31.12.2023, kanë rezultuar problematikat si në vijim:

-Katër nga pesë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës (përveç Kryetarit) kanë ushtruar këtë funksion 7 vite, pra në tejkallim të afatit 3-vjeçar të përcaktuar në pikën 1 të nenit 12, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive” të ndryshuar;

-Nga Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë nuk janë bërë përpjekje për të përmbyllur procesin e kontrollit të llogarive vjetore të Agjencisë, por është mjaftuar vetëm me miratimin e zërit të shpenzimeve për audituesit të pavarur, në kundërshtim me pikën “e” të nenit 14, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar. Llogaritë financiare janë audituar për të tre vitet me vonesë nga audituesi i pavarur dhe për secilin vit, është refuzuar dhënia e opinionit prej tyre.

-Këshilli Mbikëqyrës nuk ka mbikëqyrur e kontrolluar përdorimin e fondeve financiare për shpenzimet operative, në kundërshtim me pikën “f” të nenit 14, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar, si dhe nuk ka monitoruar në mënyrë efektive dhe as nuk ka vlerësuar risqet në lidhje me veprimtarinë e Agjencisë, në kundërshtim me pikën 2/c neni 14, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, i ndryshuar,

- Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë, për periudhën objekt auditimi nuk ka raportuar asnjëherë pranë Këshillit të Ministrave, në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar;

- Sistemi elektronik i Kreditit nuk ofron një pasqyrim të saktë të kredive të trajtuara nga Agjencia, për shkak të mangësive në të dhëna të plotësuar ndër vite, prej mospërputhjeve në

² Opinion i kundërt mbi auditimin e përputhshmërisë: *Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura.*

numër dhe vlerë të kredive të konstatuara me inventarizimin e vitit 2014; mangësi të trashëguara ndër vite nisur që nga momenti i marrjes në dorëzim etj.;

- Evidentohen 7,167 rekorde klienti pa asnjë të dhënë tjetër përveç emrit në fushën “*Emërtimi*” dhe Kodit të Klientit, pra rrjedhimisht pa asnjë të dhënë identifikuese (vendlindje, datëlindje dhe adresë), me pasoja në mundësinë e rikuperimit të huasë për këto raste;

- Sistemi nuk ofron një pasqyrë të kolateraleve të debitorëve, më qëllim analizimin e tyre dhe marrjen e masave përkatëse nga Agjencia në funksion të rikuperimit të huave. Për më tepër Agjencia nuk disponon një listë me të dhëna për pasuritë e lëna si kolateral në momentin e marrjes së kredisë, për të evidentuar vlerën e tyre dhe ndryshimet gjatë viteve;

- Veprimet lidhur me arkëtimet e debitorëve përpara vendosjes në punë të Sistemit më 01.01.2004, nuk janë të reflektuara në Sistem, por janë mbajtur në një dokument Excel, duke humbur qartësinë dhe saktësinë e vlerave, me pasoja në veprimtarinë e Agjencisë;

- Kreditë e transferuara nga Banka Bujqësore për Zhvillim nuk rezultojnë të pasqyruara në Sistemin e Kreditit, por mbahen në llogari më vete në format Excel ku evidentohen 1,462 raste kredie në vlerën 16,382,187 lekë, duke vështirësuar mundësimin e një linje të qartë në arkëtime apo veprime të tjera të kryera nga debitorët përpara dhe pas implementimit të Sistemit;

- Ekzistojnë së paku 12 pasuri të paluajtshme³ për të cilat mungon certifikata e pronësisë, si dhe urdhri i kontabilizimit, rrjedhimisht përfaqësojnë pasuri të paluajtshme të pa kontabilizuara. Referuar të dhënave për pasuri të paluajtshme për të cilat është vënë në dispozicion të grupit të auditimit vendimi i kalimit të pronësisë, vlera e pa kontabilizuar e këtyre pasurive përlllogaritet në 6,284,800 lekë.

- Për 21 prona të kontabilizuara nuk disponohet certifikatë pronësie nga Agjencia, duke ndikuar potencialisht në tjetërsimin e pronës dhe duke pamundësuar shitjen e pronës në ankand;

- Masat e marra nga ATK dhe komunikimet me institucionet e tjera nuk kanë qenë të mjaftueshme, ezauruese dhe të trajtuara në kohë me qëllim evidentimin, parandalimin e tjetërsimit të pasurive dhe uljen e riskut të pamundësisë për vjeljen e detyrimit, në kundërshtim me nenin 5 dhe 6 të ligjit nr. 8894/2022, i ndryshuar.

- Nga Agjencia nuk janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me të gjitha institucionet e përcaktuara në pikën 1, neni 10, të ligjit nr. 8894/2022, i ndryshuar. Në lidhje me marrëveshjet e lidhura me BSH, DPT, Zyra Qendrore e Pasurive të Paluajtshme nuk janë ezauruar plotësisht përcaktimet e klauzolave të tyre të lidhura kryesisht me trajtimin e listës së plotë të debitorëve dhe si rrjedhojë nuk kanë dhënë efektet pozitive të pritshme;

- Llogaria “të drejta të arkëtueshme”, nuk paraqitet në mënyrë analitike, për rrjedhojë paraqitja e të drejtave të arkëtueshme në kontabilitet nuk është e plotë dhe nuk përmbush pohimet e “saktësisë”, “plotësisë”, “klasifikimit dhe identifikimit”;

- Detyrimet ndaj KFW zënë 99% të totalit të detyrimeve dhe gjendja në fund e tij, nga viti 2021 deri në vitin 2023 ka pësuar rritje të konsiderueshme përkatësisht, në vitin 2021 paraqitet në shumën 1,809,242 Euro, në vitin 2022 paraqitet në shumën 2,013,983 Euro dhe në vitin 2023 paraqitet në shumën 2,210,455 Euro.

- Kalimi i kompetencave të Agjencia “*Për ndjekjen dhe administrimin e garancisë shtetërore të huasë me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve që tregtojnë me shumicë produkte ushqimore bazë për të mundësuar financimin e nevojshëm për mbajtjen e rezervave*”, para miratimit të ligjit nr. 55/2023, datë 13.07.2023 “*Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyer*”, është në kundërshtim me nenin 40 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006,

³ Për 9 pasuri të paluajtshme disponohet Vendimi i Kalimit të Pronësisë duke përcaktuar dhe vlerë të pronës referuar ankandit të fundit, ndërsa për 3 prona të tjera, nuk disponohet Vendimi apo vlera e tyre.

“Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjin nr. 8894, datë 14.05.2002 i ndryshuar.

- Gjatë aktivitetit të saj për tre vitet objekt auditimi Agjencia nuk ka zbatuar nenin 22, pika 2 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2022 i ndryshuar, pasi ka mbajtur në llogaritë e veta fonde më shumë se ¼ e buxhetit operativ vjetor të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës. Nga të dhënat rezultojnë se për vitin 2021 Agjencia ka derdhur në buxhetin e shtetit vlerën prej 20,457 mijë lekë dhe ka mbajtur për përdorim 74% të arkëttimeve vjetore; për vitin 2022 ka derdhur në buxhetin e shtetit vlerën prej 31,871 mijë lekë dhe ka mbajtur për përdorim 49%, si dhe për vitin 2023 ka derdhur në buxhetin e shtetit vlerën prej 29,835 mijë lekë dhe ka mbajtur për përdorim 62%, duke ndikuar ndjeshëm në nivelin e arkëttimeve në buxhet.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 185/1 prot., datë 09.02.2024, i miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 12.02.2024 deri në datë 03.05.2024, në Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera (këtu e në vijim Agjencia), u krye auditimi mbi përputhshmërinë e aktivitetit për periudhën nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2023, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. E.H, Përgjegjëse Grupi,
2. A.H, Auditues,
3. Xh.N, Audituese,
4. K.N, Audituese,
5. M.V, Audituese.

1. Objektivat dhe qëllimi

Objektivi i auditimit është arritja e një konkluzioni dhe dhënia e opinionit nëse aktiviteti i zhvilluar në Agjenci është në përputhje ose jo me dispozitat ligjore, nënligjore dhe rregullatorë përkatëse. Qëllimi i auditimit është vlerësimi i funksionimit të sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga Agjencia gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi, vlerësimi objektiv i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi në lidhje me administrimin e kredive, asetëve të tjera, të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror, të kjo agjenci, vlerësimin e portofolit të investimeve të kryera në banesa nga shoqëria INSIG SHA, si dhe të asetëve të tjera, të transferuara me ligje të veçanta, vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve financiare, çështjeve që lidhen me organizimin dhe funksionimin e agjencisë etj. Mbi bazën e akt-konstatimeve, diskutimeve me zyrtarët e subjektit të audituar, vërejtjeve dhe sugjerimeve në takimin përmbyllës në terren, observacioneve të sjella hartohet Raporti Përfundimtar i Auditimit.

2. Identifikimi i çështjes

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 “*Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi*”.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë nëse veprimtaria e Agjencisë lidhur me administrimin e kredive, asetëve të tjera, të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht

shtetëror, te kjo agjenci, vlerësimin e portofolit të investimeve të kryera në banesa nga shoqëria INSIG SHA, si dhe të aseteve të tjera, të transferuara me ligje të veçanta, është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e riskut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë e Agjencisë.

3. Përgjegjësia e Drejtimit për Përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi:

Për periudhën objekt auditimi, Organet Drejtuese të Agjencisë kanë qenë Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria.

Organet drejtuese përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësisve publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), për fushat e veprimtarisë së Agjencisë.

Për periudhën objekt auditimi 2021-2023, kjo agjenci ka vepruar si person juridik publik, në varësi të Ministrit të Financave, në zbatim të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar (këtu e në vijim Agjencia). Organet Drejtuese të Agjencisë kanë qenë Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria, duke patur për objekt: *“trajtimin e kredive dhe aseteve të tjera, të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror... Agjencia e Trajtimit të Kredive, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë ligj, trajton edhe portofolin e investimeve të kryera në banesa nga shoqëria INSIG SHA, si dhe të aseteve të tjera, të transferuara me ligje të veçanta”*. Këshilli Mbikëqyrës ndër të tjera ka kompetencë miratimit e buxhetit vjetor të Agjencisë, mbikëqyrjen e përdorimit të fondeve financiare për shpenzimet operative dhe është përgjegjës në marrjen e vendimeve për përmbushjen e detyrimeve.

Drejtoria e Agjencisë është përgjegjëse për: ushtrimin e funksioneve të ngarkuara me këtë ligj, nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e tjera, në zbatim të dispozitave të këtij ligji, kryerjen e detyrave të tjera që dalin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Agjencisë, në përputhje me aktet nënligjore.

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e

veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafi 44-51.

Përveç standardeve të ISSAI, ne aplikuar edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Gjithashtu ne: Identifikuam dhe përpunuam riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikuam, realizuam procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, dhe grumbulluam evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë.

Krijuar një konkluzion final nëse çështjet rutinë të raportimit të të dhënave janë kryer në mënyrën e duhur dhe u bazuar në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çonin në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht.

Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.

Ne komunikuar me drejtuesin ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë, përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që identifikuam gjatë auditimit tonë.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

-Ligji nr. 8894, datë 14.05.2002 "*Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive*", i ndryshuar;

-Ligji nr. 55, datë 13.07.2023 "*Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera*";

-Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për arkivat*";

-Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*";

-Ligji nr. 25, datë 11.05.2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*";

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar;

-Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 "*Për ankandin publik*", i ndryshuar;

-VKM nr. 450, datë 16.06.2010 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 681, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror, në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, për kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive, të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfi-teozë të këtyre pasurive"*;

-VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

-VKM nr. 723, datë 19.12.2023 "*Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera*".

-VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 "*Për miratimin e rregullave të ankandit publik*", i ndryshuar.

-Udhëzimi nr. 33 datë 24.09.2010 "*Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna*

si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfitozë të këtyre pasurive.”

-Rregullore e funksionimit të brendshëm të Agjencisë së Trajtit të Kredive, miratuar me Vendimin nr. 83 të Këshillit Mbikëqyrës, datë 01.10.2019, e ndryshuar me Vendimin nr. 873, datë 08.03.2022;

- Të tjera akte ligjore dhe nënligjore rregullative që lidhen me objektin e veprimtarisë së njësive të audituar.

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë “Parimet INTOSAI-t” ku përfshihet: ISSAI-P-1 “Deklarata e Limës”, ISSAI-P-10 “Deklarata e Meksikos”; Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t” ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik; ISSAI 200-299 “Parimet bazë të auditimit financiar”, ISSAI 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”.

Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:

ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë”

ISSAI 130 “Kodin Etik”

ISSAI 2315 “Risku”

ISSAI 2320-2450 “Materialiteti”

ISSAI 2500 “Dokumentimi”

7. Metodatat e auditimit

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

-*Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

-*Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël si mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

-*Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

-*Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit të subjektit që auditohet.

-*Raportet dhe informacionet* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

-*Pyetësorët* - grupi i auditimit ka përdorur pyetësor për vlerësimin dhe testimin e drejtimeve të auditimit.

-*Verifikimi në sistemet e Agjencisë* - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

-*Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

8. Dokumentimi i auditimit

Është mbështetur në kërkesat e Manualit të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerë është person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrisë Përgjegjëse për Financat dhe ushtron kompetencat bazuar në ligjin nr. 55/2023, datë 13.07.2023, “Për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyerë”.

Aktualisht kjo Agjenci përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe ka si funksion:

a) *menaxhimin e skemave të veçanta të garancive të huas;*

b) *kthimin e garancive shtetërore të huas;*

c) *kthimin e huave dhe nënhuave të garantuara nga ministri përgjegjës për financat;*

ç) *verifikimin e aftësisë pagese të subjekteve huamarrëse për të cilat është kryer pagesa e garancisë në secilën prej skemave të garancive të miratuara, huave dhe nënhuave, të garantuara nga ministri përgjegjës për financat;*

d) *trajtimin e kredive të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror pas privatizimit të tyre;*

dh) *trajtimin e portofolit të investimeve të kryera në banesa nga shoqëria I SHA., para privatizimit të saj.*

Për periudhën objekt auditimi 2021-2023, kjo agjenci ka vepruar si person juridik publik, në varësi të Ministrisë të Financave, në zbatim të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar. Kjo pasi sipas pikës 3, neni 17 të ligjit nr. 55/2023, deri në datën 01.01.2024 Agjencia vijon në proces ristrukturimi dhe organizimi/funksionimi i saj sipas ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, i ndryshuar.

Agjencia përfaqësohet nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtorja, duke patur për objekt: “*trajtimin e kredive dhe asetëve të tjera, të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror... Agjencia e Trajtimit të Kredive, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë ligj, trajton edhe portofolin e investimeve të kryera në banesa nga shoqëria I SHA, si dhe të asetëve të tjera, të transferuara me ligje të veçanta.*”

Auditimi i zhvilluar në Agjenci paraqitet me rëndësi në planet e auditimit të KLSH-së, për rolin e veçantë që ky institucion ka në fushën e administrimit të kredive, asetëve të tjera, të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror, të kjo agjenci, vlerësimin e portofolit të investimeve të kryera në banesa nga shoqëria I SHA, si dhe të asetëve të tjera, të transferuara me ligje të veçanta, si rrjedhojë edhe në buxhetin e shtetit nisur nga arkëtimet e pritshme pasi sipas pikës 1, të nenit 22, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, i ndryshuar, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, të gjitha fondet e mbajtura ose të arkëtuara nga Agjencia derdhen në favor të Buxhetit të Shtetit brenda datës 5 të muajit pasardhës.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve:

2.1 Veprimtaria dhe vendim-marrja e Drejtorisë dhe Këshillit Mbikëqyrës të AMGKP-së.

a) Mbi veprimtarinë e Këshillit Mbikëqyrës.

Viti 2021

Përgjatë vitit 2021 Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë-së ka pasur në përbërje të tij 5 anëtarë si më poshtë:

Tabela nr.1 “Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë për vitin 2021”

Nr. rendor	Emër Mbiemër	Pozicioni	Emërimi sipas:
1	O.M	Kryetar	Urdhrit nr.212, datë 08.09.2020 të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave
2	D.D	Nënkryetar	Gubernatorit të BSH, me anë të shkresës nr. 3073, datë 08.05.2015.
3	G.O	Anëtar	VKM nr.29, datë 22.01.2014
4	K.M	Anëtar	VKM nr.29, të KM, datë 22.01.2014
5	E.L	Anëtar	VKM nr.29, të KM, datë 22.01.2014

Burimi: AMGKP, përpunuar nga Grupi i Auditimit të KLSH-së.

Nga tabela më sipër rezulton përbërja e Këshillit Mbikëqyrës, për vitin 2021 ka qenë në përputhje pikën 1 dhe 3, të nenit 12, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 “Për agjencinë e trajtimit të kredive”, të ndryshuar. Gjithashtu për sa i përket kriterëve profesionale të anëtarëve, ato rezultojnë të plotësohen nga anëtarët e Këshillit. Në lidhje më përbërjen e tij rezultoi se:

- Përbëhet nga 5 anëtarë;
- Një anëtar i caktuar nga Banka e Shqipërisë z. D.D, në cilësinë e zëvendës kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës;
- Tre anëtare të caktuar nga Këshilli i Ministrave z. G.O; znj. K.M dhe znj. E.L dhe;
- z. O.M i emëruar me anë të Urdhrit nr. 212, datë 08.09.2020 të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës, në përputhje me pikën 3 të nenit 12 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Anëtari i emëruar nga Ministri i Financave ka cilësinë e Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës, ndërsa anëtari i emëruar nga Banka e Shqipërisë ka cilësinë e zëvendës kryetarit të këtij Këshilli”.

Katër nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës (përveç Kryetarit) kanë ushtruar këtë funksion, prej katër vitesh, në kundërshtim me afatin e përcaktuar në pikën 1 të nenit 12, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës caktohen për një periudhë kohore 3 vjeçare”.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë me anë të shkresës nr. 4596, datë 18.07.2018 ka njoftuar Ministrin e Financave dhe Ekonomisë (MFE) z. A.A për përfundimin e afatit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, por nga ana e MFE-së nuk ka pasur përgjigje. Në lidhje afatin e përfundimit të mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës ligji nr. 8894, datë 14.05.2002, nuk parashikon si duhet të veprohet, nga ana e institucioneve, përgjegjëse për përzgjedhjen dhe emërimin e tyre.

Gjatë vitit 2021, Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë është mbledhur 13 herë, frekuencë kjo në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr.8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mbahen në selinë e Agjencisë të paktën 1 herë në muaj...*”. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës janë thirrur në të gjitha rastet nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës dhe rendi i ditës është caktuar nga ky i fundit, kjo në zbatim të pikave 1 dhe 3 të nenit 13 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar. Praktika e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës përmban njoftimin e thirrjes së mbledhjes, dërguar anëtarëve të Këshillit së bashku me rendin e ditës, procesverbalin e mbledhjeve dhe materialet e diskutuara në mbledhje.

Sipas procesverbaleve të mbledhjeve, prezenca në mbledhje ka qenë 100% nga anëtarët e Këshillit dhe me praninë e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë ose zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm, në rastet kur Drejtori i Përgjithshëm ka qenë me leje. Të gjitha mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli nuk janë kryer në selinë e Agjencisë, por në ambientet e MFE-së, kjo në kundërshtim me pikën 1 të nenit 13, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar, ku citohet se: “*Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mbahen në selinë e Agjencisë ...*”.

Përgjatë vitit 2021 Këshilli Mbikëqyrës nuk ka raportuar asnjëherë pranë Këshillit të Ministrave, në kundërshtim me nenin 14 të ligjit të sipërcituar, ku përcaktohet se: “Këshilli Mbikëqyrës raporton me shkrim çdo 6 muaj përpara Këshillit të Ministrave.”

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2021 nga Këshilli Mbikëqyrës janë marrë 14 vendime, 9 prej të cilave, të marra prej muajit Qershor 2021 nuk kanë të përcaktuar numrin e vendimit, ndryshe nga praktika e muajve janar-maj 2021 dhe e periudhës 2022 e 2023, ku vendimet e Këshillit kanë të përcaktuar numrin e vendimit, sipas shpjegimeve të dhëna nga subjekti, në atë periudhë Agjencia ka qenë subjekt kontrolli nga Drejtoria e Arkivave.

Gjithashtu gjatë vitit 2021, vendimet e datave: 24.03.2021; 26.03.2021; 04.06.2021; 02.08.2021; 15.09.2021, 01.11.2021 nuk rezultojnë me praktika të mbledhjeve të zhvilluara nga Këshilli Mbikëqyrës, kjo në kundërshtim me pikën 4 të nenit 13, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Këshilli Mbikëqyrës i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të votimeve të anëtarëve...*”, për vendimet më sipër nuk rezulton ndonjë procesverbal për zbardhjen e mbledhjes.

Nga procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës për vitin 2021 rezulton të jenë trajtuar e diskutuar mbi çështjet në vijim: Prezantimi i raportit të veprimtarisë për muajin paraardhës, ku çdo muaj nga Drejtori i Përgjithshëm është prezantuar realizimi dhe objektivat e pritshme për muajin pasues, janë firmosur kontrata individuale në lidhje me emërimet e anëtarëve të Drejtorisë, është raportuar nga Drejtori i Përgjithshëm mbi veprimtarinë vjetore, çështje, të cilat janë brenda kompetencave të Këshillit Mbikëqyrës, të Agjencisë.

Në mbledhjen e datës 30.03.2021 Drejtori i Përgjithshëm ka njoftuar Këshillin Mbikëqyrës, se Pasqyrat Financiare të vitit 2020 nuk mund të mbylleshin brenda datë 31.03.2021. Arsyet e dhëna nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë janë:

- *Përgjegjësi i Financës ka marrë detyrën në fund të muajit Dhjetor 2020;*
- *Kryerja e inventarizimit;*
- *Mungesa 3 javore e stafit të punës për arsye shëndetësore (Covid 19)*
- *Dorëzimi me vonesë i raportit të auditimit të vitit 2019 (të një viti më parë) nga eksperti për arsye shëndetësore (covid 19),*

Në mbledhjen e datës 26.04.2021 janë miratuar në mënyrë unanime, treguesit financiar dhe Bilanci Kontabël i vitit 2020.

Në mbledhjen e datës 04.06.2021 është kërkuar nga anëtarja e Këshillit Mbikëqyrës znj. K.M ndryshimi i ligjit të Agjencisë dhe rishikimi rolit të Këshillit Mbikëqyrës.

Në mbledhjen e datës 02.07.2021 nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë është kërkuar shtesë buxheti për marrjen e ambienteve me qira, për transferimin e ish zyrove Rajonale Tiranë dhe Kavajë, por nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk është miratuar, pasi është kërkuar informacion më i detajuar në mbledhjen e radhës, shtesa e buxhetit është miratuar nga Këshilli në mbledhjen e datës 03.08.2021, pas vënies në dispozicion nga Drejtori i Përgjithshëm, të relacionit përkatës për anëtarët e Këshillit.

Në mbledhjen e datës 28.12.2021 në rendin e ditës ka qenë miratimi i Projekt Buxhetit, për vitin 2022, relacioni përkatës është vënë në dispozicion të Këshillit nga Drejtori i Përgjithshëm, të cilët e kanë miratuar me anë të vendimit nr. 6458/4 prot., datë 28.12.2021, sipas këtij vendimi plani arkëtimeve të parashikuara është në masën 90,000,000 lekë dhe plani i shpenzimeve në masën 51,783,000 lekë. Gjithashtu në këtë mbledhje është miratuar dhe shtesa e pagës për punonjësit e Agjencisë, për mbështetje për rezultate të arritura në punë. Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 6458/6 prot., datë 28.12.2021 është vendosur dhënia e shpërblimit në masën ½ e pagës për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe të gjithë punonjësit e Agjencisë përveç specialistes së Sektorit Juridik dhe Operacional znj. A.Z, që do të shpërblehet me një pagë mujore, si rrjedhojë e performancës në punë.

Nga sa më sipër konstatohet se, Këshilli Mbikëqyrës ka ushtruar pjesërisht kompetencat e tij ligjore. Konkretisht për vitin 2021 nuk është siguruar që llogaritë financiare të Agjencisë të kontrollohen nga një ekspert i jashtëm, në kundërshtim me pikën 2/e të nenit 14 të ligjit nr. 8894, datë 22.05.2002, që përcakton: *“Siguron që llogaritë financiare të Agjencisë të kontrollohen jo më pak se 1 herë në vit nga një ekspert kontabël i licencuar. Siguron gjithashtu që kontrollat të kryhen në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të kontroll-revizionit”*.

Gjithashtu, rezulton se Këshilli Mbikëqyrës nuk ka ndërmarrë veprime në lidhje me monitorimin e përdorimit të buxhetit, në kundërshtim me pikën 2/f të nenit 14 të ligjit nr. 8994, datë 22.05.2002, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Këshilli miraton buxhetin vjetor të Agjencisë dhe mbikëqyr përdorimin e fondeve financiare për shpenzimet operative”*. Roli i Këshillit Mbikëqyrës, nuk ka qenë aktiv në drejtim të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara me ligji, por është mjaftuar me konfirmimet e bëra ndaj propozimeve/veprimeve të Drejtorisë.

Gjatë vitit 2021 nga Këshilli Mbikëqyrës janë marrë 14 vendime, të cilat janë në përputhje kompetencat e tij, të përcaktuara në nënparagraf a-h, të pikës 2 të nenit 14, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar.

Për vitin 2022

Në vitin 2022, përbërja e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë ka ndryshuar si më poshtë:

Me anë të Urdhrit nr. 75, datë 24.02.2022 të Ministres së Ekonomisë dhe Financave është liruar nga detyra kryetari i Këshillit Mbikëqyrës z. O.M dhe është emëruar znj. O.M, e cila ka kryesuar mbledhjet prej datës së urdhrat të sipërcituar. Pjesa tjetër e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës nuk ka ndryshuar, duke vijuar të jenë në funksionet e anëtarëve, në tejkalim të afatit të përcaktuar në pikën 1, të nenit 12 të ligjit nr. 8894, datë 15.04.2002 *“Për ATK”*, të ndryshuar.

Përgjatë vitit 2022, Këshilli Mbikëqyrës nuk ka raportuar asnjëherë pranë Këshillit të Ministrave, kjo në kundërshtim me nenin 14 të ligjit të sipërcituar, ku përcaktohet se: *“Këshilli Mbikëqyrës raporton me shkrim çdo 6 muaj përpara Këshillit të Ministrave.”*

Nga procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës për vitin 2022 rezulton të jenë trajtuar e diskutuar mbi çështjet në vijim: Në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës në përgjithësi është diskutuar në lidhje me raportin e veprimtarisë për muajin paraardhës dhe objektivat e strategjitë për muajin

në vijim, janë marrë vendime në lidhje me miratimin e kontratave, emërimet/lirimet nga detyra të anëtarëve të Drejtorisë.

Në mbledhjen e datës 25.02.2022 është kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë miratimi i një shtese buxheti për zërin “Shpenzime qiraje” në lidhje me shpenzimet e parashikuara për zhvendosjen e zyrave, ku shuma e parashikuar e qirasë është në vlerën 4,400, 000 lekë për 9 muaj dhe 1,500,000 lekë për sistemimin e ambienteve të zyrave. Nga Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë kërkuar gjithashtu sqarime përse është e nevojshme rritja e shpenzimeve për programin kompjuterik (software) dhe argumentimi i Drejtorit të Përgjithshëm, për këtë ka qenë si më poshtë: *“Shtesa prej 2,600,000 lekë, përpos mirëmbajtjes dhe “upgrade” të tij me qëllim përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit të punës, do të bëhet dhe ndërtimi i një “web service” (lidhja ndërmjet ATK-së dhe DPGJC) për marrjen e të dhënave nga Gjendja Civile (MB) në kohë reale për të mos hasur pengesa në update-imin e të dhënave për një periudhë 2 vjeçare”.*

Nga verifikimi në lidhje me këtë update të sistemit, rezultoi se nga Agjencia është kërkuar upgrade i sistemit, për shkëmbimin e të dhënave me Zyrat e Gjendjes Civile, por paraprakisht mungon një marrëveshje bashkëpunimi mes këtyre dy institucioneve, por thjesht ka pasur shkëmbim të informacioneve mes tyre.

Nga Këshilli Mbikëqyrës është miratuar shtesa në buxhet dhe gjithashtu ndryshimi në strukturën organizative të Agjencisë, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm, me anë të vendimeve:

-Vendimi nr. 2 datë 25.02.2022 *“Mbi miratimin e ndryshimit të strukturës organizative për vitin 2022”;*

-Vendimi nr. 3, datë 25.02.2022 *“Për miratimin shtesë Buxheti të Agjencisë së Trajtimit të Kredive për vitin 2022”*, ku është miratuar shtesa e buxhetit në shumën 17,955,000 lekë. Nga auditimi rezultoi se shtesa e buxhetit nuk është argumentuar në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës për çdo zë por vetëm për shpenzimeve të qirasë, restaurimin e ambienteve të zyrave dhe upgrade i sistemit. Në mbledhjen e datës 28.04.2022, në rendin e ditës është diskutuar në lidhje me Bilancin Kontabël të vitit 2021 dhe miratimin e treguesve ekonomiko-financiarë, ku nga Kryetarja e Këshillit Mbikëqyrës është pyetur nëse është dorëzuar brenda datës 31.03.2022 dhe a është kryer certifikimi. Sipas shpjegimeve që i ka bërë Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë grupit të auditimit, Bilanci Kontabël i vitit 2021 është depozituar në tatime, brenda 31.12.2023, por për certifikimin nuk është vepruar pasi është pritur miratimi i Këshillit Mbikëqyrës për përcaktimin e ekspertit të autorizuar. Nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës është vendosur që në mbledhjen e radhës të diskutohet mbi kriteret e përzgjedhjes së ekspertit të autorizuar. Në lidhje me afatin e certifikimit sipas Drejtorit të Përgjithshëm, citohet se: *“Certifikimi i bilancit ka afat të kryhet pas depozitimit të tij pranë Drejtorisë së Përgjithshme në Tatime. Për këtë arsye jemi brenda afateve ligjore.”*

Në mbledhjen e radhës, të datës 30.05.2021, ku ishte paracaktuar të diskutohej në lidhje me kriteret e ekspertit kontabël, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës e kanë shtyrë këtë diskutim, për shkak të mungesës së njërit prej anëtarëve të Këshillit, z. D.D. Kriteret e përzgjedhjes së ekspertit, janë miratuar në mbledhjen e datës 30.06.2022 ku është vendosur të mbahen të njëjta kriteret si në vitet e kaluara, por të shtohet vetëm kushti që të mos ketë asnjë penalizim nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP).

Gjatë vitit 2022 nga Këshilli Mbikëqyrës janë marrë 17 vendime, të cilat janë në përputhje me kompetencat e tij, të përcaktuara në nënpikat a-h, të pikës 2 të nenit 14, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 të ndryshuar.

Viti 2023

Gjatë vitit 2023, Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë ka pasur të njëjtën përbërje si në dy vitet më parë dhe prej datës 10.04.2023 ka funksionuar me katër anëtarë, kjo në kundërshtim me pikën 1, të nenit

12 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, pasi anëtarja znj. K.M është larguar nga pozicioni i anëtares së Këshillit Mbikëqyrës, me dorëheqjen e saj, më 10.04.2022 (*vendosur viti gabim në shkresë*), të protokolluar në Agjenci me nr. 2450, datë 11.04.2023 dhe me largimin e saj nuk janë marrë masa për ta zëvendësuar.

Nga verifikimi i vendimeve të marra nga Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë për këtë vit është konstatuar se:

Në mbledhjen e datës 03.02.2023, të Këshillit Mbikëqyrës është vendosur në lidhje me emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë, ku nga 3 kandidatura të paraqitura pranë Këshillit Mbikëqyrës është miratuar kandidatura e z. E.K.

Në institucion ka munguar një Rregullore, për përcaktimin e procedurave të emërimit dhe liritimit nga puna të punonjësve, që emërohen nga Këshilli Mbikëqyrës (Drejtori dhe Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm të Agjencisë).

Gjithashtu në mbledhjen e datës 03.02.2023 është diskutuar dhe në lidhje me mbajtjen e shumës së bonusit nga shpërblimi i muajit Janar 2023, për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës pasi është keqinterpretuar VKM nr. 898, datë 29.12.2022, për këtë ka dalë Urdhri i Brendshëm nr. 643/12, datë 03.02.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë. Në tabelën nr. 4 "*Shpërblimet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë për vitin 2023*", rezulton të jetë paraqitur nga sektori i financës mbajtja e shpërblimit, konfirmuar kjo dhe me dokumentacionin shoqërues të kryerjes së pagesës në bankë.

Në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës për vitin 2023 është diskutuar në lidhje me certifikimin e pavarur të pasqyrave financiare dhe arsyet pse ishte refuzuar dhënia e opinionit nga Audituesit e Pavarur. Një nga kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës, të përcaktuara në pikën 2/e të nenit 14 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar

Në lidhje me këtë detyrë, të Këshillit Mbikëqyrës rezulton se në të tre vitet objekt auditimi, problematika e certifikimit të pasqyrave është ngritur për diskutim, por nuk është vepruar në mënyrë konkrete për marrjen e masave për të mundësuar përmirësimin e situatës dhe të mundësohej paraqitja e saktë e pasqyrave financiare dhe pse që nga viti 2019 prej audituesve të pavarur është refuzuar dhënia e opinionit .

Në mbledhjen e datës 19.04.2023 një nga pikat për diskutim ka qenë miratimi i pasqyrave financiare të vitit 2022 dhe nga anëtarët e Këshillit është kërkuar informacion përse eksperti për certifikimin e pasqyrave të vitit 2021 është kontaktuar në muajin Tetor 2022, sipas specialistes së financës citohet se: "*Nuk ka afate, pasi nuk depozitojmë Bilancin në DPT*", deklarata kjo e kundërt me deklaratën e Drejtorit të Përgjithshëm z. E.K. në mbledhjen e datës 28.04.2022. Agjencia si institucion në varësi të MFE duhet të zbatojë Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", kjo sipas pikës 4, të Kreut I të këtij udhëzimi dhe sipas pikës 117 të tij, duhet që raportimi të bëhet brenda muajit mars të vitit pasardhës. Gjithashtu kontrolli i llogarive nga ekspertë të pavarur, që duhet të sigurohet nga Këshilli Mbikëqyrës, jo më pak se njëherë në vit është kryer një vit me vonesë, kjo në kundërshtim me pikën 2/d, të nenit 14, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar.

Nga Këshilli Mbikëqyrës është kërkuar që në mbledhjen e datës 11.05.2023 të jenë të pranishëm dhe ekspertët kontabël për të dhënë sqarime për arsyet e refuzimit të opinionit.

Nga verifikimi i procesverbaleve të mbledhjeve rezulton se është diskutuar në lidhje me largimin nga puna të punonjësve znj. O.S sipas vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm. Nga punonjësja në fjalë është kërkuar rishikim i vendimit nga ana e Këshillit Mbikëqyrës cili e ka dërguar çështjen për interpretim ligjor, pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave dhe

Ekonomisë. Ky veprim i Këshillit Mbikëqyrës është i pambështetur në një bazë ligjore, pasi kompetenca në lidhje me rishikimin e vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm i takon Këshillit Mbikëqyrës, në zbatim të pikës 2/h të nenit 14, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Këshilli mund të ndryshojë, të shtojë, të revokojë ose të shfuqizojë kompetencat e drejtorisë.” Pra, interpretimi i kërkuar nga Këshilli nuk ka qenë tagër i Sektorit të Burimeve Njerëzore pranë MFE-së.

Pas verifikimit të korrespondencës me MFE-në të vënë në dispozicion nga Agjencia, rezulton se sipas interpretimit të situatës nga përfaqësuesja e strukturës së burimeve njerëzore, pranë MFE, në email-in e datës 22.04.2023 është cituar se sipas vlerësimit të tyre procedura e largimit nga puna për punonjësen nuk ka qenë e saktë, pas kësaj korrespondence nuk rezulton të jetë trajtuar më çështja nga ana e Këshillit Mbikëqyrës dhe pse pas kësaj datë janë mbajtur mbledhje prej tij.

Gjatë vitit 2023, rezultojnë procesverbalet e 11 mbledhjeve të zhvilluara nga Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë, kjo në kundërshtim me frekuencën e mbledhjeve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 13, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar, për t’u mbledhur të paktën njëherë në muaj.

Në procesverbalet e mbledhjeve rezulton se nuk është përcaktuar vendi i mbajtjes së mbledhjeve, por sipas informacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, rezulton se të gjitha mbledhjet e Këshillit për vitin 2023 janë mbajtur në ambientet e MFE-së, kjo në kundërshtim me pikën 1 të nenit 13, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar.

Gjatë vitit 2023 nga Këshilli Mbikëqyrës janë marrë 11 vendime, të cilat janë në përputhje me kompetencat e tij, të përcaktuara në nënpikat a-h, të pikës 2 të nenit 14, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar.

Vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës të Agjencisë, në tre vitet objekt auditimi, sipas llojit të tyre paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 2 “Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës për periudhën 2021-2023, të klasifikuara sipas llojeve të tyre”

Viti	Rilidhje kontrate pune DP ⁴ & zv.DP	Emërim/lirim zëv. DP	Miratim leje DP & zv/DP	Miratim i BK ⁵	Miratim Buxheti Vjetor	Miratim për shpërblyerjet/pagat e Punonjësve	Miratim shtesë/ndryshim Buxheti	Miratim strukture organizative	Vendim për rritje page punonj	Totali vendimeve
2021	2	4	4	1	1	1		1		14
2022	3	2	4	1	1	2	2	2		17
2023	2		5	1			1	1	1	11
Total	7	6	13	3	2	3	3	4	1	42

Burimi: AMGKP, Përpunuar nga Grupi i Auditimit të KLSH-së.

Si konkluzion, problematikat e evidentuara në këtë drejtim, ashtu si dhe në të gjitha çështjet e trajtuara në këtë Raport në drejtimet e tjera të auditimit, janë tregues se Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë nuk ka monitoruar në mënyrë efektive dhe as nuk ka vlerësuar risqet në lidhje me veprimtarinë e Agjencisë, veprim ky në kundërshtim me pikën 2/c neni 14, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, i ndryshuar, sipas të cilit Këshilli Mbikëqyrës është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimeve të kryera nga Agjencia dhe pikën 1, të nenit 14 sipas të cilit Këshilli i Mbikëqyrës i Agjencisë është përgjegjës për drejtimin e Agjencisë. Gjithashtu nuk ka raportuar çdo 6 muaj mbi veprimtarinë e Agjencisë tek Këshilli i Ministrave, kjo në kundërshtim me pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë.

b) Mbi veprimtarinë dhe vendimmarrjen e Drejtorisë së Agjencisë:

⁴ DP-Drejtor i Përgjithshëm

⁵ BK-Bilanc Kontabël

Drejtoria e Agjencisë, sipas pikës 1 të nenit 15, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar përbëhet nga tre anëtarë të emëruar nga Këshilli Mbikëqyrës, nga të cilët një caktohet Drejtor i Përgjithshëm dhe 2 të tjerët caktohen Zëvendës drejtorë të Përgjithshëm.

Për periudhën objekt auditimi pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm është mbajtur nga z. E.K, i cili është zgjedhur prej Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë, në zbatim të pikës 1, të nenit 15 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar dhe sipas përcaktimit të pikës 1 të seksionit “*Drejtori i Përgjithshëm*” të Rregullores “Për funksionimin e brendshëm të ATK-së”, të miratuar me Vendimin nr. 83 të Këshillit Mbikëqyrës, datë 01.10.2019, e ndryshuar, ndërsa zëvendës drejtorët e përgjithshëm në detyrë, për periudhën objekt auditimi kanë qenë si më poshtë:

Tabela nr. 3 “Zëvendës drejtorët e Përgjithshëm të Agjencisë në detyrë, për periudhën objekt auditimi”

Nr.	Emër Mbiemër	Data e fillimit	Data e Largimit
1	G.G	28.03.2018	17.10.2022
2	B.H	19.10.2020	24.03.2021
3	A.K	07.06.2021	02.08.2021
4	M.M	16.09.2021	30.10.2023
5	O.M	01.11.2022	31.10.2023

Burimi: AMGKP, Përpunuar nga Grupi i Auditimit të KLSH-së.

Të tre anëtarët e Drejtorisë, përmbushin kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 12, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002. të ndryshuar. Ata rezultojnë të emëruar me vendimet përkatëse të Këshillit Mbikëqyrës dhe janë të punësuar me kontratë pune 1 vjeçare, të miratuar nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës, kjo në zbatim të pikës 3/a, të nenit 15 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar. Për periudhën objekt auditimi rezultoi se Drejtoria e Përgjithshme nuk ka funksionuar me dy anëtarë, në periudhat e paraqitura si më poshtë:

- Në periudhën 25.03.2021-06.06.2021 ka pasur vetëm një zëvendës drejtor;
- Në periudhën 03.08.2021-15.09.2021 ka pasur vetëm një zëvendës drejtor;
- Në periudhën 18.10.2022-30.10.2022 ka pasur vetëm një zëvendës drejtor;

Ndërsa në muajt nëntor, dhjetor 2023 Agjencia ka qenë pa zëvendës drejtorë, me arsyetimin sipas sekretares së Këshillit Mbikëqyrës se: “*Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës i ka përfunduar afati i emërimit në detyrë dhe nuk është plotësuar kuorumi i nevojshëm i vendimmarrjes në mbledhje*”, nga grupi i auditimit konstatohet se në këto kushte Këshilli ka qenë gjatë gjithë periudhës objekt auditimi dhe jo vetëm në muajt tetor, nëntor 2023.

Drejtoria e Agjencisë, sipas procesverbaleve të mbledhjeve, ka marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës, e përfaqësuar së paku nga një prej anëtarëve të saj dhe ka informuar Këshillin Mbikëqyrës sipas rendit të ditës të paracaktuar nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës, duke dhënë informacion periodik mujor/vjetor mbi veprimtarinë e Agjencisë çdo muaj mbi veprimtarinë e Agjencisë, në formën dhe mënyrën e kërkuar nga Këshilli Mbikëqyrës, kjo në përputhje me nenin 17, të ligjit nr. 8894, datë 22.05.2002.

Gjithashtu, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë me anë të shkresës nr. 4596, datë 18.07.2018 ka njoftuar Ministrin e Financave dhe Ekonomisë (MFE) për përfundimin e afatit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, por nga ana e MFE-së nuk ka pasur përgjigje.

Drejtoria e Agjencisë sipas pikës b të nenit 16, të ligjit nr. 8894, datë 22.05.2002, të ndryshuar është përgjegjëse për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e tjera. Për periudhën objekt auditimi nga Drejtoria nuk është lidhur asnjë marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera, me qëllim, të rritjes së efikasitetit të institucionit në drejtim të arkëtimit të shumave të kredive.

Marrëveshje bashkëpunimi të lidhura nga Agjencia, përpara periudhës objekt auditimi, por që vijojnë të mbeten në fuqi në periudhën objekt auditimi janë:

➤ Me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), protokolluar në Agjenci me nr. 3678 e datës 26.09.2014.

➤ Me Zyrën Qendrore të Pasurive të Paluajtshme, protokolluar në Agjenci me nr. 2177, datë 30.03.2018.

➤ Me Bankën e Shqipërisë, protokolluar në Agjenci me nr. 1581, datë 09.03.2020.

Pavarësisht këtyre marrëveshjeve nga auditimi konstatohet se përcaktimet e klauzolave të tyre nuk janë ezauruar plotësisht dhe si rrjedhojë nuk kanë dhënë efektet pozitive të pritshme. Konkretisht: -Në marrëveshjen me DPT përcaktohet se: *“Agjencia i dërgon DPT listën me gjeneralitetet e shtetasve që kanë detyrime ndaj saj. Nga ana e DPT evidentohen debitorët që janë subjekte tatimpagues duke vënë në dijeni në çdo rast Agjencinë. Ky informacion shoqërohet në çdo rast me statusin aktual të aktivitetit të tatimpaguesit debitor (aktiv, pasiv, në procedurë likuidimi, falimentimi, etj.) nëpërmjet informacionit të dërguar nga Agjencia, DPT verifikon nëse debitorët e Agjencisë janë njëkohësisht dhe debitorë të saj, për t'i klasifikuar këta të fundit si subjekte me risk të lartë.....”*. Nga ana e Agjencisë, i është konfirmuar grupit të auditimit (email-i datës 24.04.2024) se listën me debitorët e Agjencisë e ka dërguar në DPT me anë të shkresës me nr. 4446 prot., datë 03.11.2014 dhe është kthyer përgjigje nga DPT me shkresën nr. 4446/1 prot., datë 01.12.2014. Gjithashtu, është dërguar sërish lista e debitorëve me anë të shkresës me nr. 86 prot., datë 12.01.2015 dhe është kthyer përgjigje nga DPT me shkresën nr. 86/1 prot., datë 23.01.2015. Grupi i auditimit nuk i disponon këto shkresa, si rrjedhojë as informacionet e përcjella.

-Në marrëveshje me Zyrën Qendrore të Pasurive të Paluajtshme, nisur nga problematikat e konstatuara në dosjet e audituara evidentohet një zvarritje procesesh, në evidentimin e rasteve dhe në kthim përgjigje. *Nga Agjencia nuk disponohet relacion, memo, analizë në lidhje me rezultate konkrete të këtyre marrëveshje, për të evidentuar sesa efektive ose jo kanë rezultuar këto masa.*

-Në Marrëveshjen e bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë, protokolluar në Agjenci me nr. 1581, datë 09.03.2020 *“Për raportimin në regjistrin e kredive, të informacionit në lidhje me portofolin e kredive të administruara nga Agjencia e Trajtimit të kredive”, në kuadër të së cilës nga Agjencia është dërguar në regjistrin e kredive lista me 3,744 debitorë të identifikuar me emër, mbiemër, numër personal (ID), e cila gjithashtu ka dhe të dhëna në lidhje me shumat e kredisë, datën e aprovimit të kredisë, kategorinë e kredisë. Megjithatë, nga sistemi i kreditit, evidentohen 6,547 rekorde me të dhëna të plotësuar duke paraqitur një diferencë të lartë prej 2,803 klientësh të paidentifikuar dhe rrjedhimisht të padërguar drejt BSH për marrjen e masave të mëtejshme për arkëtimin e detyrimit të tyre.*

-Nga Agjencia nuk janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera në kundërshtim me pikën 1, neni 10, ligji nr. 8894, datë 14.05.2002, i ndryshuar, i cili citon: *“Agjencia u dërgon zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, drejtorive rajonale të shërbimit të transportit rrugor, zyrave të gjendjes civile, Aluiznit, organeve të pushtetit vendor, bankave të nivelit të dytë, fondacioneve kredi dhënëse dhe institucioneve të tjera informacion për detyrimet, që persona të ndryshëm mund të kenë ndaj shtetit. Procedurat e shkëmbimit të informacionit përcaktohen në marrëveshjet e bashkëpunimit, të nënshkruara nga Agjencia dhe institucioni përkatës”*.

Me rëndësi në mirëfunksionimin e institucionit do të ishte një marrëveshje bashkëpunimi veçanërisht me ASHK dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Konkretisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile ka patur një inicim të një marrëveshje por e pa finalizuar, si në vijim:

-Nga Drejtori i Agjencisë me shkresën nr. 5251 prot., datë 19.10.2021 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, është kërkuar vënia në dispozicion e Regjistrin të Gjendjes Civile, i përditësuar në formën e një databaze, me qëllim gjetjen e adresave të sakta të debitorëve.

-Me shkresën nr. 7285/1 prot., datë 11.11.2021, është kthyer përgjigje nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, për adresimin në format elektronik, në programin Excel të kërkesës në Drejtorinë e Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve.

Ky komunikim është vijuar në rrugë elektronike nga specialistja e IT-së së Agjencisë, drejtuar personit të kontaktit në Drejtorinë e Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve, me emailin e datës 06.12.2021. Sipas korrespondencës në rrugë elektronike rezulton se në datën 09.02.2022 është realizuar edhe një takim në ambientet e Ministrisë së Brendshme midis specialistes së IT-së dhe përfaqësuesit të Drejtorisë së Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve, për diskutim nga ana teknike mbi nevojat e sistemit dhe të dhënave të kërkuara nga ana e Agjencisë.

Deri në janar të vitit 2023 nuk rezulton të jetë marrë asnjë në drejtim të kërkesës së parashtruar nga ana e Agjencisë. Nga kjo e fundit është dërguar sërish email në datën 18.01.2023, ku kërkohet sërish një takim, i zhvilluar ky në datën 24.01.2023. Nga ana e Agjencisë po në datën 24.01.2023 është dërguar në Drejtorinë e Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve, një listë debitorësh me ID dhe adresa sipas databazës që Agjencia disponon (12 debitor) test verifikimi nëse përputhen me të dhënat e kësaj Drejtorie, të konfirmuar nga kjo e fundit me emailin e datës 22.02.2023. Me email-in e datës 16.03.2024, nga specialistja e IT-së në Agjenci është kërkuar aksesi në fushat:

- ID
- Gjendja Civile
- Adresat e përditësuara
- Nr tel (nëse disponohet).

Komunikimi ka vijuar deri në gusht të vitit 2023, por pa u finalizuar me një marrëveshje dhe sistem të dedikuar për Agjencinë.

Për periudhën objekt auditimi, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë ka nxjerrë një sërë urdhrash që kanë të bëjnë me: Urdhër-shërbime për inspektime në terren apo përfaqësim të institucionit nëpër procese gjyqësore, urdhra për procedurat e nxjerrjeve të certifikatave të pronësisë për kolaterale, urdhra për fillim të procedurave të rivlerësimit të pasurive në pronësi më qëllim shitjen e tyre në ankand, urdhra për fillim të procedurave të ankandit, urdhra prokurimi për blerje të vogla; urdhra për kryerjen e pagesave për përmbaruesit privatë, për përzgjedhjen e të cilëve mungon gjurma e auditimit, urdhra për pagesa të ndryshme të kryera nga institucioni në lidhje me lëshimin e publikatëve të titujve ekzekutive, etj. Urdhrat e mësipërm janë marrë në funksion të drejtimin të veprimtarisë së institucionit siç përcaktohet në pikën 2 të seksionit “*Drejtori i Përgjithshëm*” të Rregullores “*Për funksionimin e brendshëm të ATK*”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 83, datë 01.10.2019, të ndryshuar. Detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm që lidhen më drejtimin e veprimtarisë së Agjencisë si fillimi i procedurave gjyqësore, përzgjedhja e debitorëve që do të trajtohen pranë shoqërive përmbaruese, përzgjedhja e këtyre të fundit, etj. nuk janë të detajuara dhe të mirë përcaktuara në mënyrë konkrete në Rregulloren për Funksionimin e Agjencisë, për të mundësuar një “standardizim” të kriterëve.

Si konkluzion, Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë (Drejtorit të Përgjithshëm dhe 2 zëvendës drejtorëve), konstatohet se për një periudhë prej 3 muajsh ka funksionuar vetëm me Drejtorin e Përgjithshëm dhe një zëvendës drejtor, dhe për muajt nëntor, dhjetor 2023, ka funksionuar vetëm me Drejtorin e Përgjithshëm, pa asnjë zëvendës drejtor. Këshilli Mbikëqyrës ka vepruar në kundërshtim me pikën 2/b, të nenit 14, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar, e cila citon Këshilli Mbikëqyrës emëron Drejtorin dhe Zëvendësdrejtorët e Drejtorisë;

- Drejtoria, gjatë periudhës së auditimit nuk ka hartuar asnjë marrëveshje të re bashkëpunimi, ne kundërshtim me përcaktimet e pikës b të nenit 16, të ligjit nr. 8894, datë 22.05.2002, të ndryshuar, ndërkohë për marrëveshjet e lidhura para periudhës objekt auditimi konstatohet se nuk kanë qenë plotësisht efektive nisur edhe nga fakti që ka munguar bashkëpunimi dhe reagimi në kohë për kthim përgjigje kryesisht nga pala tjetër.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë për pjesën e mungesës së lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me të gjitha institucionet e tjera që parashikohen në ligjin nr. 8894, datë 14.05.2002, i ndryshuar.

2.2 Zbatimi i procedurave për ndjekjen dhe mbledhjen e kredive, si dhe aplikimi i masave shtrënguese.

- Mbi vlerësimin e të dhënave të pasqyruara nga Sistemi i Kreditit të Agjencisë

Agjencia është krijuar me ligjin nr. 8339, datë 30.04.1998 “Për krijimin e Agjencisë së Trajtimit të Kredive”. Në datë 14.05.2002 është miratuar ligji nr. 8894 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i cili është ndryshuar dhe azhornuar 5 herë ndër vite deri në vitin 2007. Duke qenë se nga momenti i miratimit të ligjit deri aktualisht rezulton një periudhë gati 25 vjeçare, nga grupi i auditimit u përgatit një pyetësor me qëllim evidentimin e kronologjisë së veprimtarisë të institucionit që konsiston nga momenti i marrjes në dorëzim të kredive deri në periudhën objekt auditimi. Referuar përgjigjeve të pyetësorit, sistemi është implementuar në vitin 2004, ku janë çelur kodet e klientëve dhe kreditë e tyre, duke hedhur manualisht të dhënat në sistem. Gjithashtu, disponohet një manual përdorimi për kërkimin e përdoruesit i vitit 2022 në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Personat e autorizuar për përdorimin e sistemit janë: administratori, punonjës të sektorit të financës dhe punonjës të sektorit juridik. Për periudhën objekt auditimi personat e autorizuar nga Sektori i Financës për përdorimin e sistemit paraqiten: znj. V.S, znj. O.S (për periudhën 01.01.2021-03.12.2021 dhe 27.09.2022-06.04.2023 ka qenë pjesë e Sektorit të Financës), znj. E.Z (për periudhën 04.06.2021-01.01.2023 ka qenë pjesë e Sektorit të Financës), z. E.LI (larguar në 01.04.2022), znj. H.I (që nga 01.04.2022 ka qenë pjesë e Sektorit të Financës), znj. K.T (që nga 14.12.2022 ka qenë pjesë e Sektorit të Financës), znj. A.B (që nga 19.04.2023 ka qenë pjesë e Sektorit të Financës) dhe znj. S.E.

Konkretisht, administratori (IT) znj. E.T ka kompetenca të plota të menaxhimit të sistemit, për shtimin/modifikimin e përdoruesve të rinj ose ekzistues, regjistrimin e fazave, hapjen dhe mbylljen e periudhave financiare, menaxhimin e regjistrimit të zyrave përmbare, hapjen e fushave të ndryshme, si: Kredi, Klient, Donator, Ekzekutues. Nuk ka kompetenca në ndryshimin e të dhënave të debitorëve, të dhënave financiare dhe të raporteve të fushave: Kartelet Kredie, Gjendje kredie me datë, Gjendje kartelet krediti, të regjistruara që në fillimet e ndërtimit të Kreditit.

Punonjësit e sektorit të financës kanë kompetenca në hedhjen e arkëtimeve dhe pagesave të debitorëve, mbylljen në sistem të kredive me propozimin e komisionit dhe miratimin e drejtorisë, në sistemin e interesave të debitorëve sipas urdhërit të Ekzekutimit ose për ata që nuk i ka dalë urdhri deri më datë 30.04.2009.

Punonjësit e sektorit juridik me kompetenca editimin e ID vetëm në rast se e gjejnë si të dhënë, editimin e të dhënave juridike në të gjitha fushat e caktuara sipas të dhënave që disponojnë, siç janë: Zyra përmbare, Fazat përmbare, Urdhri ekzekutimit, Statusi i debitorit, editimin e fushës: “Shënime”;

Lidhur me mirëmbajtjen e sistemit disponohet kontrata e shërbimit nr. 896/20, datë 05.05.2022 “Ndërtim Web service dhe mirëmbajtje e sistemit të kreditimit” lidhur mes Agjencisë së Trajtimit të Kredive dhe Shoqërisë “Soft & Solution” SHPK. Mirëmbajtja e sistemit përfshin përkrahimin

dhe dokumentin e kontrolleve, përditësimin, përmirësimin apo modifikimin e sistemit nëpërmjet kontrolleve mujore të serverave, në rast update apo problematike që mund të haset, lista e kërkesave dhe verifikimet, të cilat janë kryesisht nga stafi për të përmirësuar një fushë të caktuar ose problematika që hasen gjatë përdorimit të sistemit.

Në lidhje me informacionin e kërkuar mbi listën e dosjeve fizike të debitorëve të transferuar nga bankat e nivelit të dytë, nga Agjencia nuk u vendos në dispozicion procesverbali fillestar i marrjes në dorëzim dhe inventarizimit të kredive të transferuara. Procesverbali i vetëm i vënë në dispozicion i përket vitit 2014, përkatësisht procesverbali nr. 4585 prot., datë 10.11.2014, “Mbi inventarizimin e dosjeve të debitorëve që disponon Agjencia”, ku citohet numri i dosjeve fizike, ku përkatësisht citohet se:

- janë transferuar 19,074 dosje në total nga të cilat 15,542 dosje fizike të rregullta dhe 3,230 dosje të djegura ose me mungesë dokumentacioni të cilat janë transferuar në listë emërore pa asnjë dokument shoqërues dhe mungojnë 299 dosje;
- nga inventarizimi i dosjeve të debitorëve të Bankës Bujqësore për Zhvillim ekzistojnë 5,853 dosje gjithsej nga të cilat 1,155 dosje me shënimin “të mbyllur” dhe 4,698 dosje pa shënim.

Nga analizimi i të dhënave të mësipërme të procesverbalit krahasuar me listën e inventarit në Excel të vënë në dispozicion nga subjekti, nga grupi i auditimit evidentohen mospërputhje si në vijim:

Tabela nr. 1: Krahasimi i të dhënave për dosjet e debitorëve të transferuara nga Bankat e Nivelit të Dytë drejt Agjencisë

	Nga procesverbali	Nga inventari në Excel	Diferenca
Dosje gjithsej nga Bankat e nivelit të II-të	19,074	18,775	-299
Dosje fizike të rregullta	15,542	15,545	3
Dosje të djegura		2,272	
Dosje me mungesë dokumentacioni	3,230	958	-958
Dosje që mungojnë	299	N/A	N/A
Dosje nga Banka Bujqësore për Zhvillim	5,853	5,956	103

Burimi: Të dhënat nga procesverbali nr. 4585 prot., datë 10.11.2014, “Mbi inventarizimin e dosjeve të debitorëve që disponon Agjencia” dhe Inventari në Excel. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Përpos diferencave të evidentuara në tabelën nr. 1, edhe në procesverbalin e cituar konstatohet se numri i dosjeve të munguara nuk përputhet me përlogaritjen e vetë të dhënave të cituara, si në vijim:

$19,074 \text{ dosje total} - (15,542 \text{ dosje fizike të rregullta} + 3,230 \text{ dosje të djegura/mungesë dokumentacioni}) = 302 \text{ dosje që mungojnë}$

Ndërkohë, si dosje të munguara në procesverbal janë paraqitur 3 më pak, pra 299 dosje.

Të dhënat nga ky sistem përdoren nga sektorë të ndryshëm në Agjenci për ndjekjen dhe mbledhjen e kredive, si dhe aplikimin e masave shtrënguese për debitorët. Në mungesë të një rregullore/manuali për përdorimin e sistemit, nga intervistat e zhvilluara dhe nga informacioni i vënë në dispozicion nga subjekti përmes emailit të datës 05.04.2024, bëhet me dije se më datë 31.12.2003 është bërë çelja e debitorëve dhe kredive në sistem ku çdo debitor është çelur me një kod ose numër kredie i cili është **unik** për secilin.

Nga auditimi konstatohet se në sistem rezultojnë 19,243 klientë të çelur, secili me kodin respektiv të klientit, sipas figurës nr. 1. Tek të dhënat mbi çeljen e klientëve, janë pasqyruar Kodi, Emërtimi, Vendlindja, Datëlindja, Adresa. Rezulton se të dhënat mbi vendlindjen, datëlindjen dhe adresën nuk janë të pasqyruara për të gjithë klientët e çelur.

Figura nr. 1: Pasqyrë mbi klientë të çelur në sistem

Krediti Veprime Hapje Raporte

Klient

Kërko klient

+ Shto

Nr	Kodi	Emërtim	Vendlindja	Datëlindja	Adresa
1					
2	IS26				Tirane
3	AK13		Tirane	30/08/1968	Rr Shyqiri Ishmi Tirane
4	HK24		Sovjan Korçë	15/12/1954	Sovjan
5	KG00		Trush Shkoder	20/10/1959	Trush, rrethi shkoder
6	SF03		SHkoder	18/11/1960	SHkoder
7	YB01		Korçë (Qyteti)	07/10/1962	Ravonik
8	AH24		Komsi Burrel	01/05/1955	Mat
9	BM36		Fier	01/02/1953	Kon pezes, pal 5, sh 1/10
10	NM25		Tirane		Rr Qemal Stafa Tirane
11	TO00		Durres	19/09/1965	"Irr.r." "m.shyrr"
12	AM011				

Burimi: Pamje nga Sistemi i Kreditit të AMGKP, 2024

Nga analizimi i të dhënave të pasqyruara për klientët e çelur rezultojnë gjithsej 19,243 rekorde me 19,242 kode klienti. Edhe pse fushat “Vendlindje”, “Datëlindje”, “Adresa” janë të pasqyruara në sistem, ato nuk rezultojnë të plotësuar për të gjithë klientët, ku specifikisht rezultojnë të dhënat si në tabelën nr. 2. Ndër të tjera, evidentohen 7,167 rekorde klienti pa asnjë të dhënë përveç emrit në fushën “Emërtimi” dhe Kodit të Klientit, pra rrjedhimisht pa asnjë të dhënë identifikuese (vendlindje, datëlindje dhe adresë).

Tabela nr. 2: Mbi të dhënat në sistem për klientë të çelur

Rekorde total	19,243
Kode klienti	19,242
Pa vendlindje	11,140
Pa datëlindje	11,612
Pa adresë	8,002
Kode klienti pa vendlindje, datëlindje, adresë	7,167

Burimi: Të dhënat nga Sistemi i Kreditit të AMGKP, 2024. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Për më tepër, përveç mungesës së të dhënave të evidentuara më sipër, rezultojnë edhe pasaktësi në datëlindjet e plotësuar. Nga përllogaritjet e grupit të auditimit, me supozimin se deri në vitin 1997 të jetë marrë kredia përkatëse dhe debitori të ketë qenë minimalisht 18 vjeç në momentin e marrjes së kredisë, moshë aktuale e debitorit sot në vitin 2024 nuk mund të jetë më e vogël se 45 vjeç. Ndërkohë, nga testimet e datëlindjes së klientëve të çelur rezultojnë 28 klientë të moshës 25-45 vjeç, ku për më tepër 22 klientë janë të datëlindjes 1990-1999. Gjithashtu ka 1 rekord klienti me datëlindje vitin 2056 dhe 3 rekorde klienti me moshë mbi 1,000 vjeç.

Në sistem rezultojnë 19,126 *kredi të çelura*, ku janë evidentuar Kodi (i kredisë), Emërtimi, Klienti, Zona, Vlera fillestare, Kontrata, Principali i mbetur, Interesi i mbetur, sipas figurës nr. 2.

Në lidhje me kreditë e transferuara nga Banka Bujqësore për Zhvillim konstatohet se nuk rezultojnë të hedhura në Sistemin e Kreditit, si kredi apo klient, por mbahen në llogari më vete në

Excel. Ku sipas email të datës 16.04.2024, rezultojnë 1,462 raste kredie nga BBZH në vlerën 16,382,187 lekë.

Figura nr. 2: Pasqyrë mbi kredi të çelura në sistem

Nr	Kodi	Emërtim	Klienti	Zona	Vlera fillestare	Kontrata	Principali i mbetur	Interesi i mbetur
1	05206	Grumbullim Bime medicinale	S■■■■■■■	BC	1 000 000,00	Kontrat me BTA	681 450,00	1 749 493,999
2	05205	Tregji Plera Kimike	■■■■■■■	BC	2 300 000,00	Kontrat me BTA	0,00	-0,001
3	05204	Tregji Bimesh Medicinale	M■■■■■■■	BC	460 000,00	Kontrat me BTA	460 000,00	1 320 580,999
4	05203	Blerje Blektori	F■■■■■■■	BC	1 300 000,00	Kontrat me BTA	1 300 000,00	5 202 813,999
5	05201	Blerje Plerash Kimike	F■■■■■■■	BC	1 500 000,00	Kontrat me BTA	0,00	-0,001
6	05202	Blektori	S■■■■■■■	BC	1 000 000,00	Kontrat me BTA	1 000 000,00	4 418 542,999
7	05207	Blektoral	S■■■■■■■	BC	1 500 000,00	Kontrat me BTA	1 500 000,00	6 054 669,999
8	05264	Blektori	N■■■■■■■	SH	900 000,00	kontrat me BTA	720 000,00	1 590 909,000
9	05261	Tregji Plera Kimike	F■■■■■■■	SH	756 000,00	kontrat me BTA	0,00	0,000
10	04832	Traktor	■■■■■■■	PR	1 907 719,00	Kontrat me BTA	1 060 233,00	-1 144 608,480
11	04830	Traktor	T■■■■■■■	PR	1 808 347,00	kontrat me BTA	0,00	0,000
12	04831	Traktor	■■■■■■■	PR	2 201 383,00	Kontrat me BTA	2 091 383,00	658 494,799

Burimi: Pamje nga Sistemi i Kreditit të AMGKP, 2024

Në kreditë e çelura evidentohen raste të kredive me vlerë fillestare të pasqyruar zero në 2,186 kredi.

Tabela nr. 3: Mbi të dhënat në sistem për klientë të çelur

Vlera fillestare e kredisë	Raste
Vlera = 0	2,186
Vlera ≥ 1	16,940
Total	19,126

Burimi: Të dhënat nga Sistemi i Kreditit të AMGKP, 2024. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Në mungesë të procesverbalit fillestar të marrjes në dorëzim të kredive nga Agjencia, grupi i auditimit ka krahasuar të dhënat mes procesverbalit nr. 4585, datë 10.11.2014 “Mbi inventarizimin e dosjes së debitorëve që disponon Agjencia”, klientëve të çelur dhe kredive të çelura, nga ku ka rezultuar:

Sipas inventarizimit të vitit 2014 rezultojnë 19,074 dosje debitorësh transferuar nga bankat e nivelit të dytë dhe 5,853 dosje nga Banka Bujqësore për Zhvillim. Ndërkohë, sipas çeljes së klientëve rezultojnë 19,243 rekorde dhe sipas çelje kredie rezultojnë 19,126 rekorde. Sipas tabelës nr. 4 evidentohet se të dhënat përkatëse për secilin rast nuk përpunohen me njëra-tjetrën.

Tabela nr. 4: Mbi të dhënat e inventarizimit, klientëve dhe kredive të çelura

Sipas inventarizimit 2014	Sipas çelje klienti	Sipas çelje kredie
19,074 dosje nga Bankat e Niv. II	19,243 klientë	19,126 kredi
5,853 dosje nga BBZH	N/A	N/A

Burimi: Të dhënat nga procesverbali nr. 4585, datë 10.11.2014, “Mbi inventarizimin e dosjeve të debitorëve që disponon Agjencia” dhe Sistemi i Kreditit të AMGKP, 2024. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Nga Agjencia nuk u vu në dispozicion informacion mbi kredi të transferuara sipas bankave përkatëse të nivelit të dytë, ndaj referuar informacionit që ofrohet nga Sistemi i Kreditit, rezulton

tabela nr. 5. Duke qenë se në çelje kredie nuk ofrohet informacion nga Sistemi lidhur me monedhën përkatëse, nuk mund të përcaktohet vlera e kredisë së çelur sipas bankave dhe monedhës.

Tabela nr. 5: Të dhëna mbi kreditë e çelura sipas bankave

Banka ku është marrë kredia	Numër kredisë të çelura
Nga Banka Tregtare Agrare	2,887
Nga Banka e Kursimeve	14,359
Nga Banka Kombëtare Tregtare	1,837
Nga INSIG	33
Pa specifikuar	10
Total	19,126

Burimi: Të dhënat nga Sistemi i Kreditit të AMGKP, 2024. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Nga Agjencia u vu në dispozicion informacioni për kreditë sipas bankave me tabelën nr. 6, për periudhën objekt auditimi, ku evidentohet gjendja e kredive në secilën prej periudhave të cituara në tabelë.

Tabela nr. 6: Të dhëna mbi kreditë sipas bankave për periudhën objekt auditimi 2021-2023

Sipas ekzekutuesit	Monedha	Krediti			
		Nr	Vlerë		
			Shpenzime Gjyqi (ALL)	Principal i mbetur (sipas monedhës)	Interes (sipas monedhës)
Më datë 01.01.2021					
Banka e Kursimeve	ALL	8,510	63,813,875.39	2,904,472,255.74	8,680,797,051.02
	EUR	2	24,600.00	22,645.32	20,176.99
	USD	35	1,284,098.22	1,072,998.63	2,835,856.11
Banka Tregtare Agrare	ALL	1,427	27,174,124.60	1,087,761,829.20	1,397,709,818.14
	EUR	-	-	-	-
	USD	-	-	-	-
Banka Kombëtare Tregtare	ALL	201	7,493,881.00	321,948,587.14	724,021,698.70
	EUR	285	9,169,049.68	5,450,497.12	2,273,960.23
	USD	646	10,269,580.77	6,996,714.21	8,801,375.62
INSIG	ALL	-	-	-	-
	EUR	-	-	-	-
	USD	6	202,655.50	49,939.50	56,796.00
Më datë 31.12.2021					
Banka e Kursimeve	ALL	8,412	63,487,972.39	2,853,938,048.45	8,543,686,874.13
	EUR	2	24,600.00	22,645.32	20,176.99
	USD	35	1,292,498.22	1,072,998.63	2,835,856.11
Banka Tregtare Agrare	ALL	1,414	27,246,927.59	1,080,957,667.26	1,391,991,775.60
	EUR	-	-	-	-
	USD	-	-	-	-
Banka Kombëtare Tregtare	ALL	200	7,630,321.00	318,674,822.14	709,518,740.18
	EUR	283	8,914,920.68	5,385,857.78	2,247,772.90
	USD	641	10,375,894.77	6,936,490.74	8,745,803.86
INSIG	ALL	-	-	-	-
	EUR	-	-	-	-
	USD	6	202,655.50	42,239.50	56,796.01
Më datë 31.12.2022					
Banka e Kursimeve	ALL	8,315	62,743,524.39	2,809,033,264.63	8,440,318,943.07
	EUR	2	24,600.00	21,645.32	20,176.99
	USD	35	1,292,498.22	1,072,998.63	2,883,856.11
Banka Tregtare Agrare	ALL	1394	26,795,969.59	1,077,199,527.26	1,390,211,153.69
	EUR	-	-	-	-
	USD	-	-	-	-
Banka Kombëtare Tregtare	ALL	199	7,629,521.00	317,912,152.14	708,778,108.08
	EUR	275	8,260,290.53	5,344,355.14	2,227,370.86
	USD	638	10,324,494.77	6,899,034.35	8,699,358.57
INSIG	ALL	-	-	-	-
	EUR	-	-	-	-
	USD	6	101,755.50	27,662.00	56,796.01
Më datë 31.12.2023					
Banka e Kursimeve	ALL	8,126	62,030,054.39	2,774,893,765.37	8,318,903,055.21
	EUR	2	24,600.00	20,145.32	20,176.99

	USD	35	1,293,398.22	1,050,684.35	2,845,549.42
Banka Tregtare Agrare	ALL	1,351	26,755,054.59	1,066,447,801.43	1,369,290,965.61
	EUR	-	-	-	-
	USD	-	-	-	-
Banka Kombëtare Tregtare	ALL	196	7,647,821.00	316,516,614.88	708,727,124.48
	EUR	269	8,126,622.53	5,296,483.71	2,214,940.11
	USD	626	9,842,284.77	6,748,990.57	8,462,821.48
INSIG	ALL	-	-	-	-
	EUR	-	-	-	-
	USD	4	100,255.50	24,395.00	52,065.01

Burimi: Agjencia e Menaxhimit të Kredive dhe Garancive të Pakthyer, 2024.

Referuar të dhënave që ofron Sistemi i Kreditit të Agjencisë, grupi i auditimit ka kryer disa testime ku janë evidentuar mospërputhje mes të dhënave siç sqarohet në vijim.

Testi 1 – Kryqëzimi i të dhënave mes klientë të çelur dhe kredi të çelura

Nga krahasimi i të dhënave duke përdorur si variabël fiks “Kod Klienti”, rezulton se lista me klientë të çelur ka 19,242 rekorde, ndërsa lista me kredi të çelura ka 19,126 rekorde. Pra, rezultojnë 116 rekorde më shumë të çelura me të dhënat e klientëve.

Testi 2 - Kryqëzimi i listës së klientëve të çelur dhe gjendjes së kredive në datë 01.01.2021

Nga krahasimi i të dhënave duke përdorur si variabël fiks “Kod Klienti”, rezulton se lista me klientë të çelur ka 19,242 rekorde, ndërsa regjistri me të dhënat e gjendjes së kredive të datës 01.01.2021 ka 18,134 rekorde. Pra, rezultojnë 1,109 rekorde më shumë të çelura me të dhënat e klientëve. Për më tepër, nga përpunimi i të dhënave në Excel evidentohen 2,177 kode klienti që nuk janë pjesë e gjendjes së kredisë në datën 01.01.2021 (fillimi i periudhës objekt auditimi). Duke qenë se në seksionin e klientëve të çelur nuk ka të dhëna mbi kredinë e marrë, por të dhëna vetëm për klientët, nuk mund të përcaktohet vlera që përfaqësojnë këto 2,177 rekorde.

Testi 3 dhe Testi 4 – Kryqëzimi i listës së kredive të çelura dhe gjendjes së kredive në datë 01.01.2021 me variabël fiks “Kodi i Kredisë”/“Emërtimi”.

Duke përdorur si variabël krahasues Kodin e Kredisë, për listat e kredive të çelura dhe për gjendjen e kredive në datën 01.01.2021, rezulton se ka diferenca në numrin e rekordeve të paraqitura. Specifikisht, rezultojnë 992 kode të cilat janë pjesë e kredive të çelura, por nuk janë pjesë e gjendjes së kredive. Nga këto rekorde, 16 paraqiten si kredi me vlerë fillestare zero dhe 976 rekorde kanë vlerë fillestare pozitive për kredinë. Për më tepër, nga totali prej 992 rekorde që diferencojnë mes listave, 989 rekorde paraqiten me principal të mbetur zero, 1 me principal në vlerë negative dhe 2 me principal në vlerë pozitive⁶.

Tabela nr. 7: Përmbledhje për rekordet e kredive të çelura që nuk janë pjesë e gjendjes së kredisë në 01.01.2021 (Testi sipas “Kodi i Kredisë”)

Vlerë fillestare = 0	16	Principal i mbetur = 0	989
Vlerë fillestare > 0	976	Principal i mbetur < 0	1
		Principal i mbetur > 0	2
Total	992	Total	992

Burimi: Të dhënat nga Sistemi i Kreditit të AMGKP, 2024. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

⁶ Vlera e principalit të mbetur gjenerohet nga sistemi në momentin aktual të marrjes së të dhënave nga sistemi, pra nuk pasqyron principalin e mbetur në datën 01.01.2021.

Nga krahasimi i të dhënave të emrave të klientëve (duke përdorur si variabël krahasues “Emërtimi”⁷), rezulton se për 952 rekorde janë çelur kredite, por nuk janë pjesë e gjendjes së kredive në datën 01.01.2021. Nga to, rezulton se 16 paraqiten me vlerë fillestare zero. Në total, tek të dhënat e kredive të çelura evidentohen 2,186 rekorde ku vlera fillestare e kredisë paraqitet në vlerën zero. Ndërkohë, nga këto 2,186 raste, vetëm 16 rekorde nuk janë pjesë e gjendjes së kredisë në 31.12.2021. Pra, evidentohen raste me trajtim të dyfishtë sa i takon paraqitjes së tyre në gjendjen e kredisë në një datë të caktuar.

Tabela nr. 8: Përmbledhje për rekordet e kredive të çelura që nuk janë pjesë e gjendjes së kredisë në 01.01.2021 (Testi sipas “Emërtimi”)

Vlerë fillestare = 0	16	Principal i mbetur = 0	949
Vlerë fillestare > 0	936	Principal i mbetur < 0	1
		Principal i mbetur > 0	2
Total	952	Total	952

Burimi: Të dhënat nga Sistemi i Kreditit të AMGKP, 2024. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Analitikisht, 16 rastet me vlerë fillestare zero, paraqiten si në tabelën nr. 9:

Tabela nr. 9: Rekordet me vlerë fillestare kredie zero që nuk janë pjesë e gjendjes së kredive më 01.01.2021 (Testi sipas “Emërtimi” dhe Testi sipas “Kodi i Kredisë”)

Klienti	Zona	Vlera fillestare	Kontrata	Principali i mbetur	Interesi i mbetur
B.L	KJ	0.00	Kontrate me BTA	0.00	0.000
E.G	SH	0.00	Kontrate me BTA	0.00	0.000
S.Q	LU	0.00	Kontrate me BTA	0.00	0.000
Firma K.....	DR	0.00	Kontrate me BKT	0.00	0.000
R.R	LU	0.00	Kontrate me BKT	0.00	0.000
A.B "A...."	TR	0.00	Kontrate me BKT	0.00	0.000
"L..." SHPK	TR	0.00	Kontrate me BKT	0.00	0.000
E.S	BR	0.00	Kontrate me BTA	0.00	0.000
S.K	DR	0.00	Kontrate BTA	0.00	0.000
H.T	SR	0.00	Kontrate BTA	0.00	0.000
S.Th	SR	0.00	Kontrate me BTA	0.00	0.000
N.B	SH	0.00	Kontrate me BTA	0.00	0.000
G.D, S.K	SH	0.00	Kontrate me BKT	0.00	0.000
K.D	GJ	0.00	Kontrat me BKT	0.00	0.000
C.XH	VL	0.00	Kontrat me BTA	0.00	0.000
M.T	KO	0.00	Kontrate me BK	0.00	0.000

Burimi: Të dhënat nga Sistemi i Kreditit të AMGKP, 2024. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Nga ndërthurja e dy testeve të kryera deri tani nga grupi i auditimit: (i) bazuar në “Kodi i Kredisë” dhe (ii) bazuar në “Emërtimi”, për të njëjtat lista: Kredi të Çelura dhe Gjendje e Kredive në datën 01.01.2021, konstatohet se:

- Ekzistojnë diferenca në paraqitjen e të dhënave në sistemin elektronik të kredive të Agjencisë;
- Vlerat e paraqitura si vlerë fillestare/principali/interesi paraqiten në tre mënyra: pozitive, negative dhe vlerë zero;
- Në 40 raste, emri i debitorit (klientit) është i njëjtë në dy listat Kredi të Çelura dhe Gjendje e Kredive në datën 01.01.2021, ndërsa Kodi i Kredisë është i ndryshëm. Në të gjitha këto 40 raste, principali i mbetur dhe interesi paraqiten me vlerë zero. Për 950 raste, Klienti i paraqitur në Kredi të Çelura nuk ndodhet në Gjendje Kredie as sipas “Kodi i Kredisë”, as sipas “Emërtimi”.

Tabela nr. 10: Rezultate nga ndërthurja e Testit 3 dhe Testit 4

Kod Kredie	Kredia e çelur ekziston në Gjendje	Kredia e çelur ekziston në Gjendje Kredie	Klienti	Vlera fillestare	Banka
------------	------------------------------------	---	---------	------------------	-------

⁷ Testi mund të mbartë riskun e gabimit në mënyrën sesi shënohen emrat e debitorëve.

	Kredie – TESTI 3 (Kodi i Kredisë)	- TESTI 4 (Emërtimi)			
01239	FALSE	TRUE	Sh.H	3,100,000.00	BTA
01150	FALSE	TRUE	H.G	2,000,000.00	BTA
00051	FALSE	TRUE	I.D	1,400,000.00	BTA
00611	FALSE	TRUE	F.M	1,100,000.00	BTA
01172	FALSE	TRUE	B.M	1,100,000.00	BTA
00839	FALSE	TRUE	G.H	1,000,000.00	BTA
00686	FALSE	TRUE	H.K	990,000.00	BTA
01200	FALSE	TRUE	Q.T	900,000.00	BTA
03501	FALSE	TRUE	Sh.B	550,000.00	BTA
05238	FALSE	TRUE	F.H	540,000.00	BTA
00813	FALSE	TRUE	P.I	500,000.00	BTA
01049	FALSE	TRUE	M.Z	500,000.00	BTA
02909	FALSE	TRUE	V.T	500,000.00	BTA
01002	FALSE	TRUE	M.H	495,000.00	BTA
01261	FALSE	TRUE	K.K	280,000.00	BTA
12107	FALSE	TRUE	D.R	269,278.00	BKT
03505	FALSE	TRUE	A.A	250,000.00	BTA
02387	FALSE	TRUE	F.LI	140,000.00	BTA
02748	FALSE	TRUE	M.D	60,000.00	BTA
03507	FALSE	TRUE	B.M	50,000.00	BTA
01194	FALSE	TRUE	F.V	49,000.00	BTA
03574	FALSE	TRUE	L.B	40,000.00	BTA
03557	FALSE	TRUE	V.K	30,000.00	BTA
03563	FALSE	TRUE	F.D	30,000.00	BTA
02674	FALSE	TRUE	K.M	18,000.00	BTA
13200	FALSE	TRUE	M.A	17,134.00	BKT
02642	FALSE	TRUE	Gj.Gj	15,600.00	BTA
02603	FALSE	TRUE	G.Sh	15,000.00	BTA
00782	FALSE	TRUE	M.H	12,000.00	BTA
00765	FALSE	TRUE	A.D	10,000.00	BTA
00630	FALSE	TRUE	R.G	10,000.00	BTA
00654	FALSE	TRUE	R.D	10,000.00	BTA
01067	FALSE	TRUE	P.M	10,000.00	BTA
04518	FALSE	TRUE	A.K	10,000.00	BTA
02796	FALSE	TRUE	P.D	10,000.00	BTA
02854	FALSE	TRUE	Gj.D	10,000.00	BTA
02071	FALSE	TRUE	O.M	8,000.00	BTA
00753	FALSE	TRUE	O.E	6,500.00	BTA
00606	FALSE	TRUE	A.B	5,000.00	BTA
02023	FALSE	TRUE	N.Z	3,600.00	BTA

Burimi: Të dhënat nga Sistemi i Kreditit të AMGKP, 2024. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Testi 5 – Kryqëzimi i listës së gjendjes së kredisë për vitet 2021, 2022 dhe 2023

Në gjendjet e kredisë për vitet 2021, 2022 dhe 2023 paraqiten respektivisht 18,143 rekorde për vitet 2021-2022 dhe 18,145 rekorde për vitin 2023, pra evidentohen 2 rekorde më shumë.

Tabela 11 paraqet gjendjen e kredive sipas monedhës dhe viteve për periudhën objekt auditimit, ndërsa në tabelën nr. 12 paraqiten rezultatet e dy debitorëve që rezultojnë më shumë në vitin 2023 nga testimi sipas variablit “Kod Klienti”.

Tabela nr. 11: Të dhëna mbi kreditë e pasqyruara në sistem për periudhën 2021 – 2023

Viti 2021	Numri	Shp.gjyqësore	Principal	Interes	shp gjyq <0	Shp gjyq= 0	SHp gjyq>0	Principal <0	Principal =0	Principal >0
Debitorë në ALL	16,750	98,365,221	4,253,570,538	10,645,197,391	10	9,344	7,396	16	7,143	9,591
Debitorë në EURO	425	8,939,521	€ 5,408,503	€ 2,267,950	1	214	210	4	143	278
Debitorë në USD	959	11,871,048	\$8,051,729	\$11,638,456	4	429	526	0	285	674
Totali	18,134	119,175,790			15	9,987	8,132	20	7,571	10,543
Viti 2022	Numri	Shp.gjyqësore	Principal	Interes	shp gjyq <0	Shp gjyq= 0	SHp gjyq>0	Principal <0	Principal =0	Principal >0
Debitorë në ALL	16,750	97,169,015	4,204,144,943	10,539,308,206	10	9,470	7,270	21	7,273	9,456
Debitorë në EURO	425	8,284,891	€ 5,366,000	€ 2,247,548	0	221	204	3	151	271
Debitorë në USD	959	11,718,748	\$7,999,695	\$11,640,011	1	438	520	0	289	670
Totali	18,134	117,172,654			11	10,129	7,994	24	7,713	10,397
Viti 2023	Numri	Shp.gjyqësore	Principal	Interes	shp gjyq <0	Shp gjyq= 0	SHp gjyq>0	Principal <0	Principal =0	Principal >0
Debitorë në ALL	16,752	96,432,930	4,157,858,182	10,396,921,145	8	9,704	7,040	31	7,535	9,186
Debitorë në EURO	425	8,151,223	€ 5,316,629	€ 2,235,117	0	225	200	2	157	266
Debitorë në USD	959	11,235,938	\$7,824,070	\$11,360,436	1	450	508		303	656
Totali	18,136	115,820,091			9	10,379	7,748	33	7,995	10,108

Burimi: Të dhënat nga Sistemi i Kreditit të AMGKP, 2024. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Tabela nr. 12: Rekordet e paraqitura nga krahasimi i klientëve në gjendje kredie për periudhën 2021-2023

Kod klienti	Kod kredie	Debitori	Monedha	Shpenzime gjyqësore	Principal i mbetur	Shpenzime interesi
RP04	00824	R P	ALL	7,000.00	0.00	0.00
SS00	00879	S Sh	ALL	0.00	-1,027,825.00	0.00

Burimi: Të dhënat nga Sistemi i Kreditit të AMGKP, 2024. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Në sistemin elektronik evidentohen raste të paraqitjes së vlerave zero, pozitive dhe negative të shpenzimeve gjyqësore, principalit të mbetur dhe interesit në listat e gjendjes së kredisë sipas periudhave përkatëse kohore. Nga intervistat e zhvilluara me subjektin, sipas procedurës së kryer nga ata lidhur me debitorët, gjendja zero në sistem përfaqëson dosje të mbyllura, ku detyrimet janë shlyer. Ndërkohë, vlera negative paraqet kryerje të pagesave nga debitorët për të gjitha vlerat përkatëse, por nuk janë realizuar procedurat e mbylljes, pasi debitorët nuk kanë paraqitur kërkesë për mbyllje; apo rastet kur një pronë është vendosur si kolateral, ose debitori paraqitet si debitor pas ekzekutimit të kolateralit.

Për më tepër, sistemi nuk ofron një pasqyrë të kolateraleve të debitorëve, më qëllim analizimin e tyre dhe marrjen e masave përkatëse nga Agjencia. Sistemi i Kreditit ka të shënuar në kartelat përkatëse të debitorëve faktin nëse kredia ka kolateral, por jo vlerën e saj, pasi nga Agjencia deklarohet se këto kolaterale nuk kanë patur vlerë të përcaktuar në treg në momentin e marrjes së kredisë, si dhe përgjatë viteve nuk janë kryer vlerësime të tyre (*Trajtuar më hollësisht në Drejtimin - Administrimi i kolateraleve të kaluara në pronësi të AMGKP-së, si dhe zbatimi i procedurave të shitjes së tyre*).

Duke qenë se Sistemi i Kreditit shërben si bazë për trajtimin e debitorëve rast pas rasti sepse nga ky sistem nxirren të dhëna, ai paraqitet një rëndësi të veçantë për të ofruar një pasqyrim të saktë të numrit të kredive, vlerave të tyre dhe të dhënave të tjera që administrohen në këtë sistem. Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga plotësimi i pyetësorit lidhur me sistemin, rezultojnë mangësitë e mëposhtme:

- *nuk disponohet informacion nga Agjencia në lidhje me kontratën për ndërtimin e sistemit, e cila do të përcaktonte edhe të drejta e detyrime për Autoritetin Kontraktor (Agjencia) dhe Kontraktorin;*
- *nuk disponohet informacion mbi marrjen në dorëzim të sistemit, urdhrin për ngritjen e grupit e punës që ka realizuar hedhjen manuale në sistem, apo për procesverbalet e hedhjes së të dhënave në sistem;*
- *nuk disponohet rregullore/manual për përdorimin e sistemit.*

Gjithashtu, referuar informacionit të vënë në dispozicion nga Agjencia, disa prej veprimeve lidhur me arkëtimet e debitorëve përpara vendosjes në punë të Sistemit, nuk janë të reflektuara në Sistem, por janë mbajtur në një dokument Excel. Kjo çënon gjurmën audituese pasi vështirëson mundësimin e një linje të qartë në arkëtime apo veprime të tjera të kryera nga debitorët përpara dhe pas implementimit të Sistemit.

Nga Agjencia është vënë në dispozicion databaza e dërguar drejt Bankës së Shqipërisë për 3,744 debitorë të identifikuar me ID. Megjithatë, nga të dhënat mbi klientë të çelur, evidentohen 6,547 rekorde me të dhëna të plotësuara për fushat “Emër klienti”, “datëlindje”, “vendlindje”, “adresë”, duke paraqitur një diferencë të lartë prej 2,803 klientësh të paidentifikuar dhe rrjedhimisht të padërguar drejt BSH për marrjen e masave të mëtejshme për arkëtimin e detyrimit të tyre. Marrëveshja e bashkëpunimit me Zyrën e Gjendjes Civile paraqitet mjaft me rëndësi në kuadër të identifikimit të debitorëve, apo trashëgimtarëve të tyre në rastet kur plotësohen kushtet për çelje trashëgimie. Ndërsa, sa i takon debitorëve që kanë ndërruar jetë, në Sistem nuk paraqitet asnjë e dhënë për këtë fakt, duke mos i diferencuar nga debitorë të tjerë.

Bazuar në të gjithë analizën e mësipërme, referuar mangësi të evidentuara lidhur me të dhënat e ofruara nga Sistemi i Kreditit (që nga momenti i transferimit, mospërputhjeve me inventarizimin e vitit 2014, mospërputhjen/mungesën e të dhënave në Sistem) grupi i auditimit konstaton se Sistemi i Kreditit nuk ofron një pamje të saktë të kredive të trajtuara nga Agjencia, për shkak të

mangësive në të dhëna të plotësuara ndër vite, apo prej mospërputhjeve të konstatuara në numër dhe vlerë të kredive; mangësi të trashëguara ndër vite.

Përsa trajtuar më sipër nga përfaqësuesit e subjektit, znj. R.Xh në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm aktual të AMGKP-së, deleguar në muajin prill 2024 (konceptuar nga znj. Xh.K në cilësinë e Arkivistes në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, znj. V.S në cilësinë e specialistes së Sektorit të Financës dhe Buxhetit, znj. A.Xh në cilësinë e specialistes në Sektorin e Ndjekjes së Procedurave të Ekzekutimit Përmbarimor, znj. E.Z në cilësinë e Përgjegjëses së Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Skemave të veçanta të Garancisë, znj. A.H në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, znj. K.T në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Financës dhe Buxhetit), është paraqitur observacion me shkresën nr. 2041/2 prot., datë 01.07.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 185/11 datë 03.07.2024.

Pretendimi i subjektit:

- Referuar gjetjes nr. 3 mbi kreditë e transferuara nga BBZH të cilat nuk rezultojnë të pasqyruara në Sistemin e Kreditit, sqarojmë se detyrimet për këto kredi janë detyrime përpara viteve 1990. Sipas ekspertit kontabël të marrë në vitin 2016, me vendimin nr. 50, datë 01.12.2007, z. I.C, shprehet se lista e këtyre debitorëve nuk plotëson kushtet e marrjes në konsideratë për një kontabilizim korrekt. Agjencia i ka mbajtur të evidentuara në Excel kreditë e transferuara nga BBZH pasi nuk është e mundur të saktësohet vlefshmëria juridike. Dokumenti që ne disponojmë është pa firmë dhe pa vulë.

- Referuar gjetjes nr. 3 mbi veprimet lidhur me arkëtimet e debitorëve përpara vendosjes në punë të Sistemit të cilat nuk janë reflektuar në sistem, por mbahen në format dokumenti Excel veçmas, sqarojmë se çelja e sistemit të kreditit është bërë në vitin 01.01.2004 me detyrimin gjendje të debitorëve. Deri në këtë datë detyrimet janë mbajtur në ditarë Excel duke zbritur arkëtimet dhe llogaritur interesat. Në vite të ndryshme, trajtimi i debitorëve ka qenë i ndryshëm. Me daljen e VKM nr. 450, datë 16.06.2010 dhe Udhëzimit nr. 33, datë 24.09.2010, debitorit i falën 100% interesat e transferuar dhe të llogaritura në rast shlyerje të menjëhershme të detyrimit. Kur debitori kërkon shlyerje të menjëhershme të detyrimit, nga sektori i financës i jepet gjendja aktuale e detyrimit duke zbritur nga principali të gjitha arkëtimet që mund të jenë kontabilizuar për interesa, pas verifikimit të arkëtimeve, pavarësisht se ku mund të jenë kontabilizuar. Për çdo detyrim të dhënë, shikohet dosja e debitorit, kartela dhe verifikohet çdo arkëtim i mundshëm, edhe ato që nuk janë në kartelë përpara datës 01.01.2004, për të mos lejuar gabime në detyrimet e debitorëve.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Përsa më sipër, grupi i auditimit sqaron se:

- Në gjetjen nr. 3, grupi i auditimit ka konstatuar situatën aktuale lidhur me pasqyrimin e kredive të transferuara nga Banka Bujqësore për Zhvillim, të mbajtura në format Excel veçmas Sistemit të Kreditit. Edhe pse nga ana e subjektit është cituar Vendimi nr. 50, datë 01.12.2007 mbi listën e debitorëve të BBZH, ky vendim nuk gjendet bashkëlidhur observacionit.

- Gjithashtu, edhe për pretendimin e subjektit mbi arkëtimet e debitorëve përpara vendosjes në punë të Sistemit të Kreditit, grupi i auditimit evidenton faktin se mbajtja veçmas e arkëtimeve përpara vitit 2004, cënon reflektimin e saktë të kredive në Sistemin e Kreditit, duke bërë të nevojshëm rakordimin edhe me formatin Excel për nxjerrjen e detyrimit aktual për kreditë.

Sa më sipër, observacioni nuk sjell fakte apo dokumentacione të reja dhe rrjedhimisht nuk ndryshon gjetjet e grupit të auditimit.

- Mbi vlerësimin e zbatimit të masave të marra përmes shqyrtimit të 9 dosjeve të kredive që paraqiten me vlerë të lartë të detyrimit të mbetur dhe pa arkëtime gjatë periudhës objekt auditimi:

Me qëllim evidentimin e masave të marra mbi kredi që janë në proces (jo të likuiduara), grupi i auditimit bazuar në të dhënat e ofruara nga Sistemi i Kreditit, ka përzgjedhur 9 dosje në proces, për periudhën objekt auditimi të cilat rezultojnë pa arkëtime, dhe kanë vlerë të larta të detyrimit të mbetur referuar monedhës përkatëse. Përzgjedhja është bërë nisur nga 3 kreditë me vlerat më të larta në secilën monedhë, në datën 31.12.2023.

Dosje te zgjedhura ne ALL					
Nr.	Kodi i klientit	Kodi i kredisë	Klienti	Shpenz. gjyq	Principali
1	SA01	07003	Sh.A	24,000.00	22,456,880.00
2	SA024	62149	S.A	0.00	20,693,295.00
3	NL047	38376	N.L	24,000.00	2,300,000.00
	NL046	38377	N.L	0.00	3,678,400.00
4	ET03	10121	E.T	37,050.00	30,233,037.17
				Vlera e dosjeve	79,361,612.17
				Vlera e sistemit ne ALL 2023	4,157,858,182
				Ne %	1.91%

Dosje te zgjedhura ne EUR					
Nr.	Kodi i klientit	Kodi i kredisë	Klienti	Shpenz. gjyq	Principali
1	AB33	12108	A.B	24,970.00	244,623.51
2	AM27	12004	A.K.M	118,010.00	213,062.48
3	AB32	12114	A.B	92,550.00	108,145.39
				Vlera e dosjeve	565,831.38
				Vlera e sistemit ne EUR 2023	5,316,629.00
				Ne %	10.64%

Dosje te zgjedhura ne USD						
Nr.	Kodi i klientit	Kodi i kredisë	Klienti	Kredia	Shpenz. gjyq	Principali
1	LK033	42064	L.K	L.K - Kredi BK	5,500.00	100,000.00
2	VS002	90021	V....	V.... - Kredi BK	1,420.00	57,575.00
3	NL041	38382	N.L	N.L - Kredi BK	0.00	98,135.00
					Vlera e dosjeve	255,710.00
					Vlera e sistemit ne USD 2023	7,824,070.00
					Ne %	3.27%

1) Dosja nr. – N/A

Kodi kredisë – N/A

Debitori – z. Sh.A

Sipas sistemit të kreditit:

Vlera fillestare e transferuar e kredisë më datë 30.09.1998, nga BTA, rezulton me principal 22,456,880 lekë dhe interes 4,653,718 lekë.

Kodi kredisë – 07003

Kodi klientit – SA01

Sipas inventarit të brendshëm të dosjes, dokumentat, pjesë e saj janë të periudhës 1995 deri në vitin 2015.

Nga dokumentacioni në dosje konstatohet se me shkresën nr. 549/1 prot., datë 26.04.2007 nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Durrës i është kthyer përgjigje Agjencisë së z. Sh.A ka të regjistruar në ZVRPP Durrës një shtëpi banimi 3 kate me nr. hipotekor 11807 datë 23.07.1998, e cila është vënë në sekuestro për llogari të zyrës përmbarimore, ndërsa me Vendimin e zyrës përmbarimore nr. 1249 datë 21.12.2000, kati i dytë i banesës i ka kaluar z. S.V.P me nr. hipotekor 1045 datë 21.12.2000. Me shkresën nr. 1060 prot., datë 23.01.2008 është marrë vendimi për pushimin e urdhrin të ekzekutimit, duke qenë se objekti në pronësi të z. Sh.A ka kaluar në pronësi të personave të tretë, sipas shkresës nr. 2522 datë 30.11.2007 të ZVRPP Durrës. Konkretisht kati

përdhe dhe kati i tretë, shitur fondacionit “N.....”. Në dosje nuk gjendet shkresa e kalimit të pronësisë në favor të fondacionit. Me shkresën nr. 497/1 prot., datë 22.03.2008 nga Agjencia, drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, është kërkuar fotokopje e njehsuar me origjinalin e kontratës së shitjes dhe informacion për pasurinë “magazinë+truall i lirë 100 m katror”, Durrës, vendosur si garanci në favor të bankës.

Në dosje nuk gjendet shkresë kthim përgjigje. Në vitin 2019, me shkresat nr. 5289 prot., dhe nr. 5290 prot., datë 16.09.2009 nga Agjencia është kërkuar informacion nga Zyra Rajonale e ALUIZNI-T dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, nëse disponohen pasuri të paluajtshme në emër të z. Sh.A. Nga ZVRPP Durrës me shkresën nr. 3424/1 prot., datë 24.09.2009, është kërkuar nr. hipotekor i pasurisë për të bërë të mundur identifikimin e gjendjes juridike të saj. Nga Agjencia nga viti 2009 deri në vitin 2015 nuk ka patur komunikime apo masa të tjera të marra. Konkretisht masat e fundit të marra nga Agjencia për vitin 2015 janë:

-Shkresa nr. 1387 prot., datë 16.03.2015, “Njoftim për shlyerje detyrimi”;

-Shkresa nr. 1635 prot., datë 30.03.2015, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, për saktësim të dhënash, adresën e debitorit. Në dosje nuk disponohet kthim përgjigje;

-Kërkesa nr. 3502 prot., datë 10.06.2015, drejtuar zyrës përmbarimore “Z..”, për vënien në ekzekutim të urdhër ekzekutimit nr. 30 datë 11.02.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës;

-Urdhri nr. 3991, datë 23.06.2015 “Për pagesën e tarifës paraprake të shërbimit të përmbaruesit gjyqësor privat”;

-Shkresa nr. 5860 prot., datë 02.09.2015 drejtuar Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, lënda autorizim për përfaqësim për marrjen e dokumentacionit ligjor kartelë dhe hartë treguese për pasurinë me numër hipotekor 11807, datë 23.07.1997.

Pas kësaj periudhe në dosje nuk gjendet asnjë dokumentacion tjetër në lidhje me masat e marra nga Agjencia.

Inventari i dosjes: Punuar nga znj. V.N

2) Dosja nr. – N/A

Kodi kredisë – N/A

Debitori – Shoqëria I D, përfaqësuar nga L.K

Sipas sistemit të kreditit:

Vlera fillestare e transferuar e kredisë më datë 31.08.2001, nga BK, rezulton me principal 100,000 usd dhe interes 192,144 usd.

Kodi kredisë – 42064

Kodi klientit – LK033

Nga auditimi konstatohet se në sistemin e kreditit, në menunë “Hapje kredie”, monedha rezulton “lekë”. Sipas fletës së inventarit të dosjes, dokumentet, pjesë e saj rezultojnë të periudhës 1995 - 2012. Nga dokumentacioni në dosje, konstatohet se masat e marra nga Agjencia rezultojnë si në vijim:

-Shkresa nr. 7622 prot., datë 04.03.2005, “Kërkesë për lëshimin e urdhër ekzekutimit për akt-marrëveshjen”, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër;

-Shkresa nr. 7622/1 prot., datë 04.03.2005, autorizim për përfaqësim të punonjësit të Agjencisë pranë kësaj gjykate;

-Vendimi nr. regj. them. 129 datë 14.06.2005, për lëshimin e urdhër ekzekutimit;

-Shkresa nr. 5129 prot., datë 05.09.2005, drejtuar Zyrës së Përmbarimit Shkodër, për marrjen e masave me qëllim ekzekutimin e detyrimit të debitorit;

-Me shkresën e datës 28.08.2006, informacion mbi ecurinë e dosjes së debitorit nga përgjegjësi i zyrës rajonale Shkodër citohet se në favor të Bankës janë bllokuar 2 prona, me vlerë 1,500,000

lekë secila dhe rekomandon, që nga zyra e përmbartimit Shkodër të kërkohet lirimi tyre dhe të bëhet kalimi në favor të Agjencisë;

-Me shkresën nr. 2/9 prot., datë 01.09.2006 nga Zyra e Përmbartimit Shkodër i është drejtuar Agjencisë në lidhje me vonesat, nga kjo e fundit për pagesën e avokatit, pa të cilën nuk fillohen procedurat përmbartimore;

-Me shkresën nr. 585 prot., datë 02.02.2007 (prot., në Agjenci), nga Përmbartuesi Gjyqësor është vendosur pushimi i urdhrit ekzekutiv, duke qenë pas kontrolleve të ushtruara nuk kanë rezultuar pasuri të paluajtshme në emër të debitorit;

-Shkresa nr. 1010, prot., datë 05.03.2009, njoftim për detyrimin e mbetur ndaj Agjencisë, drejtuar Zyrës Rajonale Shkodër, për dijeni "I... D...", me përfaqësues L.K;

-Shkresa nr. 259 prot., datë 29.05.2009, drejtuar Zyrës Përmbartimore Shkodër "Kërkesë për vënienë ekzekutim të detyrueshëm të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër";

-Shkresa nr. 6902/1 prot., datë 11.01.2010, shkresa për pjesëmarrje në shitjen e pasurisë së paluajtshme me ankand në datën 26.01.2010, me vlerë fillestare 3,000,000 lekë;

-Vendimi i datës 19.11.2009 "Për caktimin e ekspertit për vlerësimin e sendeve të paluajtshme";

-Vendimi i datës 31.03.2010 "Për pushimin e urdhrit të ekzekutimit", për shkak të shitjes së pronës me vlerë 1,960,000 lekë;

Mungon raporti me shkrim i ekspertit për vlerësimin e pasurisë, procedura e zhvillimit të ankandit dhe mandat pagesa/kalimi i shumës në llogari të Agjencisë nga shitja e pronës;

Me shkresën nr. 559 prot., datë 11.06.2010 nga Agjencia është kërkuar rivënienë ekzekutim për detyrimin e debitorit, duke vepruar mbi pasurinën tjetër të paluajtshme "apartament banimi";

-Shkresa nr. 2662 prot., datë 11.06.2010 drejtuar DRSHRR Shkodër, ku është kërkuar informacion nëse rezulton e regjistruar pasuria e luajtshme e tipit "kamion", në emër të debitorit, që është lënë peng në bankë, me vlerë 4,800,000 lekë;

-Shkresa nga DRSHRR Shkodër, kthim përgjigje nr. 4096/1 prot., datë 30.06.2010, ku konfirmohet se në emër të debitorit nuk ka pasuri të regjistruar;

-Shkresa nr. 2898 prot., datë 29.06.2010, drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, për tërheqjen e certifikatës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme apartament, në emër të debitorit;

-Shkresa nr. 131 prot., datë 22.06.2012 "Kërkesë për lëshimin e urdhër ekzekutimit", drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;

-Shkresa nr. 131/2 prot., datë 22.06.2012 për autorizim të punonjësit të Agjencisë, për të marrë pjesë në procesin gjyqësor;

Pas kësaj periudhe në dosje nuk gjendet asnjë dokumentacion tjetër në lidhje me masat e marra nga Agjencia;

Inventari i dosjes: Punuar nga znj. V.N

3) Dosja nr. 18

Kodi kredisë – pa kod

Debitori – S.A

Sipas sistemit të kreditit:

Vlera fillestare e transferuar e kredisë më datë 31.08.2001, nga BK, rezulton me principal 20,693,295 lekë dhe interes 29,445,177 lekë.

Kodi kredisë – 62149

Kodi klientit – SA024

Në dosje gjendet vetëm procesverbali "Për dorëzimin e dosjeve të kreditit të Degës së Bankës së Kursimeve Elbasan", mbajtur në datë 01.03.2001.

Sipas këtij procesverbali janë dorëzuar gjithsej 176 dosje të degës së Bankës së Kursimeve Elbasan, gjithsej 3,393 fletë.

Në këtë procesverbal është cituar se “...mangësitë për secilën dosje janë të evidentuara në listat përmbledhëse bashkëlidhur këtij procesverbal”.

Nga auditimi konstatohet se në dosje ndodhet lista përmbledhëse e dosjeve të konstatuara me mangësi e datës 27.02.2001 dhe të klasifikuara si të humbura, e cila përmban 89 debitorë, me 277 fletë, firmosur nga 2 përfaqësues të Agjencisë dhe 2 përfaqësues së Bankës së Kursimeve Elbasan. Për debitorin në fjalë z. S.A sipas listës përmbledhëse, dosja përmban 193 fletë dhe dokumentat, që mungojnë janë:

- Vendimi i Kom.Kreditit;
- Marrëveshja e huasë;
- Titulli i detyrimit;
- Vërtetimi i pronësisë;
- Kontrata hipotekore

Duke qenë se në dosje nuk disponohen 193 fletët e dorëzuara të këtij debitori, asnjë informacion tjetër apo masë e marrë nga Agjencia për këtë rast, grupi i auditimit nuk mund të japë një vlerësim, pasi mungon gjurma e auditimit.

Megjithatë mungesa e marrjes së masave nga Agjencia është në kundërshtim me nenin 10, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, ku citohet se: “Për huatë e transferuara në Agjencinë e Trajtimit të Kredive pa dokumentacion ligjor, që vërteton marrjen e kredisë, procesverbali i transferimit të detyrimit kontabël të këtyre huave përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga përmbaruesi gjyqësor”.

4) Dosja nr. – N/A

Kodi kredisë – N/A

Debitori – Firma V..., përfaqësuar nga B.K

Sipas sistemit të kreditit:

Vlera fillestare e transferuar e kredisë më datë 31.08.2001, nga BK, rezulton me principal 57,575 Usd dhe interes 299,348 Usd.

Kodi kredisë – 90021

Kodi klientit – VS002

Nga auditimi konstatohet se në sistemin e kreditit, në menunë “Hapje kredie”, monedha rezulton në lekë, ndërsa rekordi “Kontabiliteti” rezulton i plotësuar “BK-BK Tiranë – usd”.

Pasaktësi vërehen edhe në rekordin “Data e bllokimit të interesave” ku rezulton data 06.05.2005, ndërsa te rekordi “Data e llogaritjes së interesave” rezulton data 31.12.2005.

Sipas inventarit të brendshëm të dosjes, dokumentat, pjesë e saj rezultojnë të periudhës 1992 - 2000. Nga dokumentacioni në dosje konstatohet se masat e marra nga Agjencia rezultojnë si në vijim:

- Me shkresën nr. 7731 prot., datë 17.03.2005, kërkesë për lëshimin e urdhër ekzekutimit drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë;
- Me shkresën nr. 7331/1 prot., datë 17.03.2005, Agjencia ka autorizuar personin për ta përfaqësuar në gjykatë;
- Vendimi nr. 536 akti datë 06.05.2005, lëshim i urdhrit të ekzekutimit;
- Shkresa nr. 4765 prot., datë 29.06.2005, drejtuar Zyrës së Shërbimeve Përmbarimore Tiranë, për vënien në ekzekutim të Urdhrit të ekzekutimit;

-Shkresa nr. 63 prot., datë 31.08.2006 informacion nga përgjegjësi i zyrës rajonale Tiranë, për pritje përgjigje nga Z.R.P.P për truallin e lënë peng nga ana e debitorit, konkretisht truall me sipërfaqe 1000 m katrorë, rruga Konferenca e Pezës, Tiranë, regjistruar datë 04.05.1992;

-Shkresa nr. 9340 prot., datë 16.10.2006, drejtuar Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vënien e sekuestros konservative mbi pasurinë e paluajtshme me nr. 1543 datë 04.05.1992 në pronësi të dorëzanësit B.B.K;

-Shkresa nr. 1239 prot., datë 28.03.2007, drejtuar Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, për informacion në lidhje me pasuritë e regjistruara në emër të firmës “V...” ose z. B.K;

-Shkresa nr. 1972 prot., datë 24.04.2008, “*Autorizim për tërheqjen e çertifikatës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme në emër të debitorit firma V..., me përfaqësues B.K*”;

-Shkresa nr. 3777 prot., datë 31.03.2008, drejtuar Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, për pajisjen e Agjencisë me çertifikatë dhe kartelat e pasurisë për pasurinë e paluajtshme truall 1000 m katror;

-Vendimi nr. 20069 prot., datë 28.12.2009 i përmbauesit gjyqësor “*Për pezullimin e Urdhrit të Ekzekutimit*” me argumentin e mosparaqitjes për një kohë të gjatë të dokumentacionit të pronësisë pranë Zyrës së Përmbaimit Tiranë. Vendim i pa-ankimuar nga Agjencia në Gjykatë;

-Shkresa nr. 383 prot., datë 27.01.2010, drejtuar noterës znj. M.S me lëndën “*Autorizim për përfaqësim*” për tërheqjen e dosjes së privatizimit në kontratën shtesë nr. 3397/925, datë 02.05.1992, dokument që nevojitet për tërheqjen e çertifikatës së pronësisë, sipas shkresës nr. 2342 prot., datë 20.05.2008 të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.

Veprimet nga ana e Agjencisë rezultojnë me vonesa të konsiderueshme duke sjellë risk të shtuar me pasojë mosarritjen e vjeljes së detyrimit në kohë;

-Shkresa nr. 1048 prot., datë 11.03.2010, drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile, ku nga ana e Agjencisë kërkohet çertifikata e trungut familjar, përbërjes familjare, lindjes dhe trashëgimtarëve të tij dhe çertifikata e vdekjes (*nuk disponohet dokumentacion mbi kohën që Agjencia është vënë në dijeni se ky debitor ka ndërruar jetë*) me qëllim kërkimin në gjykatë të lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë;

-Shkresa nr. 365/1 prot., datë 18.03.2010 e Njësisë Bashkiake nr. 10, ku konfirmohet se z. B.K rezulton i vetëm në familje, bashkëlidhur gjendet dhe çertifikata e vdekjes, e cila mban datën 23.05.2001. Nga Agjencia evidentohet një mungesë komunikimi prej gati 10 vitesh me zyrën e gjendjes civile për evidentimin e këtij fakti.

Agjencia pavarësisht këtij fakti jo vetëm që nuk ka marrë masa për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, marrjen e çertifikatës të pronësisë së truallit dhe vijimin e procedurave të mëtejshme për shitje në ankand, por ka vijuar t'i dërgojë shkresa lajmërimi për ekzekutim vullnetar firmës dhe z. K, duke treguar në këtë mënyrë mungesë përgjegjshmërie në lidhje me njohjen e dosjes dhe trajtimin e saj me seriozitet dhe korrektësi.

Konkretisht:

-Shkresa nr. 1294 prot., datë 11.02.2016 “Lajmërim për ekzekutim vullnetar”;

-Shkresa nr. 2761 prot., datë 23.03.2016 nga Zyra Përmbaimore Tiranë, drejtuar Agjencisë, për saktësim të adresës së debitorit Firma V... me administrator B.K;

Kjo e fundit madje ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 2110/1 prot., datë 07.04.2016 duke i cituar si në vijim:

“...firma V..., B.K rezulton i datëlindjes 21.02.1966 dhe banues në Rr. Qamil Guranjaku nr. 9 Tiranë.

Pas kësaj periudhe në dosje nuk gjendet asnjë dokumentacion tjetër në lidhje me masat e marra nga Agjencia.

Inventari i dosjes: Punuar nga - mungon

5) Dosja nr. – N/A

Kodi kredisë – N/A

Debitori – Firma O....., A.B

Sipas sistemit të kreditit:

Vlera fillestare e transferuar e kredisë më datë 30.06.2000, nga BKT Kavajë, rezulton me principal 478,442 euro dhe interes 262,309 euro.

Kodi kredisë – 12108

Kodi klientit – AB33

Sipas fletës së inventarit të dosjes, dokumentat pjesë e saj rezultojnë të periudhës 1994 deri në vitin 1995. Nga verifikimi i dokumentacionit, pjesë e dosjes konstatohet se masat e marra nga Agjencia rezultojnë si në vijim:

-Vendimi nr. regj. them. 606/25, datë 22.01.2004 i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka pranuar kërkesën e palës paditëse, Agjencisë kundër të paditurëve: Zyra e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Kavajë, A.B dhe Shoqërisë O..... SHPK Rrogozhinë;

Objekti: pavlefshmëria e veprimit juridik të akt-dhurimit të datës 29.10.1996, me rep. nr. 847 kol për **objektin nr. 4** magazinë ambalazhi (reparti salcës) Rrogozhinë, objekt i vendosur si hipotekë në favor të B.K.T.

-Shkresa nr. 2600 prot., datë 04.06.2004, kërkesë e Agjencisë, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë, Kavajë, për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit;

-Shkresa nr. 2600/1 prot., datë 04.06.2004, autorizim i Agjencisë për përfaqësim në Gjykatë;

-Urdhër Ekzekutimi nr. 74 datë 02.09.2004, pranimit dhe lëshimit të urdhrë ekzekutimit;

-Shkresa nr. 1947 prot., datë 21.10.2004, drejtuar Zyrës së Përmbartimit Kavajë, për vënien në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit;

-Shkresa nr. 1219/1 prot., datë 30.03.2005 e Agjencisë, drejtuar Zyrës së Përmbartimit Kavajë, për rivendosjen e vendimit të ekzekutimit, pasi nuk është ekzekutuar tërësisht duke qenë se është realizuar vetëm ri-regjistrimi i hipotekës në favor të Agjencisë;

-Shkresa nr. 2531/1 prot., datë 10.07.2006 e Agjencisë, drejtuar Komisarariatit të Policisë Peqin, me dijeneri z. Ahmet Bala, si punonjës i këtij Komisarierati;

-Shkresa nr. 5285 prot., datë 16.09.2009 e Agjencisë, drejtuar Zyrës Rajonale të Aluiznit me lëndën “Kërkesë për informacion për pasuri të paluajtshme të legalizuara ose në proces legalizimi për debitorin A.B”;

-Shkresa nr. 306 prot., datë 07.08.2009 e Agjencisë, drejtuar Zyrës së Shërbimeve Përmbartimore Kavajë, për vënien në ekzekutim të detyrueshëm të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë;

-Shkresa nr. 375 prot., datë 14.09.2009, urdhër për vënien e sekuestros konservative, drejtuar Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë;

-Shkresa nr. 5719/1 prot., datë 15.10.2009 e Agjencisë, drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë;

-Shkresa nr. 1319/1 prot., datë 15.10.2009, kthim përgjigje e shkresës nr. 375, prot., datë 14.09.2009 e cila kërkon një përfaqësues nga Agjencia për të kryer aplikimin së bashku me një kopje të pronësisë për pronën që kërkon të vendos sekuestro konservative;

Mungon paraqitja dhe aplikimi nga ana e Agjencisë në lidhje me kërkesat e shkresës nr. 1319/1 prot., datë 15.10.2009.

-Vendimi nr. 375 prot., datë 26.10.2009 i përmbartuesit gjyqësor “Për caktimin e ekspertit për vlerësimin e sendeve të paluajtshme”, znj S.S, e cila duhet të paraqesë një raport brenda 15 ditësh;

Në dosje gjendet një shkresë e specialistit të zyrës rajonale të Agjencisë, Durrës –Kavajë, e datës 02.11.2009, protokolluar në Agjenci me nr. 6123, datë 04.11.2009, me lëndën mendim për vlerësim kolateralesh për 4 debitorë, ndër të cilët dhe për kolateralin e A.B;

-Raporti vlerësimi i ekspertit është dorëzuar në datën 15.07.2010, pra rreth 8 muaj më vonë se afati i përcaktuar në vendimin nr. 375, prot., datë 26.10.2009;

Sipas këtij raporti, akt ekspertimi teknik, vlerësuar me metodën e krahasimit të drejtëpërdrejtë objekti repart bashkë me truall është vlerësuar 6,000,000 lekë, me firmë dhe vulë të ekspertes ing. S.S, konkretisht:

*300 m katror * 20,000 lekë/m katror= 6,000,000 lekë*

Në dosje gjendet gjithashtu vetëm 1 faqe e shkëputur akt ekspertimi teknik për vlerësim apartamenti 85 m katror, gjendur brenda repartit, vlerësuar 4,250,000 lekë, firmosur nga ekspertja ing. S.S, data 15.07.2010, pa vulë, konkretisht:

*85 m katror * 50,000 lekë/ m katror = 4,250,000 lekë*

Në shkresën nr. 375 prot., datë 29.07.2010, nga Zyra Përmbartimore Kavajë është dërguar në Agjenci, fatura për tatimore e akt ekspertimit, prej 20,000 lekë, bashkëlidhur dhe akt-ekspertimi i ekspertes, vetëm me pjesën e vlerësimit të 300 m katrorë në vlerën 6,000,000 lekë, pa pjesën e akt-ekspertimit të vlerësimit të apartamentit;

-Procesverbali nr. 375 prot., datë 15.12.2010, ku u vendos mbyllja e ankandit të parë për shitjen e pasurisë magazinë me sipërfaqe 300 m katrorë, për mosparaqitjesh ofertuesish për blerje, me çmim 4,800,000, me 20% më të ulët se vlerësimi prej 6,000,000 lekë, duke ndjekur procedurat për ankand të dytë me çmim të ri brenda 10 ditëve dhe të zhvillojë ankandin e ri jo më vonë se 15 ditë nga caktimi i çmimit të ri; Në dosje nuk disponohet shpallja apo procedura e ndjekur e ankandit.

-Shkresa nr. 375 prot., datë 18.01.2011 e Zyrës Përmbartimore Kavajë, drejtuar kreditorit (Agjencisë) dhe debitorit (A.B), për zhvillimin e ankandit të dytë në datën 01.02.2011, me vlerë 3,840,000 lekë, 20% më të ulët se vlera e ankandit të parë;

-Procesverbali i datës 01.02.2011, mbyllja e ankandit të dytë pa ofertues dhe i është propozuar palës kreditore Agjencisë, të marrë në pronësi pasuritë e debitorit në vlerën e ankandit të dytë.

-Shkresa nr. 1215 prot., datë 04.03.2011 e Agjencisë drejtuar Zyrës Përmbartimore Kavajë, për miratimin e marrjes në pronësi të objektit;

-Vendimi nr. 375 prot., datë 16.05.2011, sipas të cilit citohet se Agjencia ka pranuar të marrë në pronësi pasuritë e debitorit A.B me shkresën nr. 1215 prot., datë 04.03.2011 dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë të kryejë veprimet për regjistrimin e pasurisë në pronësi të Agjencisë;

-Shkresa nr. 2520/1 prot., datë 05.07.2011, drejtuar ZVRPP Kavajë, lënda autorizim për përfaqësim të punonjësit të Agjencisë për nxjerrjen e çertifikatës së pronësisë;

-Vendimi nr. 12-2017-1640/570, datë 18.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas së cilit:

**gjykata ka vendosur pranimin e paditësve F.B dhe A.B, kundër të paditurve Agjencia dhe Zyra Përmbartimore Kavajë, Avokatura e Shtetit Durrës si palë e tretë.*

**detyrimin e Agjencisë dhe Zyrës Përmbartimore t'i kthejë paditësve sendin e paluajtshëm magazinë me sipërfaqe 300 m katrorë, regjistruar në hipotekë në regjistrin 1992-1994, faqe nr. 94, indeks 282, vol 3, në bashkëpronësi të paditësve, duke i detyruar të paditurit t'i njohin të drejtën e bashkëpronësisë paditësve në këtë pasuri.*

-Shkresa nr. 10535 prot., datë 17.11.2017, drejtuar Gjykatës së Apelit Durrës nga Agjencia, “Kundërshtim i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë”;

Në dosje mungon vendimi i Gjykatës së Apelit. Megjithatë nisur nga Rekursi nr. 700 prot., datë 07.02.2020 evidentohet se Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; Nga ana e Agjencisë është bërë rekurs duke kërkuar rrëzimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës dhe pushimin e gjykimit, si të pambështetur në ligj dhe prova.

Inventari i dosjes: Punuar nga - mungon

6) Dosja nr. – N/A

Kodi kredisë – N/A

Debitori – z. N.L

Sipas sistemit të kreditit:

Nga auditimi konstatohet se janë transferuar 3 kredi, me vlerë fillestare të transferuar si në vijim:

1) *Më datë 31.08.2001, nga BK Lezhë, rezulton me principal 98,135 Usd dhe interes 67,650 Usd.*

Kodi kredisë – 38382

Kodi klientit – NL041

2) *Më datë 31.08.2001, nga BK Lezhë, rezulton me principal 2,300,000 lekë dhe interes 2,665,404 lekë.*

Kodi kredisë – 38376

Kodi klientit – NL047

3) *Më datë 31.08.2001, nga BK Lezhë, rezulton me principal 3,678,400 lekë dhe interes 3,737,005 lekë.*

Kodi kredisë – 38377

Kodi klientit – NL046

Sipas sistemit të kreditit, plotësimi i rekordeve të datës së bllokimit të interesit nuk përputhet me rekordin e datës së llogaritjes të interesit. Konkretisht data e bllokimit të interesit rezulton 20.05.2005, ndërsa data e llogaritjes së interesit 31.12.2005. Sipas inventarit të brendshëm të dosjes, dokumentat që rezultojnë pjesë janë të periudhës 1995 - 2016. Nga inventari i dosjes evidentohet se masat e marra nga Agjencia rezultojnë si në vijim:

-Shkresa nr. 3079/1 prot., datë 07.07.2023, kërkesë e Zyrës Rajonale Shkodër për lëshim urdhër ekzekutimi;

-Vendimi nr. Regj. Them. 24 datë 23.04.2004 i Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, për lëshimin e Urdhër Ekzekutimit, për vlerën e detyrimit prej 6,115,494 lekë, kredia me kod 38376 lekë;

-Vendimi nr. Regj. Them. 51 datë 06.09.2004 i Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, për lëshimin e Urdhër Ekzekutimit, për vlerën e detyrimit prej 192,466 Usd (principal 98,135 usd dhe interes 94,331 usd), kredia me kod 38382;

Në dosje nuk gjendet dokumentacion për kërkesë dhe vendim për lëshim urdhër ekzekutimi për kredinë me kod 38377;

-Shkresa nr. 7758 prot., datë 21.03.2005, “Kërkesë për lëshim urdhër ekzekutimi”, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë;

-Shkresa nr. 7758/1 prot., datë 21.03.2005, “Autorizim për përfaqësim në Gjykatën e Shkallës së Parë Lezhë”;

-Shkresa nr. 7947 prot., datë 25.03.2005, “Kërkesë padi”, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, për pagimin e detyrimit në lekë;

-Shkresa nr. 7947/1 prot., datë 25.03.2005, “Autorizim për përfaqësim në Gjykatën e Shkallës së Parë Lezhë”;

-Shkresa nr. 4399 prot., datë 04.05.2005 drejtuar Zyrës së Shërbimeve Përmbartimore Lezhë, për vënien në ekzekutim të detyrueshëm të vendimit nr. 41 datë 06.09.2004, vetëm për pjesën e kredisë në USD;

-Shkresa nr. 254/c prot., datë 09.03.2006 e Zyrës Përmbaremore Lezhë, vendim “Pushim i urdhrin të ekzekutimit kur nuk ka pasuri debitori”;

-Informacion i datës 28.08.2006 mbi ecurinë e dosjes së huamarrësit N.L, nga Zyra Rajonale Shkodër. Sipas këtij informacioni rezulton se debitori ka 3 kredi të pashlyera. Evidentohet se pasuria e lënë peng në favor të bankës është: *një magazinë, objekt mulliri, peshore, furrë buke, qendër e përpunimit të qumështit, me sipërfaqe të përgjithshme 7,207 m katrorë dhe vlerë 18,112,000 lekë*. Në këtë informacion evidentohet gjithashtu se është kërkuar informacion zyrtarisht nga Z.R.P.P Lezhë, por pa përgjigje. Në dosje nuk gjendet kjo korrespondencë.

-Shkresa nr. 3388/1 prot., datë 29.09.2006, drejtuar Zyrës së Përmbaremit Lezhë, kërkesë rivënie në ekzekutimit të detyrimit në Usd;

-Shkresa nr. 3388/2 prot., datë 03.10.2006, drejtuar Zyrës së Përmbaremit Lezhë, kërkesë rivënie në ekzekutimit të detyrimit në lekë;

-Shkresa nr. 1079/1 prot., datë 28.03.2007, drejtuar Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë, për verifikim të pasurisë të këtij debitori;

-Shkresa nr. 107 prot., datë 12.03.2007 e Zyrës Rajonale Shkodër, drejtuar Agjencisë. Sipas kësaj shkrese nga Z.R.P.P Lezhë është konfirmuar pronësia dhe meqenëse nga ana e Zyrës së Përmbaremit Lezhë dosja është pushuar, kërkohet vënia në ekzekutim e kësaj dosje me qëllim që të vijohet me shitjen në ankand;

-Shkresën nr. 1078/2 prot., datë 28.03.2007 kërkesë e Agjencisë, drejtuar Zyrës së Shërbimeve Përmbaremore Lezhë, për rivënie në ekzekutim të detyrimit;

-Shkresa nr. 385/B prot., datë 17.05.2007, vendim për transferimin e çështjes përmbaremore në Krujë, për shkak të ndryshimit të vendbanimit të debitorit;

-Shkresa nr. 44/H prot., datë 14.02.2008 vendim për transferimin e çështjes përmbaremore në Kurbin, për shkak të ndryshimit të vendbanimit të debitorit;

-Shkresa nr. 4606/1 prot., 2008 e Zyrës Rajonale Kurbin, drejtuar Agjencisë, sipas së cilës nga Zyra Përmbaremore Kurbin ka njoftuar për vendimin e pushimit të ekzekutimit, pasi debitori nuk ka pasuri. *Nga auditimi konstatohet se ky informacion është në kundërshtim me informacionin e shkresës nr. 107 prot., datë 12.03.2007 ku është konfirmuar se debitori në fjalë rezulton me pasuri;*

-Shkresa nr. 380 prot., datë 18.02.2008, lajmërim për ekzekutim vullnetar;

-Shkresa nr. 1458 prot., datë 25.03.2008, drejtuar Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë, autorizim për përfaqësim të punonjësit të Agjencisë, për tërheqjen e dokumenteve të pronësisë për debitorin;

Në dosje nuk disponohet çertifikata e pronësisë.

-Shkresa nr. 795 prot., datë 04.04.2008, drejtuar Komisarariatit të Policisë Kurbin, për mbështetje të forcave të policisë në ekzekutimin e urdhrin të ekzekutimit nr. 51 datë 06.09.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë;

-Shkresa nr. 2371 prot., datë 28.10.2008, vendim “Pushim i urdhrin të ekzekutimit” kur nuk ka pasuri debitori;

-Shkresa nr. 297 prot., datë 17.10.2012 kërkesë e Agjencisë drejtuar Zyrës Zyrë Përmbaremore Private Anastas Kote, për vënie në ekzekutim të titullit ekzekutiv;

-Me shkresën pa datë, viti 2012 është lidhur kontrata e shërbimit me këtë zyrë;

-Shkresa nr. 50/2012, datë 18.10.2012, e Zyrës Përmbaremore Private, lajmërim për ekzekutim vullnetar;

-Shkresa nr. 50/2012, datë 23.10.2012, urdhër për bllokim, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor Lezhë, Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë,

Bankave të nivelit të dytë. Nga kjo e fundit është kërkuar vendosja e masës së sekuestros konservative;

-Shkresa nr. 3259 prot., datë 05.09.2014, drejtuar Shoqërisë së Shërbimit Përmbarrimor “Z...”, për vendosjen në ekzekutim;

-Shkresa nr. 165 prot., datë 10.02.2014 e Zyrës Përmbarrimore Private “A.K”, drejtuar Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë, “*Urdhër i përsëritur për vendosjen e sekuestros konservative*”;

-Shkresa nr. 429/1 prot., datë 27.02.2014, kthim përgjigje nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë. Sipas kësaj shkrese “*është vendosur sekuestro nga përmbarrimi nr. 3086 prot., datë 26.10.2012*”;

-Shkresa e datës 11.09.2014, vendim për pranimin e kërkesës së Agjencisë për vazhdimin e procesit të ekzekutimit, njoftim për ekzekutimin e UE nga shoqëria përmbarrimore “Z....”, Vendim nr. 29 datë 20.05.2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë;

-Shkresa e datës 27.03.2015, sërish njoftim për vazhdimin e UE, nga shoqëria përmbarrimore “Z...”, vendim nr. 29 datë 20.05.2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë;

Pra edhe 6 muaj më vonë nga kjo Zyrë vijohet me shkresa formale, pa asnjë ecuri të mëtejshme në ekzekutim.

Nga Agjencia është bashkëpunuar me 2 zyra përmbarrimore private, veprim i cili ka rritur kostot, por as nuk ka sjellë ndonjë vlerë të shtuar në lidhje me zhvillimin dhe ekzekutimin e UE.

-Shkresa nr. 6615, prot., datë 28.09.2016, drejtuar Zyrës Përmbarrimore Shtetërore Tiranë, ku kërkohet informacion mbi arsyet përse nga kjo Zyrë procedura për ekzekutim të detyrimeve për 36 debitorë ka mbetur në fazën e “lajmërimit për ekzekutim vullnetar”, ndër të cilët edhe debitori N.L;

Në dosje nuk disponohet asnjë shkresë tjetër pas kësaj periudhe.

Inventari i dosjes: Punuar nga - mungon

7) Dosja nr. – N/A

Kodi i kredisë – N/A

Debitori – “A...” SHPK, përfaqësuar nga z. A.M

Sipas sistemit të kreditit:

Vlera fillestare e transferuar e kredisë më datë 30.06.2000, nga BKT-AID3, rezulton me principal të transferuar 416,714 Euro dhe interes 152,687.7 Euro.

Kodi i kredisë – 12004

Kodi i klientit – AM27

Sipas fletës së inventarit të dosjes, dokumentat pjesë e saj janë të periudhës 1993 deri në vitin 2013. Referuar dokumentave të dosjes, kredia është miratuar sipas Vendimit të Komisionit të Miratimit të Kredisë Gjermane në Degën e Bankës Kombëtare Tregtare Fier të datës 16.08.1995, ndërmjet shoqërisë “A...” SHPK me administrator z. A.M (krijuar më 08.06.1994 sipas statutit të shoqërisë) dhe BKT Fier. Për këtë kredi është lënë garanci prona me sipërfaqe 80 m² në pronësi të shtetasit V.N e regjistruar sipas transkriptimit nr. 1291, datë 15.11.1993 të Hipotekës së Rrethit Fier, me indeks 951, transkriptuar me nr. 167 në regjistrin e pasurisë bankare për llogari të Bankës Kombëtare Tregtare në datë 04.03.1994. Referuar deklaratës së datës 21.09.1994, prona e cituar është lënë peng në favor të Bankës Kombëtare Tregtare për kredinë e marrë nga z. A.M deri në shlyerjen e plotë të saj. Kontrata e hipotekimit ndërmjet z. V.N dhe Bankës Kombëtare Tregtare specifikon të dhëna të plota mbi pronën e lënë kolateral si: përmasat, kufitarët, vendndodhja, vlera e përgjithshme e objektit të hipotekuar e cila rezulton 2,108,593 lekë. Kredia është transferuar tek Agjencia e Trajtimit të Kredive, e cila në vitin 2002 vërteton se detyrimi i regjistruar në kontabilitet

i z. A.M është 213,062.48 Euro principal, 91,917.04 Euro interes (31.08.2002), shpenzime përmbarimi 9,149.39 Euro dhe shpenzime gjyqësore 200 Lekë.

Referuar masave të marra nga Agjencia për pagesën e detyrimit të debitorit, nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se:

-Agjencia ka kërkuar vendosjen e urdhër ekzekutimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier përmes shkresës nr. 239/1 prot., datë 18.03.2002. Gjykata ka lëshuar Urdhër Ekzekutimi me nr. 162, datë 02.04.2002 për akt detyrimin e datës 05.10.1995;

-Më datë 11.09.2002 Agjencia i ka kërkuar Zyrës së Shërbimeve Përmbarimore Fier vënien në ekzekutim të detyrueshëm të Vendimit të Gjykatës. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier ka deklaruar për Zyrën Përmbarimore Fier se në emër të z. A.M është pasuria e llojit apartament me nr. pasurie 5/156+1-4, Vol. 1, fq. 119 me sipërfaqe ndërtimi 76.1 m², ZK. 8533, Fier. Ndërsa sa i takon dorëzanësit, Gjykata e Rrethit Fier me Vendimin nr. 15, datë 07.01.1993, ka vërtetuar faktin se z. V.N ka ndërtuar një banesë tri katëshe, me leje të rregullt ndërtimi, vendimi i cili ka marrë formë të prerë pa u ankimuar;

Zyra e Shërbimit Përmbarimor Fier ka bllokuar pronën (fabrikën për të cilën është marrë kredia) me nr. pasurie 67/2, vol. 6, faqe 205, ZK 3695 në pronësi të debitorit A.M dhe z. V.K, me sipërfaqe 260 m², në bashkëpronësi të pandarë. Sipas vlerësimit të datës 20.07.2003 nga Ark. L.B me nr. license A0176/3, vlera e tregut të lirë për pronën është 5,007,293 lekë.

-Agjencia përmes shkresës nr. 7228/1 prot., datë 30.08.2003 i ka kërkuar Zyrës së Përmbarimit Fier të sqarojë problemin e konfliktit me bashkëpronarët e tjerë për pronën dhe është e mendimit se nga ana e ekspertit është bërë një vlerësim jo real i objektit, me qëllim rivënien në ekzekutim të detyrimit të debitorit. Zyra Rajonale Fier e Agjencisë, ka dërguar shkresën nr. 54 prot., datë 07.11.2003 me raportet e vlerësimit të huamarrësit A.M, për objektin e të cilit është vendosur bllokim pasurie;

-Zyra Përmbarimore Fier i është drejtuar Agjencia-Dega Fier me shkresën nr. 70 prot., datë 18.11.2003, ku e ka vënë në dijeni këtë të fundit se pasuria e kredimarrësit A.M është vënë në shitje, konkretisht fabrikë qumështi me vlerë ndërtimi 5,007,293 lekë, ndërsa linja e prodhimit të qumështit kap vlerën 200,418 Euro. Në ankandin e dytë kjo shpallje është bërë me vlerë më të vogël deri në 5% ulje të vlerës së shënuar më sipër. Kërkesa e Degës Përmbarimore konsiston në marrjen e pasurisë për efekt shlyerje të kredisë nga Dega Rajonale e Agjencisë referuar nenit 577 të Kodit të Procedurës Civile. Për pronën e sekuestruar rezulton që nga Zyra Përmbarimore Fier të jetë mbajtur procesverbali nr. 70/6, datë 17.11.2003, ku për ankandin e dytë të shpallur në datën 15.08.2003, nuk është paraqitur asnjë ofertues për blerje të objektit, ndaj në këto kushte referuar nenit 577 të Kodit të Procedurës Civile do t'i drejtohet debitorit për marrje të sendit të sekuestruar për kompensim kthim kredie;

-Zyra Rajonale e Agjencisë Fier ka dhënë mendim për rishkimin e vlerësimit të ekspertit, pasi prona ka kaluar në proces gjyqësor, është lëshuar Urdhër Ekzekutimi dhe nga Agjencia ka kaluar në sekuestrim përmes Zyrës Përmbarimore Fier dhe për më tepër vlera e vënë në aktin e vlerësimit nuk i përgjigjet vlerës faktike dhe vlerës së tregut sot. Sipas propozimit nr. 2220, datë 10.12.2003, Komisioni i Posaçëm i Agjencisë propozon të mos miratohet kërkesa e Zyrës Përmbarimore Fier për kalimin në pronësi të objektit të debitorit A.M, por të kërkohen edhe pasuri të tjera dhe objekti të qëndrojnë në hipotekë. Drejtoria e Agjencisë ka miratuar Propozimin e Komisionit;

-Zyra Përmbarimore Fier ka nxjerrë Vendimin nr. 70, datë 16.12.2003 për pushimin e Urdhrit të Ekzekutimit nr. 162, datë 02.04.2002, pasi prona e sekuestruar nuk është shitur në dy ankande dhe nga Agjencia nuk është paraqitur asnjë përgjigje si dhe nuk është kryer pagesa e vlerës së ekspertizës.

-Referuar proceseve gjyqësore të ndjekura nga Agjencia, me shkresën nr. 2761 prot., datë 20.06.2003, kjo e fundit ka paraqitur Apel Kundërshtues me objekt *“Mospranimi i ankimit dhe lënies në fuqi të vendimit nr. 2126, datë 16.05.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë”*, bazuar në nenin 546 të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu është paraqitur kundër rekurs me shkresën nr. 2574/1 prot., datë 28.05.2004, ku kërkohet lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë;

Rezulton se nga ZVRPP Fier gjatë viteve janë dhënë përgjigje kontradiktore lidhur me pasuritë e z. A.M. Në prill të vitit 2003, nga ZRPP Fier është konfirmuar në pronësi të z. A.M një apartament banimi me sipërfaqe 76.1 m² në qytetin e Fierit. Në kohën që Agjencia i është drejtuar shërbimit përmbarimor për rivënien në sekuestro të shoqërisë *“A...”* SHPK me administrator z. A.M, nga ana e zyrës përmbarimore është kërkuar në ZRPP konfirmimi i pasurisë së administratorit. ZRPP përmes shkresës nr. 1725/1 prot., datë 29.12.2006, deklaron se nuk rezulton pasuri e regjistruar në emër të z. A.M;

Shkresa nr. 33/1 prot., datë 26.01.2007 e Zyrës Vendore të Regjistrimit Fier, sqaron se në pronësi të shtetasit A.M rezulton e regjistruar në bashkëpronësi pasuria nr. 67/2, vol. 6, fq. 105, ndërtesë 260 m², bllokuar në favor të Agjencisë në 09.07.2003;

Agjencia përmes shkresës nr. 480/1 prot., datë 14.02.2007, ka rikërkuar nga ZRPP Fier konfirmim përfundimtar për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të disa debitorëve, ndër ta edhe z. A.M, pas përgjigjeve kontradiktore lidhur me këto pasuri;

ZRPP Fier me shkresën nr. 202/1 prot., datë 23.02.2007, konfirmon apartamentin në pronësi të z. A.M, pasuri nën sekuestro në favor të Agjencisë referuar shkresës nr. 336 prot., datë 06.06.2003 të Zyrës Përmbarimore Fier. Për periudhën përpara Mars 1997, ZRPP Fier deklaron se nuk mund të kryejë konfirmime, pasi regjistrat e hipotekës janë djegur në trazirat e muajit Mars të vitit 1997; Me shkresën nr. 605/1 prot., datë 20.03.2009, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive Fier informon Agjencinë se për pasurinë nr. 5/156+1-4, vol. 1, fq. 119, ZK 8533, Fier nga vendimi nr. 433, datë 19.03.2004 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier, është vendosur pjesëtimi i sendit dhe lënia e apartamentit në bashkëpronësi të K.M, D.S, A.V dhe D.M;

-Me shkresën nr. 3189 prot., datë 11.08.2006, Agjencia i ka kërkuar Degës Fier të riaktivizojë detyrimet përmbarimore, të kërkojë vlerësim të ri me vlerën e tregut të objektit (pa tokën) si dhe të vihet masa e sekuestros për pasurinë e llojit apartament me nr. 5/156+1-4, vol. 1, fq. 119, ZK 8533, Fier;

-Është kryer rivlerësim i pasurisë më datë 10.06.2009 nga Ing. Ë.S me nr. license VP0193, ku vlera për ndërtesën me sipërfaqe 260 m² rezulton 800,000 lekë, pasi ndërtesa ka 20 vite që është ndërtuar dhe është amortizuar 100%;

-Agjencia i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier me shkresën nr. 5465 prot., datë 29.09.2009, ku kërkon ushtrimin e autoritetit të DRT Fier për të bërë të mundur shlyerjen e detyrimit të z. A.M, pasi ky i fundit rezulton se ushtron profesionin e lirë si ekspert kontabël i miratuar, i regjistruar pranë DRT Fier me NIPT K.....S. Nga DRT Fier është kthyer përgjigja se referuar ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, nenet 88-103 nuk përmendet detyrim i administratës tatimore mbledhja me forcë e detyrimeve që një tatimpagues ka ndaj të tretëve;

-Më datë 16.02.2010 Zyra Përmbarimore Fier ka lëshuar Vendimin nr. 284 për pushimin e urdhrin të ekzekutimit, pasi sendi i paluajtshëm (fabrika) është nxjerrë në ankand pjesërisht dhe vlera monetare i ka kaluar për llogari kreditorit dhe për vlerën e mbetur janë kryer veprimet përkatëse ku debitori rezulton pa pasuri. Nga verifikimi i bërë në sistemin e kreditit nuk rezulton kreditim i principalit për vlerën e ankandit;

-Me shkresën nr. 1120 prot., datë 15.03.2010, Agjencia i është drejtuar edhe DPT për mbledhjen e detyrimit të debitorit, por nga ana e DPT me shkresën nr. 4609/1 prot., datë 12.04.2010 është kthyer përgjigje se nuk është objekti i aktivitetit të DPT;

-Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier me Urdhrin nr. 272, datë 05.10.2010, ka shpallur deklarin fajtor të shtetasit A.M për veprën penale “*Pengim për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës*” duke e dënuar me gjobë 66,666 lekë, e cila duhet të shlyhet brenda një viti nga dita që vendimi të marrë formë të prerë (*bazuar në vendimin nr. 223, datë 20.09.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier*). Në dosje nuk disponohet informacion nëse kjo gjobë është paguar;

-Përmes shkresës nr. 1086 prot., datë 17.11.2010 Agjencia i është drejtuar Zyrës Përbarimore Fier për rivënie në ekzekutim të detyrimit;

-Agjencia ka paditur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me shkresën nr. 3524/2 prot., datë 31.10.2011, shtetasit V.N dhe Rr.Gj me objekt pavlefshmërinë absolute të kontratës së shitjes nr. 1443 rep, nr. 966 kol, e datës 29.06.2011 lidhur mes palës shitëse V.N dhe palës blerëse Rr.Gj, marrjen e masës së sigurimit të padisë duke mos lejuar tjetërsimin e pronës tek të tretët, rikthimin e palëve në gjendjen fillestare dhe detyrimin e ZRVPP Fier të bëjë shënimet përkatëse në regjistrat hipotekorë;

-Me shkresën nr. 4833 prot., datë 31.10.2011, Agjencia ka kryer kallëzim penal kundër shtetasit V.N me objekt falsifikimin e dokumenteve parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë;

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka dërguar pranë Agjencisë një kopje të vendimit të pushimit datë 12.03.2012, të procedimit penal nr. 728, viti 2011, të regjistruar për veprën penale “*Falsifikimi i dokumenteve*”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Vendimi i Prokurorisë konsiston në pronën e lënë si kolateral nga shtetasi V.N për kredinë e marrë nga shtetasi A.M si dhe në tjetërsimin e destinacionit të objektit dhe deklarin përpara noterit se mbi këtë objekt nuk rezulton asnjë barrë apo pretendim tjetër pronësie. Referuar fakt akteve të fashikullit penal ku rezulton një shkëputje e gjatë kohore prej vitit 1995 deri në vitin 2011 ku Agjencia i ka kërkuar përbaruesit privat “*F....*” ekzekutimin e detyrimit të debitorit A.M përmes sekuestros së pasurisë së shtetasit V.N, si dhe duke qenë se dokumenti i kallëzuar nga Agjencia si i falsifikuar rezulton të jetë kryer në një periudhë kohore mbi pesë vjet nga momenti i kryerjes së veprimeve hetimore në lidhje me kallëzimin penal, Prokuroria ka vendosur pushimin e çështjes, në kushtet e parashkrimit të ndjekjes penale;

-Me shkresën nr. 58/2 prot., datë 26.01.2011, Agjencia i është drejtuar përbaruesit privat F.A për vënie në ekzekutim të titullit ekzekutiv. Përmes shkresës nr. 663 prot, nr. 20 regj., datë 06.07.2011 nga Zyra Përbarimore “*F....*” është urdhëruar vendosja e sekuestros konservative mbi pasurinë e paluajtshme të dorëzanësit V.N;

-Nga ZRVPP Fier me shkresën nr. 162/1 prot., datë 31.01.2013 i konfirmohet Agjencisë se në emër të subjektit “*A....*” SHPK me përfaqësues ligjor z. A.M, nuk figuron të ketë të regjistruar pasuri të paluajtshme. Megjithatë si rezultat i djegies së dokumenteve në vitin 1997 dhe procesit të kryer manualisht për verifikimin e të dhënave, nuk garanton plotësisht saktësinë e të dhënave;

-Me shkresën nr. 8211 prot., datë 06.11.2018, Agjencia i ka kërkuar zyrës përbarimore E.K vënien në ekzekutim të detyrimit të urdhrin të ekzekutimit nr. 162, datë 02.04.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Me shkresën nr. 8556, datë 20.11.2018, Agjencia ka nënshkruar kontratën e shërbimit me përbarues privat E.K me objekt kryerjen e shërbimit përbarimor për ekzekutimin e titullit ekzekutiv marrëveshje huaje, datë 05.10.1995;

Përbaruesi privat ka lëshuar Vendimin “*Për pezullimin e ekzekutimit*” nr. 1043, datë 03.09.2020, për mosqetje të pasurive të palës debitore, bazuar në faktet se: *Agjencia ka dërguar shkresën nr.*

633/2 prot., datë 02.03.2020 ku nga verifikimi i pasurive të debitorit me Drejtorinë Vendore të ASHK rezulton se nuk ka pasuri të regjistruara në emër të debitorit; nga bankat e nivelit të dytë rezulton se debitori nuk ka llogari me gjendje pozitive; dhe së fundmi kanë kaluar 6 muaj nga fillimi i ekzekutimit dhe nuk është bërë e mundur gjendja e pasurive të palës debitore.

Ndërsa më datë 08.09.2020, përmbauesi privat ka lëshuar Vendimin “Për pushimin e ekzekutimit” nr. 1078, bazuar në faktet e mësipërme, si dhe në shkresën nr. 3284 prot., datë 04.09.2020 të Agjencisë ku kjo e fundit ka kërkuar heqjen dorë nga ekzekutimi i detyrimit të urdhrimit të ekzekutimit për dosjet e pezulluara për arsyetimin e mosgjete pasurie.

-Përmes shkresës nr. 610 prot., datë 16.02.2022, Agjencia i ka dërguar z. A.M njoftimin për shlyerje detyrimi, zarfi i së cilës është kthyer nga posta me arsyetimin “Adresë e shkurtër”.

Pas këtij momenti, në dosje nuk rezultojnë shkresa të tjera apo korrespondenca me qëllim marrjen e masave për pagesën e detyrimit nga debitori.

Inventari i dosjes: Punuar nga - mungon

8) Kodi kredisë – N/A

Debitori – z. A.B

Sipas sistemit të kreditit:

Vlera fillestare e transferuar e kredisë më datë 30.06.2000, nga BKT, rezulton me principal 80,928.16 lekë dhe interes 80,928 lekë.

Kodi kredisë – 12114

Kodi klientit – AB32

Nga verifikimi i sistemit të kreditit në menunë “Hapje kredie” rezulton se rekordi monedha është plotësuar “Lekë”, por tek gjendjet e kredisë rezulton se shuma e principalit dhe interesit përkatës është euro.

Në sistemin e kreditit tek seksioni “Të dhëna të tjera” data e Urdhër Ekzekutimit është plotësuar saktë (08.10.2002) ndërsa si datë e bllokimit të interesave është data 31.08.2002, rekordi “Hipoteka” është plotësuar “Lokal”, por në fakt kolaterali është “Magazinë”

Sipas inventarit të brendshëm të dosjes, dokumentet pjesë e saj janë të periudhës 1992 deri në vitin 2016. Dosja fizike nuk ka pjesë të saj: të dhëna në lidhje me kodin e kredisë apo të klientit, dokumentacion në lidhje me procesverbalin e marrjes në dorëzim të dosjes, prej Bankës së Nivelit të Dytë, të dhëna në lidhje me njoftimet për pagesë, të bëra nga Agjencia për debitorin.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes konstatohet se masat e marra nga Agjencia rezultojnë si në vijim:

-Është kërkuar verifikimi i pasurive për debitorin A.B, nga Zyra e Rajonale e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Lushnjë;

-Me Vendimin nr. 250, datë 08.10.2002 të Gjykatës së Shkallës së I-rë, Lushnjë është fituar “Lëshimi të Urdhër Ekzekutimit” ndaj debitorit A.B për shumën e detyrimit 156,552.75 euro;

-Me daljen e Urdhër Ekzekutimit, Agjencia me anë të shkresës nr. 253/1, datë 27.01.2003 i është drejtuar Zyrës Përmbareshme, Lushnje “Për dërgim pranë Organit Përmbareshme të huamarrësit “K.....” SHPK, të përfaqësuar nga z. A.B, në lidhje garancinë e huasë (magazinë dhe linjë teknologjike për paketimin e qumështit), kjo e fundit më datë 11.03.2003 i ka dërguar Agjencisë Vendimin nr.179, datë 18.11.2005, për vendosjen e pushimit të Urdhrit të Ekzekutimit, pasi debitori sipas kësaj të fundit nuk ka pasuri të sekuestrueshme;

-Me anë të shkresës nr. 885/1, datë 27.03.2006 nga Agjencia është kërkuar prej Zyrës Përmbareshme Lushnje rivënia në ekzekutim për huamarrësin A.B, dhe për të vërtetuar se debitori disponon pasuri, nga Agjencia është vënë në dispozicion të Shërbimit Përmbareshme kontrata e hipotekës nr. 642, Rep 426 vol, datë 13.03.1995 dhe Vërtetimi i Pronësisë nr. 3358, datë

06.09.1994 që është inskriptuar më datë 12.01.1995 në favor të Bankës, nga kjo e fundit nuk ka përgjigje;

-Në dokumentacionin pjesë të dosjes rezulton se, Agjencia me shkresën nr. 4461, datë 22.10.2007 i është drejtuar ZVRPP, Tiranë për informacion në lidhje me pasurinë e debitorit A.B, i cili është zhvendosur në Tiranë, në dosje nuk disponohen shkresa në lidhje me përgjigjen e kësaj të fundit;

-Në lidhje me pasurinë e sekuestruar, Agjencia ka kërkuar raport vlerësimi nga eksperti dhe sipas raportit të vlerësimit të ekspertit të protokolluar në Agjenci me nr. 5152 prot., datë 20.11.2007 “Raport Vlerësimi”, i përgatitur nga ASVP znj. V.Ç me nr. liçence S....., vlera e lirë e tregut në momentin e vlerësimit është 2,684,000 lekë, pas vlerësimit rezulton që nga Agjencia të jenë nisur procedurat e shitjes me ankand, në dosje disponohet dokumentacioni në lidhje me procedurën e ankandit që prej Urdhrit për zhvillimin e procedurës së ankandit deri tek procesverbali për mos paraqitjen e ofertave;

-Me anë të shkresës nr.3523, datë 02.09.2011 Agjencia i ka kërkuar përmbaruesit Privat “T.LI” të bëjë dorëzimin fizik të objektit të lirë nga çdo posedues sipas vendimit nr.142, datë 31.08.2011;

-Nga Agjencia është siguruar kartela e pasurisë për objektin “Magazinë 1 kat”, në zonën kadastrale 1197, me numër pasurie 84/2 ND, Vol 4, fq 229 e zotëruar nga z. A.B, e cila me dokumentin nr. 0372, datë 14.12.2011 i është kaluar “Agjencisë së Trajtimit të Kredive”;

-Me kalimin e pronësisë së objektit të pasurisë së paluajtshme në emër të Agjencisë prej kësaj të fundit janë bërë përpjekje për shitjen e kësaj pasurie, në dosje disponohet dokumentacion për procedurat e vlerësimit të pasurisë nga eksperti, njoftimet për zhvillimin e ankandit deri në procesverbalet e mos paraqitjes së ofertave, në ankandet e zhvilluara;

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se pjesë e dosjes është dhe shkresa e Agjencisë nr. 227, datë 08.02.2016 dërguar Bashkisë Lushnjë “*Njoftim për shitje më Ankand*”, ankand për herë të parë me vlerë të kontabilizuar për pasurinë: Tokë arë me sipërfaqe 7210 m², me numër pasurie 154/29 vol 5, faqe 51, ZK 1615, me vlerë 2,210,031 lekë”. *Nga praktika pjesë e dosjes rezulton se kjo pasuri nuk përputhet me pasurinë e debitorit e cila rezulton të jetë magazinë me numër pasurie 54/2, ZK 1197, vol 4, fq 229 me sipërfaqe 131 m².*

Sipas propozimit të përmbaruesit Privat, Komisioni Teknik i Agjencisë më datë 28.07.2011 ka vendosur marrjen në pronësi e pasurisë së luajtshme “*Makineri për përpunimin e pasterizimit e qumështit të markës S....., tipi 6034 me vlerë ankandi të dytë prej 15,302 euro*”.

Me anë të Urdhrit të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 646, datë 12.08.2011, është urdhëruar kontabilizimi i pasurisë së luajtshme “*Makineri S....., tipi 6034*” me vlerën e ankandit të dytë prej 15,302 Euro.

Me anë të Urdhrit të Brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë nr. 886, datë 19.12.2011 është urdhëruar gjithashtu kontabilizimi i pasurisë së paluajtshme “Magazinë”, me sipërfaqe 131 m², të sekuestruar debitorit A.B me vlerën 1,280,000 lekë, nga verifikimi i bërë nga grupi i auditimit mbi vlerën e kësaj pasurie rezulton se për periudhën objekt auditimi pasuria, është pjesë e listës së pronave që disponohet nga Agjencia, pikërisht në vlerën 1,280,000 lekë.

Nga verifikimi i bërë në sistemin e kreditit rezultoi se në kartelën e kredisë së debitorit është bërë (SK) ulje e shumës së detyrimit me vlerën kontabël të pajisjes, konkretisht në shumën -15,302 euro. Në dosjen e debitorit, mungon vendimi i shpalljes së fituesit për shitjen e makinerisë dhe procesverbali i zhvillimit të ankandit.

Nga subjekti u vu në dispozicion të grupit të auditimit Vendimi nr. 129, datë 26.09.2012 “*Për shpalljen e fituesit të ankandit të zhvilluar për objektin Linjë e përpunimit dhe sterilizimit të qumështit të markës S.....*” në vlerën 8,000 euro.

Në dokumentacionin pjesë të dosjes rezulton se përpjekja e fundit për shitje në ankand prej Agjencisë rezulton të jetë shkresa nr. 4175, datë 16.06.2016 dërguar Bashkisë Lushnjë “Njoftim për shitje më Ankand” ankand i dytë për herë të dytë me 30% ulje të rivlerësuar në lidhje me pasurinë: “Ndërtesë me numër pasurie 54/2, ZK 1197, vol 4, fq 229 me sipërfaqe 131 m²” me vlerë 908,110 lekë, ku sipas së cilës ankandi zhvillohet me 12.07.2016, ora 11.00, por nuk disponohet procesverbali për zhvillimin e ankandit në këtë datë.

Për periudhën objekt auditimi nuk rezulton të jenë marrë masa nga Agjencia, veprimi i fundit daton në 16.06.2016.

Inventari i dosjes: Punuar nga – K.Z

9) Dosja nr. – N/A

Kodi kredisë – N/A

Debitori – E.T

Sipas sistemit të kreditit:

Vlera fillestare e transferuar e kredisë më datë 30.06.2000, nga BKT Tiranë, rezulton me principal 31,399,995 lekë dhe interes 121,182,693 lekë.

Kodi kredisë – 10121

Kodi klientit – ET03

Sipas fletës së inventarit të dosjes, dokumentat pjesë e saj janë të periudhës 1991 deri në vitin 2011. Nga auditimi konstatohet se te sistemit i kreditit, menuja “Hapje kredie”, rekordi “hipoteka rezulton i paplotësuar, ndërkohë që nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Agjencia evidentohet se për këtë debitor ka kolateral, me vlerë të papërcaktuar.

Nga dokumentacioni në dosje konstatohet se masat e marra nga Agjencia rezultojnë si në vijim:

-Shkresa nr. 431 prot., datë 11.03.2004, kërkesë e Agjencisë për lëshim urdhër ekzekutimi në lidhje me marrëveshjen e huasë nr. 21.04.1994, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë;

-Shkresa nr. 431/1 prot., datë 11.03.2004, autorizim nga Agjencia për përfaqësim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë;

-Vendimi i datës 15.04.2004 i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pranimit kërkesë padie dhe lëshim urdhër ekzekutimi;

-Shkresa e Agjencisë nr. 1196 prot, datë 13.09.2004, drejtuar Zyrës së Shërbimeve Përmbartimore Tiranë;

Nga periudha shtator 2004 deri në maj të vitit 2006 nuk ka asnjë masë të marr nga Agjencia.

-Shkresa e Agjencisë nr. 1626/1 prot., datë 30.05.2006, drejtuar Zyrës së Shërbimit Përmbartimor Kurbin, mbi arsyet e kërkesës së paraqitur në Gjykatë që kanë të bëjnë me kundërshtimin për kompetencën e ekzekutimit të debitorit, çështja e të cilit është transferuar nga Zyra e Përmbartimit Tiranë;

-Shkresa e Agjencisë nr. 2172/1 prot., datë 19.06.2006, drejtuar Zyrës së Përmbartimit Kurbin, kërkesë për përshpejtim procedurash për ankiminin e paraqitur në Gjykatë;

-Shkresa nr. 63 prot., datë 31.08.2006, përgatitur nga Zyra Rajonale Tiranë sipas së cilës ky debitor ka lënë kolateral një hotel restorant me vlerë 11,910,000 lekë me nr inskriptimi 166 datë 22.09.1992 Krujë. Dosja është transferuar nga Zyra e Përmbartimit Tiranë në Zyrën e Përmbartimit Laç dhe sygjerohet marrja e informacioneve nga Zyra Përmbartimore Laç;

-Shkresa e Agjencisë nr. 4378/1 prot., datë 09.11.2006, drejtuar Zyrës së Përmbartimit Tiranë, ku është kërkuar informacion mbi veprimet e kësaj zyre duke qenë se dosja është transferuar në Tiranë.

Nga auditimi konstatohet se nuk është marr në konsideratë shkresa nr. 63 prot., datë 31.08.2006, për të marr informacione në Zyrën Përmbartimore Laç ku janë dhe pronat e këtij debitori.

-shkresa e Agjencisë nr. 4378/3 prot., datë 30.11.2006, drejtuar Zyrës Rajonale Tiranë, sipas së cilës konfirmohet transferimi i dosjes në Zyrën e Përmbarrimit Tiranë, pas shpalljes së moskompetencës së Zyrës së Përmbarrimit Kurbin, shpallur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Në dosje mungojnë këto vendime;

-Shkresa e Agjencisë nr. 158/1 prot., datë 29.01.2007, drejtuar Zyrës së Regjistrimit Tiranë, lënda: autorizim për aplikim në Z.R.P.P për marrjen e dokumentit të pronësisë për debitorin, me qëllim shitjen në ankand;

Nuk gjendet në dosje dokumentacion që të vërtetoj marrjen e dokumentit të pronësisë ose memo mbi arsyet e mos-marrjes.

-Shkresa e Agjencisë nr. 1216 prot., datë 28.03.2007, drejtuar Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, ku kërkohet informacion mbi pronat e regjistruara në emër të debitorit;

-Shkresa e Agjencisë nr. 4189 prot., datë 04.10.2007, drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Sipas kësaj shkrese autorizohet punonjësi i Agjencisë për përfaqësim pranë kësaj zyre me qëllim marrjen e çertifikatës, pasuri e regjistruar pranë Z.R.P.P Tiranë mbi të cilën është vënë sekuestro konservative;

Në dosje nuk gjendet dokumentacioni që vërteton vënien e sekuestros konservative, përpos faktit që nga ana e Agjencisë ky autorizim për tërheqje çertifikatë është bërë edhe me shkresën nr. 158/1 prot., datë 29.01.2007, duke treguar për veprime formale nga ana e Agjencisë dhe zvarritje procedurash me risk të lartë në mirëfunksionimin e institucionit dhe realizimin e misionit për të cilin është krijuar.

-Shkresa e Agjencisë nr. 4276/1 prot., datë 18.10.2007, drejtuar Zyrës Përmbarrimore Tiranë me lëndën “Informacion mbi aplikimet në ZVRPP Tiranë”, me qëllim vijimin e mëtejshëm të procedurave përmbarrimore;

Në dosje mungojnë bashkëlidhur këto praktika:

-Shkresa e Agjencisë nr. 5263 prot., datë 27.11.2007, drejtuar Zyrës Përmbarrimore Tiranë, sipas së cilës i dërgon kësaj zyre një kopje të çertifikatës për vërtetim pronësie “apartament banimi”;

-Shkresa e Agjencisë nr. 5402 prot., datë 26.12.2007, drejtuar Zyrës Përmbarrimore Tiranë, sipas së cilës i dërgon kësaj zyre fotokopje të njehsuar të çertifikatës për vërtetim pronësie “apartament banimi”, duke theksuar se origjinali gjendet në dosjen e debitorit;

Në dosje nuk gjendet çertifikata e pronësisë, as kopje. Nga ky komunikim deri në 17.03.2010, pra për më shumë se 2 vite në dosje nuk gjendet asnjë masë e marrë nga Agjencia.

-Shkresa e Agjencisë nr. 2161 prot., datë 17.03.2010, drejtuar Zyrës Përmbarrimore Tiranë, ku kërkohet informacion mbi kryerjen e veprimeve përmbarrimore të vlerësimit dhe shpalljes së ankandit për shitjen e pasurisë “apartament banimi”;

Sipas kësaj shkrese Agjencia ka informuar Zyrën Përmbarrimore Tiranë se debitori ka marr kredi në vlerën 24,000,000 lekë ndërkohë detyrimi sipas sistemit dhe vërtetimit të detyrimeve të datës 06.09.2004 detyrimet rezultojnë 31,399,995 lekë. Në dosje nuk gjenden pagesa që të justifikojnë uljen e detyrimit. Pagesa nuk rezultojnë as sipas sistemit të kreditit për këtë periudhë.

Pagesa e vetme sipas sistemit rezulton në 23.11.2018 në vlerën 1,166,958 lekë.

-Shkresa Agjencisë nr. 2163 prot., datë 17.05.2010 drejtuar Zyrës së Shërbimeve Kurbin, sipas së cilës kërkohet rivënia në ekzekutim të urdhër ekzekutimit;

Kjo shkresë bie në kundërshtim me vet shkresën tjetër të Agjencisë nr. 4378/3 prot., datë 30.11.2006, drejtuar Zyrës Rajonale Tiranë, sipas së cilës konfirmohet transferimi i dosjes në Zyrën e Përmbarrimit Tiranë, pas shpalljes së moskompetencës së Zyrës së Përmbarrimit Kurbin, shpallur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

-Shkresa e Agjencisë nr. 2162 prot., datë 17.05.2010, drejtuar Kantierit Detar Durrës, kërkesë për informacion nëse anija e peshkimit e blerë nga debitori është bllokuar për llogari të BKT Tiranë;

-Shkresa nr. 2162/1 prot., datë 19.05.2010, kthim përgjigje nga Kantieri Detar Durrës. Sipas kësaj shkrese ky informacion nuk është detyrë funksionale e këtij institucioni dhe duhet drejtuar në Bankë ose te Regjistri i Durrësit Tiranë nëse disponon këtë informacion;

-Shkresa e Agjencisë nr. 2162/1 prot., datë 08.06.2010 drejtuar Regjistrin Detar Shqiptar Durrës, kërkesë informacion. Nuk disponohet kthim përgjigje;

-Shkresa e Agjencisë nr. 562 prot., datë 11.06.2010 drejtuar Zyrës Përmbartimore Tiranë, kërkohet rivënia në ekzekutim e detyrimit të debitorit;

-Shkresa e Agjencisë nr. 362 prot., datë 19.04.2011, drejtuar Zyrës Përmbartimore A.S, për rivënie në ekzekutim të debitorit;

Bashkëlidhur gjendet vërtetimi për detyrimin me principal 31,399,996 lekë dhe interes deri në UE 159,281,354 lekë.

-Urdhri i Agjencisë nr. 425 datë 03.05.2011 “Për pagesën e tarifës paraparake të shërbimit të përmbartuesit gjyqësor privat”;

-Shkresa e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë nr 5325/1 prot., datë 13.06.2011 “kthim përgjigje”. Sipas kësaj shkrese është vendosur sekuestro konservative mbi pasurinë nr. 3/10+1-7 apartament me sipërfaqe 80 m katror, e regjistruar në volumn 2, faqe 42, të ZK. 8360, në favor të debitorit dhe 5 bashkëpronarëve të tjerë me mbiemrin T.;

Nga ky komunikim deri në tetor të vitit 2018 në dosje nuk gjenden dokumentacion që të vërtetojnë masa të marra nga Agjencia.

-Shkresa e Agjencisë nr. 7272 prot., datë 02.10.2018, drejtuar Zyrës Përmbartimore Tiranë, kërkesë për vënie në ekzekutim të detyrimi të UE;

-Memo pa datë, drejtuar përgjegjësit të Sektorit Juridik dhe Operacional, zv. Drejtorit të Përgjithshëm dhe për dijeni Drejtorit të Përgjithshëm nga znj. M.H;

Sipas kësaj memo informohet se debitori ka arkëtuar në Agjenci pjesën takuese të pasurisë apartament në vlerën 1,166,958 lekë të cilës i ishte vendosur sekuestro konservative dhe sygjeron heqjen e kësaj të fundit si dhe aplikim në ASHK për pasuri të tjera të debitorit me qëllim vjeljen e detyrimit.

-Raport vlerësimi tetor 2018 me objekt “përcaktimi i vlerës në tregun e lirë për pasurinë apartament nr. 3/10+1-7 “Apartament” me sipërfaqe 80.02 m katror, zona kadastrale 8360, e regjistruar në volumn 2, faqe 42 në emër të 7 bashkëpronarëve, nisur me kërkesë të debitorit;

Nëse veprimet do të ishin kryer në vitin 2011, nisur nga shkresa e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë nr. 5325/1 prot., datë 13.06.2011, kjo pronë rezultonte në emër të 5 bashkëpronarëve. Në dosje mungon çertifikata për vërtetim pronësie.

Për vlerësimin e pronës është marrë në konsideratë Udhëzimi nr. 3 datë 28.12.2016 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, për vitin 2016, zona 8/2, me çmim 100.000 lekë/m katror.

$Vlera\ e\ pronës = 80.02\ m^2 * 100,000\ lekë/m^2 = 8,002,000\ lekë.$

Duke i zbritur vlerën e amortizimit prej 25% duke qenë se rezulton pallat i ndërtuar në vitin 1961, vlera përfundimtare zbrit në 6,001,500 lekë. Me 7/36 pjesë ideale ky debitor vlerësohet me 1,166,958 pjesë takuese.

-Shkresa nr. 13060 prot., datë 20.11.2018 e Zyrës Përmbartimore Tiranë, drejtuar Agjencisë, ku kërkohet dhënia e pëlqimit nga Agjencia për tu paguar nga debitori pjesa e tij takuese;

-Shkresa nr. 8602, datë 21.11.2018, përgatitur nga specialisti jurist dhe arkëtimeve, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, zv. Drejtorit të Përgjithshëm, Përgjegjëses së Sektorit Juridik dhe

Arkëtimeve, memo në lidhje me situatën e debitorit E.T, i cili ka propozuar komisionit teknik miratimin e kërkesës së Zyrës Përmbartimore Tiranë për arkëtimin e vlerës prej 1,166,958 lekë;
-Shkresa nr. 8602/1 prot., datë 22.11.2018, e komisionit teknik e cila miraton kërkesën e Zyrës Përmbartimore Tiranë;
-Shkresa nr. 8663 prot., datë 23.11.2018, vendim i Drejtorisë së Agjencisë për miratimin e propozimit të komisionit teknik, firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm z. E.K dhe zv. Drejtori Përgjithshëm znj. G.G. Pozicioni i zv. Drejtorit tjetër rezulton vakant;
Inventari i dosjes: Punuar nga N/A.

Përsa trajtuar më sipër nga përfaqësuesit e subjektit, znj. R.Xh në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm aktual të AMGKP-së, deleguar në muajin prill 2024 (konceptuar nga znj. Xh.K në cilësinë e Arkivistes në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, znj. V.S në cilësinë e specialistes së Sektorit të Financës dhe Buxhetit, znj. A.Xh në cilësinë e specialistes në Sektorin e Ndjekjes së Procedurave të Ekzekutimit Përmbartimor, znj. E.Z në cilësinë e Përgjegjëses së Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Skemave të veçanta të Garancisë, znj. A.H në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, znj. K.T në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Financës dhe Buxhetit), është paraqitur observacion me shkresën nr. 2041/2 prot., datë 01.07.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 185/11 datë 03.07.2024.

Pretendimi i subjektit: Referuar gjetjes nr. 16 lidhur me mangësitë për dy rastet e plotësimit të rekordeve në sistemin e kreditit për “datën e llogaritjes së interesave”, “datën e bllokimit të interesave” dhe “monedhës”, sqarojmë se për kreditë e transferuara në Lek ose Usd, të dhënat e kredisë së debitorit ku shfaqen të vlera fillestare, banka, rrethi, kodi, numri i kredisë, detyrimi i transferuar, data e urdhrat të ekzekutimit dhe data e bllokimit të interesave, detyrimi i transferuar, monedha është e njëjtë me atë që shfaqet në kartelën e debitorit. Për kreditë në Euro, sipas aktmarrëveshjeve, kredia është akorduar në monedha të huaja si Lireta, DM, Dhrahmi greke, etj. Pavarësisht që me hedhjen e të dhënave në sistemin e kreditit i cili daton në 31.12.2003, nuk mund të jetë përzgjedhur monedha e duhur, çelja si shumë është sipas transferimit dhe në kartelën e debitorit monedha shfaqet në Euro (sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë) gjë e cila nuk çënon saktësinë e detyrimit.

Po ashtu, për Urdhër Ekzekutimet, për cilët data e UE nuk është e njëjtë me datën e bllokimit të interesave, sqarojmë se kjo ndodh vetëm për ata debitorë për të cilët UE i ka dalë me shumë, pasi për debitorët e tjerë sipas Udhëzimit nr. 33, pika 4, germa b, “Debitorëve të cilëve u ka dalë UE përpara datës 30.04.2009, interesat do të llogariten deri në datën e shpalljes së tij (kur UE ka dalë pa shumë)”.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Përsa më sipër, grupi i auditimit sqaron se pretendimi juaj nuk e ndryshon gjetjen dhe rekomandimin tonë, pra në rastet kur monedha nuk është lekë, rekordet nuk janë të plotësuar saktë. Në lidhje me pjesën e UE, pretendimi i paraqitur nuk ka dokumentacion shtesë, që e provon të kundërtën. Për sa më sipër, observacioni i paraqitur nga subjekti nuk merret në konsideratë.

- Mbi veprimet e Agjencisë për mbledhjen e detyrimeve referuar subjekteve SHPK, debitorëve që kanë ndërruar jetë, marrëveshje të bashkëpunimit etj.

Nga auditimi në lidhje me zbatimin e procedurave për ndjekjen dhe mbledhjen e kredive, si dhe aplikimi i masave shtrënguese konstatohet se nga ana e Agjencisë nuk janë zbatuar të gjitha procedurat dhe nuk janë marrë të gjitha masat shtrënguese meqenëse janë konstatuar:

-66 SHPK pa status aktiv, për të cilat Agjencia nuk i është drejtuar Gjykatës për shpallje falimenti dhe caktim likuidatori, në kundërshtim me pikën 1, neni 6, ligji nr. 8894, datë 14.05.2002, i ndryshuar, i cili citon: “Agjencia ka të drejtë të kërkojë nga organet gjyqësore fillimin e procedurave të falimentit ose likuidimit, kundrejt personave fizik apo juridik ndaj të cilave ajo ka pretendime për përmbushjen e një detyrimi”. Sipas sistemit të kreditit vlera e principalit për periudhën objekt auditimi paraqitet si në vijim:

Monedha	01.01.2021		31.12.2023	
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
ALL	61	278,663,397.49	61	270,146,154.49
EUR	2	104,014.78	2	104,014.78
USD	3	86,025.00	3	86,025.00

-Nga Agjencia nuk është vepruar me çelje trashëgimie për asnjë debitor, që ka ndërruar jetë, në kundërshtim me pikën 1/a, seksioni B, ku citohet se: “Për debitorët e vdekur, pavarësisht nga shuma e kredisë, të përcaktuar në pikën A, u kërkohet trashëgimtarëve të tyre të likuidojnë vetëm shumën e principalit të mbetur në momentin e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, kreu I, Udhëzimi nr. 33, datë 24.9.2010 “Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfi-teozë të këtyre pasurive”.

- Mbi vlerësimin e procedurave të ndjekura për proceset gjyqësore

Nga grupi i auditimit u kërkuar informacion në lidhje me proceset gjyqësore për periudhën objekt auditimi dhe statusin e tyre aktual. Nga ana e Agjencisë u informua si në vijim:

Viti 2021

Gjatë vitit 2021 Agjencia ka patur gjithsej 83 procese të hapura, të iniciuara nga vitet e kaluara. Në vitin 2021 janë mbyllur 6 procese gjyqësore, nga Shkalla e Parë, ku rezultati i këtyre gjyqeve përkon si më poshtë vijon:

Gjyqe të fituara: 2

Gjyqe të humbura: 2

Gjyqe të pushuara: 2

Nga gjyqet që janë iniciuar në vitin 2021 rezultojnë 16 gjyqe në proces ndjekje, në shkallë të ndryshme. Agjencia ka depozituar 3 ankime dhe ka bërë 2 rekurse.

Viti 2022

Gjatë vitit 2022 Agjencia ka patur gjithsej 85 gjyqe të hapura. Gjatë vitit 2022 është mbyllur 1 seancë gjyqësore, konkretisht 1 gjyq i pushuar. Nga gjyqet që janë hapur në vitin 2022 janë 10 gjyqe që vazhdojnë të jenë në proces ndjekje, në shkallë të ndryshme. Gjatë vitit 2022 nuk ka patur çështje të humbura nga Agjencia dhe gjatë këtij viti janë kryer 7 Ankimime.

Viti 2023

Gjatë vitit 2023 Agjencia ka patur gjithsej 107 gjyqe të hapura.

Gjatë vitit 2023 janë mbyllur 2 seanca gjyqësore, konkretisht 2 Gjyqe të pushuara.

Nga gjyqet që janë hapur në vitin 2023 janë 20 gjyqe që vazhdojnë të jenë në proces ndjekje, në shkallë të ndryshme. Nuk ka patur gjyqe të humbura. Gjatë këtij viti, Agjencia ka depozituar 7 ankime dhe ka bërë 1 rekurs.

Ky informacion nuk rakordon me të dhënat e paraqitura në analizën vjetore të Agjencisë ku sipas viteve 2021-2023, konkluzionet paraqiten si në vijim:

-Viti 2021 nuk paraqet të dhëna në lidhje me rezultatet gjyqësore

-Viti 2022 paraqitet me 7 gjyqe të fituara në Shkallën e Parë dhe 3 të fituara në Gjykatën e Apelit.

-Viti 2023 paraqitet me 7 gjyqe të fituara nga Agjencia në Shkallën e Parë.

Aktualisht Agjencia në vlerësimin e grupit të auditimit rezulton në kushtet e vështirësisë dhe gati të pamundësisë për vjeljen e detyrimeve nisur nga këto problematikat:

-Pavlefshmëria e titujve ekzekutivë - kjo lloj problematike ekziston sepse kreditë e trajtuara nga Agjencia janë kredi të cilat janë alokuar afro 30-të vite më parë.

-Cilësia e borxhit - borxhi tejet i vështirë për t'u rikuperuar nga ana ligjore, ligji nr. 8894, datë 14.05.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive" nuk ka patur mjaftueshëm masa shtrënguese dhe përditësimin e duhur në vite.

-Adresat jo të sakta të debitorëve - pasi lëvizjet demografike dhe emigrimi jashtë vendit i popullsisë në gjithë këto vite kanë qenë të shumta. Në këto raste zyrat përmbare nuk kanë vazhduar me procedurat për caktimin e përfaqësuesit ligjor, pasi bazuar në Nenin 522, të Kodit të Procedurës Civile shpenzimet duhet të parapaguhën nga pala kreditore, e cila është (40,000 lekë), sipas rasteve që duhet caktuar përfaqësuesi ligjor për vazhdimin e ekzekutimit. Ky fakt bën që veprimet përmbare të pezullohen, pasi shpenzimet që parapaguhën për këtë shërbim janë shumë të larta dhe numri i debitorëve që nuk gjenden është i konsiderueshëm.

-Moshë e debitorëve - me kalimin e viteve shumë nga kredimarrësit kanë dalë në pension ose kanë ndërruar jetë.

Debitor të identifikuar nga Agjencia që kanë ndërruar jetë:

Sipas databazës, dërguar me email-in e datës 15.04.2024, nga Agjencia rezultojnë se janë identifikuar 92 debitorë që kanë ndërruar jetë. Nga auditimi konstatohet se kjo databazë nuk është e saktë pasi janë konstatuar minimalisht 3 debitorë që kanë ndërruar jetë të cilët nuk gjenden te kjo listë.

-Mungesa e bashkëpunimit ndërinstucional – mungesa e krijimit të lehtësirave për shkëmbimin e informacioneve nga institucionet e tjera.

-Mungesa e bashkëpunimit me Zyrat Përmbare Private – mungesa e bashkëpunimit nga ana e Zyrate Përmbare private ka vështirësuar punën e institucionit, si edhe ka sjellë mungesën e efekteve frytdhënëse të punës në institucion.

-Mungesa e dokumentacionit tekniko-ligjor të pasurive në pronësi të Agjencisë - kjo lloj mungese në dokumentacion ka bërë të pamundur vijimin e procedurave të nxjerrjes në ankand të pronave. Problematikë e pronave është fakti që shumica e tyre janë në zona rurale shumë të thella, si edhe janë shumë të amortizuara, shkak ky që nuk është favorizues për një rritje të tregut për ato zona. Kjo gjë ka sjellë që Agjencia të mos ketë sukses në shitjen e tyre në ankand.

-Mungesa e regjistrimit në QKB - SHPK që nuk janë të hedhura në regjistrin aktual të QKB-së, janë pa "NUIS" të vlefshëm, rrjedhimisht statusi i tyre nuk është aktiv.

-Mungesa e të dhënave të debitorëve – mungesa e gjeneraliteteve të debitorëve si numër identifikimi, atësi, datëlindje. Gjithashtu dhe dosjet që rezultojnë të djegura, vetëm me procesverbal transferimi.

-Numri në rritje i proceseve gjyqësore - problematikë mbetet edhe rritja e numrit të proceseve gjyqësore, të ngritura nga debitorët, me objekt-padie për: "pavlefshmëri titulli detyrimi" për pretendim të plotësisimit të afatit të parashkrimit, për shkak se janë kredi të cilat janë dhënë para më shumë se 25 viteve.

Bashkëpunimi me Zyrat Përmbare

Krahas bashkëpunimit me Zyrat Përmbare Shtetërore, Agjencia ka bashkëpunim edhe me Zyrat Përmbare Private, me të cilat për çdo rast të vënies në ekzekutim të detyrimit të debitorit lidhet kontratë shërbimi. Gjatë vitit 2021-2023, Agjencia ka pasur bashkëpunim me 22 Zyra Përmbare Private. **Nga auditimi konstatohet se mungon gjurma e auditimit në lidhje me përzgjedhjen e zyrate përmbare private dhe një analizë e detajuar mbi performancën**

e tyre e cila në gjykimin e grupit të auditimit, nisur nga përzgjedhja e dosjeve të audituara, rezulton jo efektive ndër vite.

Lista e urdhrave të ekzekutimit për periudhën 2021-2023.

Gjatë periudhës 2021-2023 janë depozituar pranë Gjykatave përkatëse 42 kërkesa për lëshimin e publikatave të Urdhrave të Ekzekutimeve, të cilët gjatë shqyrtimit të dosjeve dhe nevojës për të vazhduar procedurat e mëtejshme për vënien në ekzekutim është vënë re që këto UE-origjinale nuk gjendeshin në dosjet e arkivuara pranë Agjencisë si dhe as në Zyrat Përmbartimore Private dhe Shtetërore, për rrjedhojë pretendohet të kenë humbur. Nga 42 Kërkesa të depozituara, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë është bërë lëshimi i publikatës së Urdhrit të Ekzekutimit për Vendimin Gjyqësor Civil nr. 29, datë 20.05.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë për detyrimin e debitorës znj. L.N.D.

Pjesa tjetër rezultojnë në proces të hapur për nxjerrjen e Publikatave të këtyre UE-ve Origjinale.

Mbi veprimtarinë e Komisionit Teknik

Komisioni Teknik funksionon si një strukturë e përhershme pranë Agjencisë, i cili ka funksion konsultativ, teknik dhe ligjor në lidhje me vendimmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm, miratuar në Rregulloren e Brendshme të Agjencisë.

Konkretisht sipas pikës 1 të kreut “Komisioni Teknik”, të Rregullores citohet “*Komisioni Teknik është komision i përhershëm pranë Agjencisë i cili në ushtrim të kompetencave të tij, ka përgjegjësi institucionale, në analizën dhe propozimet rast pas rasti që bën, në trajtimin e debitorëve deri në likuidimin e plotë të tyre, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi*”.

Nga auditimi u konstatua se kreu “*Spektori juridik, operacional dhe menaxhimit të riskut*” pika 8 e Rregullores citon se: “*zv. Drejtori i Përgjithshëm i juridik, operacional dhe menaxhimit të riskut*” është anëtar i përhershëm i Komisionit Teknik dhe Komisionit të Ankandëve”

Kjo pikë bie në kundërshtim me pikën të rregullores ku citohet se: “*Anëtarë të Komisionit Teknik janë: përgjegjësi i sektorit juridik dhe operacional, përgjegjësi i sektorit të financës, përgjegjësi i sektorit të menaxhimit të riskut, specialist jurist operacional*”.

Nuk janë konstatuar problematika në lidhje me mbylljen e tyre nga ana financiare, për dosjet që janë përzgjedhur për auditim, por në tërësi të detyrave funksionale nisur nga problematikat që konsistojnë lidhur me nivelin e ulët të arkëtimeve dhe me faktin që nuk janë marr masa për trajtimin e dosjeve të tjera, rezulton se nuk është realizuar detyra e pikës 1 të kreut “Komisioni Teknik”, të Rregullores.

Megjithatë duke marr në konsideratë rolin dhe funksionin që ka sektori juridik për mbledhjen dhe realizimin e planit të arkëtimeve, si detyrë funksionale grupi i auditimit vlerëson si problematikë të Rregullores së brendshme të Agjencisë miratimin e pikës 1 të detyrave të Komisionit Teknik që i ka dhënë tagër këtij komisioni në analizë dhe propozime rast pas rasti që bën, në trajtimin e debitorëve deri në likuidimin e plotë të detyrimit, ndërkohë që pika 7 Rregullores e cila citon “*Pika 7: Komisioni Teknik shqyrton të gjitha kërkesat për trajtimin e detyrimit të debitorëve për shlyerje të menjëhershme, për shlyerjen e detyrimit me këste, për miratimin e ristrukturimit të kredisë, për ndryshimin e termave të marrëveshjes së huasë, kërkesa për zëvendësimin e debitorit si dhe për zëvendësimin e hipotekave që bëhen nga debitorët në Drejtorinë e Përgjithshme*” e ka kufizuar këtë tagër në vlerësime apo propozime vetëm për debitorët që paraqesin kërkesa pranë Agjencisë për shlyerje të menjëhershme, me këste apo ristrukturim kredie.

Pavarësisht periudhës objekt auditimi 2021 – 2023, mangësitë dhe problematikat e evidentuara lidhur me masat e marra për arkëtimin e detyrimit të mbetur të debitorëve, shtrihen përgjatë gjithë periudhës që nga krijimi i institucionit deri në momentin aktual. Në këto kushte, përgjegjësia e strukturave drejtuese apo strukturave të tjera të cilat kanë si detyrë funksionale të marrin masa për

arkëtim të detyrimeve referuar kuadrit ligjor në fuqi sipas periudhave, mbetet e shtrirë në kohë mbi Drejtorinë e Përgjithshme së bashku me strukturat përkatëse në varësi të saj.

Si konkluzion:

-Masat e marra nga Agjencia dhe komunikimet me institucionet e tjera nuk kanë qenë të mjaftueshme, ezauruese dhe të trajtuara në kohë me qëllim evidentimin, parandalimin e tjetërsimit të pasurive dhe uljen e riskut të pamundësisë për vjeljen e detyrimit, largimit të debitorëve jashtë vendit, ndërrimit të jetës për shkak të moshës etj.

-Këto problematika dhe mos-marrja e masave në kohë nga Agjencia ndër vite, që nga momenti i krijimit si institucion, ka sjellë që vitet e fundit niveli i mbledhjes së kredive dhe realizimit të të ardhurave, të jetë konsiderueshëm i ulët dhe në kufijtë gati për të mbuluar shpenzimet. Nga Agjencia përveç pagesës së një pjesë detyrimi kundrejt KFW-së, nuk ka asnjë derdhje tjetër në buxhetin e shtetit. Madje dhe detyrimi kundrejt KFW-së, ka ardhur duke u rritur si pasojë e gjenerimit të interesat nga mos-pagimi në kohë dhe në vlerë të plotë, trajtuar më hollësisht në drejtimin “Përgatitja e pasqyrave financiare, miratimi dhe raportimi në organin drejtues”.

-Fleta e inventarit nuk është hartuar sipas nenit 30 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, pasi nuk disponon të listuara dhe numerizuara dokumentacionin e plotë të dosjes.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: Drejtoria e Agjencisë së Trajtimit të Kredive së bashku me strukturat e saj të varësisë, referuar detyrave funksionale në mbledhjen e kredive dhe marrjen e masave shtrënguese. Gjithashtu dhe Këshilli Mbikëqyrës, për pjesën e mosvlerësimit të risqeve dhe mungesës së raportimit pranë Këshillit të Ministrave, sipas trajtimit në drejtimin “Veprimtaria dhe vendimmarrja e Këshillit Mbikëqyrës”.

2.3 Administrimi i kolateraleve të kaluara në pronësi të AMGKP-së, si dhe zbatimi i procedurave të shitjes së tyre.

Në dispozitat e ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar, përcaktohet ndër të tjera se Agjencia merr në pronësi pasuri të luajtshme e të paluajtshme, ku specifikisht neni 4 i këtij ligji përcakton se “Agjencia bëhet pronare edhe për pasuritë, të cilat mund të jenë vendosur ose jo nga debitorët si mjete garancie, për sigurimin e kredive, e që i janë transferuar kësaj Agjencie nga bankat, së bashku me kreditë, kur këto pasuri kalojnë në favorin e saj si kreditorë, sipas dispozitave ligjore në fuqi”.

Në nenin 5 të ligjit nr. 8894/2002, i ndryshuar, përcaktohet se Agjencia ka si objekt të veprimtarisë së saj të shërbejë si instrument i trajtimit të të gjitha aseteve në pronësi të saj e për këtë qëllim kryen shitjen e sendeve të luajtshme ose të paluajtshme, të kaluara në pronësi të Agjencisë, personave të tretë, fizikë apo juridikë, me kapital joshtetëror ose të kontrolluar nga shteti, sipas dispozitave ligjore në fuqi për shitjen e pronës shtetërore.

Neni 9 i ligjit nr. 8894/2002, i ndryshuar, i jep Agjencisë të drejtën të pranohet zëvendësimin e debitorit në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë në rast se një zëvendësim i tillë është në interes të shlyerjes së kredisë. Në rast se Agjencia pranon zëvendësimin e debitorit, ajo ka të drejtë të kërkojë nga debitori i ri vendosjen e garancive të reja për shlyerjen e kredisë, në ato raste kur garancitë e dhëna nga debitori nuk kanë qenë të barazvlefshme për shlyerjen e detyrimit. Në të gjitha rastet kur pranohet zëvendësimi i debitorit sipas këtij neni sendet e vendosura si garanci, ose garancitë e tjera të dhëna nga debitori i parë, mbeten në favor të Agjencisë për aq kohë sa pretendimi të jetë shlyer në përputhje me marrëveshjen e lidhur ndërmjet Agjencisë dhe debitorit të ri, me qëllim ripagimin e detyrimeve që rrjedhin nga kredia.

Në këtë kuadër, nga grupi i auditimit është kërkuar informacion lidhur me kolaterale të lëna nga kredimarrësit në momentin e marrjes së kredisë dhe ecurisë së këtyre kolateraleve përgjatë viteve, veçanërisht për periudhën objekt auditimi. Nga Agjencia u vu në dispozicion informacioni i menaxhuar nga Sistemi i Kreditit në vitin 2024, ku përcaktohet numri i kredive të marra me kolateral, të ndara sipas monedhës përkatëse. Në tabelën nr. 1 pasqyrohet numri i debitorëve me kolateral ku për 80% të tyre paraqiten shpenzime gjyqësore pozitive (shpenzime gjyqësore të cilat i ngarkohen Agjencisë, ose shpenzime gjyqësore që nuk janë paguar nga debitori). Pavarësisht se janë identifikuar 5,230 debitorë të cilët kanë lënë pasuri kolateral në marrjen e kredisë me principal të mbetur në monedhën ALL prej 3,207,173.6 mijë lekë, në monedhën EUR në vlerë 4,782.9 mijë Euro dhe në monedhën USD në vlerë 4,791.1 mijë dollarë, rezulton një numër shumë i ulët i pasurive të sekuestruara/kontabilizuara nga Agjencia (gjatë periudhës objekt auditimi Agjencia ka patur të kontabilizuara më së shumti 97 prona të sekuestruara). Në total debitorët me kolateral përfaqësojnë rreth 29% të debitorëve të evidentuar më 31.12.2023.

Tabela nr. 1: Debitorë me kolateral sipas monedhës

Monedha	Debitorë me kolateral		Principal i mbetur (sipas monedhës)		Raste të shpenzimeve gjyqësore		
	Në numër	Në % ⁸	Në vlerës	Në % ⁹	<0	=0	>0
ALL	4,607	27.50%	3,207,173,664	77.14%	20	894	3,693
EUR	227	53.41%	4,782,889	89.96%	1	55	171
USD	396	41.29%	4,791,121	61.24%	1	62	333
Total	5,230	28.84%			22	1,011	4,197

Burimi: Të dhënat nga Sistemi i Kreditit të AMGKP, 2024. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Referuar informacionit të vënë në dispozicion, vlera e identifikuar në sistem pasqyron vlerën totale të detyrimeve të debitorëve me kolateral, dhe jo vlerën e pasurisë së lënë si kolateral, pasi Agjencia deklaroi se kolaterale të lëna nga debitorët nuk kanë patur vlerë të përcaktuar në treg, si dhe nuk janë kryer asnjëherë vlerësime të tyre. Në këto kushte, për këto kolaterale nuk disponohet një pasqyrim real i vlerës së tyre, me qëllim marrjen e masave të mëtejshme nga ana e Agjencisë për debitorë që nuk kanë shlyer ndër vite detyrimet. Për më tepër, nuk rezulton që Agjencia të ketë zhvilluar minimalisht analiza krahasimore kosto-përfitim mbi çështjen e vlerësimit të këtyre pasurive të lëna si kolateral (për debitorë që nuk kanë shlyer detyrimet ndër vite), për të evidentuar më pas nëse është ekonomikisht efektive të ndiqen procedurat e vlerësimit të këtyre pasurive. Rrjedhimisht, mosveprimi nga ana e Agjencisë për vlerësimin e këtyre kolateraleve ka sjellë moskalimin e këtyre pasurive në emër të Agjencisë e më pas mos-shitjen e tyre në ankand, duke mos gjeneruar dot të ardhura.

Mbi debitorët pas ekzekutimit të kolateralit

Në nenin 2 të Kreut I të Udhëzimit nr. 33/2010, citohet se “Debitorë pas ekzekutimit të kolateralit do të konsiderohen:

- debitorë, të cilëve kolaterale të vëna garanci u janë shitur nga zyra e përmbarimit;
- debitorë, të cilëve kolaterale të vëna garanci u janë shitur nga ATK-ja, pasi janë marrë në pronësi nëpërmjet procedurave përmbarimore;
- debitorë, të cilëve kolaterale u janë marrë në pronësi nga ATK-ja nëpërmjet procedurave përmbarimore.”

⁸ Përlllogaritur si përqindja e numrit të debitorëve të evidentuar me kolateral me numrin total të debitorëve më 31.12.2023 për secilën monedhë.

⁹ Përlllogaritur si përqindja e vlerës së principalit të mbetur të debitorëve të evidentuar me kolateral me vlerën totale të principalit të mbetur më 31.12.2023 për secilën monedhë.

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga Agjencia, rezultojnë 52 debitorë të tillë, me vlerë totale¹⁰ 168,773,205 lekë më 31.12.2023 (detyrim i mbetur pas kontabilizimit të pronës, ku përfshihen: shpenzime gjyqësore, principal i mbetur, interesa), paraqitur sipas bankave dhe monedhës në tabelën nr. 2.

Tabela nr. 2: Debitorë pas ekzekutimit të kolateralit gjatë periudhës objekt auditimi

Ekzekutuesi	Monedha	01.01.2021	31.12.2021	31.12.2022	31.12.2023
Banka e Kursimeve	ALL	16,360,322.44	16,360,322.44	16,360,322.44	16,360,322.44
Banka Tregtare Agrare	ALL	118,447,399.16	118,447,399.16	118,447,399.16	118,453,499.16
Banka Kombëtare Tregtare	ALL	28,294,905.00	28,294,905.00	28,294,905.00	28,294,905.00
	USD	5,664,477.96	5,664,477.96	5,664,477.96	5,664,477.96
INSIG	ALL/EUR/USD	0.00	0.00	0.00	0.00

Burimi: Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthëra, 2024.

Mbi administrimin e pasurive të sekuestruara -Pasuri të luajtshme të sekuestruara

Për pasuritë e luajtshme, nga Agjencia disponohet lista me 5 pasuri të tilla, ku pas kryqëzimit të të dhënave sipas Sistemit të Kreditit për secilin debitor i cili ka patur në pronësi këto sende, grupi i auditimit ka konkluduar me hartimin e tabelës nr. 3. Referuar pikës 2 të Kreut III të Udhëzimit nr. 33 të Ministrit të Financave, datë 24.09.2010, “Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfiteozë të këtyre pasurive”, përcaktohet se “Marrja në pronësi e pasurive të lëna garanci ose jo nga debitorët, të sekuestruara nga përmbartuesi gjyqësor, bëhet me pëlqimin e drejtorisë së ATK-së, si palë kreditore, kundrejt vlerës së ankandit të fundit të zhvilluar nga përmbartuesi gjyqësor”.

Tabela nr. 3: Përmbledhje mbi pasuritë e luajtshme në pronësi të Agjencisë

Nr.	Debitori	Kod Klienti	Kod Kredie	Vlera fillestare e kontratës	Principali i mbetur më 01.01.2021	Monedha	Prona	Vlera kontabël në Lekë (2021-2023)
1	B.S	BS12	10024	4,784,000.00	4,283,700.00	ALL	Automjet	1,100,000.00
2	K.Xh	KX08	13277	15,907.00	15,907.00	USD	Traktor	560,000.00
3	F.R ¹¹	FR07	10029	14,000,000.00	-	ALL	Makineri pajisje poligrafike	4,579,459.00
4	B.A	BA05	00395	1,100,000.00	885,000.00	ALL	Traktor	448,000.00
5	R.B	RB21	12208	45,586.00	15,899.76	EUR	Traktor, Rimorko	528,000.00
							SHUMA	7,215,459.00

Burimi: Të dhënat nga Agjencia. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Vlera kontabël e këtyre pasurive i është referuar dokumentave si në vijim:

-Pasuria e luajtshme e llojit “Automjet” i vitit 1995, sekuestruar debitorit B.S, është kontabilizuar në bazë të Urdhrit të Brendshëm nr. 115, datë 25.03.2008, i cili i është referuar Vendimit të Zyrës së Shërbimit Përmbartimor Tiranë me nr. 9968, datë 10.10.2007 “Vendim për kalimin e sendit të luajtshëm në pronësi të kreditorit” me vlerën e ankandit të dytë prej 1,100,000 lekë përfunduar pa fitues më datë 19.07.2007.

¹⁰ Mënyra e përlllogaritjes së vlerës për debitorët pas ekzekutimit të kolateralit ka ndryshuar përgjatë viteve, duke mos ruajtur një linjë të vetme në përlllogaritje, ndaj është i pamundur evidentimi i saktë i elementëve përbërës të vlerës së paraqitur në tabelë.

¹¹ Debitor pas ekzekutimit të kolateralit

-Pasuria e luajtshme e llojit "Traktor", sekuestruar debitorit K.Xh, është kontabilizuar referuar Vendimit të Zyrës Përbarimore "B....S..M....& Co" SHPK me nr. 503 prot., datë 23.01.2012 "Vendim për kalimin e sendit të luajtshëm në pronësi të kreditorit" me vlerën e ankandit të dytë prej 560,000 lekë përfunduar pa fitues më 20.12.2011.

-Pasuria e luajtshme e llojit "Makineri pajisje poligrafike", sekuestruar debitorit F.R, është kontabilizuar referuar Urdhrit të Brendshëm nr. 122/1, datë 25.08.2005, në vlerën e ankandit të dytë prej 5,591,000 lekë sipas Vendimit nr. 4240, datë 21.06.2004 "Për kalimin e pronësisë së sendit të luajtshëm në favor të kreditorit" nga Zyra e Përbarimit Tiranë. Më pas, në datë 25.08.2005, është lidhur kontrata e qirasë nr. 4213 mes ATK (qiradhënësit) dhe S.B (qiramarrësi) me vlerë 100,000 lekë në muaj. Në vlerën e pasurisë së luajtshme është ulur më datë 31.08.2005 vlera prej 450,000 lekë (debitor për qira), duke arritur në vlerë 5,141,000 lekë. Në vitin 2007, nga veprimet në llogari, evidentohen ulje e vlerës me 641,600 lekë (ngurtësim i shumës 20% për pjesëmarrje në ankand të fituesit), dhe shtim të shpenzimeve gjyqësore dhe zgjidhjes së kontratës për fituesin e ankandit në vlerën 80,059 lekë, duke përfunduar në vlerë totale të pasurisë së luajtshme në vlerën 4,579,459 lekë.

-Pasuria e luajtshme e llojit "Traktor", sekuestruar debitorit B.A, është kontabilizuar referuar Vendimit nr. 5023 prot., datë 18.06.2012 "Vendim për shpalljen e ankandit të dytë të pasurisë së luajtshme" nga Zyra Përbarimore "B.... S....M.... & Co" SHPK me vlerë 448,000 lekë.

-Pasuri e luajtshme e llojit "Traktor" i vitit 1992, sekuestruar debitorit R.B, është kontabilizuar sipas Urdhrit të Brendshëm nr. 217, datë 06.09.2010, në vlerën 528,000 lekë, referuar Vendimit nr. 07-10.C.Regj. më datë 17.05.2010, të Zyrës Përbarimore Elbasan "Vendim për kalim sendi të luajtshëm në pronësi".

Referuar dokumentacionit për këto pasuri të luajtshme, evidentohet se pavarësisht se vlera kontabël e regjistruar e tyre është në shumën 7,215,459 lekë, dokument pronësie disponohet vetëm për pasurinë e llojit "Automjet" të sekuestruar nga debitori B.S me vlerë 1,100,000 lekë. Për 4 pasuritë e tjera, ndër vite nuk disponohet dokument pronësie, duke riskuar tjetërsimin e pasurisë, zhvlerësimin e tyre në kohë për shkak të amortizimit dhe si rrjedhojë dhe mungesën e përfitimit të të ardhurave nga mos-shitja e tyre përmes procedurave të ankandit.

Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga Agjencia përmes e-mail të datës 02.05.2024, këto pasuri të luajtshme janë lënë për ruajtje tek debitorët përkatës në momentin e inventarizimit që i përket një periudhe të deri 20 viteve më parë, duke nënshkruar procesverbalet e inventarizimit dhe duke ua lënë përgjegjësi debitorëve të ruajnë këto sende. Konstatohet se Agjencia nuk i ka marrë në ruajtje këto pasuri të luajtshme në kundërshtim me pikën 6 të Kreut III të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 33, datë 24.09.2010, ku përcaktohet se: "ATK-ja është përgjegjëse për ruajtjen dhe administrimin e sendit të marrë në pronësi, sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare", të ndryshuar, dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 70, datë 11.3.1985 dhe nr. 445, datë 25.12.1990. Në raste të veçanta, mund të vendoset edhe për ruajtjen fizike ose elektronike të sendeve të marra në pronësi. Kur sendi është i luajtshëm, në rast të pamundësisë për ta magazinuar në ambientet përkatëse të ATK-së, ai mund të ruhet kundrejt pagesës, në magazina ose vende parkimi në pronësi të personave të tretë".

Në këto kushte, 5 pasuritë e luajtshme, duke u lënë në ruajtje tek debitorët, paraqesin risk për përdorim dhe amortizim të mëtejshëm të tyre për shkak të përdorimit të mundshëm nga debitori, apo qoftë edhe risk për tjetërsimin e tyre duke qenë se për 4 prej tyre nuk disponohet as dokument pronësie në emër të Agjencisë. Për më tepër, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, për

pasurinë e llojit “Traktor” të debitorit K.Xh, disponohet dokumentacioni ku përmbartuesi privat ka kryer kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, se mjeti nuk është marrë dot fizikisht, pasi në momentin e paraqitjes pranë banesës, nuk u gjend mjeti dhe as debitori, ku ky i fundit është bërë pengesë për ekzekutimin e Urdhër Ekzekutimit dhe Titullit Ekzekutiv. Nuk ka më korrespondenca në vijimësi për statusin e kësaj pasurie të luajtshme.

Nga auditimi rezulton se këto pasuri të luajtshme janë pjesë e llogarisë “Aktive të mbajtura për shitje” dhe referuar përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, për këto pasuri të luajtshme është ndërprerë amortizimi. Megjithatë, grupi i auditimit referuar vitit të prodhimit të tyre dhe vendimit të kalimit në pronësi ku specifikohet vlera përkatëse, konstaton se edhe pse në Pasqyrat Financiare të Agjencisë nuk është përlllogaritur amortizim për këto pasuri të paluajtshme dhe ato janë pasqyruar me vlerën kontabël, vlera reale e tyre më 31.12.2023 është shumë e ulët (paraqitur në tabelën nr. 4, pas përlllogaritjeve të grupit të auditimit), duke riskuar shitjen e suksesshme të tyre përmes procedurave të ankandit. Vlera e mbetur (reale) e makinerive dhe pajisjeve janë përlllogaritur nga grupi i auditimit bazuar në pikën 36 të UMF nr. 8/2018 ku citohet “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon: ... Për aktivet afatgjata materiale si ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit, dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur. ... Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi. ...”.

Tabela nr. 4: Vlera reale e pasurive të luajtshme përgjatë periudhës objekt auditimi duke marrë në konsideratë amortizimin ndër vite

Në lekë

Nr.	Pasuria	Vit kontabilizimi	Vlera kontabël në momentin e regjistrimit	Norma e AM	Vlera reale		
					2021	2022	2023
1	Automjet	2008	1,100,000	20%	48,379	38,703	30,962
2	Traktor	2012	560,000	20%	60,130	48,104	38,483
3	Makineri pajisje poligrafike	2007 ¹²	4,579,459	5%	2,121,623	2,015,542	1,914,765
4	Traktor	2012	448,000	20%	48,104	38,483	30,786
5	Traktor	2010	528,000	20%	36,284	29,027	23,222
TOTAL			7,215,459		2,314,520	2,169,859	2,038,218

Burimi: Të dhënat nga Agjencia. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Gjatë periudhës objekt auditimi, nuk rezulton të ketë pasur veprime nga ana e Agjencisë lidhur me këto pasuri të luajtshme.

Përsa trajtuar më sipër nga përfaqësuesit e subjektit, znj. R.Xh në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm aktual të AMGKP-së, deleguar në muajin prill 2024 (konceptuar nga znj. Xh.K në cilësinë e Arkivistes në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, znj. V.S në cilësinë e specialistes së Sektorit të Financës dhe Buxhetit, znj. A.Xh në cilësinë e specialistes në Sektorin e Ndjekjes së Procedurave të Ekzekutimit Përmbartimor, znj. E.Z në cilësinë e Përgjegjëses së Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Skemave të veçanta të Garancisë, znj. A.H në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, znj. K.T në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Financës dhe

¹² Konsideruar viti 2007 për vlerën 4,579,459 lekë pasi për këtë pasuri të paluajtshme ka patur ndryshime të vlerës duke filluar nga viti 2005 për shkak të dinamikave të sqaruara më sipër lidhur me regjistrimin dhe vlerësimin e saj.

Buxhetit), është paraqitur observacion me shkresën nr. 2041/2 prot., datë 01.07.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 185/11 datë 03.07.2024.

Pretendimi i subjektit:

- Referuar gjetjes nr. 5 mbi pasuritë e luajtshme të pasqyruara në llogarinë “Aktive të mbajtura për shitje”, në vlerë kontabël 7,215,459 lekë, vlerë e cila nuk paraqet vlerën reale aktuale të tyre, sqarojmë se referuar SKK nr. 5, një aktiv afatgjatë i klasifikuar si i mbajtur për shitje nuk amortizohet edhe pse ai vijon të përdoret në prodhim nga njësitë ekonomike deri në momentin e nxjerrjes jashtë përdorimit (pra shitjes). Pesë pronat e paluajtshme nuk janë vlerësuar nga një ekspert, pasi do të të rëndonin buxhetin e Agjencisë akoma dhe më shumë, duke ditur që 4 prej tyre nuk mund të nxirren në shitje pasi nuk disponohet dokumenta pronësie.

- Referuar gjetjes nr. 5 mbi mungesën e kontrollit fizik mbi ekzistencën e pasurive të luajtshme, sqarojmë se është ngritur grupi i punës në institucion ku janë verifikuar dhe kryer kontrolli fizik i pasurive të luajtshme. Ekzistenca dhe pasqyrimi i tyre është kryer dhe dokumentuar. Bashkëlidhur ju vëmë në dispozicion dokumentacionin dhe fotot: procesverbal nr. 2015 prot., datë 20.03.2023: pasuria e debitorit K.Xh dhe B.A, procesverbal nr. 1526 prot., datë 13.03.2023: pasuria e debitorit R.B, procesverbal nr. 1341/2 prot., datë 06.03.2023: pasuria e debitorit B.S.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Përsa më sipër, grupi i auditimit sqaron se:

- Në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 8, datë 09.03.2018 dhe SKK nr. 5, nga ana e Agjencisë nuk është përllogaritur amortizimi për këto pasuri të luajtshme. Megjithatë, grupi i auditimit referuar vitit të prodhimit të tyre dhe vendimit të kalimit në pronësi ku specifikohet vlera përkatëse, konstaton se edhe pse në Pasqyrat Financiare të Agjencisë nuk është përllogaritur amortizim për këto pasuri të paluajtshme dhe ato janë pasqyruar me vlerën kontabël, vlera reale e tyre më 31.12.2023 është shumë e ulët duke riskuar shitjen e suksesshme të tyre përmes procedurave të ankandit. Përllogaritja e kryer nga grupi i auditimit thekson faktin se në momentin e nxjerrjes në ankand dhe shitjes, vlera reale e pasurive të luajtshme do të jetë shumë më e ulët se vlera e pasqyruar nga Agjencia, përforcuar edhe me faktin e mungesës së dokumentacionit të pronësisë për 4 nga 5 pasuri të luajtshme.

- Lidhur me kontrollin fizik të pasurive të luajtshme, nuk ka dokumente bashkëlidhur observacionit pavarësisht se subjekti i audituar ka cituar procesverbale të mbajtura gjatë vitit 2023 për kontrollin e pasurive të luajtshme.

Sa më sipër, observacioni nuk sjell fakte apo dokumentacione të reja dhe rrjedhimisht nuk ndryshon gjetjet e grupit të auditimit.

Pasuri të paluajtshme të sekuestruara

Lidhur me pasuri të paluajtshme të sekuestruara të debitorëve, përgjatë periudhës objekt auditimi, nga lista e vënë në dispozicion nga Agjencia, evidentohen sipas viteve pasuri të paluajtshme, regjistruar sipas vlerave:

- 31.12.2021: 79 prona në vlerë totale 135,794,240.20 lekë;
- 31.12.2022: 77 prona në vlerë totale 125,731,740.20 lekë;
- 31.12.2023: 75 prona në vlerë totale 121,273,063.20 lekë.

Nga të dhënat, rezulton se gjatë vitit 2022 janë pakësuar 2 prona në vlerë 10,062,500 lekë dhe 2 prona gjatë vitit 2023 në vlerë 4,458,677 lekë. Pasuritë e paluajtshme, së bashku me pasuritë e luajtshme, Agjencia i ka klasifikuar në llogarinë “Aktive të mbajtura për shitje” në Pasqyrat Financiare të saj.

Lidhur me kalimin në pronësi të Agjencisë të pronave të sekuestruara përmes shërbimit përmbarimor, për periudhën objekt auditimi konstatohet se:

-Referuar Analizave Vjetore 2021-2023, Agjencia deklaroi se ka bashkëpunuar me zyrat e shërbimit përmbarimor shtetëror dhe privat për evidentimin e debitorëve dhe ekzekutimin e detyrimit;

-Bazuar në përgjigjet që Agjencia ka dhënë në Pyetësorin e përgatitur nga grupi i auditimit, Agjencia ka përcaktuar se praktika për përzgjedhjen e zyrave të shërbimit përmbarimor privat ka qenë e tillë: *“Si fillim publikohet kërkesa nga ana jonë, në faqen zyrtare të institucionit “Online”, tek seksioni i “Njoftimeve”, ku ftohen përmbarues privatë që ushtrojnë aktivitetin në territorin e vendit, për bashkëpunim, për vënien në ekzekutim të titujve ekzekutiv. Publikohet dhe dokumentacioni i nevojshëm që duhet të depozitohet. Përmbaruesit privatë të interesuar për bashkëpunim me institucionin e Agjencisë kanë depozituar kërkesat e tyre përkatëse për bashkëpunim, duke sjellë: Kërkesën për bashkëpunim, CV-në e përmbaruesit gjyqësor, Çertifikatën e Ushtrimit të Aktivitetit si Përmbarues Gjyqësor Privat (të noterizuar), Çertifikatën e regjistrimit me Nr. NIPT përkatës dhe Liçencë të QKB-së. Me shqyrtimin e kërkesave të tyre dhe duke studiuar historikun dhe portofolin e punëve të bëra dhe të ndjekura, nga drejtoria ka filluar bashkëpunimi duke dërguar disa dosje për të parë ecurinë e ndjekjes dhe ekzekutimit të tyre. Pas arritjeve të rezultateve të caktuara, sipas pritshmërive dhe ezaurimin e fazave përmbarimore brenda afateve ligjore, është vazhduar bashkëpunimi duke dërguar dosje të tjera me qëllim ekzekutimin e plotë të detyrimeve”.*

Me email e datës 02.05.2024, Agjencia bën me dije, pa specifikuar datën e saktë, se gjatë periudhës 2021-2023 është publikuar në faqen zyrtare të saj një kërkesë për bashkëpunim. Gjithashtu, nga Agjencia bëhet me dije se me zyrat përmbarimore private janë lidhur kontrata shërbimi si në vijim: gjatë vitit 2021, 256 kontrata shërbimi; gjatë vitit 2022, 160 kontrata shërbimi; gjatë vitit 2023, 360 kontrata shërbimi.

Sa i takon procedurës së kalimit të pronësisë së sendit të paluajtshëm në favor të kreditorit, nga Agjencia u vu në dispozicion informacioni se gjatë periudhës objekt auditimi, përkatësisht në vitin 2021 ka patur raste të likuidimit të zyrave përmbarimore duke qenë se këto të fundit kanë kryer procedurën për marrjen në dorëzim të sendit të paluajtshëm në favor të palës kreditore, për 12 raste.

Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të informacionit dhe dokumentacionit, ka konkluduar me tabelën nr. 5, në të cilën përcaktohen të dhënat mbi pasuritë e paluajtshme të cilat janë marrë në dorëzim përgjatë vitit 2021. Nga kryqëzimi i këtyre të dhënave, me listën e pasurive të paluajtshme të kontabilizuara të Agjencisë, konstatohet se minimalisht 9 pasuri të paluajtshme të identifikuar nuk rezultojnë të jenë të kontabilizuara (*nuk disponohet certifikatë pronësie dhe as urdhri i kontabilizimit*), specifikisht për:

1. Pasuria e llojit “Arë” me nr. Pasurie 26/21, vol. 2, fq. 237, sip. 14,100 m², Kalivaç, Tepelenë, e debitorit B.B, marrë në dorëzim në vitin 2020¹³, vlera e përcaktuar në vendim: 1,804,800 lekë;
2. Pasuria e llojit “Truall”, me nr. Pasurie 207/2, vol. 4, fq. 107, ZK 2473, sip. 250 m², Livadhja, Sarandë, e debitorit A.K, vlera e përcaktuar në vendim: 1,920,000 lekë;
3. Pasuria e llojit “Truall” me nr. Pasurie 204/1, vol. 2, fq. 104, sip. 300 m², Kalivaç, Tepelenë, e debitorit Ç.Ç, vlera e përcaktuar në vendim: 89,600 lekë;
4. Pasuria e llojit “Arë + Truall” me nr. Pasurie 126/1, vol. 3, fq. 39, ZK 2869, Panahor,

¹³ Sipas informacionit të dorëzuar nga Agjencia, pagesa për përmbaruesin është kryer në 2021, ndaj kjo pasuri është pjesë e listës së dorëzuar për vitin 2021.

Mallakastër, e debitorit B.Rr, nuk u vu në dispozicion vendimi për kalimin e pronësisë;

5. Pasuria e llojit “Depo farnash”, sip ndërtimi 267 m², Tepelenë, e debitorit V.L, vlera të përcaktuar në vendim: 800,000 lekë;

6. Pasuria e llojit “Arë” me nr. Pasurie 300/3, vol. 4, fq. 188, ZK 3421, sip. 600 m², Gjirokastrë, e debitorit T.T, vlera e përcaktuar në vendim: 134,400 lekë;

7. Pasuria e llojit “Arë” me nr. Pasurie 2/8, vol. 1, fq. 12, ZK 3421, sip. 3,600 m², Gjirokastrë, e debitorit T.T, vlera e përcaktuar në vendim: 832,000 lekë;

8. Pasuria e llojit “Arë” me nr. Pasurie 138, vol. 2, fq. 113, ZK 3421, sip. 2,250 m², Gjirokastrë, e debitorit T.T, vlera e përcaktuar në vendim: 448,000 lekë;

9. Pasuria e llojit “Shtëpi banimi”, nr. 19, me nr. Pasurie 213/11, vol. 1, fq. 38, ZK 2259, sip. Trualli 185 m² nga ku ndërtesa 53 m², Krahës i Poshtëm, Tepelenë, e debitorit J.R, vlera e përcaktuar në vendim: 256,000 lekë.

Vlera totale e 9 pasurive të cituara, sipas vlerës së përcaktuar në secilin prej vendimeve të kalimit të pronësisë, përllogaritet në 6,284,800 lekë.

Për më tepër, nga kryqëzimi i tabelës nr. 5 me listën e pronave të sekuestruara dhe kontabilizuara, rezultojnë dhe 3 debitorë për të cilët nuk rezulton pronë e kontabilizuar: *F.D, P.B dhe S.K.* Potencialisht, duke marrë në konsideratë edhe minimalisht nga 1 pronë të sekuestruar për secilin nga këta 3 debitorë, numri i pasurive të sekuestruara për të cilat nuk disponohet certifikatë pronësie dhe urdhër kontabilizimi arrin në minimalisht 12. Konstatohet se nga Agjencia nuk janë marrë masa për nxjerrjen e certifikatave të pronësisë së këtyre pasurive dhe regjistrimin e tyre në kontabilitet, veprime jo në përputhje me përcaktimet e pikës 4 të Kreut III të Udhëzimit nr. 33, datë 24.09.2010, ku citohet se “... *Gjithashtu personi i autorizuar, sipas rastit, bën aplikimet përkatëse në ZVRPP, DRSHTRR ose institucione të tjera të ngarkuara me ligj, për pajisjen me dokumentin e pronësisë, pasi përmbaruesi gjyqësor të ketë dërguar një kopje të vendimit përkatës në këto institucione*”, si dhe përcaktimet e pikës 5 të Kreut III të po këtij Udhëzimi ku citohet “*Pas përfundimit të procedurave për marrjen në dorëzim të sendit dhe regjistrimit në pronësi të ATK-së, plotësohet dosje e veçantë me dokumentacionin e plotë teknikoekonomiko-ligjor, një kopje e së cilës arkivohet në dosjen e debitorit. Njëkohësisht drejtorja e ATK-së merr vendim për regjistrimin në kontabilitet të vlerës së sendit të marrë në pronësi nëpërmjet procedurave përmbarimore*”.

Tabela nr. 5: Të dhëna mbi pasuri të marra në dorëzim në favor të palës kreditore

Nr.	Debitori	Pasuria	Vendimi i kalimit të pronësisë			Procesverbali i marrjes në dorëzim	
			Nr.	Datë	Vlera e pasurisë	Nr.	Datë
1	B.B	- "Truall" me nr. Pasurie 128/22, vol. 1, fq. 168, sip. 300 m ² , Kalivaç, Tepelenë - "Arë" me nr. Pasurie 26/21, vol. 2, fq. 237, sip. 14,100 m ² , Kalivaç, Tepelenë	Nr. 275/2011, nr. 3731 prot.	11.7.13	3,084,800	Nr. Extra prot.	2.3.20
2	A.K	"Truall", me nr. Pasurie 207/2, vol. 4, fq. 107, ZK 2473, sip. 250 m ² , Livadhja, Sarandë	Nr. 182/2011, nr. 439 prot.	10.2.14	1,920,000	Nr. Extra prot.	3.2.21
3	Ç.Ç	"Truall" me nr. Pasurie 204/1, vol. 2, fq. 104, sip. 300 m ² , Kalivaç, Tepelenë	Nr. 329/2012, nr. 5360 prot.	19.11.13	89,600	Nr. Extra prot.	10.2.21
4	Xh.M	"Shtëpi banimi", nr. 4 regj. Hipoteke, Hekal, Mallakastër	Nr. 1234 prot.	29.4.16	930,352	Nr. Extra prot.	9.2.21
5	L.I	"Tokë arë" me nr. Pasurie 107/112, vol. 3, fq. 185, Treblovë, Vlorë	Nr. 582 dosje, nr. 2287 prot.	14.9.16	490,000	Nr. Extra prot.	9.7.21
6	B.Rr	"Arë + Truall" me nr. Pasurie 126/1, vol. 3, fq. 39, ZK 2869, Panahor, Mallakastër	N/A	N/A	N/A	Nr. Extra prot.	9.2.21
7	V.L	"Depo farmash", sip ndërtimi 267 m ² , Tepelenë	Nr. 410/2012, nr. 8463 prot.	23.11.12	800,000	Nr. Extra prot.	10.2.21
8	F.D	N/A ¹⁴	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
9	T.T	- "Arë" me nr. Pasurie 300/3, vol. 4, fq. 188, ZK 3421, sip. 600 m ² , Gjirokastër - "Arë" me nr. Pasurie 2/8, vol. 1, fq. 12, ZK 3421, sip. 3,600 m ² , Gjirokastër - "Arë" me nr. Pasurie 138, vol. 2, fq. 113, ZK 3421, sip. 2,250 m ² , Gjirokastër	Nr. 317/2011, nr. 1761 prot.	29.5.14	1,414,400	Nr. Extra prot.	25.2.21
10	J.R	"Shtëpi banimi", nr. 19, me nr. Pasurie 213/11, vol. 1, fq. 38, ZK 2259, sip. Trualli 185 m ² nga ku ndërtesa 53 m ² , Krahës i Poshtëm, Tepelenë	Nr. 256/2011, nr. 8462 prot.	23.11.12	256,000	N/A	N/A
11	P.B	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
12	S.K	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Burimi: Të dhënat nga Agjencia. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

¹⁴ N/A – nuk u vu në dispozicion dokumentacion fizik për detajet përkatëse

Referuar VKM nr. 681, datë 11.06.2009, *“Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror, në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, për kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive, të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfiteozë të këtyre pasurive”*, i ndryshuar, janë përcaktuar procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga debitorët, të administrimit, shitjes e dhënies me qira apo me enfiteozë të këtyre pasurive dhe kriteret dhe kushtet, që duhen plotësuar për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, zëvendësimin e debitorit dhe të kolateralit.

Procedurat e ankandit duhet të organizohen nga Agjencia duke respektuar procedurat e shitjes së pronës shtetërore, të parashikuara në kreun III të vendimit nr. 1638, datë 17.12.2008 *“Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes”*, për aq sa është i zbatueshëm në kushtet specifike të funksionimit të Agjencisë. Si vlerë fillestare e pronës, që do të shitet me ankand, shërben vlera e kontabilizuar nga kjo agjenci. Sipas VKM nr. 61/2009, e ndryshuar, Agjencia ka të drejtën e rivlerësimit të pronës, para fillimit të procedurave të shitjes me ankand, me kusht rritjen e vlerës fillestare, kur e gjykon të arsyeshme se kanë ndryshuar pozitivisht kushtet e tregut, në zonën ku kjo pronë ndodhet.

Në rast se sendi nuk shitet në ankandin e parë, Agjencia ka të drejtën e përsëritjes së ankandit të dytë deri në tre herë duke ulur gradualisht çmimin e sendit deri në vlerën maksimale:

a) 30%, për sendet e paluajtshme;

b) 50%, për sendet e luajtshme.

Pasi arrihet vlera maksimale e uljes dhe sendi nuk shitet, bëhet rivlerësimi i tij me ekspert vlerësues të licencuar dhe më pas fillojnë procedurat e ankandit, në bazë të çmimit të ri.

Procedura e shitjes në ankand për të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme rregullohet edhe nga përcaktimet e Kreut III të Udhëzimit nr. 33, datë 24.09.2010, *“Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfiteozë të këtyre pasurive”*. Në Kreun II, pika 1 e Udhëzimit nr. 33/2010 citohet se *“Këtij udhëzimi u nënshtrohen të gjitha pasuritë e luajtshme dhe/ose të paluajtshme të lëna garanci ose jo nga debitorët e Agjencisë së Trajtimit të Kredive, të cilat kalojnë në pronësi të saj, në bazë të neneve 557 dhe 577 të Kodit të Procedurës Civile, pasi nuk janë shitur në ankandet e zhvilluara nga përmbaruesi gjyqësor, në zbatim të procedurave ligjore për ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimit”*. Në këto kushte, që pasuria të kalojë në procedurat e ankandit, duhet të jetë fillimisht në pronësi të Agjencisë. Nga analizimi i informacionit mbi pasuritë e paluajtshme të kontabilizuara dhe dokumentat e tyre të pronësisë, për periudhën 2021-2023, grupi i auditimit konstaton se:

- Për 54 prona të kontabilizuara, të pasqyruara me vlerë totale kontabël prej 98,499,714.20 lekë disponohen Certifikatë për vërtetim pronësie/Certifikatë për regjistrim pronësie;
- Për 19 prona të kontabilizuara të pasqyruara me vlerë totale kontabël prej 19,193,349 lekë disponohen vërtetime hipotekore, 5 prej të cilave janë në emër të Bankës Bujqësore apo debitorit dhe jo të Agjencisë (vlera e tyre paraqitet 6,305,365 lekë);
- Për 2 prona të kontabilizuara me vlerë totale kontabël prej 3,580,000 lekë disponohen kartela pasurie;
- Për 4 prona të kthyera debitorit, Agjencia ka nënshkruar kontratë shitje të pasurisë së paluajtshme (për 3 prona janë disponuar certifikata pronësie nga Agjencia dhe për 1 pronë është disponuar vërtetim nga dokument hipotekor).

Nga auditimi konstatohet se, më 31.12.2023, për 21 prona të kontabilizuara nuk disponohet certifikatë pronësie nga Agjencia, duke ndikuar potencialisht në tjetërsimin e pronës dhe duke mos mundësuar shitjen e pronës në ankand, duke qenë se kusht për shitjen e pronës përmes procedurave të ankandit është fakti që pasuria të jetë në pronësi të Agjencisë. Për më tepër,

vlera kontabël e pasqyruar nga Agjencia është bazuar vetëm në vlerën e ankandit të fundit të zhvilluar nga përmbaruesi, që i përket një periudhe të shumë viteve më parë. Në këto kushte, lista e mësipërme me pasuri të paluajtshme nuk pasqyron vlerën e tregut të pronave (treg i cili ka pësuar rritje të çmimeve gjatë viteve), pasi nuk janë kryer rivlerësime të pasurive edhe pse pika 10 e Kreut III të Udhëzimit 33/2010 parashikon se “ATK-ja ka të drejtën e rivlerësimit të pronës para fillimit të procedurave të shitjes me ankand, me kusht rritjen e vlerës fillestare, kur e gjykon të arsyeshme se kanë ndryshuar pozitivisht kushtet e tregut në zonën ku ndodhet kjo pronë”.

Mbi pronat e kthyer debitorit pas shlyerjes së detyrimit

Gjatë periudhës objekt auditimi konstatohet se në vitin 2021 është shitur një pronë me vlerë 15,450,000 lekë (*detajuar në vijim në procedurat e shitjes përmes ankandeve*), gjatë vitit 2022 janë liruar dy prona me vlerë 10,062,500 lekë dhe në vitin 2023 janë liruar dy prona me vlerë 4,458,677 lekë, duke kaluar në pronësi të debitorëve përkatës.

Sa i takon 4 pronave të kaluara sërish në pronësi të debitorëve, rezulton se:

- Për pasurinë e sekuestruar të debitorit G.J.K, Agjencia ka nënshkruar deklaratën noteriale për fshirje hipoteke me nr. rep. 1009, nr. kol. 503, më datë 01.04.2022, pasi debitori ka shlyer detyrimin për kredinë me kod 12232. Është nënshkruar kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. 1010 rep., nr. 504 kol., datë 01.04.2022 mes shitësit (Agjencia) dhe blerësit (H.K, T.K, D.H, R.K – trashëgimtarë të debitorit G.K).
- Për pasurinë e sekuestruar të debitorit A.K, Agjencia dhe debitori kanë nënshkruar Kontratë shit-blerje pasurie të paluajtshme me nr. rep. 955, nr. kol. 440/2, më datë 16.10.2017, pasi debitori ka shlyer detyrimin e kredisë me kod 87242, në shumën 2,976,142 lekë principal i mbetur dhe 78,450 lekë shpenzime gjyqësore më datë 13.09.2017, referuar Kartelës së Kredisë në sistem.
- Për pasurinë e sekuestruar të debitorit Q.M, Agjencia dhe debitori kanë nënshkruar Kontratë shitje pasurie të paluajtshme me nr. rep. 7961, nr. kol. 45045/2, më datë 05.12.2023, pasi debitori ka shlyer detyrimin e kredisë me kod 74913, në shumën 1,148,000 lekë principal i mbetur dhe 236,893 lekë shpenzime gjyqësore më datë 07.11.2023, referuar Kartelës së Kredisë në sistem.
- Për pasurinë e sekuestruar të debitorit N.A, Agjencia dhe debitori kanë nënshkruar Kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. rep. 4777, nr. kol. 2279, më datë 21.12.2023, pasi debitori ka shlyer detyrimin e kredisë me kod 11850, me pagesa përgjatë vitit 2023 për principalin e mbetur dhe shpenzimet gjyqësore.

Mbi procedurat e shitjes përmes ankandeve

Referuar procedurave të shitjes përmes ankandeve, Udhëzimi nr. 33/2010 përcakton përbërjen e Komisionit të Ankandeve të Agjencisë dhe detyrat e tij, por duke qenë se ky Udhëzim nuk është përditësuar me ndryshimin e strukturës së ATK gjatë viteve, nuk pasqyron në mënyrë të drejtë përbërjen e Komisionit, duke sjellë mospërputhje mes Udhëzimit dhe Rregullores si në vijim.

Pika nr. 26 e Kreut III të Udhëzimit nr. 33/2010 përcakton se Komisioni i ankandit kryesohet nga një zëvendës drejtor i përgjithshëm dhe përbëhet nga:

1. Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Llogaritjes së Detyrimit;
2. Drejtor i Drejtorisë së Migrimit dhe Koordinimit me Zyrat Rajonale;
3. Përgjegjës i Administrimit të Objekteve të Sekuestruara;
4. Përgjegjës i Sektorit Juridik.

Referuar Rregullores së funksionimit të brendshëm të ATK, në detyrat përkatëse sipas funksionit të punonjësve të Agjencisë, evidentohet ndër të tjera edhe të qenit anëtar i Komisionit të Ankandeve. Megjithatë, në Rregullore nuk ka një seksion të veçantë i cili të përcaktojë detyrat e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit të Ankandeve.

Nga shqyrtimi i detyrave të secilit punonjës (pozicion pune) sipas kësaj rregullore, konstatohet se pjesë e Komisionit të Ankandeve është:

1. Zv. Drejtori i Përgjithshëm Juridik, Operacional dhe Menaxhimit të Riskut (anëtar i përhershëm);
2. Përgjegjësi i Sektorit Juridik dhe Operacional (anëtar i përhershëm);
3. Përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Riskut (anëtar i përhershëm);
4. Specialist i Sektorit të Menaxhimit të Riskut (sekretar).

Detyrat dhe përbërja e Komisionit të Ankandeve përcaktohen në pikat 9-39 të Kreut III të Udhëzimit nr. 33/2010, i cili nuk përputhet me strukturën e Agjencisë për vitet 2021-2023. Edhe pse në pikën 38 të Kreut III të Udhëzimit nr. 33/2010 citohet se “*ATK-ja, në përputhje me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 681, datë 11.6.2009, ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 450, datë 16.6.2010 dhe këtij udhëzimi, ka të drejtë të hartojë rregulloren e brendshme për zhvillimin e ankandit, e cila miratohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës*”, nuk rezulton që Agjencia të ketë ndërmarrë hapa për miratimin e një rregullore specifike për zhvillimin e ankandeve, duke qenë as në Rregulloren e funksionit të brendshëm të ATK, nuk ka një seksion/pikë ku të jenë përcaktuar detyrat e Komisionit të Ankandeve.

Për vitet 2021, 2022 dhe 2023 rezulton të jetë ngritur dhe ndryshuar Komisioni i Ankandeve sipas urdhrave në vijim. Komisioni i Ankandeve deri në 08.03.2021 përbëhej nga:

1. G.G, Kryetare – zv. Drejtor i Përgjithshëm Juridik;
2. G.I, Anëtar – Përgjegjës i Sektorit të Financës;
3. M.K, Anëtar – Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Operacional;
4. B.L, Anëtar – Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Riskut;
5. E.Z, Anëtar – Specialist i Menaxhimit të Riskut/Sekretar i Komisionit të Ankandeve.

Me Urdhrin nr. 1718 prot., datë 08.03.2021 Komisioni i Ankandeve ndryshon duke zëvendësuar G.I me E.Ll, për të njëjtin pozicion (përgjegjës i Sektorit të Financës).

Me Urdhrin nr. 1718/1 prot., datë 08.06.2021, Komisioni i Ankandeve ndryshon përbërjen pasi E.Z. zëvendësohet me F. J. Ll, si Specialist i Menaxhimit të Riskut/Sekretar i Komisionit të Ankandeve.

Me Urdhrin nr. 1718/2 prot., datë 20.08.2021, Komisioni i Ankandeve ndryshon duke vendosur si Kryetar përgjegjës i Sektorit të Financës E.Ll në vend të zv. Drejtorit të Përgjithshëm G.G; M.K zëvendësohet me R.J (përgjegjës i komanduar i Sektorit Juridik dhe Operacional); shtohet O.S në Komision (specialist i Sektorit Juridik dhe Operacional).

Me Urdhrin nr. 1718/3 prot., datë 08.09.2021, ndryshohet përbërja e Komisionit duke rivendosur G.G si Kryetar të Komisionit dhe duke kaluar E.Ll si Anëtar; E.S zëvendëson R.J si përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Operacional; largohet O.S nga Komisioni.

Me Urdhrin nr. 1629/1 prot., datë 28.04.2022, Komisioni i Ankandeve ndryshon përbërjen sërish sipas listës:

1. G.G, Kryetar – zv. Drejtor i Përgjithshëm Juridik;
2. O.S, Anëtar – Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Riskut;
3. E.Z – Anëtar, Specialist i Sektorit Juridik dhe Operacional;
4. E.S – Anëtar, Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Operacional;
5. B.V – Anëtar, Specialist i Sektorit të Menaxhimit të Riskut/Sekretar i Komisionit të Ankandeve.

Me Urdhrin nr. 1629/2 prot., datë 29.09.2022, përbërja e Komisionit të Ankandeve ka ndryshuar ku si Sekretar i Komisionit është vendosur H.I në vend të B.V.

Urdhri nr. 3931 prot., datë 17.10.2022 ka ndryshuar përbërjen e Komisionit të Ankandeve ku është përcaktuar si Kryetar zv. Drejtori i Përgjithshëm Ekonomik M.M në vend të G.G.

Me Urdhrin nr. 4317 prot., datë 14.11.2022 është përcaktuar si Kryetar zv. Drejtori i Përgjithshëm Juridik O.M në vend të M.M.

Me Urdhrin nr. 2449 prot., datë 11.04.2023, Komisioni i Ankandeve zëvendëson O.S (specialist i Sektorit të Financës) me K.T (përgjegjës i Sektorit të Financës).

Gjatë periudhës objekt auditimi, sipas informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Agjencia, konstatohet se janë realizuar procedurat e ankandit me disa faza për 10 pasuri të paluajtshme, ku në total janë kryer 26 faza ankandi dhe ka përfunduar në shitje vetëm një pasuri.

Nga analizimi i dokumentacionit të dosjeve përkatëse, grupi i auditimit ka konstatuar:

- Në asnjërën prej dosjeve nuk është administruar Urdhri përkatës për ngritjen e Komisionit të Ankandeve;

- Në 5 dosje nuk është administruar propozimi i Agjencisë për kthimin e sendit të marrë në pronësi në kundërshtim me pikën 5 të pjesës II të VKM nr. 61/2009, e ndryshuar, ku përcaktohet se *“ATK pas kontabilizimit të pronës, kundrejt shlyerjes së menjëhershme të detyrimit të ristrukturuar, sipas përcaktimeve të bëra në kreun I të këtij vendimi, i propozon debitorit kthimin e sendit të marrë në pronësi. Debitori duhet të kthejë përgjigje, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit. Pas kalimit të këtij afati, ATK përgatit dosjen për shitjen me ankand”* duke humbur gjurmën e auditimit për kalimin apo jo të afatit prej 30 ditëve nga data e njoftimit;

- Në 9 prej dosjeve nuk është administruar procesverbali i nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të Ankandeve për hartimin e dokumentave, në kundërshtim me pikën 5.1 të VKM nr. 1719, datë 17.12.2008, *“Për miratimin e rregullave të Ankandit Publik”* përcaktohet se *“... Gjatë procesit të hartimit të dokumenteve duhet të mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e njësisë. ...”*;

- Në 5 faza ankandi, procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Ankandeve nuk specifikon nëse gjatë procedurës ka patur ofertues të interesuar për pjesëmarrje, por vendimmarrja e Komisionit kalon menjëherë në fazën e ardhshme me ulje vlere;

- Rrjedhimisht, dosjet e procedurave të ankandit nuk rezultojnë të inventarizuara dhe arkivuara në kundërshtim me nenin 30 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, i cili përcakton se *“... Në inventar dosjet renditen sipas sektorëve në përputhje me radhën që kanë në strukturën organizative të subjektit shtetëror apo joshtetëror, brenda çdo sektori sipas drejtimeve kryesore të tij dhe brenda këtij të fundit sipas rëndësisë së çështjes. Dosjet në inventar marrin numër një pas një për gjithë vitin. Inventari përfshin këto elementë: numrin rendor, numrin e dosjes, titullin e dosjes (së bashku me shënimin kur ka të tillë), datat ekstreme, sasinë e fletëve, afatin e ruajtjes, numrin e kutisë, afatin e shfrytëzimit, shënime. Në rastet kur pas përpunimit tekniko-shkencor dhe bërjes së inventarit të dokumenteve të një viti, evidencohen dokumente të tjera të pasistemuara, atëherë atyre u bëhet përpunimi tekniko-shkencor dhe ato trajtohen si “shëna”. Dosjet ku vendosen këto dokumente marrin numër progresiv, duke vazhduar numrin e fundit të dosjes në inventarin e vitit përkatës. Në rast se në dosje ndodhen dokumente të një rëndësie të veçantë, atëherë bëhet inventari i brendshëm i dosjes (Mod. 8)”*.

- Gjatë vitit 2021

Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2021 janë realizuar procedura ankandi edhe me ulje të vlerës për 4 pasuri të paluajtshme, ku ka përfunduar në shitje vetëm njëra prej pasurive.

1. Për 2 (dy) pasuri të sekuestruara të debitorit B.O

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve për këto dy procedura, rezulton se nuk janë pjesë e dosjes dokumentat fillestare të procedurës si:

- propozimi për kthimin e sendit të marrë në pronësi;
- Urdhri për ngritjen e Komisionit të Ankandit;
- procesverbali për hartimin e dokumentave të ankandit.

Më datë 30.12.2020, Komisioni i Ankandeve ka mbajtur procesverbalin me shkresën nr. 4585 prot., datë 30.12.2020, për mbledhjen e zhvilluar mbi vijimin e procedurave të ankandit për debitorin B.O, përkatësisht për pronat në vijim, të cilat sugjerohen të hidhen në ankand pas inspektimit të kryer nga specialistët e sektorit juridik dhe operacional:

A) Pasuria e llojit “Ndërtesë” me nr. 219/25, Vol. 4, fq. 224, ZK 1306, sipërfaqe ndërtimi 200 m², fshati Çepan, Skrapar;

B) Pasuria e llojit “Ndërtesë” me nr. 156, Vol. 2, fq. 201, ZK 3868, sipërfaqe totale 655 m², fshati Zabërzan i Ri, Skrapar.

Tabela nr. 6: Të dhëna mbi detyrimin dhe pronat e sekuestruara të debitorit me kod BO001

Debitor	Kod klienti	Kod kredie	Shp. Gjyqësore	Principal i mbetur	Monedha	Prona të sekuestruara	Vlera e pronave
B.O	BO001	84202	246,766	1,285,846	ALL	Ndërtese me sip. 200 m ²	320,000
						Punishte 655 m ²	768,000

Burimi: Të dhënat nga Agjencia. Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Ankandet për këto dy prona janë zhvilluar sipas ecuresisë së mëposhtme.

Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhrin për fillimin e procedurave të shitjes me ankand të parë për të dy pasuritë:

- shkresa nr. 4583/1 prot., datë 30.12.2020, për pasurinë me nr. 219/25 me vlerë të kontabilizuar në shumën 320,000 lekë;

- shkresa nr. 4583/3 prot., datë 30.12.2020, për pasurinë me nr. 156 me vlerë të kontabilizuar në shumën 768,000 lekë.

Agjencia ka dërguar drejt Agjencisë së Prokurimit Publik njoftimin e ankandit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike:

- shkresa nr. 300 prot., datë 18.01.2021, për pasurinë me nr. 219/25;

- shkresa nr. 301 prot., datë 18.01.2021, për pasurinë me nr. 156.

Në Njoftimin e Ankandit për të secilën nga pasuritë është përcaktuar afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje në datën 15.02.2021, ora 11:00, pra periodha e zhvillimit të ankandit rezultoi 25.01.2021 – 15.02.2021.

Me shkresën nr. 690 prot., datë 26.01.2021, Agjencia i është drejtuar Bashkisë Skrapar për bashkëpunim në afishimin e njoftimit të ankandit për pasuritë.

Në dosje nuk rezultoi asnjë procesverbal i mbajtur nga Komisioni i Ankandëve për mbylljen e fazës pa ofertues apo pa fitues, por procedura kalon drejtpërdrejt në ankand të dytë (hera e parë) me vlerë të zbritur me 15% për pasurinë përkatëse.

Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhrin për nxjerrje në ankand të dytë (hera e parë) me vlerë të zbritur me 15% nga vlera e kontabilizuar:

- shkresa nr. 1506 prot., datë 18.02.2021, për pasurinë me nr. 219/25 me vlerë të ulur në shumën 272,000 lekë;

- shkresa nr. 1505 prot., datë 18.02.2021, për pasurinë me nr. 156 me vlerë të ulur në shumën 652,800 lekë.

Njoftimi i ankandit i është përcjellë APP:

- me shkresën nr. 1836 prot., datë 09.03.2021, për pasurinë me nr. 219/25;

- me shkresën nr. 1835 prot., datë 09.03.2021, për pasurinë me nr. 156.

Në Njoftimin e Ankandit përcaktohet periodha e zhvillimit të ankandit 16.03.2021 – 06.04.2021, me datë përfundimtare 06.04.2021, ora 11:00. Kërkesa për bashkëpunim për afishimin e njoftimit i është dërguar Bashkisë Skrapar me shkresën nr. 7045 prot., datë 17.03.2021.

Me shkresën nr. 2355 prot., datë 06.04.2021, Komisioni i Ankandëve ka mbajtur procesverbalin ku, përcaktohet se për ankandin e zhvilluar për këto pasuri nuk pati të interesuar dhe se për debitorin B.O u konfirmua që ka ndërruar jetë, ndaj komisioni vendosi të vërë në dijeni trashëgimtarët për detyrimin e debitorit dhe fazën aktuale të ankandit, duke i propozuar kthimin e sendit në pronësi, nëpërmjet një kontrate shërbimi.

Megjithatë, edhe pas këtij momenti, procedura ka vijuar me shpallje ankandi të tretë me vlerë të zbritur me 30% nga vlera e kontabilizuar, për dy pasuritë:

- shkresa nr. 2802 prot., datë 05.05.2021, për pasurinë me nr. 219/25 me vlerë të ulur në shumën 224,000 lekë;

- shkresa nr. 2801 prot., datë 05.05.2021, për pasurinë me nr. 156 me vlerë të ulur në shumën 537,600 lekë.

Njoftimi i Ankandit i është dërguar APP:

- me shkresën nr. 2802/2 prot., datë 05.05.2021, për pasurinë me nr. 219/25;

- me shkresën nr. 2801/1 prot., datë 05.05.2021, për pasurinë me nr. 156.

Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje është data 31.05.2021, ora 11:00. Me shkresën nr. 2820 prot., datë 10.05.2021 i është dërguar Bashkisë Skrapar kërkesa për bashkëpunim për afishimin e njoftimeve. Nuk rezulton që në dosje të ketë një procesverbal i cili të konfirmojë nëse ka patur apo jo pjesëmarrës të interesuar apo fitues.

Në dosjet e këtyre dy ankandeve, nuk ka dokumentacion për vijimin e procedurës pas konstatimit që debitori ka ndërruar jetë apo për masa të marra pas këtij momenti, por rezulton që procedura të këtë vijuar me shpalljen e ankandit të tretë. Për më tepër nga kryqëzimi i informacionit të paraqitur në shkresën nr. 2355 prot., datë 06.04.2021, me listën e debitorëve që kanë ndërruar jetë paraqitur nga Agjencia, konstatohet se debitori B.O nuk është pjesë e kësaj liste.

2. Për 1 (një) pasuri të sekuestruar të debitorit N.A¹⁵

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve për këto dy procedura, rezulton se nuk janë pjesë e dosjes dokumentat fillestare të procedurës si:

- propozimi për kthimin e sendit të marrë në pronësi;
- Urdhri për ngritjen e Komisionit të Ankandit;
- procesverbali për hartimin e dokumentave të ankandit.

Sipas shkresës nr. 4246/1 prot., datë 11.12.2020, Komisioni i Ankandeve ka mbajtur procesverbal për vijimin e procedurave të ankandit për debitorin N.A, për pronën e llojit "Truall", me nr. 205/340, Vol. 5, fq. 30, ZK 1053 me sipërfaqe 1930.5 m², në Arshiv-Lengo, Gjirokastër, me vlerë 2,248,646 lekë. Referuar gjendjes së kredive më datë 01.12.2020 (përpara daljes së urdhrin për ankandin), vlera e principalit të mbetur për debitorin M.A (MA20) është 0.00 Euro.

Tabela nr. 7: Të dhëna mbi detyrimin dhe pronat e sekuestruara të debitorit MA20

Debitori	Kod klienti	Kod kredie	Shp. Gjyqësore	Principal i mbetur	Monedha	Prona të sekuestruara	Vlera e pronës
M.A	MA20	11850	312,069	0.00	EUR	Truall me sipërfaqe 1930.5 m ²	2,248,646 lekë

Burimi: Të dhënat nga Agjencia. Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Agjencia ka dërguar drejt APP njoftimin e ankandit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike me shkresën nr. 4453 prot., datë 09.12.2020, afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje është përcaktuar data 04.01.2021, ora 11:00, pra periudha e zhvillimit të ankandit rezulton 14.12.2020 – 04.01.2021.

Me shkresën nr. 8 prot., datë 05.01.2021, është mbajtur procesverbali nga Komisioni i Ankandeve, ku rezulton të mos jetë paraqitur asnjë pjesëmarrës i interesuar për blerjen e pasurisë dhe do të vijohet me ankandin e dytë me vlerë të ulur.

Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhrin për nxjerrje në ankand të dytë (hera e parë) me vlerë të zbritur me 15% nga vlera e kontabilizuar, pra me vlerë totale 1,911,350 lekë.

Njoftimi i ankandit i është përcjellë APP me shkresën nr. 302 prot., datë 18.01.2021, ku në Njoftimin e Ankandit përcaktohet periudha e zhvillimit të ankandit 25.01.2021 – 15.02.2021, me datë përfundimtare 15.02.2021, ora 11:00. Kërkesa për bashkëpunim për afishimin e njoftimit i është dërguar Bashkisë Gjirokastër me shkresën nr. 689 prot., datë 26.01.2021.

Me shkresën nr. 1502 prot., datë 17.02.2021, Komisioni i Ankandeve ka vendosur të vijojë me fazën e radhës të ankandit për këtë pronë, pa specifikuar nëse ka patur apo jo pjesëmarrës të interesuar gjatë fazës së dytë të ankandit të zhvilluar.

¹⁵ Në Regjistrin e Kredive debitori është shënuar si M.A, me kod MA20

Drejtori i Përgjithshëm me shkresën nr. 1503 prot., datë 18.02.2021, ka nxjerrë Urdhrin për fillimin e procedurave të shitjes me ankand të dytë (për herë të dytë) të pronës me vlerë të ulur 30%, tashmë në vlerë totale 1,574,052 lekë. Njoftimi i Ankandit i është përcjellë APP me shkresën nr. 1833 prot., datë 09.03.2021, ku është përcaktuar periudha e ankandit 16.03.2021 – 06.04.2021. Përmes shkresës nr. 2044 prot., datë 17.03.2021, i është dërguar Bashkisë Gjirokastrë kërkesa për bashkëpunim për afishimin e njoftimit të ankandit.

Në dosje është administruar kërkesa e shtetasit A.D e datës 25.03.2021, në të cilën shprehet interesi për blerjen e pronës së paraqitur në ankand. Agjencia ka kërkuar nga shtetasi përmes shkresës nr. 2184/1 prot., datë 30.03.2021, të ngurtësojë në llogarinë e Agjencisë 20% të vlerës së pronës brenda afatit kohor të përfundimit të ankandit, si dhe i ka përcjellë dokumentacionin e pronës për njohje. Në dosje nuk ka vijimësi të korrespondencës.

Për më tepër, në shkresën nr. 2355 prot., datë 06.04.2021, Komisioni i Ankandeve ka mbajtur procesverbalin ku përcaktohet se për ankandin e zhvilluar nuk pati të interesuar dhe ankandi u mbyll.

3. Për 1 (një) pasuri të sekuestruar të debitorit N.Ç

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes, rezulton se nuk janë pjesë e dosjes dokumentat fillestare të procedurës si:

- propozimi për kthimin e sendit të marrë në pronësi;
- Urdhri për ngritjen e Komisionit të Ankandit.

Përmes shkresës nr. 306 prot., datë 18.01.2021, Komisioni i Ankandeve ka mbajtur procesverbalin për diskutimin e vijimësisë së ankandit për pronën e marrë në pronësi Pikë Karburanti Kompleksi, me nr. 586/9, Vol. 8, fq. 111, ZK 1967 me sipërfaqe 480 m², në Hotolisht, Librazhd. Në procesverbal citohet se është bërë rivlerësimi i pronës, por në dosje nuk gjendet dokumentacioni justifikues, por vetëm email i datës 18.01.2021 ku citohet vlera e vlerësuar nga Studio L.... prej 21,542,700 ALL ose 173,000 EUR (me kurs këmbimi 123.88 ALL/EUR sipas BSH).

Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhrin për fillimin e procedurave të shitjes me ankand të parë përmes shkresës nr. 299 prot., datë 18.01.2021 me vlerë 21,542,700 lekë.

Referuar gjendjes së kredive më datë 01.01.2021 (përpara daljes së urdhrin për ankandin), vlera e principalit të mbetur për debitorin N.Ç, administrator i Ç.... SHPK paraqitet si në tabelë:

Tabela nr. 8: Të dhëna mbi detyrimin dhe pronat e sekuestruara të debitorit Ç.... SHPK

Debitor i	Kod klienti	Kod kredie	Shp. Gjyqësore	Principal i mbetur	Monedha	Prona të sekuestruara	Vlera e pronës
Ç.... SHPK	SC035	66037	1,415,526.00	0.00	ALL	Pikë Karburanti me sipërfaqe 480 m ²	21,542,700 lekë
	SC036	66036	66,600.00	4,480,000.00	ALL		

Burimi: Të dhënat nga Agjencia. Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Referuar listës së debitorëve të ndarë nga jeta, rezulton se administratori i Ç... SHPK është ndarë nga jeta.

Agjencia ka përcjellë pranë APP Njoftimin e Ankandit përmes shkresës nr. 303 prot., datë 18.01.2021, ku përcaktohet periudha e zhvillimit të ankandit 25.01.2021 – 15.02.2021. Gjithashtu, i është dërguar kërkesë për bashkëpunim Bashkisë Librazhd për afishimin e njoftimit.

Me shkresën nr. 1502 prot., datë 17.02.2021, Komisioni i Ankandeve ka vendosur të vijojë me shpalljen në ankand për herë të dytë me ulje vlere, pa specifikuar nëse janë paraqitur pjesëmarrës të interesuar për blerje. Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhrin për fillimin e procedurave të shitjes me ankand të dytë (hera e parë) me vlerë 15% të zbritur në shumën 18,311,295 lekë përmes shkresës nr. 1504 prot., datë 18.02.2021. Gjithashtu, me shkresën nr. 1834 prot., datë 09.03.2021 është dërguar drejt APP Njoftimi i Ankandit, ku përcaktohet periudha e zhvillimit 16.03.2021 – 06.04.2021. I është dërguar bashkisë Librazhd kërkesa për bashkëpunim një afishimin e njoftimit përmes shkresës nr. 2046 prot., datë 17.03.2021.

Në procesverbalin e mbajtur përmes shkresës nr. 2355 prot., datë 06.04.2021, deklarohet se nuk janë paraqitur ofertues, ndaj do të vijojë shpallja në ankand me vlerë të ulur 30%.

Më datë 06.04.2021 është mbajtur nga Komisioni i Ankandeve, procesverbali mbi diskutimin dhe miratimin e dokumentave të ankandit të hapur për pronën e cituar, ku përcaktohen detajet:

- Data e zhvillimit të ankandit: 13.05.2021;

- Vlera fillestare: 21,542,700 lekë;

- Vlera e zbritur: 15,079,890 lekë;

- Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: 03.05.2021, ora 11:00.

Në dosje gjenden Dokumentat Standarde të Ankandit, por nuk rezultojnë të firmosura nga Komisioni i Ankandeve.

Me shkresën nr. 2356 prot., datë 06.04.2021, Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhrin për nisjen e procedurës së shitjes përmes ankandit të dytë (hera e dytë) me vlerë të ulur 30%, pra në vlerë totale 15,079,890 lekë. Njoftimi i Ankandit i është dërguar APP me shkresën nr. 2357 prot., datë 06.04.2021. Me shkresën nr. 2356/2 prot., datë 04.05.2021, është njoftuar shtyrja e afatit të ankandit për në datën 04.05.2021, pasi data 03.05.2021 është pushim zyrtar.

Në dosje administrohen kërkesat e mëposhtme për regjistrim në këtë ankand:

1. Kërkesa nr. 31 prot., datë 26.04.2021, protokolluar në Agjenci me shkresën nr. 2773 prot., datë 28.04.2021 i shoqërisë “K.....” SHPK, i cili ka derdhur në llogari të Agjencisë shumën prej 3,015,978 lekë (20% të vlerës 15,079,890 lekë) me faturën e datës 30.04.2021;

2. Kërkesa nr. 74 prot., datë 28.04.2021, protokolluar në Agjenci me shkresën nr. 2786 prot., datë 04.05.2021 i personit fizik G.T, i cili ka derdhur në llogari të Agjencisë shumën prej 3,015,978 lekë (20% të vlerës 15,079,890 lekë) me faturën e datës 04.05.2021.

Të dy ofertuesit kanë paraqitur ofertat si në vijim:

- Oferta e shoqërisë “K....” SHPK, paraqitur me shkresën nr. 29, datë 29.04.2021, protokolluar në Agjenci me shkresën nr. 2789 prot., datë 04.05.2021, me vlerë totale 15,450,000 lekë;

- Oferta e personit fizik G.T, paraqitur me shkresën pa nr, datë 28.04.2021, protokolluar në Agjenci me shkresën nr. 2790 prot., datë 04.05.2021, me vlerë totale 15,400,000 lekë.

Në dosje administrohen deklaratat e nënshkuara mbi konfliktin e interesave në ushtrimin e funksioneve publike nga kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Ankandeve.

Me shkresën nr. 2356/1 prot., datë 04.05.2021, është mbajtur procesverbali për zhvillimin e procedurave të ankandit të dytë (hera e dytë), ku fitues është shpallur shoqëria “K....” SHPK pasi ka paraqitur ofertën më të lartë, ku më pas është nxjerrë Vendimi për shpalljen fitues nr. 2798 prot., datë 04.05.2021. Në Buletinin nr. 79, datë 24.05.2021 të APP është shpallur Njoftimi i Fituesit, përcjellë përmes shkresës nr. 2798/8 prot., datë 17.05.2021. Shoqëria “K....” SHPK ka kaluar në llogari të Agjencisë shumën e mbetur prej 12,434,022 lekë për plotësimin e vlerës së ofertës, më datë 05.05.2021.

Agjencia i ka kthyer pjesëmarrësit G.T shumën prej 3,015,978 lekë që ky i fundit kishte ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mes Agjencisë dhe shoqërisë “K....” SHPK është lidhur kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. rep. 645, nr. kol. 249, më datë 05.05.2021. Me shkresën nr. 3092 prot., datë 21.05.2021, është mbajtur procesverbali për dorëzimin përfundimtar të pasurisë së paluajtshme e llojit “Ndërtesë” me nr. 586/9, Vol. 8, fq. 111, ZK 1967 me sipërfaqe 480 m², në Hotolisht, Librazhd, nënshkruar nga M.K (person i autorizuar për nënshkrimin e kontratës sipas Autorizimit nr. 2798/2 prot., datë 05.05.2021). Është mbajtur procesverbali nr. 3092 prot., datë 21.05.2021 për dorëzimin përfundimtar të pasurisë, nënshkruar nga M.K dhe përfaqësuesi i “K....” SHPK, I.N.

- Gjatë vitit 2022

Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2022 janë realizuar procedura ankandi edhe me ulje të vlerës për 2 pasuri të paluajtshme, të papërfundura me shitje.

1. Për 1 (një) pasuri të sekuestruar të debitorit A.K

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes, rezulton se nuk janë pjesë e dosjes dokumentat fillestare të procedurës si:

- Urdhri për ngritjen e Komisionit të Ankandit;
- procesverbali për hartimin e dokumentave të ankandit.

Me shkresën nr. 1741 prot., datë 10.05.2022 është mbajtur procesverbali për mbledhjen e Komisionit të Ankandeve ku është diskutuar për fillimin e procedurave të ankandit për pronën e sekuestruar të debitorit A.K. Referuar procesverbalit njoftimi për shlyerje vullnetare të detyrimit, zarfi është kthyer më datë 18.03.2022 me motivin “I panjohur”. Si rrjedhojë, Komisioni deklaroi se është kryer aplikimi me kërkesë nr. 751, datë 17.03.2022 për nxjerrjen e kartelës së rifreskuar të pronës në ASHK dhe nuk ka ende një përgjigje. Referuar Urdhrit të Brendshëm nr. 298, datë 09.11.2009, vlera për ankand e pronës përcaktohet nga Komisioni në shumën 6,720,000 lekë. Komisioni ka vendosur të mblidhet në një moment të dytë pasi të pajisjet me dokumentacion nga ASHK Përmet për pronën me dokument hipotekor origjinal nr. 14-39, datë 25.02.2009, me nr. 2/53, ZK 2917, sipërfaqe 3,143.4 m², Përmet. Me shkresën nr. 1741/1 prot., datë 31.05.2022, Komisioni i Ankandeve ka mbajtur procesverbalin ku është pajisur me dokumentacion tekniko-ligjor (certifikatë pronësie, fragment i hartës kadastrale, kartela e pasurisë) dhe propozon të vazhdohen procedurat e ankandit.

Tabela nr. 9: Të dhëna mbi detyrimin dhe pronat e sekuestruara të debitorit A.K

Debitori	Kod klienti	Kod kredie	Shp. Gjyqësore	Principal i mbetur	Monedha	Prona të sekuestruara	Vlera e pronave
A.K	AK087	36479	190,176.00	218,482.15	ALL	Truall sip.3143,4 m ²	6,720,000 lekë

Burimi: Të dhënat nga Agjencia. Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhrin për fillimin e procedurave të shitjes me ankand të parë me shkresën nr. 2266 prot., datë 06.06.2022, për pasurinë e llojit “Truall”, me nr. 2/53, Vol. 13, fq. 74, ZK 2917, me sipërfaqe 3,143.4 m² me vlerë totale 6,720,000 lekë. Me shkresën nr. 2266/1 prot., datë 06.06.2022 Agjencia i ka dërguar APP Njoftimin e Ankandit i cili do të zhvillohet në periudhën 16.06.2022 – 04.07.2022. Gjithashtu, i është dërguar kërkesë për bashkëpunim Bashkisë Përmet për afishimin e njoftimit, me shkresën nr. 2466 prot., datë 14.06.2022.

Me shkresën nr. 2627 prot., datë 04.07.2022, Komisioni i Ankandeve ka mbajtur procesverbalin ku përcaktohet se nuk ka patur asnjë aplikim nga pjesëmarrës të interesuar, ndaj propozohet hedhja në ankand të dytë me vlerë të ulur me 15%.

Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhrin për fillimin e procedurave të shitjes me ankand të dytë me vlerë të ulur në shumën 5,712,000 lekë, përmes shkresës nr. 2631 prot., datë 05.07.2022. Gjithashtu, është dërguar Njoftimi i Ankandit drejt APP me shkresën nr. 2713 prot., datë 12.07.2022, ku përcaktohet periudha e zhvillimit të ankandit 18.07.2022 – 08.08.2022. I është dërguar kërkesë për bashkëpunim Bashkisë Përmet për afishimin e njoftimit, me shkresën nr. 2762 prot., datë 20.07.2022.

Me shkresën nr. 2857 prot., datë 08.08.2022, është mbajtur procesverbali ku përcaktohet se nuk ka patur asnjë paraqitje nga pjesëmarrës të interesuar dhe në kushtet kur Kryetari i Komisionit dhe një Anëtar janë me leje vjetore, procedura pezullohet deri në një moment të dytë. Më pas, me shkresën nr. 3245 prot., datë 14.09.2022, Komisioni ka propozuar hedhjen në ankand të tretë të pronës me vlerë të ulur me 30%, pra në shumën 4,074,000 lekë. Procedurat e shitjes kanë filluar me shkresën nr. 3427 prot., datë 16.09.2022 (Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm) dhe Njoftimi i Ankandit me periudhë 26.09.2022 – 17.10.2022 është dërguar drejt APP me shkresën nr. 3427/2 prot., datë 20.09.2022. I është dërguar kërkesë për bashkëpunim Bashkisë Përmet për afishimin e njoftimit, me shkresën nr. 3537 prot., datë 26.09.2022.

Komisioni i Ankandëve ka mbajtur procesverbalin përmes shkresës nr. 3939 prot., datë 17.10.2022, ku përcakton se nuk është paraqitur asnjë kërkesë nga ofertues. Ndaj në këto kushte, Komisioni ka vendosur të mos e hedhë në ankand deri në një moment tjetër.

2. Për 1 (një) pasuri të sekuestruar të debitorit D.B

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes, rezulton se nuk janë pjesë e dosjes dokumentat fillestare të procedurës si:

- propozimi për kthimin e sendit të marrë në pronësi;
- Urdhri për ngritjen e Komisionit të Ankandit;
- procesverbali për hartimin e dokumentave të ankandit.

Procesverbali me shkresë nr. 334, datë 14.09.2022, i Komisionit të Ankandëve përcakton se referuar dokumentit të rifreskuar të pronësisë, dhe kontabilizimit të pasurisë, të vijohet me procedurat e ankandit.

Në dosje është administruar shkresa nr. 3426 prot., datë 16.09.2022, ku Drejtori i Përgjithshëm urdhëron fillimin e procedurave me ankand të parë me vlerë të kontabilizuar 257,600 lekë për pasurinë e llojit “Arë” me nr. 33, Vol. 2, fq. 161, ZK 1180 me sipërfaqe 1,250 m² në Gramsh. Njoftimi i Ankandit është përcjellë pranë APP me shkresën nr. 3427/1 prot., datë 16.09.2022, ku periudha e ankandit përcaktohet 26.09.2022 – 17.10.2022. Me shkresën nr. 3536 prot., datë 26.09.2022, i është kërkuar bashkëpunim Bashkisë Gramsh për afishimin e Njoftimit të Ankandit. Sipas shkresës nr. 3940 prot., datë 17.10.2022, në procesverbalin e Komisionit të Ankandëve përcaktohet se nuk ka patur asnjë ofertues, ndaj propozohet të vijohet me shpalljen e dytë me vlerë të ulur me 15%.

Me shkresën nr. 3940/1 prot., datë 17.10.2022, Drejtori i Përgjithshëm ka urdhëruar nisjen e procedurave të shitjes me ankand të dytë me vlerë 15% të zbritur, pra në shumën 218,960 lekë. Me shkresën nr. 3940/2 prot., datë 17.10.2022 është dërguar drejt APP Njoftimi për Ankandin me periudhë 24.10.2022 – 14.11.2022. I është dërguar kërkesë për bashkëpunim Bashkisë Gramsh për afishimin e Njoftimit. Me shkresën nr. 4317/1 prot., datë 14.11.2022, në procesverbalin e Komisionit të Ankandëve përcaktohet se nuk ka patur asnjë ofertues, ndaj propozohet të vijohet me shpalljen e dytë me vlerë të ulur me 30%.

Tabela nr. 10: Të dhëna mbi detyrimin dhe pronat e sekuestruara të debitorit D.B

Debitori	Kod klienti	Kod kredie	Shp. Gjyqësore	Principal i mbetur	Monedha	Prona të sekuestruara	Vlera e pronave
D.B	DB012	68164	81,500.00	256,000.00	ALL	Tokë arë 1,250 m ²	257,600 lekë

Burimi: Të dhënat nga Agjencia. Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Drejtori i Përgjithshëm ka urdhëruar fillimin e procedurave të shitjes me ankand të tretë me vlerë 30% të zbritur, në shumën 180,320 lekë, me shkresën nr. 4317/2 prot., datë 14.11.2022. Njoftimi për Ankandin i është dërguar APP me shkresën nr. 4317/2 prot., datë 14.11.2022, me periudhë zhvillimi 21.11.2022 – 12.12.2022. I është dërguar Bashkisë Gramsh kërkesë për bashkëpunim për afishimin e njoftimit me shkresën nr. 4375 prot., datë 21.11.2022. Referuar shkresës nr. 4806 prot., datë 12.12.2022, Komisioni i Ankandëve përcakton se nuk është paraqitur asnjë ofertues në asnjë prej fazave të ankandit, ndaj mbyllet pa ofertues.

- Gjatë vitit 2023

Nga auditimi konstatohet se sipas Analizës Vjetore të Agjencisë për vitin 2023 janë realizuar procedura ankandi për 9 prona me vendndodhje Çlirim, Goriçan, ndërsa sipas dokumentacionit gjatë vitit 2023 janë realizuar procedura ankandi 4 pasuri të paluajtshme, të papërfundura me shitje.

1. Për 4 (katër) pasuri të sekuestruara të debitorit F.Gj

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve për këto katër procedura, rezulton se nuk janë pjesë e dosjes dokumentat fillestare të procedurës si:

- Urdhri për ngritjen e Komisionit të Ankandit;
- procesverbali për hartimin e dokumentave të ankandit.

Agjencia i ka drejtuar debitorit F.Gj shkresën nr. 5548 prot., datë 21.08.2023, ku njoftohet për shlyerjen e detyrimit si në vijim, duke propozuar kthimin e sendit të marrë në pronësi, kundrejt likuidimit të detyrimit përmes një kontrate shërbimi me debitorin:

- *Principal: 15,427.20 USD;*
- *Interes: 23,407.84 USD;*
- *Shpenzime të pafalshme: 740,931 ALL;*
- *Arkëtime: 671.91 USD;*
- *Total Detyrimi: 38,163.13 USD + 740,931.00 Lekë.*

Sipas kësaj shkrese, pasuritë me nr. 104/38, 105/30, 97/26, 75/23, 77/186, 75/22, 50/206, 50/275 të ndodhura në fshatin Çlirim, Goriçan janë sekuestruar nga përmbauesi gjyqësor sipas vendimit të kalimit të pronësisë nr. 3394 prot., datë 22.05.2018. Referuar Urdhrit të Brendshëm për kontabilizimin e pronave nr. 132 prot., datë 20.03.2013, janë kontabilizuar në vlerë totale 2,143,685.25 Lekë.

Referuar gjendjes së kredive më datë 01.01.2023 (përpara daljes së urdhrin për ankandin), vlera e principalit të mbetur për debitorin F.Gj paraqitet si në tabelë:

Tabela nr. 11: Të dhëna mbi detyrimin dhe pronat e sekuestruara të debitorit

Debitori	Kod klienti	Kod kredie	Shp. Gjyqësore (Lekë)	Principal i mbetur	Monedha	Prona të sekuestruara	Vlera e pronës (Lekë)
F.Gj	FG16	12533	740,931.00	14,755.29	USD	Toke are sip 1700 m ²	527,619.75
						Toke are sip 2157 m ²	669,454.80
						Toke are sip 3200 m ²	297,949.05
						Toke are sip 1200 m ²	372,437.10
						Toke are sip 1200 m ²	111,731.66
						Toke are sip 1000 m ²	93,108.75
						Toke are sip 500 m ²	46,554.90
						Toke are sip 200 m ²	24,829.35

Burimi: Të dhënat nga Agjencia. Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Komisioni i Ankandeve ka mbajtur procesverbalin me shkresën nr. 6161 prot., datë 21.09.2023, për fillimin e procedurave për 4 prona të debitorit F.Gj:

1. Pasuri e llojit "Arë", me nr. 75/22, ZK 1806, me sipërfaqe 1,000 m², në Goriçan, Berat;
2. Pasuri e llojit "Arë", me nr. 77/186, ZK 1806, me sipërfaqe 1,200 m², në Goriçan, Berat;
3. Pasuri e llojit "Arë", me nr. 105/30, ZK 1806, me sipërfaqe 1,200 m², në Goriçan, Berat;
4. Pasuri e llojit "Arë", me nr. 75/23, ZK 1806, me sipërfaqe 3,200 m², në Goriçan, Berat.

Me shkresën nr. 6161/1 prot., datë 25.09.2023, Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhrin për fillimin e procedurave të shitjes me ankand të parë për pronat e mësipërme sipas vlerave:

1. Pasuri e llojit "Arë", me nr. 75/22, ZK 1806, me sipërfaqe 1,000 m², me vlerë 96,000 lekë;
2. Pasuri e llojit "Arë", me nr. 77/186, ZK 1806, me sipërfaqe 1,200 m², me vlerë 115,200 lekë;
3. Pasuri e llojit "Arë", me nr. 105/30, ZK 1806, me sipërfaqe 1,200 m², me vlerë 384,000 lekë;
4. Pasuri e llojit "Arë", me nr. 75/23, ZK 1806, me sipërfaqe 3,200 m², me vlerë 307,200 lekë.

Ndërkohë, sipas listës së pronave të sekuestruara të vënë në dispozicion nga Agjencia, këto prona rezultojnë në vlerat sipas tabelës nr. 12, kontabilizuar me 27,173 lekë më pak.

Tabela nr. 12: Prona të nxjerra në ankand të sekuestruara nga debitorin F.Gj

Nr.	Pasuria	Vlera sipas listës së pronave	Vlera e nxjerrjes në ankandin e parë	Diferenca
1	Pasuri e llojit "Arë", me nr. 75/22, ZK 1806, me sipërfaqe 1,000 m ²	93,108.75	96,000.00	-2,891.25
2	Pasuri e llojit "Arë", me nr. 77/186, ZK 1806, me sipërfaqe 1,200 m ²	111,731.66	115,200.00	-3,468.34
3	Pasuri e llojit "Arë", me nr. 105/30, ZK 1806, me sipërfaqe 1,200 m ²	372,437.10	384,000.00	-11,562.90
4	Pasuri e llojit "Arë", me nr. 75/23, ZK 1806, me sipërfaqe 3,200 m ²	297,949.05	307,200.00	-9,250.95

Burimi: Të dhënat nga Agjencia. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Njoftimi i Ankandit me periudhë zhvillimi 02.10.2023 – 23.10.2023, i është dërguar APP sipas shkresave të mëposhtme për secilën pasuri:

- Shkresa nr. 6161/2 prot., datë 25.09.2023, për pasurinë me nr. 77/186;
- Shkresa nr. 6161/3 prot., datë 25.09.2023, për pasurinë me nr. 75/22;
- Shkresa nr. 6161/4 prot., datë 25.09.2023, për pasurinë me nr. 105/30;
- Shkresa nr. 6161/5 prot., datë 25.09.2023, për pasurinë me nr. 75/23.

Gjithashtu, i është dërguar kërkesë për bashkëpunim Bashkisë Dimal për afishimin e njoftimit të ankandit, me shkresën nr. 6245 prot., datë 02.10.2023.

Komisioni i Ankandit me shkresën nr. 6616 prot., datë 23.10.2023, ka mbajtur procesverbalin ku ka vendosur vijimin e procedurave të ankandit me vlerë të ulur me 15%, pa përcaktuar nëse ka patur ofertues për fazën e parë të ankandit. Me shkresën nr. 6616/1 prot., datë 24.10.2023, Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhrin për fillimin e procedurave të shitjes me ankand të dytë për pronat e mësipërme sipas vlerave:

1. Pasuri e llojit “Arë”, me nr. 75/22, ZK 1806, me sipërfaqe 1,000 m², me vlerë 81,600 lekë;
2. Pasuri e llojit “Arë”, me nr. 77/186, ZK 1806, me sipërfaqe 1,200 m², me vlerë 97,920 lekë;
3. Pasuri e llojit “Arë”, me nr. 105/30, ZK 1806, me sipërfaqe 1,200 m², me vlerë 326,400 lekë;
4. Pasuri e llojit “Arë”, me nr. 75/23, ZK 1806, me sipërfaqe 3,200 m², me vlerë 261,120 lekë.

Njoftimi i Ankandit me periudhë zhvillimi 30.10.2023 – 20.11.2023, i është dërguar APP sipas shkresave të mëposhtme për secilën pasuri:

- Shkresa nr. 6616/2 prot., datë 24.10.2023, për pasurinë me nr. 75/22;
- Shkresa nr. 6616/3 prot., datë 24.10.2023, për pasurinë me nr. 75/23;
- Shkresa nr. 6616/4 prot., datë 24.10.2023, për pasurinë me nr. 77/186;
- Shkresa nr. 6616/5 prot., datë 24.10.2023, për pasurinë me nr. 105/30.

I është dërguar kërkesë për bashkëpunim Bashkisë Dimal për afishimin e njoftimit të ankandit, me shkresën nr. 6977 prot., datë 06.11.2023.

Komisioni i Ankandit me shkresën nr. 7258 prot., datë 20.11.2023, ka mbajtur procesverbalin ku ka vendosur të mos vijojë me procedurat e ankandit, pasi nuk është paraqitur asnjë ofertues dhe është në kushtet e vendit vakant të Kryetarit të Komisionit.

Lidhur me mangësitë e evidentuara mbi administrimin e kolateraleve dhe pasurive të sekuestruara, referuar detyrave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Funksionimit të Agjencisë së Trajtimit të Kredive, miratuar me Vendimin nr. 83 të Këshillit Mbikëqyrës, datë 01.10.2019, e ndryshuar, ngarkohen me përgjegjësi për veprimtarinë ndër vite si dhe gjatë periudhës objekt auditimi sipas pozicioneve përkatëse:

-Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë së Trajtimit të Kredive së bashku me strukturat e saj të varësisë: Sektori Juridik dhe Operacional dhe Sektori i Menaxhimit të Riskut të Kredive, struktura që kanë për detyrë funksionale të administrojnë kolateralet dhe shitjen e tyre, si dhe analizimin e kolateraleve e propozimin e masave në vijimësi.

Lidhur me mangësitë e evidentuara në kuadër të inventarizimit të dosjeve të procedurave të ankandeve, ngarkohet me përgjegjësi struktura e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse sa i takon detyrave lidhur me Arkivën.

2.4 Saktësia dhe plotësia e dokumentimit të dosjeve të kredive, inventarizimi dhe arkivimi i tyre.

Për periudhën objekt auditimi me qëllim vlerësimin e saktësisë dhe plotësisë së dokumentimit të dosjeve të kredive, inventarizimit dhe arkivimit të tyre, njëkohësisht është audituar edhe veprimtaria e komisionit teknik si struktura që propozon mbylljen e kredive. Komisioni Teknik e ushtron veprimtarinë e tij lidhur me debitorët në zbatim të VKM nr. 681 datë 11.06.2009 "Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, për kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së

kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfiteozë të këtyre pasurive", i ndryshuar si dhe në bazë të Udhëzimit nr. 33 datë 24.09.2010 "Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, për kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfiteozë të këtyre pasurive". Ky komision funksionon si një strukturë e përhershme pranë Agjencisë, i cili ka funksion konsultativ, teknik dhe ligjor në lidhje me vendimmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm dhe për objekt të veprimtarisë së tij, Komisioni Teknik ka shqyrtimin e kërkesave të debitorëve dhe propozimin për miratim nga Drejtoria për: mbylljen e detyrimit; likuidimin me këste (ristrukturimin e kredisë), zëvendësimin e kolateralit dhe zëvendësimin e debitorit. Për periudhën 01.01.2021-31.12.2023, komisioni ka shqyrtuar dhe propozuar drejtorisë vetëm raste për miratimin e mbylljes së kredisë, duke qenë se nuk ka patur kërkesa për likudim me këste, zëvendësim debitori ose kolaterali.

Te seksioni *"Detyra jashtë strukturës organizative"* të Rregullores së funksionimit të brendshëm të Agjencisë, miratuar me vendimin Këshillit Mbikëqyrës nr. 83 datë 01.10.2019, e ndryshuar, janë të përcaktuara detyrat e Komisionit Teknik.

Nga auditimi u konstatua se pika 8 e kreut *"Sektori juridik, operacional dhe menaxhimit të riskut"* e Rregullores e cila citon se: *"Zv. Drejtori i Përgjithshëm i juridik, operacional dhe menaxhimit të riskut"* është anëtar i përhershëm i Komisionit Teknik dhe Komisionit të Ankandëve" bie në kundërshtim me pikën 4 të kreut *"Detyra jashtë strukturës organizative, Komisioni Teknik"*, ku citohet se: *"Anëtarë të Komisionit Teknik janë: përgjegjësi i sektorit juridik dhe operacional, përgjegjësi i sektorit të financës, përgjegjësi i sektorit të menaxhimit të riskut, specialist jurist operacional"*.

Urdhrat e brendshëm për ngritjen e komisionit teknik për periudhën 2021-2023 rezultojnë si në vijim:

Viti 2021:

Urdhri nr.11 prot., datë 05.01.2021

Urdhri nr.11/1 prot., datë 08.06.2021

Urdhri nr.11/2 prot., datë 17.08.2021

Urdhri nr.11/3 prot., datë 02.09.2021

Urdhri nr.11/4 prot., datë 03.11.2021

Viti 2022:

Urdhri nr. 6491 prot., datë 31.12.2022

Urdhri nr. 1329 prot., datë 06.04.2022

Urdhri nr. 1576 prot., datë 22.04.2022

Urdhri nr. 3670 prot., datë 29.09.2022

Urdhri nr. 3846 prot., datë 07.10.2022

Urdhri nr. 4782/3 prot., datë 15.12.2022

Viti 2023:

Urdhri nr. 5 prot., datë 04.01.2023

Këto urdhra janë ngritur sipas përcaktimit të pikës nr. 4 të Rregullores së funksionimit të brendshëm të Agjencisë, pra pa përfshirjen në komisionin teknik të zv. Drejtorit të Përgjithshëm.

Për periudhën objekt auditimi janë përzgjedhur me zgjedhje 9 dosje-kredi të mbyllura (të likuiduara), duke marr në konsideratë: *përzgjedhjen e dosjeve nga secili vit, nga secila monedhë dhe rastet e kredive të mbyllura me vlerat më të larta, nisur nga momenti i arkëtimit sipas të dhënave që rezultojnë në sistemin e kreditit.*

Konkretisht testimi konsiston në evidentimin e rasteve ku në sistem, principali në fund të vitit paraqitet me vlerë 0, kombinuar me kushtin që pagesa e principalit gjatë vitit të jetë e barabartë me principalin në fillim të vitit, pra të kemi shlyerje të plotë të detyrimit. Pra, nga grupi i

auditimit këto janë konsideruar si dosje të mbyllura nga ana financiare, sipas pasqyrës që ofron sistemi, pavarësisht se faza e fundit për t'u cilësuar juridikisht e mbyllur cilësohet kërkesa e debitorit për vërtetimin e mbylljes së kredisë.

Testimi është realizuar si në vijim:

Viti	Monedha	Kredi të mbyllura		Dosje të përzgjedhura		Kampioni
		Në numër	Në vlerë	Në numër	Në vlerë	
2021	ALL	131	50,078,603	3	19,720,413	39%
	EUR	2	2000	0*	0	0%
	USD	4	1,758	0*	0	0%
2022	ALL	130	35,103,619	1**	1,915,000	5%
	EUR	7	64,917	1	25,919	40%
	USD	4	29,256	1***	11,932	41%
2023	ALL	269	39,655,091	1**	1,750,000	4%
	EUR	4	39,758	1	14,457	36%
	USD	9	97,726	1	22,314	23%

Burimi: Të dhënat nga Sistemi i Kreditit të AMGKP. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

* nuk janë përzgjedhur për shkak të vlerës së ulët të pagesës (1000 euro/1000 usd)

** është përzgjedhur vlera më e lartë e pagesës

*** dosja e përzgjedhur rezulton me pagesë gjatë vitit 2022 në sistem, por sipas dokumentacionit të dosjes procedura e mbylljes është kryer në vitin 2023.

Viti 2021

1) Dosja nr. NA

Kodi kredisë - 90287

Kodi i Klientit - HH001

Debitori - z. H.B "H....." SHPK

ID: G.....Q

Vlera fillestare e transferuar e kredisë më datë 31.08.2001, nga BK, rezulton me principal 6,000,000 lekë dhe interes 8,661,934 lekë.

Në datën 17.11.2021 me shkresën nr. 5988 prot., nga ana e debitorit është bërë kërkesa për pajisje me vërtetim për mospasje detyrimi ndaj Agjencisë dhe për lirimin e pronës.

Sipas shkresës nr. 5988/1 prot., datë 22.11.2021 trajtuar nga Komisioni Teknik, evidentohet se sipas procesverbalit të transferimit datë 31.08.2001 nga ish-Banka Kursimeve Tiranë, është transferuar në Agjenci:

Principali: 6,000,000 lekë

Interesa: 8,661,934 lekë

Bazuar në VKM nr. 450 datë 16.06.2010, neni 1(a) pika 1.1 dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 33 datë 24.09.2010, kreu 1, debitorit i falen 100% interesat në rast të shlyerjes së menjëhershme të detyrimit, meqenëse ka paguar në total shumën 6,585,791 lekë. Komisioni teknik: *znj. O.S, z. E.S, znj. V.S, z. E.Ll, znj. A.Z.*

Bashkëlidhur vendimit të Komisionit teknik është dhe vërtetimi i Sektorit të Financës në lidhje me gjendjen e detyrimit për debitorin H.B ku rezulton se në zbatim të VKM-së nr. 450 detyrimi i mbetur në lidhje me principalin dhe shpenzimet gjyqësore është 0 (zero) lekë.

Me shkresën nr. 5988/2 prot., datë 22.11.2021 është miratuar propozimi i komisionit teknik, trajtuar në shkresën nr. 5988/1 prot., datë 22.11.2021, firmosur nga zv. Drejtori i Përgjithshëm z. M.M dhe zv. Drejtori i Përgjithshëm znj. G.G, e cila ka firmosur dhe në mungesë të Drejtorit të Përgjithshëm z. E.K.

Me shkresën nr. 5988/3 prot., datë 22.11.2021 është lëshuar vërtetimi se z. H.V.B, administrator i "H..." SHPK nuk rezulton më debitor ndaj Agjencisë.

Me shkresën nr. 5988/5 prot., datë 22.11.2021 nga Agjencia është kërkuar lirimi i barrës hipotekore të hipotekuesit, në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Zyra Vendore Tiranë.

Nga auditimi rezulton se fleta e inventarit nuk është hartuar sipas përcaktimeve të nenit 30 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, pasi nuk disponon të listuara dhe numerizuara dokumentacionin e plotë të dosjes, konkretisht:

-mungon procesverbali i transferimit dhe mandatë pagesat fizikisht.

-inventari i dosjes nuk ka të paraqitur emrin e punonjësit të arkivës dhe dokumentacioni pjesë e kartelës shoqëruese përmban dokumentacione, të datuara deri më vitin 2015.

-praktika dhe shkresat e vitit 2021 për mbylljen e kredisë nuk janë pjesë e inventarit të brendshëm të dosjes.

Inventari i dosjes – mungon emri i personit nga e cila është punuar/dokumentuar

2) Dosja nr. 725

Kodi kredisë:

Kredia I -87246

Kredia II - 87245

Kodi i Klientit

Kredia I -AK012

Kredia II - AK013

Debitori - z. A.D.K

ID: G.....R.

Sipas sistemit të kreditit, vlera fillestare e kredisë me kodin 87246 e transferuar më datë 31.08.2001 nga BK, rezulton me principal 5,136,000 lekë dhe me interes 5,000,987 lekë; kurse vlera fillestare e kredisë me kodin 87245 e transferuar më 31.08.2001 nga BK rezulton me principal 2,800,000 lekë dhe interes 3,811,733 lekë.

Në datën 21.12.2021 me nr. 6428 prot., nga ana e debitorit është bërë kërkesa për pajisje me vërtetim për mospasje detyrimi ndaj Agjencisë dhe për lirim të pronës.

Sipas shkresës nr. 6428/1 prot., datë 28.12.2021 trajtuar nga Komisioni Teknik, evidentohet se sipas procesverbalit të transferimit datë 31.08.2001 nga ish-Banka Kursimeve Krujë, është transferuar në Agjenci detyrimi si më poshtë:

Emërtimi	Kredia I	Kredia II	Totali
Principal	5,173,000	2,800,000	7,973,000
Interes	5,000,897	3,811,733	8,812,630
Shuma	10,173,897	6,611,733	16,785,630

Po sipas kësaj shkrese përcaktohet se:

Ndaj debitorit janë bërë veprimet e mëposhtme:

-shpenzime gjyqësore në shumën 4,900 lekë;

-urdhër ekzekutimi nr. 23, datë 15.04.2003;

-arkëtime në Agjenci 7,977,900 lekë.

Nga llogaritjet e bëra nga grupi i auditimit rezulton se nga debitori, prej pagesave të kryera janë mbuluar principalin dhe shpenzimet gjyqësore.

Bazuar në VKM nr. 450 datë 16.06.2010, neni 1(a) pika 1.1 dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 33 datë 24.09.2010, kreu 1, debitorit i falen 100% interesat në rast të shlyerjes së menjëhershme të detyrimit, meqenëse ka paguar në total shumën 7,977,900 lekë. Komisioni teknik: znj. O.S, z. E.S, znj. V.S, z. E.Ll, znj. A.Z.

Bashkëlidhur vendimit të Komisionit teknik është dhe vërtetim i Sektorit të Financës në lidhje me gjendjen e detyrimit për debitorin A.K ku rezulton se në zbatim të VKM-së nr. 450 detyrimi i mbetur në lidhje me principalin dhe shpenzimet gjyqësore është 0 (zero) lekë.

Me shkresën nr. 6428/2 prot., datë 28.12.2021 është miratuar propozimi i komisionit teknik, trajtuar në shkresën nr. 6428/1 prot., datë 28.12.2021, firmosur nga zv. Drejtori i Përgjithshëm z. M.M dhe zv. Drejtori i Përgjithshëm znj. G.G dhe Drejtori i Përgjithshëm z. E.K.

Me shkresën nr. 6428/3 prot., datë 28.12.2021 është lëshuar vërtetimi se z. A.D.K, nuk rezulton më debitor ndaj Agjencisë.

Me shkresën nr. 6428/5 prot., datë 28.12.2021 nga Agjencia është kërkuar lirim i barrës hipotekore të hipotekuesit, në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Zyra Vendore Krujë.

Nga auditimi rezulton se fleta e inventarit nuk është hartuar sipas përcaktimeve të nenit 30 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, pasi nuk disponon të listuara dhe numerizuara dokumentacionin e plotë të dosjes, konkretisht:

-mungon procesverbali i transferimit dhe mandatë pagesat fizikisht.

-dokumentacioni i listuar në kartelën shoqëruese të dosjes ka dokumentacione që datojnë deri në vitin 2009.

-praktika dhe shkresat e vitit 2021 për mbylljen e kredisë nuk janë pjesë e inventarit të brendshëm të dosjes.

Inventari i dosjes: Punuar nga znj. V.N.

3) Dosja nr. 502

Kodi kredisë - 45124

Kodi i klientit: BI022

Debitori - z. B.S

ID: F.....E

Vlera fillestare e transferuar e kredisë më datë 31.08.2001, nga BK, rezulton me principal 8,807,413 lekë dhe me interes 9,842,668 lekë.

Në datën 27.01.2021 me shkresën nr. 697 prot., nga ana e debitorit është bërë kërkesa për pajisje me vërtetim për mospasje detyrimi ndaj Agjencisë dhe për lirim e barrës hipotekore.

Sipas shkresës nr. 697/1 prot., datë 03.02.2021 trajtuar nga Komisioni Teknik, evidentohet se sipas procesverbalit të transferimit datë 30.08.2001 nga ish-Banka Kursimeve Kukës, është transferuar në Agjenci detyrimi si më poshtë:

Principal: 8,807,413 lekë

Interesa: 9,842,668 lekë

Po sipas kësaj shkrese përcaktohet se:

Ndaj debitorit janë bërë veprimet e mëposhtme:

-shpenzime gjyqësore në shumën 65,700 lekë;

-urdhër Ekzekutimi nr. 6608, datë 05.12.2011

-arkëtime në Agjenci 8,873,113 lekë.

Nga llogaritjet e bëra nga grupi i auditimit rezulton se nga debitori, prej pagesave të kryera janë mbuluar principali dhe shpenzimet gjyqësore.

Bazuar në VKM nr. 450 datë 16.06.2010, neni 1(a) pika 1.1 dhe në zbatim të Udhëzimi të Ministrisë së Financave nr. 33 datë 24.09.2010, kreu 1, debitorit i falen 100% interesat në rast të shlyerjes së menjëhershme të detyrimit, meqenëse ka paguar në total shumën 8,873,113 lekë. Komisioni teknik: znj. O.S, z. M.K, z. T.M, znj. A.Z, z. E.Ll dhe znj. V.S.

Bashkëlidhur vendimit të Komisionit teknik është dhe vërtetim i i Sektorit të Financës në lidhje me gjendjen e detyrimit për debitorin B.S ku rezulton se në zbatim të VKM-së nr. 450 detyrimi i mbetur në lidhje me principalin dhe shpenzimet gjyqësore është 0 (zero) lekë.

Me shkresën nr. 697/2 prot., datë 03.02.2021 është miratuar propozimi i komisionit teknik, trajtuar në shkresën nr. 697/1 prot., datë 03.02.2021, firmosur nga zv. Drejtori i Përgjithshëm znj. G.G, zv Drejtori i Përgjithshëm z. B.H dhe Drejtori i Përgjithshëm z. E.K.

Me shkresën nr. 697/3 prot., datë 03.02.2021 është lëshuar vërtetimi se z. B. I. S, nuk rezulton më debitor ndaj Agjencisë.

Me shkresën nr. 992/1 prot., datë 03.02.2021 nga Agjencia është kërkuar lirim i barrës hipotekore të hipotekuesit, në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Zyra Vendore Kukës.

Nga auditimi rezulton se fleta e inventarit nuk është hartuar sipas përcaktimeve të nenit 30 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, pasi nuk disponon të listuara dhe numerizuara dokumentacionin e plotë të dosjes, konkretisht:

-mungon procesverbali i transferimit dhe mandatë pagesat fizikisht.

-dokumentacioni i listuar në kartelën shoqëruese të dosjes ka dokumentacione që i përkasin periudhës deri në vitin 2012.

-praktika dhe shkresat e vitit 2021 për mbylljen e kredisë nuk janë pjesë e inventarit të brendshëm të dosjes.

Inventari i dosjes: Punuar nga znj. K.V.

Viti 2022

1) Dosja nr. 23/120

Kodi kredisë - mungon kodi në dosje

Debitori - z. F.S.Th - BKT Fier

Sipas sistemit të kreditit:

Vlera fillestare e transferuar e kredisë rezulton me principal 1,915,000 lekë.

Kodi i kredisë: 78334

Kodi klientit: 005

Në datën 06.06.2022 me nr. 2263 prot., nga ana e debitorit është bërë kërkesa për pajisje me vërtetim për mospasje detyrimi ndaj Agjencisë dhe lirim i barrës hipotekore.

Sipas shkresës nr. 2263/1 prot., datë 08.06.2022 trajtuar nga Komisioni Teknik, evidentohet se sipas procesverbalit të transferimit datë 31.08.2001 nga ish-dega e Banka e Kursimeve Fier, është transferuar në Agjenci:

Principali: 1,915,000 lekë

Interesa: 4,941,861 lekë

Bazuar në VKM nr. 450 datë 16.06.2010, neni 1(a) pika 1.1 dhe në zbatim të Udhëzimi të Ministrisë së Financave nr. 33 datë 24.09.2010, kreu 1, debitorit i falen 100% interesat në rast të shlyerjes së menjëhershme të detyrimit, meqenëse ka paguar në total shumën 1,915,000 all dhe 24,320 lekë shpenzime gjyqësore.

Komisioni teknik: *znj. O.S, z. E.S, znj. V.S, znj. A.Z, znj. H.I.* Nuk është firmosur nga O.S, me shënimin me leje të zakonshme. Bashkëlidhur dosjes ndodhet vërtetimi nga ana e financës që detyrimi i mbetur rezulton 0 lekë.

Me shkresën nr. 2263/2 prot., datë 08.06.2022 është miratuar propozimi i komisionit teknik, trajtuar në shkresën nr. 2263/1 prot., datë 08.06.2022, firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm z. E.K dhe nga zv. Drejtorët e Përgjithshëm, znj. G.G dhe z. M.M.

Me shkresën nr. 2263/3 prot., datë 08.06.2022 është lëshuar vërtetimi se z. F.S.Th nuk rezulton më debitor ndaj Agjencisë.

Me shkresën nr. 2263/4 prot., datë 08.06.2022 është autorizuar znj. A.Z për të përfaqësuar Agjencinë pranë zyrës së noterisë për çlirimin e barrës hipotekore për pasurinë e paluajtshme në pronësi të Gj.S.Th, i cili ka lënë kolateral apartamentin e tij, në cilësinë e dorëzanësit, për llogari të huamarrësit.

Me shkresën nr. 2263/5 prot., datë 08.06.2022, Agjencia i është drejtuar ASHK Tiranë.

Nga auditimi rezulton se fleta e inventarit nuk është hartuar sipas përcaktimeve të nenit 30 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, pasi nuk disponon të listuara dhe numerizuara dokumentacionin e plotë të dosjes, konkretisht:

-mungon procesverbali i transferimit dhe mandatë pagesat fizikisht.

-shkresa e vitit më të fundit sipas listës së inventarit të brendshëm të dosjes rezulton shkresa nr. 2768/1 prot., datë 13.12.2013, ndërkohë në dosje rezultojnë shkresa në periudhën në vijim si psh: vendimi për transferimin e çështjes përmbare nr. 3641 prot., datë 20.12.2019, kontrata e shërbimit me zyrën e përmbaremit datë 02.06.2021, vendimi për pushimin e ekzekutimit nr. 447/29 prot., datë 10.06.2022.

-praktika dhe shkresat e vitit 2022 për mbylljen e kredisë nuk janë pjesë e inventarit të brendshëm të dosjes.

Inventari i dosjes: Punuar nga znj. V.N.

2) Dosja nr. N/A Shkodër

Debitori – B.T.L

ID – F.....C

Sipas sistemit të kreditit:

Vlera fillestare e transferuar e kredisë më datë 30.06.2000, nga BKT, rezulton me principal 59,879.85 dhe interes 9,044.96 DEM.

Kodi i kredisë - 12222

Kodi i Klientit - BL05

Vlera fillestare e transferuar e kredisë, sipas sistemit të kreditit në menunë “Hapje kredie” rezulton me principal 59,879.85 DEM, interes 9,044.96 DEM (monedha përcaktuar nga verifikimi i akt marrëveshjes së kredisë), të cilat të konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë, në momentin e hyrjes së monedhës Euro (1 Euro=1.95583 DEM), janë sa shuma e paraqitur në menunë “Kartelë kredie”, pra 30,616.08 euro dhe interes 4,625 euro. Sistemi krediti nuk paraqet në asnjë seksion të tijin monedhën e marrjes së kredisë.

Bazuar në VKM nr. 681, datë 11.06.2009, të ndryshuar me VKM nr. 450 datë 16.06.2010, neni 1(a) pika 1.1 dhe në zbatim të Udhëzimi të Ministrisë së Financave nr. 33 datë 24.09.2010, kreu 1, debitorit i falen 100% interesat në rast të shlyerjes së menjëhershme të detyrimit, meqenëse debitori ka paguar në total shumën 30,616.08 euro dhe 26,420 lekë.

Vendimi i komisionit Teknik është firmosur nga të gjithë anëtarët.

Me shkresën nr. 1612/2 prot., datë 09.05.2022 është miratuar propozimi i komisionit teknik, trajtuar në shkresën nr. 1612/1 prot., datë 09.05.2022, firmosur nga zv. Drejtori i Përgjithshëm z. M.M, zv Drejtori i Përgjithshëm z. G.G dhe Drejtori i Përgjithshëm z. E.K. Me shkresën nr. 1612/3 prot., datë 09.05.2022 është lëshuar vërtetimi se z. B.T.L nuk është më debitor ndaj Agjencisë.

Komisioni teknik: *znj. O.S, z. E.S, znj. V.S, znj. A.Z dhe znj. H.I.*

Bashkëlidhur vendimit të Komisionit teknik është dhe vërtetimi i Sektorit të Financës në lidhje me gjendjen e detyrimit për debitorin B.L, ku rezulton se në zbatim të VKM-së nr. 450 detyrimi i mbetur në lidhje me principalin dhe shpenzimet gjyqësore më datë 26.04.2022 është 0 (zero) lekë.

Me shkresën nr. 1612/5 prot., datë 09.05.2022 nga Agjencia është kërkuar lirimi i barrës hipotekore të hipotekuesit, në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Zyra Vendore Fier.

Nga auditimi rezulton se fleta e inventarit nuk është hartuar sipas përcaktimeve të nenit 30 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, pasi nuk disponon të listuara dhe numerizuara dokumentacionin e plotë të dosjes, konkretisht:

-mungon procesverbali i transferimit dhe mandatë pagesat fizikisht.

-praktika dhe shkresat e vitit 2022 për mbylljen e kredisë nuk janë pjesë e listës së inventarit të brendshëm të dosjes.

Inventari i dosjes: Punuar nga znj. K.V.

Viti 2023

1) Dosja nr. 89

Kodi kredisë -11947

Debitori - z. L.G.Gj / mungon kodi klientit

Sipas sistemit të kreditit:

Vlera fillestare e transferuar e kredisë, sipas sistemit të kreditit në menunë “Hapje kredie” rezulton me principal 28,276 DEM (monedha përcaktuar nga verifikimi i akt marrëveshjes së kredisë), të cilat të konvertuara me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë, në momentin e hyrjes së monedhës Euro (1 Euro=1.95583 DEM), janë sa shuma e paraqitur në menunë “Kartelë kredie”, pra 14,457.29 euro. Sistemi krediti nuk paraqet në asnjë seksion të tijin monedhën e marrjes së kredisë.

Kodi i klientit: LG13

Në datën 11.09.2023 me nr. 6040 prot., nga ana e debitorit është bërë kërkesa për pajisje me vërtetim për mospasje detyrimi ndaj Agjencisë dhe lirim i barrës hipotekore.

Sipas shkresës nr. 6041/1 prot., datë 13.09.2023 trajtuar nga Komisioni Teknik, evidentohet se sipas procesverbalit të transferimit datë 30.06.2000 nga ish-Banka Kombëtare Tregtare Shkodër, është transferuar në Agjenci:

Principali: 14,457.29 Euro

Interesa: 4,001.99 Euro

Bazuar në VKM nr. 450 datë 16.06.2010, neni 1(a) pika 1.1 dhe në zbatim të Udhëzimi të Ministrisë së Financave nr. 33 datë 24.09.2010, kreu 1, debitorit i falen 100% interesat në rast të shlyerjes së menjëhershme të detyrimit, meqenëse ka paguar në total shumën 14,457.29 Euro dhe 54,602 lekë shpenzime gjyqësore.

Komisioni teknik: *znj. E.Z, z. E.S, znj. V.S, znj. A.Z, znj. K.T.* Nuk është firmosur nga *znj. A.Z* dhe *znj. K.T*, me shënimin me leje. Bashkëlidhur dosjes ndodhet vërtetimi nga ana e financës që detyrimi i mbetur rezulton 0 lekë.

Me shkresën nr. 6040/2 prot., datë 13.09.2023 është miratuar propozimi i komisionit teknik, trajtuar në shkresën nr. 6041/1 prot., datë 13.09.2023, firmosur nga zv. Drejtori i Përgjithshëm z. O.M, zv. Drejtori i Përgjithshëm z. M.M dhe Drejtori i Përgjithshëm z. E.K.

Me shkresën nr. 6040/3 prot., datë 13.09.2023 është lëshuar vërtetimi se z. L.G.Gj nuk rezulton më debitor ndaj Agjencisë. Me shkresën nr. 6040/5 prot., datë 13.09.2023 nga Agjencia është kërkuar lirimi i barrës hipotekore të hipotekuesit, në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Zyra Vendore Shkodër.

Nga auditimi rezulton se fleta e inventarit nuk është hartuar sipas përcaktimeve të nenit 30 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, pasi nuk disponon të listuara dhe numerizuara dokumentacionin e plotë të dosjes, konkretisht:

-mungon procesverbali i transferimit dhe mandatë pagesat fizikisht.

-shkresa e vitit më të fundit sipas listës së inventarit të brendshëm të dosjes rezulton shkresa e vitit 2014, konkretisht shkresa nr. 3600 datë 19.04.2014 dhe shkresa nr. 2101 datë 19.09.2014 kërkesë ZVRPP-së. Nga auditimi i dosjes rezultojnë dokumente të panumerizuara në vitet në vijim si: vendim pushimi nr. 35 regj. datë 29.10.2019.

-praktika dhe shkresat e vitit 2023 për mbylljen e kredisë nuk janë pjesë e listës së inventarit të brendshëm të dosjes.

Inventari i dosjes: Punuar nga *znj. K.V.*

2) Dosja nr. 24

Kodi kredisë - mungon

Debitori - *znj. V.V.F / Insig Tiranë.* Ky debitor ka zëvendësuar debitorin M.Z, sipas vendimit nr. 63 datë 29.04.2011

Kodi klientit - mungon

Sipas sistemit të kreditit:

Vlera fillestare e kredisë e transferuar rezulton me principal 37,367 Usd.

Kodi kredisë - 08020

Kodi klientit – MZ026

Në datën 20.12.2022 me nr. 4930 prot., nga ana e debitorit është bërë kërkesa për pajisje me vërtetim për mospasje detyrimi ndaj Agjencisë.

Sipas shkresës nr. 4930/1 prot., datë 07.02.2023 trajtuar nga Komisioni Teknik, evidentohet se sipas procesverbalit të transferimit datë 31.12.2003 nga ish-dega e INSIG Tiranë, është transferuar në Agjenci:

Principali: 37,367 Usd

Interesa: 0 Usd

Bazuar në VKM nr. 450 datë 16.06.2010, neni 1(a) pika 1.1 dhe në zbatim të Udhëzimi të Ministrisë së Financave nr. 33 datë 24.09.2010, kreu 1, debitorit i falen 100% interesat në rast të shlyerjes së menjëhershme të detyrimit, meqenëse ka paguar në total shumën 37,367 Usd dhe 102,400 lekë shpenzime gjyqësore.

Komisioni teknik: *znj. E.Z, z. E.S, znj. V.S, znj. A.Z, znj. K.T.* Nuk është firmosur nga z. E.S, me shënimin me leje. Bashkëlidhur dosjes ndodhet vërtetimi nga ana e financës që detyrimi i mbetur rezulton 0 lekë.

Me shkresën nr. 4930/2 prot., datë 07.02.2023 është miratuar propozimi i komisionit teknik, trajtuar në shkresën nr. 4930/1 prot., datë 07.02.2023, firmosur zv. Drejtori i Përgjithshëm z.

M.M dhe Drejtori i Përgjithshëm z. E.K. Nuk është firmosur nga zv. Drejtori i Përgjithshëm z. O.M, me shënimin me raport mjekësor.

Me shkresën nr. 4930/3 prot., datë 07.02.2023 është lëshuar vërtetimi se znj. V.V.F nuk rezulton më debitor ndaj Agjencisë.

Me shkresën nr. 4930/4 prot., datë 07.02.2023 nga Agjencia është autorizuar z. E.C, specialist pranë Agjencisë, për të përfaqësuar institucionin pranë zyrës së noterisë për nënshkrimin e kontratës së shitjes:

Lloji i pasurisë: apartament

Numri i pasurisë: 9/17+2-5

Kodi Unik 8330064221

Zona Kadastrale 8330

Sip e pasurisë 111.1 m²

Adresa: Rr. Don Bosko, Nd: B1. Nr. Ap 5, Tiranë.

Nga auditimi rezulton se fleta e inventarit nuk është hartuar sipas përcaktimeve të nenit 30 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, pasi nuk disponon të listuara dhe numerizuara dokumentacionin e plotë të dosjes, konkretisht:

-mungon procesverbali i transferimit

-shkresa e vitit më të fundit sipas listës së inventarit të brendshëm të dosjes rezulton shkresa nr. 282, datë 20.01.2015 urdhër për mandatë pagesash. Nga auditimi i dosjes rezultojnë dokumente të panumerizuara në vitet në vijim si psh: autorizimi nr. 4989 prot., datë 27.12.2022, praktika e aplikimit në ASHK, kartela e pasurisë, kontratë shitja e pasurisë së paluajtshme nr. rep. 1688, nr. kolek. 927, datë 10.02.2023.

-praktika dhe shkresat e vitit 2023 për mbylljen e kredisë nuk janë pjesë e listës së inventarit të brendshëm të dosjes.

Inventari i dosjes: Punuar nga znj. V.N.

3) Dosja nr. - mungon nr

Kodi kredisë - mungon kodi në dosje

Debitori - z. P.I.P / BTA Vlorë

Sipas sistemit të kreditit:

Vlera fillestare e transferuar e kredisë rezulton me principal 1,750,000 lekë.

Kodi i kredisë – 00154

Kodi klientit – PP33

Në datën 31.12.2023 me nr. 7503 prot., nga ana e debitorit është bërë kërkesa për pajisje me vërtetim për mospasje detyrimi ndaj Agjencisë dhe lirim i barrës hipotekore.

Sipas shkresës nr. 7503/1 prot., datë 14.12.2023 trajtuar nga Komisioni Teknik, evidentohet se sipas procesverbalit të transferimit datë 31.03.1998 nga ish-dega e Bankës Tregtare Agrare Vlorë, është transferuar në Agjenci.

Principali: 1,750,000 lekë.

Interesa: 1,211,540 lekë.

Bazuar në VKM nr. 450 datë 16.06.2010, neni 1(a) pika 1.1 dhe në zbatim të Udhëzimi të Ministrisë së Financave nr. 33 datë 24.09.2010, kreu 1, debitorit i falen 100% interesat në rast të shlyerjes së menjëhershme të detyrimit, meqenëse ka paguar në total shumën 1,750,000 all dhe 65,278 lekë shpenzime gjyqësore.

Komisioni teknik: znj. E.Z, z. E.S, znj. V.S, znj. A.Z, znj. K.T. Bashkëlidhur dosjes ndodhet vërtetimi nga ana e financës që detyrimi i mbetur rezulton 0 lekë.

Me shkresën nr. 7503/2 prot., datë 14.12.2023 është miratuar propozimi i komisionit teknik, trajtuar në shkresën nr. 7503/1 prot., datë 14.12.2023, firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm z. E.K. Nuk është firmosur nga 2 zv. Drejtorët e Përgjithshëm, pasi rezultojnë pozicione vakante.

Me shkresën nr. 7303/3 prot., datë 07.02.2023 është lëshuar vërtetimi se z. P.I.P nuk rezulton më debitor ndaj Agjencisë.

Nga auditimi rezulton se fleta e inventarit nuk është hartuar sipas përcaktimeve të nenit 30 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, pasi nuk disponon të listuara dhe numerizuara dokumentacionin e plotë të dosjes, konkretisht:

-mungon procesverbali i transferimit dhe mandatë pagesat fizikisht.

-shkresa e vitit më të fundit sipas listës së inventarit të brendshëm të dosjes rezulton shkresa nr. 4711 datë 06.07.2016, ndërkohë në dosje gjendet e panumerizuar memo e vitit 2020 nga përgjegjësi i sektorit juridik dhe operacional, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, për lëshim dublikat Urdhër Ekzekutim dhe vënia në ekzekutim pranë një zyre përmbarimore private.

-praktika dhe shkresat e vitit 2023 për mbylljen e kredisë nuk janë pjesë e listës së inventarit të brendshëm të dosjes.

Inventari i dosjes: Punuar nga znj. K.V.

4) Dosja nr. 255 - Mat

Kodi kredisë - 24164

Kodi i Klientit - SB106

Debitori - z. S.B

ID: F.....J

Sipas sistemit të kredisë (tek menuja krediti) rezulton se shuma e transferuar pranë Agjencisë më datë 31.08.2011 rezulton të jetë: 22,314.28 usd dhe interesi 33,428.54 usd, vlerë e cila përputhet me kartelën e kredisë së sistemit.

Në datën 21.09.2023 me nr. 6160 prot., nga ana e debitorit është bërë kërkesa për pajisje me vërtetim për mospasje detyrimi ndaj Agjencisë.

Sipas shkresës nr. 6161/1 prot., datë 26.09.2023 trajtuar nga Komisioni Teknik, evidentohet se sipas procesverbalit të transferimit datë 31.08.2001 nga ish-Banka Kursimeve Mat, është transferuar në Agjenci:

Principali: 22,314.28 Usd

Interesa: 33,428.54 Usd

Bazuar në VKM nr. 450 datë 16.06.2010, neni 1(a) pika 1.1 dhe në zbatim të Udhëzimi të Ministrisë së Financave nr. 33 datë 24.09.2010, kreu 1, debitorit i falen 100% interesat në rast të shlyerjes së menjëhershme të detyrimit, meqenëse ka paguar në total shumën 22,315.31 Usd dhe 100 lekë.

Komisioni teknik: *znj. E.Z, z. E.S, znj. V.S, znj. K.T.* Nuk është firmosur nga znj. A.Z, me shënimin “me shërbim”.

Bashkëlidhur vendimit të Komisionit teknik është dhe vërtetim i i Sektorit të Financës në lidhje me gjendjen e detyrimit për debitorin S.B ku rezulton se në zbatim të VKM-së nr. 450 detyrimi i mbetur në lidhje me principalin dhe shpenzimet gjyqësore është 0 (zero) lekë.

Me shkresën nr. 6060/2 prot., datë 26.09.2023 është miratuar propozimi i komisionit teknik, trajtuar në shkresën nr. 6160/1 prot., datë 26.09.2023, firmosur nga zv. Drejtori i Përgjithshëm z. O.M, zv. Drejtori i Përgjithshëm z. M.M dhe Drejtori i Përgjithshëm z. E.K.

Me shkresën nr. 6160/3 prot., datë 26.09.2023 është lëshuar vërtetimi se z. S.I.B nuk rezulton më debitor ndaj Agjencisë. Me shkresën nr. 6160/5 prot., datë 09.10.2023 nga Agjencia është kërkuar lirimi i barrës hipotekore të hipotekuesit, në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Zyra Vendore Burrel.

Nga auditimi rezulton se fleta e inventarit nuk është hartuar sipas përcaktimeve të nenit 30 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, pasi nuk disponon të listuara dhe numerizuara dokumentacionin e plotë të dosjes, konkretisht:

-mungon procesverbali i transferimit dhe mandat pagesat fizikisht.

-praktika dhe shkresat e vitit 2023 për mbylljen e kredisë nuk janë pjesë e inventarit të brendshëm të dosjes.

Inventari i dosjes: Punuar nga znj. K.V.

Në lidhje me dosjet e mësipërme, nga grupi i auditimit, u verifikua saktësia e paraqitjes së pagesave të kryera, në sistemin e kreditit, konkretisht në menunë “Kartelë krediti”, ku u konstatua se pagesat e kryera nga debitorët janë të reflektuara sipas datave dhe shumave përkatëse. Këto të dhëna të paraqitura në sistem u verifikuan edhe me dokumentacionin fizik të pagesave, të cilat u vendosën në dispozicion nga sektori i financës duke qenë se nuk ishin pjesë e dosjeve të arkivuara.

Nga auditimi u konstatua gjithashtu se:

-Në kundërshtim me nenin 32 të “Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, i cili citon se: *“Pranë çdo subjekti shtetëror apo joshetëror, me urdhër të titullarit, krijohet komisioni i ekspertizës. Në të bëjnë pjesë specialistët më me përvojë të sektorëve kryesorë, si dhe punonjësi i arkivit apo sekretari-arkivit. Komisioni i ekspertizës përbëhet nga jo më pak se pesë specialistë. Ai kryesohet nga vetë titullari ose zëvendësi i tij. Në punën e tij komisioni udhëhiqet nga kriteret themelore të ekspertizës së vlerës së ruajtjes të përcaktuara në udhëzimet metodike përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”*, ky komision nuk është ngritur.

-Në kundërshtim me nenin 41 i cili citon se: *“Sekretaria dhe arkivi apo sekretari-arkivi i subjektit shtetëror apo joshetëror vendosen në lokale të përshtatshme, që plotësojnë kërkesat e teknologjisë së ruajtjes së dokumenteve. Ato pajisen me mjetet mbrojtëse nga zjarri, nga rrezet e diellit, pluhuri dhe nga dëmtuesit e tjerë fizikë e biologjikë. Dyert e dritaret e tyre sigurohen me rrjetë metalike e brava automatike. Në sekretari dhe arkiv apo sekretari-arkiv dokumentet vendosen në dosje e kuti kartoni dhe këto të fundit në raftet metalike të lyera me bojë kundër ndryshkjes. Raftet vendosen në drejtim vertikal me dritaret. Raftet vendosen 40-60 cm larg murit dhe 80 cm larg nga njëri-tjetri. Rrugicat e qarkullimit kryesor të jenë 100-120 cm. Çdo element i raftit të jetë me 7-8 nivele, secili me lartësi 30 cm, thellësi 80 cm (për t’u shfrytëzuar nga të dy anët) dhe me gjatësi 100 cm. Niveli i parë dhe i fundit i rafteve të jenë nga 20 cm mbi dysheme dhe nën tavan. Llambat e ndriçimit vendosen midis rafteve”*, këto kushte teknike dhe fizike të ruajtjes së dokumenteve nuk janë siguruar.

-Në kundërshtim me nenin 43 që citon se: *“Sekretaria dhe arkivi apo sekretari-arkivi jo më rrallë se një herë në 6 muaj bëjnë kontroll fizik të dokumenteve, i cili pasqyrohet në procesverbal”*, ky kontroll nuk është realizuar.

Këto problematika rezultojnë pjesë edhe të konstatimeve të bëra nga auditimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

Përpos dosjeve të shqyrtuara më sipër, nga auditimi u konstatuan mangësi edhe në dosjet e procedurave të ankandeve, ku specifikisht rezultoi:

-Dosjet e procedurave të ankandeve nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara si një praktikë e plotë me qëllim ruajtjen e gjurmës audituese për të gjithë procesin e ndjekur;

-Në dosje ka mangësi të dokumentacioneve si: Urdhri i ngritjes së Komisionit të Ankandeve, propozimi për kthimin e pronës tek debitori, procesverbali për hartimin e dokumenteve të ankandit.

Trajtuar më hollësisht në drejtimin “Administrimi i kolateraleve të kaluara në pronësi të AMGKP-së, si dhe zbatimi i procedurave të shitjes së tyre”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi struktura e arkivës ndër vite, duke përfshirë gjithashtu periudhën objekt auditimi (Sektori i shërbimeve mbështetëse), dhe Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë në lidhje me mungesën e monitorimit kundrejt problematikave.

Përsa trajtuar më sipër nga përfaqësuesit e subjektit, znj. R.Xh në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm aktual të AMGKP-së, deleguar në muajin prill 2024 (konceptuar nga znj. Xh.K në cilësinë e Arkivistit në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, znj. V.S në cilësinë e specialistes së Sektorit të Financës dhe Buxhetit, znj. A.Xh në cilësinë e specialistes në Sektorin

e Ndjekjes së Procedurave të Ekzekutimit Përmbartimor, znj. E.Z në cilësinë e Përgjegjëses së Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Skemave të veçanta të Garancisë, znj. A.H në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, znj. K.T në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Financës dhe Buxhetit), është paraqitur observacion me shkresën nr. 2041/2 prot., datë 01.07.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 185/11 datë 03.07.2024.

Prendimi i subjektit: Referuar gjetjes mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentimit të dosjes së kredive, inventarizimi dhe arkivimi i tyre...sqarojmë se “Referuar nenit 30 të normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor si dhe Rregullores së funksionimit të brendshëm të institucionit, ju bëjmë me dije se institucioni vepron në mënyra të ndryshme me dosjet e debitorëve dhe dosjet me dokumentacionin e administruar në institucion. Dosjet e debitorëve të transferuara nga ish bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror dhe INSIG sha në bazë të Rregullores së brendshme mbahen në vend të sigurtë ku azhurnohen me dokumentacionin e ardhur në mënyrë periodike (fotokopje) dhe çdo konsultim apo verifikim dokumentacioni nga specialistët kryhet me autorizimin e DP. Theksojmë se kjo dosje nuk përpunohet apo azhurnohet me dokumentacion fotokopje dhe mbahet e arkivuar për funksionim të brendshëm. Dosjet e tjera me dokumentacion origjinal të administruar në institucion në bazë të nenit 30 të normave teknike profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor inventarizohen, arkivohen, vendosen afatet e ruajtjes, nr. rendor, nr. dosjes si dhe të gjitha detajet sipas standardit të kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe dorëzohen nga protokollin në arkivë për të kaluar në fazën e përpunimit tekniko-shkencor. Bashkëlidhur vendimi përfundimtar i inspektimit nr. 21259/1 datë 20.06.2022, procesverbal me nr. 126 datë 28.02.2023, procesverbal me nr. 1682/1 datë 15.02.2022.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron se:

-Dokumentacioni në dosje nuk ka rezultuar i plotë, ka mangësi në dokumente si shkresa në kthim përgjigje, shkresa përcjellëse, raporte të vlerësimit të ekspertit, certifikatë pronësie, vendime të gjykatave, etj. duke mos mundur dhënien e një pamje të plotë të veprimeve të ndërmarra nga Agjencia për vjeljen e detyrimeve përkatëse;

-Dokumentacionet pjesë e dosjeve, për 7 nga 9 dosje janë deri në vitet 2015-2016 pas kësaj periudhe në dosje nuk disponohet asnjë dokumentacion tjetër në lidhje me masat e marra nga Agjencia dhe vetëm për dy dosje dokumentacioni shkon përtej këtyre datave, në njërin prej dosjeve dokumentacioni sipas fletës së inventarit është deri në vitin 2010, por brenda në dosje ka dokumentacion deri në vitin 2016.

Nisur edhe nga observacioni juaj, citohet: “*Dosjet e debitorëve të transferuara nga ish bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror dhe I sha në bazë të Rregullores së brendshme mbahen në vend të sigurtë ku azhurnohen me dokumentacionin e ardhur në mënyrë periodike (fotokopje)*”...fakt ky i cili nuk ka rezultuar nga auditimi duke qenë se nuk patur azhurnim dokumentacioni në dosje, trajtuar më hollësisht në këtë raport përfundimtar auditimi. Gjithashtu bashkëlidhur observacionit nuk disponohet evidencë/dokumentacion shtesë.

Për sa më sipër ky observacion nuk e ndryshon gjetjen dhe rekomandimin e grupit të auditimit.

2.5 Zbatimi i procedurave në planifikimin dhe realizimin e treguesve ekonomikë/buxheti.

Përputhshmëria me dispozitat ligjore e nënligjore në kryerjen e shpenzimeve. Rakordimi dhe derdhja e të ardhurave nga arkëtimet e kredive.

Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera për vitet 2021-2023, referuar buxhetit të miratuar me Vendim Këshilli Mbikëqyrës ka pasur si objektiv kryesor të saj realizimin e arkëtimeve në masën 90 milionë lekë.

Për hartimin e planit të arkëtimeve nga ana e AMGKP është mbajtur parasysh numri i debitorëve të mbetur për trajtim si dhe evidentimi i mundësive financiare të tyre duke bërë të mundur përpilimin e listës së debitorëve që do të trajtohen për t'u arkëtuar gjatë vitit. Plani vjetor i arkëtimeve është planifikuar bazuar në performancën e një viti më parë, amortizimin e portofolit, duke qenë se numri i debitorëve vjen duke u ulur për shkak të shlyerjes së

detyrimeve, duke bërë që plani të parashikohet në të njëjtat nivele ose edhe në vlerë më të ulët se viti paraardhës.

Gjithashtu, planifikimi i arkëtimeve parashikohet duke u bazuar në vlerën totale të detyrimit të mbetur sipas zonave, mundësisë së vjeljes nisur nga raportimet e juristëve për zonat që trajtojnë apo evidentimi i mundësive financiare të debitorëve sipas zonave.

Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 102 datë 29.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Agjencisë të Trajtimit të Kredive për vitin 2021” është miratuar buxheti i Agjencisë dhe struktura ku plani i arkëtimeve është miratuar në shumën 90,000,000 lekë, buxheti i shpenzimeve operative në shumën 50,604,000 lekë dhe numri i punonjësve 27.

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion planifikimi dhe realizimi për vitin 2021 rezulton si më poshtë:

Tabela nr. 1. Planifikimi dhe realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2021 në lekë

Emërtimi	Plani	Shtesë Buxheti	Fakti	% e realizimit
Arkëtimet 2021	90,000,000		77,643,154	86.3%
Shpenzimet 2021	50,604,000		42,076,131	83%

Burimi: AMGKP, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sikurse vihet re nga tabela e mësipërme për vitin 2021 arkëtimet janë realizuar në vlerën 77,643,154 lekë ose sa 86.3% e planit. Ka një mosrealizim në masën 13.7%.

Shpenzimet janë planifikuar dhe miratuar në vlerën 50,604,000 lekë dhe realizimi rezulton në vlerën 42,076,131 lekë. Ka mosrealizim të shpenzimeve operative në shumën 8,527,869 lekë ose në masën 17%.

Raporti i shpenzimeve të kryera ndaj arkëtimeve të realizuara është në masën 54.19% nga 25% që është kufiri ligjor i shpenzimeve sipas nenit 22, pika 2 e ligjit nr. 8894, datë 14.05.2022 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive” ku citohet: “Agjencia mban në llogaritë e veta fonde të barabarta në vlerë me $\frac{1}{4}$ e buxhetit operativ vjetor të Agjencisë, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.”

Më poshtë paraqitet tabela me zërat analitike të shpenzimeve:

Tabela nr. 2. Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve analitike për vitin 2021 në lekë

EMËRTIMI	Plani	Fakti	% Realizuar
ARKËTIMET GJITHSEJ	90,000,000	77,643,154	86.27
SHPENZIMET GJITHSEJ	50,604,000	42,076,131	83.15
Shpenzim Pagat e punonjësve	25,000,000	21,591,296	86.37
Shpenzim Kontribute të sigurimeve shoqërore	4,100,000	3,992,143	97.37
Shpenzim Fondi i vecantë	1,000,000	855,007	85.50
Shpenzim Pagat e Këshillit Mbikëqyrës	2,500,000	2,320,002	92.80
Shpenzim Udhëtim e dieta	2,300,000	2,219,040	96.48
Shpenzime Taksa vendore	20,000	16,268	81.34
Shpenzim Komisione bankare dhe të tjera	600,000	141,070	23.51
Shërbime për telefoninë fikse/ internet dhe telefoni celulare	469,000	538,344	114.79
Sistem për mbrojtje nga viruset	150,000	-	0.00
Shërbime postare	500,000	287,695	57.54
Shërbime për ruajtje objektsh	220,000	254,189	115.54
Shpenzime Mirëmbajtja e softit	250,000	-	0.00
Shpenzime Shërbime për faqen e internetit	100,000	95,000	95.00
Shpenzime Shërbime për auditimin e bilancit financiar	400,000	396,000	99.00
Shpenzim Larje automjetesh	170,000	151,632	89.20
Fond për përballimin e situatës nga COVID-19	200,000	195,168	97.58
Shërbime për sigurim të pasurisë	80,000	79,800	99.75
Sanitare me kontratë (15*5muaj)	75,000	-	0.00
Shërbime mirëmbajtje paisje elektronike dhe zyrave	600,000	3,000	0.50
Shpenzime shërbimi i makinës, siguracion, taksa, goma	1,330,000	449,956	33.83
Blerje naftë	1,200,000	1,199,908	99.99
Blerje Kancelari të ndryshme	600,000	532,800	88.80
Blerje Materiale pastrimi shërbimi sanitar	120,000	119,784	99.82
Blerje energji elektrike	400,000	361,510	90.38
Blerje ujë	100,000	32,425	32.42
Shpenzime për nxjerrje jashtë përdorimi	300,000	-	0.00
Shpenzime për amortizimin e mjeteve kryesore	2,720,000	3,142,632	115.54
Rikonstruksion i zyrave	500,000	411,600	82.32
Blerje Pajisje elektronike	800,000	756,000	94.50

Pagesa për shpenzimet gjyqësore, përbarimore dhe vlerësim pronash	2,500,000	1,700,662	68.03
Pagesa për Shpenzime për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës	1,000,000	233,200	23.32
Pagesa për Shërbime për ruajtjen e pronave të sekuestruara debitorëve	300,000	-	0.00

Burimi: AMGKP, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela e mësipërme evidentohet se zëri që zë përqindjen më të lartë të shpenzimeve është zëri “Shpenzimet e personelit” ku futen pagat e punonjësve, kontributet dhe fondi i veçantë të cilat janë realizuar në masën 87.8%, kjo si rezultat edhe i vendeve vakante. Struktura për vitin 2021 është miratuar me 28 të punësuar, ndërsa mesatarja e të punësuarve gjatë vitit ka qenë 26 individë. Shpenzimet e personelit zenë rreth 62.8% të shpenzimeve totale.

Zërat me realizim më të lartë janë:

- Shërbime për ruajtje objektesh 115,54%
- Shërbime për telefoninë fikse /internet dhe telefoni celulare 114.79%
- Blerje naftë 99.99%
- Shërbime për sigurim të pasurisë 99.75%
- Blerje pajisje elektronike në masën 94.5 %.

Zërat të cilët nuk janë realizuar nisur nga plan-fakt i vitit 2021 dhe arsyet paraqiten më poshtë:

-Shërbime mirëmbajtje paisje elektronike dhe zyrave me nivel realizimi 0.5%. Realizimi i këtij zëri nuk është kryer, pasi nuk ka lindur nevoja për riparimin e zyrave dhe pajisjeve elektronike, duke qenë në gjendje të mirë pune.

-Mirëmbajtja e programit të kreditit (softit) 0% – Ky zë nuk është shpenzuar, duke qenë se sistemi ka qenë i ri dhe me mirëmbajtje dy vjeçare nga kompania fituese dhe për pasojë nuk ka lindur nevoja për mirëmbajtje.

-Sistem për mbrojtje nga viruset 0% -Është parashikuar blerja e antivirusë, por për shkak të blerjes së kompjuterave të rinj, kompania kishte të përfshirë paketën e antivirusit për të gjithë PC e ofruar. Për këtë arsye, nuk ka qenë e nevojshme shpenzimi i këtij zëri.

-Blerje goma automjetesh. Ky zë parashikohet duke qenë se gomat e automjeteve zëvendësohen pasi automjeti kryhen rreth 40,000 km, por në këtë rast nuk i ka plotësuar km për zëvendësimin e tyre.

-Shpenzime për ruajtjen e pronave të sekuestruara debitorëve 0% – Dy automjetet e sekuestruara i janë lënë në ruajtje ish punonjësit të Agjencisë, me detyrë Shofer për dy vjet, prandaj ky zë nuk është shpenzuar.

Çdo vit në buxhetin e Agjencisë planifikohen 3 zëra me emërtimet si më poshtë:

- Pagesa për shpenzime gjyqësore, përbarimore dhe vlerësim pronash;
- Pagesa për ASHK-në;
- Pagesa për ruajtjen e pronave të sekuestruara debitorëve.

Këto pagesa planifikohen në buxhetin e Agjencisë, parapaguhën nga Agjencia dhe iu ngarkohen në kartelë debitorëve. Zërat që janë realizuar me një përqindje më të ulët janë pagesat për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës të cilat janë realizuar në masën 23.32%. Këto pagesa janë parashikuar në masën 1,000,000 lekë në të cilën përfshihen pagesa që Agjencia kryen për kopje kartelash, harta treguese, çertifikata të pronave të debitorëve dhe tarifa të tjera për shërbimet e kryera. Pagesat për gjyqet, përbarimin dhe vlerësimin e pronave janë realizuar në masën 68.03% nga 2,500,000 lekë që ishte planifikimi. Ky zë është parashikuar në këtë vlerë nisur edhe nga fakti që mund të ketë raste të humbjes të gjyqeve për pavlefshmëri titulli apo edhe kundërshtim të veprimeve përbarimore. Në vitin 2021 nuk ka pasur asnjë gjyq të humbur.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2022

Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës me shkresën nr. 6458/4 prot., datë 28.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Agjencisë së Trajtimit të Kredive për vitin 2022” është miratuar buxheti i Agjencisë dhe struktura, ku plani i arkëtimeve është miratuar në shumën 90,000,000 lekë, buxheti i shpenzimeve operative në shumën 51,783,000 lekë dhe numri i punonjësve 28.

Referuar të dhënave të vendosura në dispozicion planifikimi dhe realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2022 rezulton si më poshtë:

Tabela nr. 3. Planifikimi dhe realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2022

në lekë

Emërtimi	Plani	Shtesë Buxheti	Fakti	% e realizimit
Arkëtimet 2022	90,000,000		62,219,255	69%
Shpenzimet 2022	51,783,000	17,955,000	49,664,798	71%

Burimi: AMGKP, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sikurse vihet re nga tabela e mësipërme për vitin 2022 arkëtimet janë realizuar në vlerën 62,219,255 lekë ose sa 69% e planit. Ka një mosrealizim në masën 31%.

Shpenzimet janë planifikuar dhe miratuar në vlerën 51,783,000 lekë. Gjatë vitit me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës, nr. 3, datë 25.02.2022 është miratuar shtesë fondi, në shumën 17,955,000 lekë. Me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 6, datë 22.06.2022 është bërë ndryshim në zërat e shpenzimeve “Shërbime mirëmbajtje pajisje elektronike nga 500,000 lekë, në 200,000 lekë dhe shtim “Blerje Fotokopje dhe Printeri”, 300,000 lekë. Pavarësisht shtesës së buxhetit për shpenzimet operative, realizimi rezulton në vlerën 49,664,798 lekë, pra 2,118,202 lekë më pak se planifikimi dhe miratimi fillestar. Ka mosrealizim të shpenzimeve operative në shumën 20,073,202 ose në masën 29%.

Raporti i shpenzimeve të kryera ndaj arkëtimeve të realizuara është në masën 79.8% nga 25% që është kufiri ligjor i shpenzimeve sipas nenit 22, pika 2 e ligjit nr. 8894, datë 14.05.2022 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”.

Krahasuar me vitin 2021 rezulton se treguesi financiar i arkëtimeve ka pësuar rënie, ndërkohë që shpenzimet janë rritur në raport të zhdrejtë me realizimin e të ardhurave.

Më poshtë paraqitet tabela me zërat analitike të shpenzimeve:

Tabela nr. 4. Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve (analitike) për vitin 2022

në lekë

EMËRTIMI	Plani	Shtesë Buxheti	Totali	Fakti	% Realizuar
SHPENZIMET GJITHSEJ	51,783,000	17,955,000	69,738,000	49,664,798	71.22
Shpenzim Pagat e punonjësve	25,000,000	585,000	25,585,000	21,521,330	84.12
Shpenzim Kontribute të sigurimeve shoqërore	4,100,000	100,000	4,200,000	3,552,331	84.58
Shpenzim Fondi i vecantë	1,205,000		1,205,000	637,982	52.94
Pagat e Këshillit Mbikëqyrës	2,500,000		2,500,000	2,335,740	93.43
Shpenzim Qira Godine		4,400,000	4,400,000	2,308,581	52.47
Shpenzim Udhëtim e dieta	2,300,000		2,300,000	2,189,760	95.21
Shpenzime Taksa vendore	20,000		20,000	15,471	77.36
Shpenzim Komisione bankare dhe të tjera	400,000		400,000	130,077	32.52
Shërbime për telefoninë fikse dhe internet	250,000		250,000	199,800	79.92
Shërbime për telefoninë celulare	400,000		400,000	302,769	75.69
Instalim dhe blerje telefoni e brendshme		150,000	150,000	-	0.00
Shërbime postare	500,000		500,000	237,155	47.43
Shërbime për ruajtje objektësh	400,000		400,000	252,798	63.20
Shpenzime Mirëmbajtja e softit	400,000	2,600,000	3,000,000	1,655,615	55.19
Shpenzim Parkingu dhe rezervim tabele		1,320,000	1,320,000	109,200	8.27
Shpenzime Lyerje dhe punime të brendshme gipsi		1,500,000	1,500,000	1,462,644	97.51
Shpenzime në rast të transferimit të zyrave	1,000,000		1,000,000	936,000	93.60
Shpenzime Shërbime për faqen e internetit	120,000		120,000	93,600	78.00
Shpenzime Shërbime për auditimin e bilancit	400,000		400,000	384,000	96.00
Larje automjeteve	200,000		200,000	-	0.00
Fond për përballimin e situatës nga COVID-19	220,000		220,000	-	0.00
Shërbime për sigurim të pasurisë	90,000		90,000	-	0.00
Shpenzime të tjera (kontrata UKT OSHE)		500,000	500,000	-	0.00
Shërbime mirëmbajtje pajisje elektronike	500,000	700,000	1,200,000	-	0.00
Shpenzime shërbimi makinës, siguracion, taksa	1,200,000		1,200,000	570,137	47.51
Blerje naftë	1,400,000		1,400,000	959,962	68.57
Blerje goma	200,000		200,000	48,000	24.00
Blerje Kancelari të ndryshme	600,000		600,000	512,364	85.39
Blerje Materiale pastrimi shërbimi sanitar	150,000		150,000	145,800	97.20
Shpenzim blerje energji elektrike	500,000		500,000	326,560	65.31
Shpenzim Blerje ujë	100,000		100,000	18,002	18.00
Shpenzime për nxjerrje jashtë përdorimit	300,000		300,000	-	0.00
Shpenzime për amortizimin e mjeteve kryesore	2,828,000		2,828,000	2,952,060	104.39
Shpenzim montim kondicioneri		242,181	242,181	242,181	100.00
Blerje Kondicioner		1,757,819	1,757,819	936,980	53.30
Blerje pajisje zyre inventar 2181	700,000	3,800,000	4,500,000	4,398,000	97.73
Blerje Fotokopje dhe Printeri Inventar 2181		300,000	300,000	194,000	64.67
Pagesa për shpenzimet gjyqësore, përmbarimore	2,500,000		2,500,000	-	0.00
Pagesa për Shpenzime për ASHK	1,000,000		1,000,000	35,900	3.59

Pagesa për Shërbime për ruajtjen e pronave	300,000	300,000	-	0.00
--	---------	---------	---	------

Burimi: AMGKP, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela e mësipërme evidentohet se zëri që zë përqindjen më të lartë të shpenzimeve është zëri “Shpenzimet e personelit” që përfshin pagat e punonjësve, kontributet shoqërore dhe shëndetësore dhe fondin e veçantë. Për vitin 2022 ky zë është realizuar në masën 82.9% nga 30,990,000 lekë të planifikuara. Shpenzimet e personelit zenë rreth 51.77% të shpenzimeve totale të buxhetit.

Evidentohet se gjatë planifikimit të buxhetit të viteve 2021-2022 është planifikuar zëri “Shpenzime për amortizimin e mjeteve kryesore” përkatësisht në vlerat 2,720,000 lekë dhe 2,828,000 lekë. Përfshirja e këtij zëri në buxhet si shpenzim jo monetar nuk është i argumentuar.

Zërat me realizim më të lartë janë:

- Shpenzime montim kondicioneri 100%
- Blerje pajisje zyre inventar 97.73%
- Shp lyerje dhe punime të brendshme 97.51%
- Blerje Materiale pastrimi shërbimi sanitar 97.2%
- Shpenzime Shërbime për auditimin e bilancit financiar 96%
- Shpenzim Udhëtim e dieta 95.21%
- Zërat blerje kondicioner, blerje pajisje zyre, blerje printer dhe fotokopje janë realizuar në masën 84.31 % nga 6,557,819 lekë të planifikuara.

Zërat me realizim më të ulët janë:

- Instalim dhe blerje telefoni e brendshme - Ky shërbim është ofruar nga kompania telefonike “O”, pasi është lidhur një kontratë shërbimi për telefoninë celulare.
- Fond për përballimin e situatës nga Covid-19 -Fondi është parashikuar, në rast të lindjes së nevojës për blerjen e materialeve anti-COVID. Zëri nuk është shpenzuar.
- Shpenzime të tjera kontrata OSHEE, UKT- Për shkak të ndryshimit të ambienteve dhe zhvendosjes së zyrave, ky zë është parashikuar në rast të lindjes së nevojës për instalimin e të gjithë rrjetit elektrik dhe hidraulik.
- Shërbime mirëmbajtje pajisje elektronike dhe zyrave - Duke qenë se janë blerë pajisje të reja pune, nuk ka lindur nevoja për mirëmbajtjen e tyre.
- Pagesa për shërbime për ruajtjen e pronave të sekuestruara debitorëve - Dy automjetet e sekuestruara janë lënë në ruajtje ish punonjësit të Agjencisë, me detyrë shofer.

Për vitin 2022 ashtu si edhe për vitin 2021 janë planifikuar pagesa për shpenzimet gjyqësore, përmbarimore, vlerësim pronash, ASHK-në dhe pagesa për ruajtjen e pronave të sekuestruara debitorëve në masën 3,800 mijë lekë. Nga tre zërat e mësipërm vetëm pagesat për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës janë realizuar në vlerën 3.59 % nga 1,000,000 lekë të planifikuara.

Përgjatë vitit 2022 është realizuar transferimi i ambienteve të punës së ATK-së referuar VKM-së, nr. 49, datë 26.01.2022, “Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit nga Agjencia e Trajtimit të Kredive tek Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të pasurisë nr. 7/115, zona kadastrale 8270, Tiranë dhe për një ndryshim, në vendimin nr. 20, datë 19.01.2007 të Këshillit të Ministrave”, administruar në ATK me nr. 308 prot., datë 28.01.2022.

Nga ana e ATK-së është lidhur kontrata e qirasë me nr. repertori 2585 dhe nr. koleksioni 1522 datë 07.06.2022 me palë qiradhënëse shoqërinë tregtare “D....P....” shpk me Nipt L.....L. Objekt i kontratës së qirasë është pasuria 106/60-N, ZK 3292, Selitë regjistruar në ASHK Vol. 17, fq. 132 me sipërfaqe 766 m2. Me qira është marrë sipërfaqja 354 m2. Afati i kontratës është lidhur për një periudhë 5 vjeçare dhe kontrata ka hyrë në fuqi në datë 01.07.2022. Qiraja mujore është në vlerën 3,300 euro dhe paguhet më datë 1-5 të çdo muaji. Tatimi në burim paguhet nga pala qiradhënëse.

Lidhur me këtë kontratë është bërë amendim me nr. repertori 124, nr. koleksioni. 65 datë 06.02.2024 ku pagesa e qirasë mujore prej 3300 euro do të konvertohet në lekë sipas kursit të bankës së Shqipërisë në datën e prerjes së faturës.

Si rrjedhojë për vitin 2022 është shtuar zëri “Shpenzime qira për godinën”, planifikuar në vlerën 4,400,000 lekë dhe realizuar në vlerën 2,308,581 lekë.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2023

Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 16 datë 30.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Agjencisë së Trajtimit të Kredive për vitin 2023” është miratuar buxheti i Agjencisë dhe struktura, ku plani i arkëtimeve është miratuar në shumën 90,000,000 lekë, buxheti i shpenzimeve operative në shumën 57,139,000 lekë dhe numri i punonjësve 29. Me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 9, datë 29.08.2023 është bërë shtesë buxheti në vlerën 7,866,387 lekë. Total buxheti i planifikuar për vitin 2023 është në vlerën 54,546,329 lekë. Buxheti është realizuar në vlerën 83.91%, referuar planit të vitit 2023.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2023 rezulton si më poshtë:

Tabela nr. 5. Planifikimi dhe realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2023 në lekë

Emërtimi	Plani	Shtesë Buxheti	Fakti	% e realizimit
Arkëtimet 2023	90,000,000		80,624,585	90%
Shpenzimet 2023	57,139,000	7,866,387	54,546,329	84%

Burimi: AMGKP, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sikurse vihet re nga tabela e mësipërme për vitin 2023 arkëtimet janë realizuar në vlerën 80,624,585 lekë ose 90% e planit. Ka një mosrealizim në masën 10%. Krahasuar me vitin e kaluar arkëtimi ka pasur rritje në vlerën 18,405,330 lekë ose në masën 22.8%.

Shpenzimet janë planifikuar dhe miratuar në vlerën 57,139,000 lekë. Gjatë vitit është shtuar buxheti me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 9, datë 29.08.2023 “Për miratim shtesë buxheti të ATK-së për vitin 2023” në vlerën totale 7,866,387 lekë. Pavarësisht shtesës së buxhetit për shpenzimet operative, realizimi rezulton në vlerën 54,546,329 lekë, pra 2,592,671 lekë më pak edhe se planifikimi dhe miratimi fillestar. Ka mosrealizim të shpenzimeve operative në vlerën 10,459,058 lekë ose në masën 16%. Gjithashtu dhe shpenzimet janë rritur krahasuar me vitin 2021 në vlerën 4,881,531 lekë ose në masën 8.9%.

Raporti i shpenzimeve të kryera ndaj arkëtimeve të realizuara është në masën 67.65% nga 25% që është kufiri ligjor i shpenzimeve sipas nenit 22, pika 2 e ligjit nr. 8894, datë 14.05.2022 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”.

Sqarim për mosrakovimin e vlerës së arkëtimit për efekt kursi këmbimi: Arkëtimet në euro dhe dollarë për kreditë e marrë në këto monedha janë konvertuar me kursin Kontabël të sistemit të kreditit Eur 130 dhe Usd 105 dhe vlera e arkëtimeve rezulton 80,624,585 lekë, ndërsa në bilanc raportohen me kursin ditor të BSH me datën kur ka ardhur arkëtimi, ku për vitin 2023 rezulton vlera 79,104,296 lekë.

Më poshtë paraqitet tabela me zërat analitike të shpenzimeve:

Tabela nr. 6. Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve (analitike) për vitin 2023 në lekë

EMËRTIMI	Plani	Shtesë Buxheti	Totali	Fakti	% e realizimit
ARKËTIMET GJITHSEJ	90,000,000		90,000,000	80,624,585	89.58
SHPENZIME GJITHSEJ	53,239,000	7,866,387	61,105,387	52,837,341	86.47
Shpenzime për pagat e punonjësve	27,500,000	5,859,045	33,359,045	31,653,153	94.89
Shpenzime për kontribute të sigurimeve shoqërore	4,500,000	1,021,122	5,521,122	5,190,883	94.02
Shpenzime nga fondit i vecantë	1,265,000	161,550	1,426,550	132,797	9.31
Shpenzime për pagat e Këshillit Mbikëqyrës	2,600,000	824,670	3,424,670	1,557,510	45.48
Shpenzime për taksa vendore	20,000	-	20,000	15,000	75.00
Shpenzime për udhëtim e dieta	2,300,000	-	2,300,000	2,097,140	91.18
Shpenzime për automjetet	3,504,000	-	3,504,000	2,346,466	66.97
Shpenzime për transferim dhe montimin e gjeneratorit	300,000	-	300,000	258,000	86.00
Shpenzime për larje automjesh	200,000	-	200,000	67,000	33.50
Shpenzime për energji elektrike	500,000	-	500,000	298,628	59.73
Shpenzime për ujë	100,000	-	100,000	6,648	6.65
Shpenzime për telefoninë fikse, celulare dhe internet	560,000	-	560,000	364,225	65.04
Shpenzime postare	500,000	-	500,000	436,830	87.37
Shpenzime për faqen e internetit	120,000	-	120,000	94,800	79.00
Shpenzime mirëmbajtje pajisje elektronike dhe zyrave	700,000	-	700,000	698,666	99.81
Shpenzime për komisione bankare, shp. gjyqësore dhe të tjera	400,000	-	400,000	155,454	38.86
Shpenzime për sigurim të pasurisë	100,000	-	100,000	97,000	97.00
Shpenzime për nxjerrje jashtë përdorimit	300,000	-	300,000	252,000	84.00
Shpenzime për kancelari të ndryshme	600,000	-	600,000	420,000	70.00
Shpenzime për kuti kartoni për përpunimin e dosjeve me RKH	350,000	-	350,000	333,564	95.30
Shpenzime për materiale pastrimi shërbimi sanitar	150,000	-	150,000	84,000	56.00
Shpenzime për auditimin e bilancit financiar	400,000	-	400,000	383,880	95.97
Up grade dhe mirëmbajtja e sofrit	808,000	-	808,000	807,797	99.97

Shpenzim për ruajtje objektësh	400,000	-	400,000	310,800	77.70
Shpenzime për përditësimin e Financës 5	150,000	-	150,000	-	-
Shpenzim Qera godine	4,752,000	-	4,752,000	4,695,900	98.82
Shpenzime Parking	160,000	-	160,000	79,200	49.50
Blerje pajisje elektronike dhe vula	600,000	-	600,000	363,000	60.50
Pagesa gjyqësore, përbarimorë dhe vlerësim pronash	2,000,000	-	2,000,000	1,040,988	52.05
Pagesa për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës	1,000,000	-	1,000,000	187,400	18.74
Pagesa për ruajtjen e pronave të sekuestruara debitorëve	300,000	-	300,000	117,600	39.20

Burimi: AMGKP, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela e mësipërme, evidentohet se zëri që zë përqindjen më të lartë të shpenzimeve është zëri “Shpenzimet e personelit” realizuar në masën 91.73% nga 40,306,717 lekë të planifikuara. Këto shpenzime zënë rreth 67.7% të shpenzimet totale të buxhetit.

Zërat me realizim më të lartë janë:

- Shpenzime për Up grade dhe mirëmbajtja e softit 99.97%;
- Shpenzime mirëmbajtje pajisje elektronike dhe zyra 99.81%;
- Shpenzim Qera godine 98.82%;
- Shpenzime për sigurim të pasurisë 97%;

Shpenzime për blerje mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 76.2% nga 20,798,670 lekë të planifikuara. Këto shpenzime zënë rreth 29% të shpenzimeve totale të buxhetit.

Për vitin 2023 janë planifikuar 3,300,000 lekë pagesa për ASHK, përbarim, vlerësim pronash, gjyq. Tre zërat janë realizuar në masën rreth 41%.

Sipas informacionit të subjektit dhe analizave vjetore sektori Juridik dhe Operacional, ka vijuar punën për takimet në terren me debitorët, thuajse në të gjitha qarqet, bashkitë e vendit, edhe në Njësitë Administrative, për të mundur arkëtimet sipas planit, por edhe duke negociuar dhe duke iu bërë me dije lehtësirat që iu ofron ligji për faljen e interesave. Prioritet ka qenë kontakti i drejtpërdrejtë me debitorin, dalja në terren, dërgimi e ndjekja për ekzekutim në zyrat e shërbimit përbarimor, shtetëror dhe privat i praktikave të debitorëve, trajtimi ligjor i huamarrësve, çelja e dëshmisë së trashëgimisë, nxjerrja e dublikatave të urdhrave të ekzekutimit, ndjekja e proceseve gjyqësore, etj.

Në realizimin e planit mujor dhe vjetor për të tre vitet në auditim kanë patur ndikim problematika të ndryshme të hasura prej vitesh gjatë procesit të punës, trajtuar më hollësisht në drejtimin nr. 2.

Tabela nr .7. Të dhënat e arkëtimeve dhe kalimeve sipas viteve objekt auditimi

Emërtimi	Vitet		
	2021	2022	2023
Interesa në Euro	38,803	35,528	32,247
Principal në Euro	436,702	437,214	437,725
Shuma në Euro	475,505	472,741	469,972
Pagesë kredie në Euro	167,432	268,000	273,500
Pagesë në 000/lekë konvertuar me kursin e bankës -Kaluar buxhetit	20,457	31,871	29,835
Diferenca në euro	308,073	204,741	196,472
Arkëtime në 000/lekë (Kthim principal, shpenzime të pafalshme, Shitje prone, të tjera)	77,643	62,219	79,104
Mbajtur në përdorim nga ATK në 000/lekë	57,186	30,348	49,269
I takon të mbajë sipas ligjit	19,411	15,555	19,776
Mbajtur në kundërshtim me ligjin	37,776	14,793	29,493
Raporti derdhjes buxhet/arkëtime gjithsej	26%	51%	38%

Burimi: AMGKP, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se për vitin 2021 AMGKP ka derdhur në buxhetin e shtetit vlerën prej 20,457 mijë lekë të vlerësuar me kursin kontabël ose 26% të të ardhurave vjetore dhe ka mbajtur për përdorim 57,186 mijë lekë të arkëtimeve vjetore ose 74%.

-Për vitin 2022 ka derdhur në buxhetin e shtetit vlerën prej 31,871 mijë lekë të vlerësuar me kursin kontabël ose 51% të të ardhurave vjetore dhe ka mbajtur për përdorim 30,348 mijë lekë të arkëtimeve vjetore ose 49%.

-Për vitin 2023 ka derdhur në buxhetin e shtetit vlerën prej 29,835 mijë lekë të vlerësuar me kursin kontabël ose 38% të të ardhurave vjetore dhe ka mbajtur për përdorim 49,269 mijë lekë të arkëtimeve vjetore ose 62%.

Referuar nenit 22, pika 2 e ligjit nr. 8894, datë 14.05.2022 “Për Agjencinë e Trajtimin të Kredive”, i ndryshuar përcaktohet se: “Agjencia mban në llogaritë e veta fonde të barabarta në vlerë me ¼ e buxhetit operativ vjetor të Agjencisë të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.”

Sa më sipër nga auditimi konstatohet se nuk është zbatuar neni i sipërcituar.

Referuar këtij neni AMGKP duhet të mbante nga arkëtimet e vitit 2021 shumën 19,411 mijë lekë. (1/4*77,643,000)

Nga arkëtimet e vitit 2022 shumën 15,554,813.75 lekë. (1/4*62,219,255);

Nga arkëtimet e vitit 2023 shumën 19,776,074 lekë. (1/4*79,104,296);

AMGKP ka mbajtur në kundërshtim me këtë nen të ligjit në vitin 2021 shumën 37,776 mijë lekë, në vitin 2022 shumën 14,793 mijë lekë dhe në vitin 2023 shumën 29,493 mijë lekë.

Megjithatë referuar nenit 22, evidentohet se nëse agjencia mban ¼ e buxhetit operativ vjetor nuk mbulon as shpenzimet e personelit. Por ky element nuk është trajtuar në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës edhe pse është fenomen i përsëritur gjatë tre viteve objekt auditimi.

Për veprimet ose mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Këshilli Mbikëqyrës sipas viteve objekt auditimi.

Tabela nr. 8. Të ardhurat dhe shpenzimet sipas viteve

në 000 lekë

Viti	Të ardhurat	Shpenzime		Totali i shpenzimeve	Diferenca TR-Shp
		Operative	Financiare		
1998	15,952	20,392.73		20,392.73	(4,440.73)
1999	182,081	26,635.27		26,635.27	155,445.73
2000	130,308	77,664.53		77,664.53	52,643.47
2001	297,142	87,815.13		87,815.13	209,326.87
2002	575,615	108,190.23		108,190.23	467,424.77
2003	817,601	141,400.35		141,400.35	676,200.65
2004	965,122	152,685.79		152,685.79	812,436.21
2005	687,314	147,379.63		147,379.63	539,934.37
2006	413,661	105,079.33		105,079.33	308,581.67
2007	424,338	92,314.63		92,314.63	332,023.37
2008	331,240	104,151.96		104,151.96	227,088.04
2009	385,826	96,306.38		96,306.38	289,519.62
2010	293,667	73,416.98		73,416.98	220,250.02
2011	240,148	58,421.25		58,421.25	181,726.75
2012	144,199	43,656.70		43,656.70	100,542.30
2013	87,438	30,217.85		30,217.85	57,220.15
2014	84,002	35,401.60		35,401.60	48,600.40
2015	104,841	31,544.63		31,544.63	73,296.37
2016	104,167	28,094.91		28,094.91	76,072.09
2017	90,575	32,006.86	150.62	32,157.48	58,417.52
2018	66,179	30,092.37	129.41	30,221.77	35,957.23
2019	27,580	27,953.91	78.53	28,032.44	(452.44)
2020	51,817	37,422.75	61,359.72	98,782.47	(46,965.47)
2021	77,643	39,217.85	94,399.51	133,617.36	(55,974.36)
2022	62,219	43,900.63	76,298.25	120,198.88	(57,979.88)
2023	79,104	54,008.32	7,106.15	61,114.47	20,510.53
Totali	6,739,779	1,725,373	239,522	1,964,895	4,774,884

Burimi: AMGKP, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela e mësipërme paraqet situatën financiare ndër vite të Agjencisë. Siç vihet re vitet 1999-2011 kanë qenë vitet me realizim më të lartë të të ardhurave. Më pas të ardhurat kanë pësuar luhatje, ku viti 2019 shënon vlerën më të ulët të realizimit të të ardhurave. Sa i përket shpenzimeve paraqiten me luhatje ndër vite. Për vitet 2019-2022 pasqyrat financiare të Agjencisë kanë rezultuar me humbje, si rezultat i shpenzimeve të larta, ndërkohë që plani i të ardhurave nuk është realizuar.

Respektimi i dispozitave ligjore për pagat dhe shpërblimet e punonjësve

Ndryshimet e strukturës dhe rregullores paraqiten si vijon:

-Në vitin 2019 u propozua krijimi i Sektorit të Menaxhimit të Riskut, i përbërë prej 1 (një) Përgjegjës dhe 3 (tre) Specialistë. Me vendimin nr. 8/5 prot., datë 01.09.2019 të Këshillit Mbikëqyrës u miratua ndryshimi i strukturës organizative me 27 punonjës total. Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 9/10 prot., datë 01.10.2019 u miratua Rregullorja me ndryshimet përkatëse, e cila deri në vitin 2024 nuk ka patur asnjë ndryshim, përveç ndarjes së pozicioneve në vijim, por asnjë ndryshim në detyra funksionale.

-Në vitin 2021, për shkak të fluksit të punës në Arkiv/Protokoll, u propozua nga Agjencia ndarja e pozicioneve në dy funksione të ndryshme. Me vendimin nr. 6386/5 prot., datë 16.12.2021 “Mbi miratimin e ndryshimit të strukturës organizative për vitin 2021” të Këshillit Mbikëqyrës u miratua ndryshimi i strukturës organizative, me ndarjen në dy pozicione: Arkivist dhe Protokollist, duke bërë që numri total i punonjësve të jetë 28.

-Në vitin 2022, me vendimin nr. 724/4 prot., datë 25.02.2022 “Mbi miratimin e ndryshimit të strukturës organizative për vitin 2022” të Këshillit Mbikëqyrës u miratua ndarja e pozicionit Sekretare e Drejtorit/Sekretare e Këshillit Mbikëqyrës/Specialiste e Burimeve Njerëzore në dy pozicione: Sekretare e Drejtorit/ Sekretare e Këshillit Mbikëqyrës dhe Specialiste e Burimeve Njerëzore dhe numri total i punonjësve bëhet 29.

-Në vitin 2023, me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave lindi nevoja për shtimin e një pozicioni Arkivist. Për këtë arsye, me vendimin nr. 4027/6 prot., datë 29.06.2023 “Mbi miratimin e ndryshimit të strukturës organizative për vitin 2023” të Këshillit Mbikëqyrës u miratua ndryshimi i strukturës me shtimin e një pozicioni Arkiviste dhe numri i punonjësve shkoi në 30 total.

-Në datën 13.07.2023 është miratuar ligji nr. 55/2023 “Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera” shpallur me dekretin nr. 160 datë 27.07.2023 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Megjithatë Agjencia ka vijuar të organizohet dhe të funksionojë sipas ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, i ndryshuar deri në ristrukturimin e saj sipas nenit 3 të këtij ligji, i cili përfundon brenda datës 01.01.2024. Struktura e re është miratuar me urdhër të Kryeministrit nr. 17 datë 25.01.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera”, në tejkallim të afateve të përcaktuara në pikën 3, të nenit 17 të ligjit nr. 55/2023.

Struktura për vitet 2021-2023 bashkë me shpenzimet e personelit paraqitet sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr. 9. Struktura e punonjësve për vitet 2021-2023 me shpenzimet e personelit në lekë

Viti	Nr. i të punësuarve sipas strukturës	Nr. mesatar i të punësuarve	Shpenzimet e personelit
2021	28	26	26,438,446
2022	28	27	30,990,000
2023	29	26	40,306,717

Burimi: Të dhënat nga AMGKP, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr. 10. Emërimet dhe ndryshimet e pozicionit për vitet 2021-2023

Viti	Emërimet	Ndryshim pozicioni
2021	8	6
2022	16	9
2023	6	7

Burimi: Të dhënat nga AMGKP, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr. 11. Largimet sipas arsyeve për vitet 2021-2023

Viti	Dorëheqje	Pension	Masë disiplinore	Përfundon Kontrata e punës	Total largime
2021	14	1	-	-	15
2022	8	-	-	-	8
2023	6	-	1	1	8

Burimi: Të dhënat nga AMGKP, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sa më sipër janë paraqitur ndryshimet e pozicioneve, emërimet dhe largimet për vitet 2021-2023. Lidhur me këto ndryshime nuk u konstatuan problematika.

Shpenzimet e personelit zënë përqindjen më të lartë të shpenzimeve totale për të tre vitet objekt auditimi.

Marrëdhëniet e punës në AMGKP rregullohen sipas Kodit të Punës miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, i ndryshuar. Struktura e pagave për punonjësit bazohet në Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës për miratimin e buxhetit sipas secilit vit. Paga bazë përfshin pagën e grupit dhe shtesat për vjetërsi, kualifikim e pozicion.

Në funksion të auditimit të respektimit të dispozitave ligjore për pagat e punonjësve, shpërblimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, etj, u përzgjedhën në bazë risku listëpagesat si në vijim:

- Muajt janar, mars, korrik 2021
- Muajt prill, qershor, nëntor 2022
- Muajt janar, gusht, tetor 2023

Nga analiza e listë pagesave të punonjësve të zgjedhur u konstatua se janë të plotësuar me të gjitha të dhënat sipas Vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës (Paga e kategorisë, paga e grupit, vjetërsia për vite pune, si dhe shtesat e tjera). Gjithashtu janë llogaritur saktë kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi.

Sa i takon përllogaritjes së vjetërsisë në punë, bazuar në Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 70 datë 21.12.2018 “Për miratimin e vjetërsisë në punë për nëpunësit e ATK”, shtesa është miratuar në masën 1% në vit të pagës aktuale të punonjësve.

Pas VKM-së nr. 325 datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, është marrë vendimi nr. 08 datë 14.07.2023 “Për miratimin e rritjes së pagave të punonjësve të ATK-së” shtesa e vjetërsisë në vazhdim është llogaritur sipas kësaj VKM.

Konkretisht 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit:

- 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
 - 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- Përllogaritja ka rezultuar konform përcaktimeve ligjore mbi nivelin e pagës, pozicionin, raportin mjekësor dhe shtesën e vjetërsisë.

Lidhur me shpenzimet për pagesa përmbartimore

Çdo vit në buxhetin e Agjencisë është planifikuar zëri i pagesave për shpenzime përmbartimore. Këto pagesa planifikohen në buxhetin e Agjencisë, parapaguhen nga Agjencia dhe iu ngarkohen në kartelë debitorëve. Për vitet 2021-2023 ky shpenzim rezulton si vijon:

Tabela nr. 12. Pagesat për zyrat e përmbartimit privat

në lekë

Viti	Shpenzime përmbartimore
2021	1,598,662
2022	-
2023	59,188
Totali	1,657,850

Burimi: Të dhënat nga AMGKP, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

U auditua dokumentacioni dhe pagesa e 10 praktikave me vlerat më ta larta të shpenzimit përmbartimor për vitet 2021 dhe 2023. Konkretisht:

Për pagesat e tarifave përmbartimore për pasuritë e kaluara në pronësi të ATK-së nga zyra përmbartimore E.K

-Urdhri i brendshëm nr. 1041 prot., datë 05.02.2021. Nga zyra përmbartimore është lëshuar fatura nr. 92 datë 03.02.2021 në vlerën 216,576 lekë me TVSH, e cila është likuiduar me urdhër transfertën datë 05.02.2021. Pasuria e kaluar në pronësi sipas vendimit për kalim pronësie të zyrës përmbartimore “B....S....M.....&Co” nr. 1929 prot., datë 18.07.2013 të ish debitorit B.B për pasurinë “Arë” me nr. pasurie 26/21, vol. 2, fq. 37, ZK 1529 me sipërfaqe 10,600 m² të ndodhur në Kalivaç, Tepelenë. (Vlera e pasurisë sipas ankandit të dytë 1,804,800 lekë).

-Urdhri i brendshëm nr. 1042 prot., datë 05.02.2021. Nga zyra përmbartimore është lëshuar fatura nr. 93 datë 03.02.2021 në vlerën 184,320 lekë me TVSH, e cila është likuiduar me urdhër transfertën datë 05.02.2021. Pasuria e kaluar në pronësi sipas vendimit për kalim pronësie të zyrës përmbartimore “B....S....M.....&Co” nr. 750 prot., datë 26.03.2014 të ish debitorit A.K për pasurinë “Truall” me nr. pasurie 207/2, vol. 4, fq. 107, ZK 2473 me sipërfaqe 250 m² të ndodhur në Livadhja, Sarandë. (Vlera e pasurisë sipas ankandit të dytë 1,536,000 lekë).

-Urdhri i brendshëm nr. 1460 prot., datë 15.02.2021. Nga zyra përmbarimore është lëshuar fatura nr. 1 datë 09.02.2021 në vlerën 176,640 lekë me TVSH, e cila është likuiduar me urdhër transfertën datë 15.02.2021. Pasuria e kaluar në pronësi sipas vendimit për kalim pronësie të zyrës përmbarimore “B....S....M....&Co” nr. 645/2012 prot., datë 23.10.2013 të ish debitorit B.Rr për pasurinë “Arë+Truall” me nr. pasurie 126/1, vol. 3, fq. 39, ZK 2869 të ndodhur në fshatin Panahor, Mallakastër. (Vlera e pasurisë sipas ankandit të dytë 1,472,000 lekë).

-Urdhri i brendshëm nr. 1594 prot., datë 02.03.2021. Nga zyra përmbarimore është lëshuar fatura nr. 6 datë 25.02.2021 në vlerën 162,240 lekë me TVSH, e cila është likuiduar me urdhër transfertën datë 02.03.2021. Pasuria e kaluar në pronësi sipas vendimit për kalim pronësie të zyrës përmbarimore “B....S....M....&Co” nr. 317/2011 prot., datë 29.05.2014 të ish debitorit T.T për pasuritë:

-Nr. 300/3, e llojit arë, vol 4, fq. 188, zk 3421, sip 600m² në vlerën 134,400 lekë

-Nr. 2/8 e llojit arë, vol 1, fq. 12, zk 3421, sip 3600m², në vlerën 832,000 lekë

-Nr. 138 e llojit arë, vol 2, fq. 113, zk, 3421, sip 2250m² në vlerë 448,000 lekë.

Për pagesat e tarifave përmbarimore nga zyra përmbarimore K.C (shp. përmbarimore për hipotekë, vënien e sekuestros konservative)

-Urdhri i brendshëm nr. 2829/1 prot., datë 14.05.2021. Pas kërkesës nr. 2716/1 prot., datë 11.05.2021 për heqje dorë nga ekzekutimi për 43 debitorë (dosje të pezulluara), nga zyra përmbarimore janë lëshuar faturat e thjeshta tatimore 11-14 datë 12.05.2021 në vlerë totale 369,200 lekë. Këto fatura janë likuiduar me urdhër transfertën datë 14.05.2021.

-Urdhri i brendshëm nr. 6390 prot., datë 10.10.2023. Nga zyra përmbarimore janë vendosur në dispozicion faturat nga ZVRPP: nr. 16035 datë 21.09.2023, nr. 18985 datë 21.09.2023, nr. 16032 datë 21.09.2023 dhe nr. 18981 datë 21.09.2023 në vlerë totale 18,000 lekë më TVSH. Nga ana e zyrës përmbarimore nuk është lëshuar një faturë shitje përmbledhëse. Këto fatura të ZVRPP janë likuiduar me urdhër transfertën datë 11.10.2023.

-Urdhri i brendshëm nr. 1943/1 prot., datë 17.03.2023. Nga zyra përmbarimore është lëshuar faturë nr. 7/2023 datë 22.02.2023 në vlerë 5,400 lekë më TVSH, faturë e cila është likuiduar me urdhër transfertën datë 20.03.2023.

Për pagesën e tarifës përmbarimore nga zyra përmbarimore Q.... shpk

-Urdhri i brendshëm nr. 6552/2 prot., datë 23.10.2023 për pagesën e tarifës për shpenzime përmbarimore për hipotekë, RBS, shpenzime për vënien e sekuestros mbi pasuritë e debitorëve nga zyra përmbarimore Q.... shpk. Nga zyra përmbarimore janë lëshuar faturat nr. 85/2023 dhe 86/2023 datë 16.10.2023 në vlerë totale 13,188 lekë me TVSH, të cilat janë likuiduar me urdhër transfertën datë 25.10.2023.

Për pagesat e tarifave përmbarimore nga zyra përmbarimore Ç.... (shp hipotekë)

-Urdhri i brendshëm nr. 2349 prot., datë 31.03.2023. Nga zyra përmbarimore janë vendosur në dispozicion faturat nga ZVRPP: nr. 2382 datë 13.12.2023, nr. 24625 datë 13.12.2023, nr. 2293 datë 09.02.2023 dhe nr. 2294 datë 09.02.2023 në vlerë totale 8,400 lekë më TVSH. Këto fatura janë likuiduar me urdhër transfertën datë 11.10.2023.

-Urdhri i brendshëm nr. 7564/2 prot., datë 27.12.2023 për pagesën e tarifës për shpenzime përmbarimore për hipotekë nga zyra përmbarimore Ç..... Nga zyra përmbarimore janë vendosur në dispozicion faturat nga ZVRPP: nr. 18242 datë 01.11.2023, nr. 10712 datë 01.11.2023, nr. 11755 datë 30.11.2023 në vlerë totale 7,000 lekë më TVSH. Këto fatura janë likuiduar me urdhër transfertën datë 27.12.2023. Për dy rastet e trajtuara më sipër, nga ana e zyrës përmbarimore Ç..... nuk është lëshuar faturë shitje përmbledhëse.

Sa më sipër rezultoi se në tre raste pagesat për shpenzime përmbarimore në vlerë totale 33,400 lekë janë kryer pa pasur faturën e lëshuar nga zyra përmbarimore si dokument justifikues.

Referuar kreut IV pika 4 dhe 5 e udhëzimit nr. 30 datë 30.08.2018 “Për disa ndryshime në udhëzimin e përbashkët nr. 385/7, datë 28.06.2017 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat” të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të

Financave përcaktohet se: “4. Për shpenzimet e parashikuara në pikën 1 të këtij seksioni, subjekti përmbartues lëshon faturë tatimore ndaj palëve kreditore apo debitore, e cila shoqërohet me kopje të dokumenteve të pagesave të lëshuara nga të tretët, dokumente të cilat shërbejnë për të dokumentuar shpenzimet e zbritshme të subjektit përmbartues, sipas legjislacionit në fuqi. Pika 5 “Shpenzimet përmbartimore të pagueshme nga subjekti përmbartues dhe të kryera në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas masës dhe llojeve në zbatim të këtij udhëzimi përpara përfundimit të ekzekutimit, përshkruhen në një akt përmbledhës, të emërtuar Procesverbal për shpenzimet procedurale gjatë ekzekutimit, duke bashkëlidhur faturat përkatëse. Pala debitore të cilës i ngarkohen këto shpenzime, ka të drejtë të njihet dhe të marrë kopje të këtij procesverbali.” Ky veprim rezulton edhe në kundërshtim me kreun III, pikën 61 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dhe dokumentacioni si më poshtë:

- Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve;
- Regjistri i parashikimeve dhe realizimit të prokurimeve publike për periudhën 2021-2023;
- Urdhrat e titullarit për ngritjen e grupit të punës me specialistë të fushës për krijimin e komisioneve të prokurimeve;
- Planifikimi buxhetor i prokurimeve;
- Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim sipas analizës së riskut;
- DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;
- Dosjet fizike të OE të shpallur fitues;
- Urdhër pagesat e vlerave të kontratave të lidhura.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet:

Viti 2021

Referuar udhëzimit nr. 04 datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, pika 6 citohet: “Organet e pushtetit vendor, apo çdo autoritet/ent kontraktor tjetër jo buxhetor përgatisin regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik bazuar në programet e zhvillimit ekonomik dhe në çdo rast jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të buxhetit apo programet e zhvillimit ekonomik nga këshillat vendorë ose nga organet drejtuese përkatëse.

Nga sistemi dhe dokumentet fizikë nuk evidentohet gjurma e auditimit për të verifikuar datën e përgatitjes së regjistrit të parashikimeve, nëse është në përputhje me nenin e sipër përmendur. Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera për realizimin e procedurave të prokurimeve blerje me vlerë të vogël gjatë vitit 2021 ka nxjerrë Urdhër të Brendshëm nr. 15 prot., datë 05.01.2021, “Për krijimin e komisionit të prokurimeve për blerjet me vlerë të vogël”, të përbërë nga: znj. O.Ç në cilësinë e kryetarit, z. M.K dhe znj. V.S në cilësinë e anëtarëve. Me urdhrin nr. 15/2 prot., datë 13.09.2021 është ndryshuar komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, larguar anëtari z. M.K, shtuar anëtari z. E.S.

Përputhshmëria ligjore në realizimin e prokurimit të fondeve nga Autoriteti Kontraktor për periudhën 01.01.2021 deri në 31.12.2021.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor (këtu e në vazhdim AK), AMGKP, për periudhën Janar-Dhjetor 2021 janë parashikuar 18 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 4,669,995 lekë nga të cilat 13 janë Blerje me vlerë të vogël me vlerë të fondit limit 4,324,996 lekë dhe janë realizuar 9 procedura prokurimi, me fond limit 3,324,997 lekë. Gjithashtu janë parashikuar 5 procedura blerje me vlerë nën 100,000 lekë me fond limit 344,999 lekë, nga të cilat janë realizuar 3 me fond limit 223,333 lekë. Realizimi rezulton sa 66.6% e numrit të procedurave të parashikuara. AMGKP nuk ka realizuar 6 procedura me vlerë të planifikuar të fondit limit 1,121,665 lekë apo 24% të numrit të procedurave të parashikuara, çka tregon mangësi në procesin e parashikimit.

Tabela nr. 1-Planifikimi dhe realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2021 në lekë

Nr.	Lloji i procedurës	Parashikimi		Realizimi		Vlera e kontratës	% e realizimit në numër
		Numri	Vlera (lekë)	Numri	Fondi Limit (lekë)		
1	Blerje me Vlerë të Vogël	13	4,324,996	9	3,324,997	2,467,050	69.2%
2	Blerje nën vlerën 100,000 Lekë	5	344,999	3	223,333	210,251	60%

Burimi: Regjistri i Parashikimit dhe Realizimit për AMGKP, vënë në dispozicion nga AMGKP

Nga 12 procedura të realizuara janë përzgjedhur për auditim 2 procedura, që zënë 35.2% të totalit si fond limit. Përkatesisht procedura e prokurimit “Blerje Pajisje Elektronike” me fond limit 630,000 lekë dhe procedura “Shërbime për riparimin e automjeteve” me fond limit 583,333 lekë.

Nga auditimi i procedurave të mësipërme u konstatua se:

- Dosjet e procedurave të prokurimit nuk janë të arkivuara, inventarizuara dhe numerizuara me numër fletësh, veprim i cili është në kundërshtim me nenin 30 “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.
- Në dosje nuk ka procesverbal për llogaritjen e fondit limit;
- Nuk është kërkuar deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore;
- Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;
- Për procedurën “Blerje Pajisje Elektronike” në dosje nuk administrohet formulari i ofertës nga OE shpallur fitues;

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 1 të nenit 16, pikën 1 në nenin 27, pika 2 në nenin 57, pika 1 në nenin 59 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar; Pikën 5 të Udhëzimit nr. 3 datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.
Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje: znj. O.Ç, z. M.K dhe znj. V.S.

Viti 2022

AMGKP për realizimin e procedurave të prokurimeve blerje me vlerë të vogël gjatë vitit 2022 ka nxjerrë Urdhër të Brendshëm nr. 128 prot., datë 20.01.2022, “Për krijimin e komisionit të prokurimeve për blerjet me vlerë të vogël”, të përbërë nga: z. D.K në cilësinë e kryetarit, z. E.S dhe znj. V.S në cilësinë e anëtarëve. Me urdhrin nr. 128/3 prot., datë 29.04.2022 është ndryshuar komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, larguar kryetari z. D.K, shtuar z. A.Ç.

Tabela nr. 2-Planifikimi dhe realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2022 në lekë

Nr.	Lloji i procedurës	Parashikimi		Realizimi		Fondi limit
		Numri	Vlera	Numri	Vlera e kontratës	
1	Blerje e hapur e thjeshtuar	5	10,416,666	3	5,866,504	6,666,666
2	Blerje e Vogël	17	5,493,598.2	8	2,044,399	3,626,932
3	Blerje me Vlerë nën 100,000 Lekë	4	283,333.33	3	137,483	208,333
4	Totali	26	16,193,597.53	14	8,048,386	10,501,931

Burimi: Regjistri i Parashikimit dhe Realizimit për AMGKP, vënë në dispozicion nga AMGKP

Për vitin 2022 janë realizuar 14 procedura prokurimi, nga të cilat 8 procedura blerje e vogël me vlerë të kontratës 2,044,399 lekë; 3 procedura blerje me vlerë nën 100,000 lekë me vlerë të kontratës 137,483 lekë dhe 3 procedura të hapura të thjeshtuara me vlerë të kontratës 5,866,504 lekë. Realizimi rezulton sa 53.8% e numrit të procedurave të parashikuara. AMGKP nuk ka realizuar 12 procedura ose 46.2% të numrit të prokurimeve të parashikuara, çka tregon mangësi në procesin e parashikimit, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu II, neni 3, pika 2, ku përcaktohet se:

“Regjistri i parashikimeve duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimit në kohë të procedurave të prokurimit publik.”

Nga 14 procedura të realizuara janë përzgjedhur 3 procedura, që zënë 72.89% të totalit të vlerës së kontratës të realizuar. Përkatësisht procedura “Blerje Pajisje Zyre” me fond limit 3,750,000 lekë, procedura “Lyerje dhe punime të brendshme gipsi” me fond limit 1,250,000 lekë dhe procedura “FV Kondicionere” me fond limit 1,666,666 lekë.

-Procedura e prokurimit “Blerje Pajisje Zyre”

Referuar dosjes së procedurës së prokurimit u konstatua se është e arkivuar, inventarizuar por nuk është numerizuar me numër fletësh, veprim i cili është në kundërshtim me nenin 30 “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se:

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

Ndërsa argumentimi i fondit limit, hartimi i kriterëve të përgjithshme dhe specifike, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratës rezultojnë në përputhje me VKM-në nr. 285/2021.

- Procedurat e prokurimit “Lyerje dhe punime të brendshme gipsi” dhe “FV Kondicionerë”

Dosjet e procedurave të prokurimit janë të arkivuara, inventarizuara por nuk janë numerizuar me numër fletësh, veprim i cili është në kundërshtim me nenin 30 “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

Argumentimi i fondit limit

Me urdhrin me shkresën nr. 2628/1 prot., datë 05.07.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike-termat e referencës dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës “Lyerje dhe punime të brendshme gipsi”. Komisioni përbëhet nga znj. O.S, znj. E.Z dhe z. F.M. Me shkresën nr. 2756/1 datë 20.07.2022 është urdhri për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike-termave të referencës dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës “FV Kondicionerë” e përbërë nga z. B.V, zj. A.Xh dhe znj. Xh.K.

Përcaktimi i kriterëve kualifikuese: Për të dyja procedurat kriteret e kapacitetit financiar dhe teknik profesional janë përcaktuar në tejkallim të përcaktimeve ligjore.

-Kapaciteti financiar: Xhiro vjetore për të paktën tre nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë jo më e vogël se 40%. Kopje të çertifikuara të bilanceve për tre vitet. Ky kriter rezulton në kundërshtim me pikën 2, germa c të nenit 43 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 ku citohet: “2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

-Kapaciteti teknik profesional: Dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. OE duhet të dorëzojë vërtetime/fatura për përvojën e mëparshme me sektorin publik dhe fatura për përvojat me sektorin privat. Ky kriter rezulton në kundërshtim me pikën 3 të nenit 41 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik” ku citohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

Për argumentimin e fondit limit, vlerësimin e ofertave dhe zbatimin e kontratës nuk u konstatuan problematika.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike në përbërje, znj. O.S, znj. E.Z dhe z. F.M për procedurën “Lyerje dhe punime të brendshme gipsi”. Dhe grupi i punës znj. B.V, znj. A.Xh dhe znj. Xh.K për procedurën “FV Kondicionerë” Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3 të nenit 41 dhe germës c pikës 2, të nenit 43 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021.

Viti 2023

AMGKP për realizimin e procedurave të prokurimeve me blerje me vlerë të vogël gjatë vitit 2023 ka nxjerrë Urdhër të Brendshëm nr. 143 prot., datë 13.01.2023, “Për krijimin e komisionit të prokurimeve për blerjet me vlerë të vogël”, të përbërë nga: z. A.Ç në cilësinë e kryetarit, z. E.S në cilësinë e anëtarit dhe znj. V.S në cilësinë e anëtarit. Me urdhrin nr. 143/1 prot., datë 19.12.2023 është ndryshuar komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, larguar kryetari z. A.Ç, shtuar z. M.K.

Tabela nr. 3- Planifikimi dhe realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2023 në lekë

Nr.	Lloji i procedurës	Parashikimi		Realizimi		Fondi limit
		Numri	Vlera (lekë)	Numri	Vlera (lekë)	
1	Blerje e Vogël	12	4,099,999	11	2,370,854	3,933,332
2	Blerje me Vlerë nën 100,000 Lekë	3	258,333	3	194,761.33	258,330
	Totali	15	4,358,332	14	2,565,615.33	4,191,662

Burimi: Regjistri i Parashikimit dhe Realizimit për AMGKP, vënë në dispozicion nga AMGKP

Për vitin 2023 janë realizuar 14 procedura prokurimi, nga të cilat 11 procedura blerje e vogël me fond limit 3,933,332 lekë, 3 procedura blerje me vlerë nën 100,000 lekë me fond limit 258,330 lekë. Realizimi rezulton sa 93.3% e numrit të procedurave të parashikuara. AMGKP nuk ka realizuar 1 procedurë prokurimi.

Nga 14 procedura janë përzgjedhur 2 procedura, që zënë 33.7% të totalit të vlerës së kontratës së realizuar. Përkatësisht procedura “Shërbim mirëmbajtje pajisje elektronike dhe zyrave” me fond limit 583,333 lekë dhe procedura “Kancelari + Tонера” me fond limit 500,000 lekë.

Nga procedurat e audituara rezultoi se dosjet e procedurave nuk janë të arkivuara, inventarizuara dhe numerizuara me numër fletësh, veprim i cili është në kundërshtim me nenin 30 “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

Gjithashtu sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se:

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

Lidhur me argumentimin e fondit limit, vlerësimin të ofertave dhe zbatimin të kontratës nuk u konstatuan problematika.

Përsa trajtuar më sipër nga përfaqësuesit e subjektit, znj. R.Xh në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm aktual të AMGKP-së, deleguar në muajin prill 2024 (konceptuar nga znj. Xh.K në cilësinë e Arkivistës në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, znj. V.S në cilësinë e specialistes së Sektorit të Financës dhe Buxhetit, znj. A.Xh në cilësinë e specialistes në Sektorin e Ndjekjes së Procedurave të Ekzekutimit Përmbarimor, znj. E.Z në cilësinë e Përgjegjëses së Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Skemave të veçanta të Garancisë, znj. A.H në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, znj. K.T në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Financës dhe Buxhetit), është paraqitur observacion me shkresën nr. 2041/2 prot., datë 01.07.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 185/11 datë 03.07.2024.

Pretendimi i subjektit: Mosdokumentimi i fondit limit në të dy rastet dhe mungesa në dosje e formularit të ofertës për procedurën “Blerje pajisje Elektronike” nuk ka ndikuar në

pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit nga të gjithë operatorët ekonomikë si edhe në përzgjedhjen e operatorit ekonomik fitues. Përsa i përket formularit të ofertës i cili mungon në dosje, theksojmë se fatura nr. 8/2021, datë 17.02.2021 është realizuar bazuar në zërat e formularit të ofertës. Gjithashtu nuk është tejkaluar fondi i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës për këto dy zëra. Njëkohësisht për të dyja procedurat e blerjeve nuk ka patur ankimime nga asnjë operator ekonomik pjesëmarrës, pra nuk ka cënuar transparencën e zhvillimit të një procedurë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit, si dhe nuk i ka shkaktuar asnjë dëm ekonomik institucionit.

Për procedurat e prokurimit “Lyerje dhe punime të brendshme gipsi” dhe “FV Kondicionerë”- Gjatë hartimit dhe shqyrtimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të kapacitetit teknik, është bërë lapsus në caktimin e “më e vogël se, apo më e madhe se 40% e vlerës së fondit limit”, lapsus i cili pas verifikimit të detajuar të dosjes është vënë re se nuk ka patur ndikim në përzgjedhjen e ofertuesve apo skualifikimin e tyre, procedura ka vazhduar dhe është mbyllur pa problematika. Pas verifikimit të vazhdimësisë së procedurës është vënë re që operatori ekonomik i shpallur fitues është operatori i parë pjesëmarrës në procedurë, nga ky fakt rezulton se kriteret dhe specifikimet e vendosura nuk kanë ndikuar në vijueshmërinë e procedurës e për rrjedhojë nuk është bërë kusht për pengim në pjesëmarrjen dhe shpalljen fitues të operatorëve të tjerë. Nga verifikimet dhe llogaritjet e bëra të dokumenteve të dorëzuara nga Operatori Ekonomik Fitues, konstatohet se ky kriter i sipërpërmendur është brenda kufijve të parashikuara nga VKM 285, datë 19.05.2021. Ky kriter i cili është vendosur gabimisht ndikuar nga lapsusi i bërë nuk ka krijuar pabarazi apo diskriminim mes operatorëve, si dhe nuk ka patur ndikim në pjesëmarrjen në procedurë të operatorëve ekonomik ofertues. Për këtë procedurë nuk është bërë asnjë ankimim nga asnjë operator pjesëmarrës, pra dhe pse në parim duket si një kriter pengues, asnjë nga operatorët ekonomik nuk është ndikuar nga ky kriter duke mos marrë pjesë në procedurë.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura nga subjekti i audituar, sqarojmë se këto argumenta janë parashtruar edhe pas lënies së akt konstatimeve. Argumentat e sjella nuk ndryshojnë konstatimin e grupit të auditimit për parregullsi procedurale lidhur me mungesën e dokumentacionit përkatës apo vendosjen e kriterëve dhe specifikimeve teknike në tejkallim të përcaktimeve të VKM-së 285 datë 19.05.2021. Observacioni nuk paraqet fakte dhe prova të reja, për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

2.6 Përgatitja e pasqyrave financiare, miratimi dhe raportimi në organin drejtues.

a. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Struktura e llogarive është hartuar bazuar në ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, si dhe në zbatim të Standarteve Ndërkombëtare e Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara dhe të përshtatura më legjislacionin që ushtron veprimtarinë AMGKP.

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës).

Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të AMGKP, rezulton se nga ana e Sektorit të Financës bëhet përgatitja e tyre dhe më pas dërgohen për miratim në Organin Drejtues të Institucionit, i cili është “Këshilli Mbikëqyrës”.

Për vitin 2021, pasqyrat e hartuara nga ana e Sektorit të Financës në AMGKP dhe të firmosura nga z. E.LI në funksionin e Përgjegjës të Sektorit të Financës si dhe nga Drejtori i

Përgjithshëm z. E.K, rezulton të jenë hartuar në datën 20.04.2021, jashtë afatit kohor, veprime këto në kundërshtim me ligjin 25/2018 datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Gjithashtu në lidhje me miratimin e tyre nga Këshilli Mbikëqyrës, rezulton se Relacioni "Mbi analizën e treguesve ekonomiko-financiare të bilancit kontabël të ish ATK-së" për vitin 2021 i janë dërguar Këshillit Mbikëqyrës me shkresën nr. 1152, datë 30.03.2022.

Për vitin 2022, pasqyrat e hartuara nga ana e Sektorit të Financës në AMGKP dhe të firmosura nga zj. K.T në funksionin e Përgjegjës të Sektorit të Financës si dhe nga zv. Drejtori i Përgjithshëm z. M.M dhe Drejtori i Përgjithshëm z. E.K.

Gjithashtu në lidhje me miratimin e tyre nga Këshilli Mbikëqyrës, rezulton se Relacioni "Mbi analizën e treguesve ekonomiko-financiare të bilancit kontabël të ish ATK-së" për vitin 2022 i janë dërguar Këshillit Mbikëqyrës me shkresën nr. 2313, datë 30.03.2023.

Për vitin 2023, rezulton se Pasqyrat Financiare janë hartuar draft por nuk janë dërguar dhe miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës si edhe të jenë audituar nga ekspertë kontabël të licencuar, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8894, datë 24.04.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", neni nr.14, pika nr.1 ku përcaktohet se "Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë është përgjegjës për drejtimin e Agjencisë dhe përgjigjet para Këshillit të Ministrave" dhe pika nr.2, germa "e", ku përcaktohet se: "Siguron që llogaritë financiare të Agjencisë të kontrollohen jo më pak se 1 herë në vit nga një ekspert kontabël i licencuar. Siguron gjithashtu që kontrollat të kryhen në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të kontroll-revizionit."

Pasqyrat Financiare (AMGKP)

Bilanci Kontabël AMGKP (në lekë)

Nr	AKTIVET	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
	Aktivët Afatshkurtra			
	➤ Aktivët Monetare	20,300,766	37,689,738	(17,388,972)
	1.Banka	20,300,766	37,689,738	(17,388,972)
	2.Arka			
	➤ Investimet			
	1.Në tituj pronësie të njesive ekonomike brenda grupit			
	2.Aksionet e veta			
	3.Të tjera financiare			
	➤ Të drejta të arkëtueshme	117,625,428	119,175,790	(1,550,362)
	1.Debitorë për shpenzime gjyqi	117,172,654	119,175,790	(2,003,136)
	2.Debitorë të tjerë	67,301		67,301
	3.Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
	4.Siguracion i kontratës së qerasë	385,473		385,473
	5.Kapital i nënshkruar i papaguar			
	➤ Inventarët	4,676,757	16,199,826	(11,523,069)
	1.Rezerva materiale (inventar)	4,676,757	16,199,826	(11,523,069)
	2.Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte			
	3.Produkte të gatshme			
	4.Mallra			
	5.Aktive biologjike (gjë e gjallë)			
	6.AAGJM të mbajtura për shitje			
	7.Parapagime për inventar			
	➤ Shpenzime të shtyra			
	➤ Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara			
I	TOTALI I AKTIVEVE AFATSHKURTRA	142,602,951	173,065,354	(30,462,403)
	Aktivët Afatgjata			
	➤ Aktive financiare	132,947,199	143,009,699	(10,062,500)
	1.Aktive të mbajtura për shitje	132,947,199	143,009,699	(10,062,500)
	2.Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit			
	3.Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
	4.Tituj të huadhënies një njësitë eko. ku ka interesa pjesëmarrëse			
	5.Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata			
	6.Tituj të tjerë të huadhënies			
	➤ Aktivët Materiale	30,818,339	36,719,230	(5,900,891)
	1.Ndërtesa	22,891,705	31,867,934	(8,976,229)
	2.Makineri, pajisje			
	3.Mjete transporti	1,379,350	1,586,102	(206,752)

	4. Inventar ekonomik	5,539,902	495,616	5,044,286
	5. Pajisje informatike dhe softëare	1,007,382	2,769,578	(1,762,196)
	> Aktivet Biologjike			
	> Aktivet jo material	1,596,084	134,331	1,461,753
	1. Mjete të pa trupëzuara që përdoren për veprimtari	1,596,084	134,331	1,461,753
	2. Emri i Mirë			
	3. Projekte për investime			
	> Aktive tatimore të shtyra			
	> Kapitali i nënshkruar i papaguar			
II	TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA	32,414,423	36,853,561	(4,439,138)
	AKTIVET TOTALE	307,964,573	352,928,614	(44,964,041)
Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	Viti 2022	Viti 2021	
	> Detyrimet afatshkurtra			
	1. Titujt e huamarrjes			
	2. Detyrime ndaj KFË	230,057,286	218,484,013	11,573,273
	3. Arkëtime në avancë për porosi			
	4. Të pagueshme ndaj furnitorëve	572,411	100,604	471,807
	5. Të pagueshme ndaj punonjësve për (dieta)			
	6. Të pagueshme për buxhetin e ATK-së sipas ligjit			
	7. Të pagueshme të tjera			
	8. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shend	576,126	764,024	(187,898)
	9. Të pagueshme për detyrimet tatimore	186,932	166,335	20,597
	10. Të tjera të pagueshme për derdhje në Buxhet			
	> Të pagueshme për shpenzime të konstatuara			
	> Të ardhura të shtyra			
	Të ardhura të shtyra			
	> Provizione			
I	TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKUTRA	231,392,755	219,514,976	11,877,779
	> Detyrimet Afatgjata			
	1. Titujt e huamarrjes			
	2. Detyrime ndaj Institucioneve të kredisë			
	3. Arkëtimet në avancë për porosi			
	4. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit			
	5. Të tjera të pagueshme			
	> Të pagueshme për shpenzime të konstatuara			
	> Të ardhura të shtyra			
	> Provizione			
	1. Provizione për pensionet			
	2. Provizione të tjera			
	> Detyrime tatimore të shtyra			
II	TOTALI I DETYRIMEVE AFATGJATA			
III	DETYRIMET TOTALE	231,392,755	219,514,976	11,877,779
	> Kapitali i paguar	125,966,043	133,413,638	(7,447,595)
	> Kapitali i Nënshkruar			
	> Primi i lidhur me kapitalin			
	> Rezerva rivlerësimi			
	> Rezerva të tjera			
	1. Rezerva ligjore			
	2. Rezerva statutoare			
	3. Rezerva të tjera			
	> Fitimi i pashpërndarë	(49,394,225)		(49,394,225)
	> Fitim/Humbja e Vitit			
IV	TOTALI I KAPITALIT	76,571,818	133,413,638	(56,841,820)
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	307,964,573	352,928,614	(44,964,041)

Burimi: AMGKP

AKTIVET

Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Kjo llogari përfshin llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, për vitin 2022 llogaria “Bankat” paraqitet në shumën 20,300,766 lekë, ku krahasuar me vitin ushtrimor 2021 e cila paraqitet në shumën 37,689,738 lekë, ka ardhur në rënie në shumën (17,388,972) lekë.

Analitiku i llogarisë “Bankat”

Banka	Në lekë	Në Euro	Kursi	Shuma lekë	Në USD	Kursi	Shuma lekë	Totali në lekë
BKT	2,981,188	27,891	114.23	3,185,988	20,057	107.5	2,147,123	8,314,300
RFZ Bank	5,615,418	13,392	114.23	1,529,853	22,319	107.5	2,389,315	9,534,587
I Sa	1,258,486	-	-	-	-	-	-	1,258,486
T B	1,179,351	55	114.23	6,364	71	107.5	7,675	1,193,392
Totali	11,034,444	41,339		4,722,207	42,448		4,544,114	20,300,766

Burimi: AMGKP

Llogaria “Banka”, u kryqëzua me të dhënat e paraqitura në Pasqyrën e Fluksit të Mjeteve Monetare, ku në fund të periudhës ushtrimore mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre paraqitet në shumën 20,300,766 lekë, shumë e cila rakordon me Analitikun e Bankës.

Të drejta të arkëtueshme

Llogaria *“Debitorë për shpenzime gjyqi”*, në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 117,172,654 lekë, ku krahasuar me periudhën ushtrimore 2021 e cila paraqitet në shumën 119,175,790 lekë, ka ardhur në rënie në shumën (2,003,136) lekë.

Sipas informacionit të marrë nga AMGKP, kjo shumë përbëhet nga shpenzimet për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit, shpenzime për tarifa vlerësimi të pronave, tarifa për plane rilevimi, tarifa për përfaqësues ligjor dhe pagesa të tjera që bëhen për debitorët. Sipas AMGKP, këto shpenzime të kryera për debitorët pasqyrohen te sistemi i kreditit bashkë me principalin dhe interesat, dhe pasi bëhen njoftimet për debitorët në lidhje me detyrimin që ata i kanë Institucionit, ju bëhet me dije edhe shuma e shpenzimeve të pafalshme që kanë për të paguar. Gjithashtu principalin dhe interesat ndryshe nga shpenzimet gjyqësore për debitorët, ato *nuk pasqyrohen në kontabilitet* tek *“të drejtat e arkëtueshme”*, por mbahen jashtë kontabilitetit në një pasqyrë të veçantë *“Pasqyra e llogarive jashtë Bilancit”*.

Konstatim:

Nga auditimi i kryer nga Grupi i Auditimit, në lidhje me klasën e llogarive *“të drejta të arkëtueshme”*, rezulton se ato nuk paraqiten në mënyrë analitike, ku të jenë specifikuar të gjithë debitorët mbi të cilët ka lindur detyrimi ndaj AMGKP-së, si dhe të jenë të përshkruar në mënyrë të detajuar, principalin i detyrimit, interesat e akumuluar përgjatë viteve si edhe çdo shpenzim tjetër të kryer nga Institucioni për mbledhjen e këtyre detyrimeve që i shtohen vlerës së detyrimit në total (principal + interesa), për rrjedhojë paraqitja e të drejtave të arkëtueshme në kontabilitet *është jo i plotë dhe nuk përmbush pohimet e “saktësisë”, “plotësisë”, “klasifikimit dhe identifikimit”*, veprime në kundërshtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Gjithashtu nga auditimi rezulton se, për këto të drejta të arkëtueshme, nga ana e AMGKP, nuk është vepruar me njohjen fillimisht me vlerën e drejtë të *“të drejtave të arkëtueshme”* dhe më pas me koston e amortizuar të tyre duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi, ku provigjoni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna objektive se AMGKP, nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet, si edhe vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose hapja e çështjeve gjyqësore në ngarkim të klientit konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme duhet të zhvlerësohen. Shuma e provigjontit llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël (neto) të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Veprime në kundërshtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Llogaria *“Siguracion i kontratë së qerasë”*, në fund të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në shumën 385,473 lekë, e cila përbën pagesën e qerasë mujore për siguracion kontrate “ambientet e marra me qera” kundrejt shoqërisë “D...P.....”, në vlerën 3,300 euro e cila e konvertuar në lekë është 385,473 lekë.

Inventarët

Llogari *“Rezerva Materiale, (Inventar)”*, në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 4,676,757 lekë, ku krahasuar me vitin 2021 që ka qenë në shumën 16,199,826 lekë, ka ardhur në rënie në shumën (11,523,069) lekë. Ky pakësim nga viti 2021 në vitin 2022, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se ka ardhur si pasojë e keqklasifikimit që Sektori i Financës ka kryer gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare 2021, ku ka klasifikuar aktive afatgjata si pjesë të inventarit, si edhe pas rekomandimeve të audituesve të pavarur, gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2022, Sektori i Financës ka kryer riklasifikimin e këtyre aktiveve duke i kaluar në klasën e llogarive aktive afatgjata materiale në vlerën kontabël 11,523,069 lekë.

Aktivet Financiare

Llogaria “*Aktive të mbajtura për shitje*”, në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 132,947,199 lekë, ku krahasuar me periudhën e vitit ushtrimor 2021 ku kjo llogari është në shumën 143,009,699 lekë, ka ardhur në rënie në shumën (10,062,500) lekë.

Analitiku i llogarisë Aktive të mbajtura për shitje

Emërtimi	Të dhënat e pasurisë së paluajtshme	Viti 2021	Shtesa	Pakësime	Viti 2022
H.T	Sip.784m ² (truall+ndert.K.3 mag.)	2,167,975			2,167,975
T.A	Shtepi +truall+pemtore	696,000			696,000
A.A	Truall;Ndert(200m ² ;80 m ²)	2,400,000			2,400,000
B.G	Toke are 5038m ²	1,289,728			1,289,728
B.G	Toke are 1200m ²	230,400			230,400
B.G	Toke are 2000m ²	224,000			224,000
B.G	Ullishte 1400m ²	153,600			153,600
B.G	Ullishte 1750m ²	192,000			192,000
Sh.H	Zdrukhtari + Trualli	3,396,000			3,396,000
I.M	Shtepi Sukth	600,000			600,000
Xh.L	Apartament	1,785,000			1,785,000
Sh.K	Toke are 11000m ²	16,000,000			16,000,000
G.B	Toke are 1000m ²	2,300,000			2,300,000
B.K	Ndertese (600 m ²)	5,068,800			5,068,800
B.K	Ndertese (628 m ²)	5,069,800			5,069,800
S.G	Magazine "Qeret"	951,746			951,746
K.G	Shtepi Oblik	897,259			897,259
N.Gj	Shtepi banimi	571,360			571,360
V.P	Shtepi banimi+are+truall	1,200,000			1,200,000
Sh.B	Shtepi banimi	560,000			560,000
B.O	Apartament	900,900			900,900
H.H	Shtepi 108m ² + 80m ² oborr	1,500,000			1,500,000
F.D	Shtepi "Gur i zi"	700,000			700,000
R.P	Toke are "Fushe Preze"(7800 m ²)	808,654			808,654
Xh.S	Shtepi Ibe	960,320			960,320
S.Sh	Shtepi Berzhite	900,000			900,000
A.Q	Shtepi Krabe	630,320			630,320
M.B	Shtepi Shengjergj	280,000			280,000
A.K	Ish-punishte pasta sip.234m ²	4,480,000			4,480,000
F.C	Furre Buke "Tragjas"	942,555			942,555
N.K	Ndertese + truall "Vodice"	124,445			124,445
N.B	Banese 3+1 "Llakatund"	133,699			133,699
J.P	Depo sip.73.5m ² L."28 Nentori" VL	2,632,720			2,632,720
T.M	Apartament sip. 31 m ²	704,000			704,000
Q.S	Are sip.1970 m ² , Gajde	832,000			832,000
Q.S	Are sip.500 m ² , Gajde	256,000			256,000
I.M	Ndertese 99 m ²	1,389,000			1,389,000
A.B	Magazine sip.131 m ²	1,280,000			1,280,000
M.N	Truall sip.250m ² +ndertes80m ²	1,233,027			1,233,027
H.K	Toke are 1000m ² (BKT KJ €)	2,496,000			2,496,000
H.K	Toke are 500m ² (BKT KJ €)	1,248,000			1,248,000
N.A	Ullishte sip 1114 m ² \$	425,355			425,355
F.GJ	Toke are sip 1700 m ² \$	527,620			527,620
F.GJ	Toke are sip 2157 m ² \$	669,455			669,455
F.GJ	Toke are sip 3200 m ² \$	297,949			297,949
F.GJ	Toke are sip 1200 m ² \$	372,437			372,437
F.GJ	Toke are sip 1200 m ² \$	111,732			111,732
F.GJ	Toke are sip 1000 m ² \$	93,109			93,109
F.GJ	Toke are sip 500 m ² \$	46,555			46,555
F.GJ	Toke are sip 200 m ² \$	24,829			24,829
B.S	Toke are sip 3900 m ² Euro	852,641			852,641
L.K	Truall 108 m ² Euro	1,427,247			1,427,247
N.M	Truall + ndertese 300 m ² \$	873,795			873,795
A.P	Toke are 2828 m ² Euro	1,555,450			1,555,450
H.H	Toke are 3273 m ² truall 300 m ²	1,083,320			1,083,320
Xh.M	Ndertese 81 m ²	788,115			788,115
N.P	Njesi tregtare 332.9 m ²	17,491,200			17,491,200
A.K	Truall sip.3143,4 m ²	6,720,000			6,720,000
D.M	Punishte Frutash 734 m ²	4,480,000			4,480,000
E.H	Apartamet sip.46 m ² Corovode	576,000			576,000
A.K	Ndertese 119.86m ²	879,495			879,495
Q.M	Toke are 7210m ² (FierShegan)	2,210,031			2,210,031
A.A	Ndertese sip. 70 m ²	448,000			448,000
A.D	Truall+Ndert. sip. 250 m ²	1,568,231			1,568,231
D.B	Toke are 1250 m ²	257,600			257,600
ZA	Ndertese Sip 70 m ²	448,000			448,000
S.N	Are 690m ² +Truall 300 m ² +Nd 120 m ²	344,563			344,563

A.Z	Ndertese 76 m2	2,560,000			2,560,000
K.B	Toke are sip 1910 m2	1,283,520			1,283,520
B.O	Ndertese sip 200 m2	320,000			320,000
B.O	Punishte 655 m2	768,000			768,000
P.Gj	Toke are sip 875 m2	348,600			348,600
B.B	Truall sip 300 m2 (BKT EUR)	1,354,938			1,354,938
N.A	Truall 1930.5 m2	2,248,646			2,248,646
Q.M	Toke are 8400 m2	1,408,000			1,408,000
Q.M	Toke are 1200m ²	192,000			192,000
L.I	Toke are	490,000			490,000
A.K	Baxho+Rep.pije alkol(164,8+145,1)m ²	3,562,500		3,562,500	-
G.K	Toke are 8620 m ² (Helmës)	6,500,000		6,500,000	-
Totali		135,794,240		10,062,500	125,731,740

Burimi: AMGKP

Referuar tabelës më sipër, kjo rënie ka ardhur si rezultat i kthimit të pronës të 2 (dy) debitorëve të cilët kanë shlyer detyrimin e tyre ndaj AMGKP, konkretisht kthim prone debitorit z. A.K në shumën 3,562,500 lekë dhe kthim prone z. G.K në shumën 6,500,000 lekë.

Sipas dokumentacioni të vënë në dispozicion nga Sektori i Financës në AMGKP, llogaria “aktive të mbajtur për shitje”, përbëhet nga pronat të mbajtura nga debitorët, për të cilat Institucioni ka të drejtën që për rekuperimin e detyrimit, të fillojë procedurat e shitjes me ankand.

Konstatim:

Nga auditimi i llogarisë “*aktive të mbajtura për shitje*”, rezulton se kjo llogari e paraqitur në klasën e aktiveve afatgjata financiare në pasqyrën e pozicionit financiar në analitikun e vënë në dispozicion nga Sektori i Financës, në 31.12.2022, ka të regjistruar 77 prona me vlerë kontabël 125,731,740 lekë, vlera e këtyre pronave nga viti në vit ka ngelur e pa ndryshuar, dhe në regjistrin analitik të paraqitur janë përshkruar vetëm emri dhe mbiemri i debitorit, lloji i pronës edhe vlera kontabël e regjistrimit.

Nga verifikimi i regjistrimit analitik rezulton se nuk është i paraqitur në mënyrë të detajuar ku përveç të dhënave të debitorit, të ishin të përshkruar lloji i pronës, sipërfaqja respektive, vendndodhja e pronës, statusi i regjistrimit në ASHK, etj. Gjithashtu bazuar në SNK dhe SKK, në klasën e aktiveve financiare nga ana e Institucionit duhej të kryhej vlerësimi i drejtë dhe real i vlerës së aktiveve duke përmbyshur pohimet e “saktësisë së vlerës”, “plotësisë” dhe “klasifikimit dhe identifikimit real”, ku të identifikohesh nëse aktivi financiar do të zhvlerësohej nëse ka të dhëna objektive se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi, zhvlerësimi i cili matur me koston e amortizimit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Për rrjedhojë nga ana e Institucionit nuk është kryer vlerësimi për të nxjerrë vlerën reale kontabël të aktiveve financiare, *Veprime në kundërshtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK)*.

Aktivitet Materiale

Pasqyrat e Aktiveve Afatgjata Materiale

Emërtimi	Vlera fillestare Gjendja në 01.01.2022	Shtesa	Pakësime	Vlera fillestare Gjendja në 31.12.2022
<i>Ndërtesa</i>	68,040,204	-	13,238,157	54,802,047
<i>Mjete Transporti</i>	8,793,000	-	-	8,793,000
<i>Inventar Ekonomik</i>	7,652,872	5,334,980	1,759,760	11,228,092
<i>Pajisje Informatike</i>	8,892,964	194,000	-	9,086,964
<i>Aktive të pa trupëzuara (sisteme informacioni)</i>	12,120,000	-	-	12,120,000
Totali (Vlera Fillestare)	105,499,040	5,528,980	14,997,917	96,030,103

Emërtimi	Amortizimi Akumuluar 01.01.2022	Amortizimi Vjetor	Pakësime Amortizimi	Amortizimi Akumuluar 31.12.2022
<i>Ndërtesa</i>	36,172,269	1,528,635	5,790,562	31,910,342
<i>Mjete Transporti</i>	7,206,900	206,750	-	7,413,650
<i>Inventar Ekonomik</i>	7,022,924	392,739	1,727,473	5,688,190
<i>Pajisje Informatike</i>	7,787,674	291,908	-	8,079,582

Aktive të pa trupëzuara (sisteme informacioni)	9,991,888	532,028	-	10,523,916
Totali (Amortizimi)	68,181,655	2,952,060	7,518,035	63,615,679

Emërtimi	Vlera Neto Gjendja në 01.01.2022	Vlera Neto Shtesa	Vlera Neto Pakësime	Vlera Neto Gjendje në 31.12.2022
<i>Ndërtesa</i>	31,867,935	(1,528,635)	7,447,595	22,891,705
<i>Mjete Transporti</i>	1,586,101	(206,750)	-	1,379,350
<i>Inventar Ekonomik</i>	629,948	4,942,241	32,287	5,539,902
<i>Pajisje Informatike</i>	1,105,290	(97,908)	-	1,007,382
Aktive të pa trupëzuara (sisteme informacioni)	2,128,112	(532,028)	-	1,596,084
Totali (Vlera Neto)	37,317,385	2,576,920	7,479,882	32,414,423

Burimi: AMGKP

-Llogaria “*Ndërtesa*”, në fund të vitit ushtrimor 2021, paraqitet me vlerë kontabël neto prej 31,867,935 lekë. Gjatë vitit ushtrimor 2022 kanë rezultuar pakësime të kësaj llogarie në shumën 13,238,157 lekë, e cila ka ardhur si rrjedhojë e zbatimit të VKM-së nr.49, datë 26.01.2022 si edhe Urdhrit të Drejtorit të ish ATK-së me nr.3964 prot., datë 19.10.2022, “Kalim pronësie për vlerën e mbetur të objektit pasuria nr.7/115, ZK.8270, tek Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”.

Ndërtesa e kaluar te AMF në vitin 2022, ka patur koston historike prej 13,238,157 lekë si edhe amortizimin e akumuluar ndër vite në vlerën (5,790,562) lekë, për rrjedhojë vlera kontabël neto e objektit paraqitet në shumën 7,447,595 lekë, vlerë e cila i është zbritur llogarisë “*Ndërtesa*” të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të AMGKP.

Gjithashtu pakësim të kësaj llogarie ka patur edhe si rezultat i amortizimit vjetor gjatë vitit 2022, ku vlera kontabël neto prej 31,867,935 lekë * amortizimin vjetor (5%) = 1,528,635 lekë.

-Llogaria “*Mjete Transporti*”, në fund të vitit ushtrimor 2021, paraqitet me vlerë kontabël neto prej 1,586,101 lekë. Kjo llogari nuk ka pësuar shtesa ose pakësime gjatë vitit 2022. Amortizimi vjetor është përlllogaritur vlera kontabël neto në çelje të vitit prej 1,586,101 lekë * amortizimin vjetor (20%) = 206,750 lekë.

-Llogaria “*Inventar Ekonomik*”, në fund të vitit ushtrimor 2021, paraqitet me vlerë kontabël neto prej 629,948 lekë. Gjatë vitit ushtrimor 2022 kanë rezultuar shtesa në shumën 5,334,980 lekë si edhe pakësime në shumën (1,759,760) lekë. Pakësimi i kësaj llogarie ka ardhur si rezultat i zbatimit të VKM-së nr.49, datë 26.01.2022 si edhe Urdhrit të Drejtorit të ish ATK-së me nr.3964 prot., datë 19.10.2022, “Kalim pronësie për vlerën e mbetur të objektit pasuria nr.7/115, ZK.8270, tek Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”.

Materialet me koston historike prej 1,759,760 lekë që janë bërë transferim, kanë patur edhe amortizim të akumuluar në vlerën 1,727,473 lekë, dhe vlera kontabël neto e tyre është në shumën 32,287 lekë.

Amortizimi i kësaj llogarie është kryer me normën prej 20% mbi vlerën kontabël neto, në shumën 392,739 lekë.

-Llogaria “*Pajisje Informatike*”, në fund të vitit ushtrimor 2021, paraqitet me vlerë kontabël neto prej 1,105,290 lekë. Gjatë vitit ushtrimor 2022 kanë rezultuar shtesa të kësaj llogarie në vlerën 194,000 lekë. Amortizimi i kësaj llogarie është kryer me normën prej 25% mbi vlerën kontabël neto, në shumën 392,739 lekë.

Llogaria e Aktiveve Afatgjata të patrupëzuara “*Sisteme Informacioni*”, në fund të vitit 2021 paraqitet me vlerë kontabël neto prej 2,128,112 lekë. Kjo llogari nuk patur shtesa ose pakësime gjatë vitit 2022. Llogaria përbëhet nga sistemi i kreditit të cilin përdor AMGKP, si edhe amortizimi i llogarisë është kryer me normë amortizimit 20% dhe vlerë amortizimi prej 532,028 lekë.

DETYRIMET

Detyrimet Afatshkurtra

Llogaria “*Detyrime ndaj KFŴ*”, në fund të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në shumën 230,057,286 lekë, ku në krahasim me vitin 2021 që paraqitet në shumën 218,484,013 lekë, ka ardhur në rritje në vlerën 11,573,273 lekë.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga AMGKP-ja, detyrime ndaj KFŴ përfaqësojnë borxhin e Institucionit sipas planit të pagesave të nënshkruar me Ministrinë e Financave ndaj KFŴ, ku në 31.12.2022 është në vlerën 2,013,983 Euro ose 230,057,286 lekë.

Lëvizjet e detyrimeve ndaj KFŴ gjatë vitit 2022

Periudha	Interes	Principal	Total
Gjendja 31.12.2021	32,451	1,776,789	1,809,241
Shtesat gjatë vitit 2022	35,527	437,213	472,741
Pagesa gjatë vitit 2022	50,625	217,374	268,000
Gjendja 31.12.2022	17,354	1,996,628	2,013,983
Dif. Gjendje 2022 – 2021			204,741

Burimi: AMGKP

Marrëveshjet e ish ATK-së me KFŴ

Nga ana e Grupit të Auditimit, i është kërkuar Institucionit të AMGKP-së, informacion i detajuar në lidhje me detyrimin e huasë që AMGKP ka ndaj KFŴ, ku të përcaktohen, marrëveshja e huasë, afatet, kushtet e pagesës dhe dokumentacione shtesë mbi këtë hua.

Nga ana e AMGKP, grupit i është vënë në dispozicion dokumentacioni si më poshtë:

-Shkresa me nr.1401 prot., datë 11.06.2002, nga ana e ATK-së drejtuar MFE-së, ku dërgohet informacion mbi marrëveshjet e huasë për kreditë me burime financimi të huaja të transferuara nga BKT-ja tek ATK-ja.

Informacion mbi marrëveshjen e huasë për kreditë me burime financimi të huaja për kreditë e transferuara nga Banka Kombëtare Tregtare (BKT) tek Agjensia e Trajtimit të Kredive (ATK), konkretisht për marrëveshjen e huasë Gjermane (KFŴ):

Marrëveshja e Parë

1.Data e nënshkrimit 11 Maj 1992 midis KFŴ dhe Bankës Shtetërore të Shqipërisë si huamarës.

2.Shuma e huasë së miratuar është 7,000,000 Deutsche Marke (këtu e në vijim DM) .

3.Objekti i huasë, ndihmë prodhimi (C....AID II), për importin e pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit për sektorin e bujqësisë private.

4.Kjo marrëveshje është lidhur mbi bazën e marrëveshjes midis Qeverisë të Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, datë 13.12.1991

5.Interesi i huasë është 0.75 % me bazë vjetore.

6.Shuma e interesit që duhet paguar për çdo 6-mujor deri në fillimi e pagesës të këstit të principalit është 26,250 DM

7.Likuidimi i detyrimit do të bëhet me 2 këste në vit (30 qershor deri 31 Dhjetor të përcaktuar 116,000 DM deri në 30 Qershor 2012, dhe nga 31 Dhjetor 2012 e deri në shlyerjen e fundit është përcaktuar 117,000 DM.

8.Pagesa e Këstit të Parë për principalin (7,000,000 DM) do të fillojë nga 31 Dhjetor 2002.

Marrëveshja e Dytë

1.Data e nënshkrimit 11 Maj 1992 midis KFŴ dhe Bankës Shtetërore të Shqipërisë si huamarës.

2.Shuma e huasë së miratuar është 5,000,000 DM.

3.Objekti i huasë, ndihmë për industrinë e lehtë (C....AID III), për importin e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse, si dhe pajisje për industrinë e lehtë.

4.Kjo marrëveshje është lidhur mbi bazën e marrëveshjes midis Qeverisë të Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, datë 13.12.1991

5.Interesi i huasë është 0.75 % me bazë vjetore.

6.Shuma e interesit që duhet paguar për çdo 6-mujor deri në fillimi e pagesës të këstit të principalit është 18,750 DM.

7.Likuidimi i detyrimit do të bëhet me 2 këste në vit (30 qershor dhe 31 Dhjetor të çdo viti). Shuma e një kësti për principalin është përcaktuar 83,000 DM.

8. Pagesa e Këstit të Parë për principalin (5,000,000 DM) do të fillojë nga 31 Dhjetor 2002.

Marrëveshja e Tretë

1. Data e nënshkrimit 9 Shkurt 1993 midis KFW dhe Bankës Shtetërore të Shqipërisë si huamarës.

2. Shuma e huasë së miratuar është 6,000,000 DM.

3. Objekti i huasë, ndihmë për prodhimi (C...AID IV), për importin e mjetve dhe pjesëve të këmbimit për sektorin e transportit dhe bujqësisë private.

4. Kjo marrëveshje është lidhur mbi bazën e marrëveshjes midis Qeverisë të Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, datë 03.01.1993

5. Interesi i huasë është 0.75 % me bazë vjetore.

6. Shuma e interesit që duhet paguar për çdo 6-mujor deri në fillimi e pagesës të këstit të principalit është 22,500 DM

7. Likuidimi i detyrimit do të bëhet me 2 këste në vit (30 qershor dhe 31 Dhjetor të çdo viti duke filluar nga viti 2003). Shuma e një kësti për principalin është përcaktuar 100,000 DM.

8. Pagesa e Këstit të Parë për principalin (7,000,000 DM) do të fillojë nga 30 Qershor 2003.

Marrëveshja e Katërt

1. Data e nënshkrimit 8 Shtator 1993 midis KFW dhe Bankës Shtetërore të Shqipërisë si huamarrës.

2. Shuma e huasë së miratuar është 8,000,000 DM.

3. Objekti i huasë, ndihmë prodhimi (C...AID IV), për importin e mjeteve, pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit për sektorin e bujqësisë private.

4. Kjo marrëveshje është lidhur mbi bazën e marrëveshjes midis Qeverisë të Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, datë 04.01.1993

5. Interesi i huasë është 0.75 % me bazë vjetore.

6. Shuma e interesit që duhet paguar për çdo 6-mujor deri në fillimi e pagesës të këstit të principalit është 30,000 DM.

7. Likuidimi i detyrimit do të bëhet me 2 këste në vit (30 qershor dhe 31 Dhjetor të çdo viti duke filluar nga viti 2003). Shuma e një kësti për principalin është përcaktuar 100,000 DM.

8. Pagesa e Këstit të Parë për principalin (7,000,000 DM) do të fillojë nga 30 Dhjetor 2003. Shuma e një kësti për principalin është 131,000 DM.

Për këto katër marrëveshje detyrimi i marrë nga Banka Kombëtare Tregtare si fonde të kredive të dhëna prej saj, është 22,656,160 DM. Sipas këtyre marrëveshjeve ky detyrim është për t'u likuiduar nga Agjencia e Trajtimit të Kredive ndaj Bankës së Shqipërisë në vitin 2003. Të gjitha likuidimet do të bëhen në DM (Deutsche Marke) të konvertuar në Euro.

Me shkresën nr.8924 prot., datë 24.12.2003, nga ana e MFE-së drejtuar ATK-së, i bëhet me dije se në lidhje me shlyerjen e detyrimeve për Marrëveshjet e kredive të financuara nga KFW-ja për projektet C.....Aid II, C..... Aid III, C..... Aid IV, ju sqarojmë se ATK-ja do të paguajë si më parë detyrimin ndaj KFW-së (interesat dhe principalin) sipas njoftimeve të Bankës së Shqipërisë, deri në shlyerjen e plotë të detyrimeve.

Për periudhën objekt auditimit detyrimi që ka ATK ndaj KFW-së, kryhet nëpërmjet rakordimeve me MFE-në, e cila i paraqet në regjistrin e garancive shtetërore për borxhin.

Korrespondencat për periudhën e auditimit (2021 – 2023) e AMGKP-së me MFE-në, për pagesat e detyrimit ndaj KFW-së.

Mbi rakordimin e detyrimeve për vitin 2020

-Me shkresën nr.166 prot., datë 07.01.2021, nga ana e MFE-së i është drejtuar ATK-së në lidhje me gjendjen e detyrimeve të ATK-së ndaj MFE-së në 31.12.2020 për kreditë e KFW, në shumën 1,501,168 Euro.

Tabelat e Rakordimit të detyrimeve të ATK ndaj MFE për kreditë e KFÛ për vitin 2020

Në Euro

Nr. i Kredisë	Kredia	Gjendja e Detyrimeve të ATK në 31.12.2019			Detyrime të vitit 2020					
		Interes	Principal	Total	6 – Mujori i Parë			6 Mujori i Dytë		
		Interes	Principal	Total	Interes	Principal	Total	Interes	Principal	Total
10	C.... AID II	11,889	221,913	233,802	5,608	59,821	65,429	5,383	59,821	65,205
11	C.... AID III	8,511	217,173	225,684	4,016	42,437	46,454	3,857	42,437	46,294
14	C.... AID IV	10,545	193,165	203,710	4,985	51,129	56,114	4,793	51,129	55,922
27	Sektor progr. Agricultural 1	14,407	389,781	404,189	6,838	64,963	71,802	6,594	64,963	71,558
Total		45,353	1,022,033	1,067,387	21,448	218,351	239,799	20,629	218,351	238,980

vazhdim tabele

Nr. i Kredisë	Kredia	Shlyer ATK gjatë vitit 2020			Gjendje e detyrimeve të ATK në 31.12.2020		
		Interes	Principal	Total	Interes	Principal	Total
10	C.... AID II	17,497	-	17,497	5,383	341,555	346,939
11	C.... AID III	12,527	-	12,527	3,857	302,048	305,905
14	C.... AID IV	14,974	-	14,974	5,349	295,423	300,772
27	Sektor progr. Agricultural 1	-	-	-	27,840	519,708	547,549
Total		45,000	-	45,000	42,432	1,458,736	1,501,168

Burimi: AMGKP

Për vitin 2020, ATK-ja në lidhje me detyrimet për marrëveshjet me KFÛ, ka paguar vetëm shumën prej 45,000 Euro.

Mbi rakordimin e detyrimeve për vitin 2021

-Me shkresën nr.903 prot, datë 18.01.2022, nga ana e MFE-së i është drejtuar ATK-së në lidhje me gjendjen e detyrimeve të ATK-së ndaj MFE-së në 31.12.2021 për kreditë e KFÛ, në shumën 1,809,241 Euro.

Tabelat e Rakordimit të detyrimeve të ATK ndaj MFE për kreditë e KFÛ për vitin 2021

Në Euro

Nr. i Kredisë	Kredia	Gjendja e Detyrimeve të ATK në 31.12.2020			Detyrime të vitit 2021					
		Interes	Principal	Total	6 – Mujori i Parë			6 Mujori i Dytë		
		Interes	Principal	Total	Interes	Principal	Total	Interes	Principal	Total
10	C.... AID II	5,383	341,555	346,939	5,159	59,821	64,980	4,935	59,821	64,756
11	C.... AID III	3,857	302,048	305,905	3,698	42,437	46,135	3,539	42,437	45,976
14	C.... AID IV	5,349	295,423	300,772	4,601	51,129	55,730	4,409	51,129	55,539
27	Sektor progr. Agricultural 1	27,840	519,708	547,549	6,351	64,963	71,314	6,107	64,963	71,071
Total		45,353	1,458,736	1,501,168	19,810	218,351	238,162	18,992	218,351	237,343

vazhdim tabele

Nr. i Kredisë	Kredia	Shlyer ATK gjatë vitit 2021			Gjendje e detyrimeve të ATK në 31.12.2021		
		Interes	Principal	Total	Interes	Principal	Total
10	C.... AID II	22,881	5,383	28,265	10,094	455,814	465,908
11	C.... AID III	16,385	3,857	20,243	7,237	338,064	345,302
14	C.... AID IV	20,323	758	21,082	9,011	396,923	405,935
27	Sektor progr. Agricultural 1	34,192	63,648	97,840	6,107	585,987	592,094
Total		93,783	73,648	167,432	32,451	1,776,789	1,809,241

Burimi: AMGKP

Për vitin 2021, ATK-ja në lidhje me detyrimet për marrëveshjet me KFÛ, ka paguar vetëm shumën prej 167,432 Euro.

Mbi rakordimin e detyrimeve për vitin 2022

-Me shkresën nr.1246 prot, datë 23.01.2023, nga ana e MFE-së i është drejtuar ATK-së në lidhje me gjendjen e detyrimeve të ATK-së ndaj MFE-së në 31.12.2022 për kreditë e KFÛ, në shumën 2,013,983 Euro.

Tabelat e Rakordimit të detyrimeve të ATK ndaj MFE për kreditë e KFÛ për vitin 2022

Në Euro

Nr. i Kredisë	Kredia	Gjendja e Detyrimeve të ATK në 31.12.2021			Detyrime të vitit 2022					
		Interes	Principal	Total	6 – Mujori i Parë			6 Mujori i Dytë		
		Interes	Principal	Total	Interes	Principal	Total	Interes	Principal	Total
10	C.... AID II	10,094	455,814	465,908	4,710	59,821	64,532	4,486	59,821	64,307
11	C.... AID III	7,237	338,064	345,302	3,380	42,437	45,817	3,221	42,948	46,169
14	C.... AID IV	9,011	396,923	405,935	4,218	51,129	55,347	4,026	51,129	55,155
27	Sektor progr. Agricultural 1	6,107	585,987	592,094	5,863	64,963	70,827	5,620	64,963	70,583
Total		32,451	1,776,789	1,809,241	18,173	218,351	236,524	17,334	218,862	236,216

vazhdim table

Nr. i Kredisë	Kredia	Shlyer ATK gjatë vitit 2022			Gjendje e detyrimeve të ATK në 31.12.2022		
		Interes	Principal	Total	Interes	Principal	Total
10	C.... AID II	14,805	75,905	90,710	4,486	499,551	504,037
11	C.... AID III	10,618	-	10,618	3,221	423,450	426,671
14	C.... AID IV	13,229	-	13,229	4,026	499,181	503,208
27	Sektor progr. Agricultural 1	11,971	141,469	153,441	5,620	574,444	580,065
Total		50,625	217,374	268,000	17,354	1,996,628	2,013,983

Burimi: AMGKP

Për vitin 2022, ATK-ja në lidhje me detyrimet për marrëveshjet me KFŴ, ka paguar vetëm shumën prej 268,000 Euro.

Mbi rakordimin e detyrimeve për vitin 2023

-Me shkresën nr.589 prot, datë 30.01.2024, nga ana e MFE-së i është drejtuar ATK-së në lidhje me gjendjen e detyrimeve të ATK-së ndaj MFE-së në 31.12.2023 për kreditë e KFŴ, në shumën 2,210,454 Euro.

Tabelat e Rakordimit të detyrimeve të ATK ndaj MFE për kreditë e KFŴ për vitin 2023

Në Euro

Nr. i Kredisë	Kredia	Gjendja e Detyrimeve të ATK në 31.12.2022			Detyrime të vitit 2023					
		Interes	Principal	Total	6 – Mujori i Parë			6 Mujori i Dytë		
					Interes	Principal	Total	Interes	Principal	Total
10	C.... AID II	4,486	499,551	504,037	4,262	59,821	64,083	4,037	59,821	63,589
11	C.... AID III	3,221	423,450	426,671	3,060	42,948	46,008	2,899	42,948	45,847
14	C.... AID IV	4,026	499,181	503,208	3,834	51,129	54,963	3,642	51,129	54,772
27	Sektor progr. Agricultural 1	5,620	574,444	580,065	5,376	64,963	70,340	5,133	64,963	70,096
Total		17,354	1,996,628	2,013,983	16,533	218,862	235,396	15,713	218,862	234,575

vazhdim table

Nr. i Kredisë	Kredia	Shlyer ATK gjatë vitit 2023			Gjendje e detyrimeve të ATK në 31.12.2023		
		Interes	Principal	Total	Interes	Principal	Total
10	C.... AID II	12,786	223,898	236,685	-	395,294	395,294
11	C.... AID III	9,180	-	9,180	-	509,347	509,347
14	C.... AID IV	11,504	-	11,504	-	601,440	601,440
27	Sektor progr. Agricultural 1	16,130	-	16,130	-	704,372	704,372
Total		49,601	223,898	273,500	-	2,210,454	2,210,454

Burimi: AMGKP

Për vitin 2022, ATK-ja në lidhje me detyrimet për marrëveshjet me KFŴ, ka paguar vetëm shumën prej 273,500 Euro.

Tabela - Përmbledhëse e detyrimeve ndaj KFŴ, për periudhën 2021 – 2023

në euro

Përshkrimi	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Gjendja në çelje	1,501,168	1,809,242	2,013,983
Detyrimi Vjetor për t'u paguar nga ATK	475,505	472,741	469,972
Detyrimi i shlyer nga ATK	167,432	268,000	273,500
<i>Diferenca e pa shlyer nga ATK</i>	<i>(308,073)</i>	<i>(204,741)</i>	<i>(196,472)</i>
Gjendja në fund e Detyrimit ndaj KFŴ	1,809,242	2,013,983	2,210,455

Konstatim:

Nga auditimi i Detyrimeve, rezulton se Detyrimet ndaj KFŴ zënë 99% të totalit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Sektorit të Financës në AMGKP, u konstatua se gjendja në fund e detyrimit ndaj KFŴ, nga viti 2021 deri në vitin 2023 ka pësuar rritje të konsiderueshme përkatësisht, në vitin 2021 paraqitet në shumën 1,809,242 Euro, në vitin 2022 paraqitet në shumën 2,013,983 Euro dhe në vitin 2023 paraqitet në shumën 2,210,455 Euro. Nga grupi i auditimit u konstatua se kjo rritje e vazhdueshme vjen si rezultat i mos shlyerjes së kësteve 6 mujore për çdo vit bazuar në rakordimet ndërmjet MFE-së dhe AMGKP.

Gjithashtu Detyrimi i Institucionit AMGKP ndaj KFŴ, është regjistruar në kontabilitet si një Detyrim Afatshkurtër, ndërkohë që kemi të bëjmë me një keqklasifikim, pasi ky Detyrim duhej të njihej në klasën e Detyrimeve Afatgjata, duke qënë se Huaja është disa vjeçare.

Veprime në kundërshtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Llogaria “*Të pagueshme ndaj furnitorëve*”, në fund të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 572,411 lekë, shumë e cila përfaqëson detyrimet e AMGKP ndaj palëve të treta për mallra dhe shërbime në 31.12.2022

Në mënyrë analitike

Nr.	Emri i Furnitorit	Vlera
1	A..... SHA	3,000
2	E.... Gj....	24,000
3	P.... Sh....	18,795
4	O.....	29,889
5	O.... A.....	117,228
6	D..... P.....	379,500
Totali		572,411

Burimi: AMGKP

Llogaria “*Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore*”, në fund të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në shumën 576,126 lekë, shumë e cila përfaqëson detyrimet që ka Institucioni ndaj punonjësve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në muajin Dhjetor.

KAPITALI

Pasqyra e Kapitalit

	Kapitali nënshkruar	Rezerva të tjera	Fitimet/Humbjet e pashpërndara	Fitimi/Humbja e periudhës	Totali
Pozicioni financiar në fillim viti 2021	187,151,601	-	-	-	187,151,601
Fitimi/(Humbja) e periudhës 2021				(53,737,963)	(53,737,963)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	(53,737,963)	-	-	53,737,963	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën	(53,737,963)	-	-	-	(53,737,963)
Pozicioni financiar në fund viti 2021	133,413,638	-	-	-	133,413,638
Fitimi/(Humbja) e periudhës 2022	-	-	-	(49,394,225)	(49,394,225)
Të ardhur. Të tjera gjithpërf. (kalim pronësie nga vlera e mbetur)	(7,447,595)	-	-	-	(7,447,595)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën	(7,447,595)	-	-	(49,394,225)	(56,841,820)
Pozicioni financiar në fund viti 2022	125,966,043	-	-	(49,394,225)	76,571,818

Burimi: AMGKP

Llogaria “*Kapitali i nënshkruar*”, në çelje të vitit ushtrimor 2021, kapitali i nënshkruar ka qenë në shumën 187,151,601 lekë, si dhe gjatë vitit Institucioni ka rezultuar me humbje në shumën (53,737,963) lekë, çka ka sjellë që humbja e vitit të zbritet nga kapitali i nënshkruar i cili në fund të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 133,413,638 lekë.

Gjithashtu në fund të vitit ushtrimor 2021, paraqitet në vlerën 133,413,638 lekë, ku përgjatë vitit ushtrimor 2022 ka patur pakësim të kapitalit të nënshkruar në vlerën (7,447,595) lekë që përfaqëson kalim kapitali të objektit tek AMF, dhe për rrjedhojë kapitali i nënshkruar në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 125,966,043 lekë.

Humbja e vitit ushtrimor 2022, në vlerën (49,394,225) lekë, në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të AMGKP-së është regjistruar në llogarinë “Fitim/Humbje e pashpërndarë”.

Konstatim:

Sa më sipër, Pasqyra e lëvizjes së Kapitalit, nuk është e shoqëruar me dokumentacion të plotë në lidhje me vlerën fillestare të Kapitalit dhe ndryshimet e akumuluar gjatë viteve periudhë auditimi.

Veprime në kundërshtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Raportet e Audituesve të Pavarur

Gjithashtu në zbatim të Ligjit nr.8894, datë 24.04.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, neni nr.14, pika nr.2, germa “e”, ku përcaktohet se: “Siguron që llogaritë financiare të Agjencisë të kontrollohen jo më pak se 1 herë në vit nga një ekspert kontabël i licencuar. Siguron gjithashtu që kontrollet të kryhen në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të kontroll-revizionit”, janë shprehur me opinion Audituesit Ligjor të kontraktuar për certifikimin e Pasqyrave Financiare si më poshtë:

1.Me shkresën nr.4958, datë 21.12.2022, Audituesit Ligjor, kanë kryer auditimin në Institucionin e AMGKP-së, për pasqyrat financiare 2021 janë shprehur me “Refuzim Opinioni”, për shkak se nuk kanë siguruar evidencë e nevojshme të auditimit për të krijuar një bazë për një opinion auditimi.

2.Me shkresën nr.5146, datë 07.08.2023, Audituesit Ligjor, kanë kryer auditimin në Institucionin e AMGKP-së, për pasqyrat financiare 2022 janë shprehur me “Refuzim Opinioni”, për shkak se nuk kanë siguruar evidencë e nevojshme të auditimit për të krijuar një bazë për një opinion auditimi.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

1.Struktura e Financës – për hartimin e Pasqyrave Financiare periudhë auditimi.

2.Ish – Drejtori i ATK-së, për miratimin e Pasqyrave Financiare periudhë auditimi.

3.Këshilli Mbikëqyrës – për mos analizimin e problematikave dhe mangësive të raportuar në Pasqyrat Financiare, periudhë auditimi.

*Shënim Në vitin 2023, është miratuar ligji nr. 55/2023, “Për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive Shtetërore të Pakthyer”, i cili ka shfuqizuar ligjin e mëparshëm nr. 8894, datë 14.05.2002, “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, konkretisht neni nr. 19 “Shfuqizime”.

Referuar ligjit nr.55/2023, “Për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive Shtetërore të Pakthyer”, konkretisht në nenin nr. 3 “Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer” përcaktohet se:

“1.Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer (në vijim “Agjencia”) është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për financat, me seli në Tiranë.

2. Të ardhurat e përfituara sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 4 dhe nenit 15 të këtij ligji derdhen në buxhetin e shtetit. Këto të ardhura derdhen në buxhetin e shtetit brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

3. Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Për rrjedhojë gjatë auditimit të periudhave të mëparshme të cilat kanë qenë sipas ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, nga ana e Grupit të Auditimit, janë konstatuar mangësitë për Raportimin Financiar, në referencë të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe (SNK), mbi të cilat Institucioni ish-ATK, ka patur detyrimin ligjor t’iu referohej gjatë hartimit të pasqyrave financiare.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore të mësipërme, nga ana e Grupit të Auditimit gjatë hartimit të Raportit të Auditimit, rekomandimet në lidhje me drejtimin e auditimit “Mbi Raportimin Financiar”, do të jepen referuar kuadrin ligjor në fuqi për Institucionet Buxhetore, konkretisht, Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018”.

Për sa trajtuar më sipër në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar, znj. O.M, z. D.D, znj. E.L, znj. K.M, z. G.O, është paraqitur observacion ndaj akt konstatimit nr. 3 datë 03.05.2024, me shkresën, datë 05.06.2024, protokolluar në KLSH me nr. 185/10, datë 05.06.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit: Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës të AMGKP-së janë paraqitur komentet si vijon: 1.pasqyrat financiare të vitit 2020 janë mbyllur në datën 20.04.2021, referuar edhe procesverbalit të datës 30.03.2021 ku Drejtori i Përgjithshëm ka njoftuar se pasqyrat financiare nuk mund të mbyllen brenda datës 30.04.2021 me arsyet se përgjegjësi i financës kishte marrë detyrën në fund të muajit dhjetor 2020, kryerja e inventarizimit nuk kishte përfunduar dhe kishte mungesa 3 javore të stafit në punë për arsye shëndetësore nga covid 19. Pasqyrat financiare të vitit 2021 janë mbyllur brenda afateve në datën 30.03.2022, sipas relacionit të dërguar me shkresën nr.1152, datë 30.03.2022 dhe data e mbylljes është lapsus

nga hartuesi i pasqyrave financiare. Me ndryshimet ligjore të Agjencisë dhe hyrjen në fuqi të Ligjit nr.55/2023 “Për Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të pakthyera”, në datën 1 Janar 2024, ligji nr.8894, datë 24.04.2002 “Për ATK” është shfuqizuar, rrjedhimisht Agjencia në vitin 2024 nuk funksionon me Këshill Mbikëqyrës dhe nuk mund të marrë më vendime.

2.Me vendim të këshillit mbikëqyrës nr.50, datë 01.02.2017 “Për përpilimin dhe përmirësimin e pasqyrave financiare” është marrë vendim të merret një ekspert kontabël i licensuar i jashtë për asistim dhe bashkëpunim në hartimin e bilancit 2016 dhe dhënien e rekomandimeve për korigjim. Audituesi i jashtëm shprehet se duke qenë se ne çelje të veprimtarisë së ATK-së të gjitha huatë e dhëna klientëve janë trajtuar si të humbura dhe si të tilla janë provigjonuar në masën 100%, mbajtja e tyre brenda grupit të drejtave të arkëtueshme nga ana e ATK denatyrton dhe nuk paraqet me vërtetësi dhe në mënyrë besnike pasqyrat e pozicionit financiar detyrimet e kredimarrësve dhe fondi i provigjonimit i llogaritur, bazuar edhe në praktikën dhe legjislacionin bankar, u trajtuan si llogari në ndjekje, por jashtë bilancit. Pra Institucioni që nga viti 2016 e në vazhdim e ka mbajtur këtë llogari jashtë bilancit, por të evidentuar në mënyrë analitike sipas debitorëve. Kur debitori paraqet kërkesë për likuidim të menjëhershëm të detyrimit, strukturat përkatëse të ATK-së llogaritin principalin e transferuar ose të mbetur duke i zbritur arkëtimet e bëra në ATK dhe duke i shtuar shpenzimet gjyqësore, përmbarimore apo të tjera. Shpenzimet e gjyqit janë çelur në sistemin e kreditit në datën 01.01.2004 sipas procesverbaleve të transferimit nga ish-bankat shtetërore BTA, BK, BKT dhe Insig në mënyrë jo analitike, por me shumën totale për secilin debitor. Informacioni i detajuar për çdo shpenzim mund të gjurmohet nëse nevojitet në librat e bankës sipas datave të veprimeve që ndodhen në sistemin e kreditit. Referuar Ligjit nr.9731, datë 10.05.2007, neni nr.10 “Huatë e transferuara në Agjencinë e Trajtimit të Kredive pa dokumentacion ligjor që vërteton marrjen e kredisë, procesverbali i transferimit të detyrimit kontabël të këtyre huave përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga përmbaruesi gjyqësor”. Pra vetë ligji në këtë nen ka konstatuar se dokumentacioni i transferuar ATK-së ka qenë problematik.

3.Sipas Udhëzimit nr.33, datë 24.09.2010, Kreu III, pika 10, ATK-ja ka të drejtën e rivlerësimit të pronës para fillimit të procedurave të shitjes me ankand, me kusht rritjen e vlerës fillestare, kur e gjykon të arsyeshme se kanë ndryshuar pozitivisht kushtet e tregut në zonën ku ndodhet ajo pronë. Rrjedhimisht në zbatim të këtij udhëzimi ATK nuk mund të bëjë vlerësim për të gjitha pronat, por vetëm në rastet e fillimit të procedurave të shitjes me ankand, kur gjykohet se kanë ndryshuar kushtet e tregut. ATK-ja duke qenë një Institucion me vetëfinancim, ku pjesën e shpenzimeve e mbulonte me arkëtimet e debitorëve, vlerësimi i të gjitha pronave në emër të saj, duke marrë një ekspert vlerësues do të rëndonte situatën financiare.

4.Detyrimi i KFW -së është mbajtur në kontabilitet si një detyrim afatshkurtër për arsye se në bilanc nuk paraqitet huaja shumëvjeçare që është marrë ndaj KFW -së, por detyrimi i Institucionit ndaj Ministrisë së Financave që paguan KFW-në. Ky zë ndryshon çdo vit sepse kemi rritje të detyrimit sipas shkresave vjetore që dërgon Ministria e Financave dhe pagesa sipas gjendjes financiare të Institucionit.

5.Në pasqyrat financiare të viteve 2022 dhe 2023 është pasqyruar lëvizja e kapitalit, ndryshimi i të cilit ka ardhur nga zvogëlimi i pronës kaluar te AMF si dhe nga efekti i rezultatit financiar. Në vitin 1998 kur është krijuar ATK me ligjin nr.8339, datë 30.04.1998 si Institucion ka qenë projekt i Bankës Botërore dhe pasqyrat auditoheshin sipas SKK-ve të Bankës Botërore. Kur u ndryshua struktura e ATK-së duhej ndryshuar dhe baza ligjore (kërkuar në mënyrë të vijueshme nga Këshilli Mbikëqyrës) duke krijuar për ATK-në një formë bilanci specifik, duke qenë se ATK-ja është një Institucion me karakteristika të veçanta nga të gjithë Institucionet e tjera.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1.Në lidhje me komentet tuaja mbi dorëzimet e pasqyrave financiare dhe afateve të tyre, nga ana e Grupit të Auditimit në PRA është evidentuar si konstatim mos dorëzimi në afat i pasqyrave financiare për vitin 2021, por nuk është hartuar gjetje pasi edhe janë marrë parasysht

problemet që dhe ju keni parashtruar në lidhje me covid-19 ose lapsuset që keni cituar, për rrjedhojë observacioni juaj merret pjesërisht në konsideratë.

2.Në lidhje me komentet tuaja mbi klasën e të drejtave të arkëtueshme, nga ana e Grupit të Auditimit në PRA është hartuar rekomandimi përkatës ku të evidentohen dhe pasqyrohen në mënyrë të plotë si dhe të kryhet regjistrimi kontabël i të gjithë debitorëve mbi të cilët ka lindur detyrimi ndaj AMGKP-së duke përmbushur pohimet e “saktësisë”, “plotësisë” dhe “klasifikimit dhe identifikimit”, kjo në zbatim të kuadrit ligjor mbi raportimin financiar si një institucion buxhetor në varësi të MFE me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr.55/2023, për rrjedhojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

3.Në lidhje me komentet tuaja mbi aktivet e mbajtura në shitje, ju shpreheni se Institucioni ka të drejtën e rivlerësimit të pronave vetëm para fillimit të procedurave të ankandit, por Grupi i Auditimit sqaron se në PRA është evidentuar fakti se kjo llogari duhet të paraqitet me të gjitha asetet në vlerë reale në kontabilitet ku nga ana e Institucionit duhej të kryhej vlerësimi i drejtë dhe real i vlerës së aktiveve duke përmbushur pohimet e “saktësisë së vlerës”, “plotësisë” dhe “klasifikimit dhe identifikimit real”, ku të identifikohesh nëse aktivi financiar do të zhvlerësohej nëse ka të dhëna objektive se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi, për rrjedhojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

4.Në lidhje me komentin tuaj mbi detyrimin që Institucioni ka ndaj KFŴ, Grupi i Auditimit sqaron se janë analizuar të gjitha marrëveshjet si edhe rakordimet përkatëse që AMGKP ka bërë me MFE, nga ku ka rezultuar se gjendja në fund e detyrimit ndaj KFŴ, nga viti 2021 deri në vitin 2023 ka pësuar rritje të konsiderueshme përkatësisht, në vitin 2021 paraqitet në shumën 1,809,242 Euro, në vitin 2022 paraqitet në shumën 2,013,983 Euro dhe në vitin 2023 paraqitet në shumën 2,210,455 Euro. Nga grupi i auditimit u konstatua se kjo rritje e vazhdueshme vjen si rezultat i mos shlyerjes së kësteve 6 mujore për çdo vit bazuar në rakordimet ndërmjet MFE-së dhe AMGKP, si edhe kontabilizimi i detyrimit nuk është kryer në klasën e detyrimeve afatgjata, për rrjedhojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

5.Në lidhje me komentin tuaj mbi analizën e kapitalit, Grupi i Auditimit sqaron se edhe pse ky konstatim është lënë në rekomandimet e ekspertëve kontabël, nga ana e Institucionit pasqyra e lëvizjes së kapitalit duhej të ishte e shoqëruar me dokumentacion të plotë në lidhje me vlerën fillestare dhe ndryshimet përkatëse gjatë periudhave, për rrjedhojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Për sa trajtuar më sipër në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar, znj. R.Xh në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm aktual të AMGKP-së, deleguar në muajin prill 2024 (konceptuar nga znj. Xh.K në cilësinë e Arkivistes në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, znj. V.S në cilësinë e specialistes së Sektorit të Financës dhe Buxhetit, znj. A.Xh në cilësinë e specialistes në Sektorin e Ndjekjes së Procedurave të Ekzekutimit Përmbarrimor, znj. E.Z në cilësinë e Përgjegjëses së Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Skemave të veçanta të Garancisë, znj. A.H në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, znj. K.T në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Financës dhe Buxhetit), është paraqitur observacion ndaj PRA datë 31.05.2024, me shkresën nr. 2041/2, datë 01.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 185/11, datë 03.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit: Nga ana e AMGKP-së janë paraqitur komentet si vijon: *1.Referuar Gjetjes nr. 7 në PRA, është dërguar informacioni i kërkuar, megjithatë po jua rivëmë në dispozicion. Sa u përket pasurive të cilat nuk disponojmë dokumentacion pronësie janë bërë aplikimet për të gjitha pasuritë por nga ASHK nuk kemi patur përgjigje. Për këtë gjë i kemi dërguar Drejtores së Përgjithshme të ASHK ku i kërkojmë që të veprohet mbi aplikimet e kryera që nuk kanë përgjigje. Për pasuritë të cilat ASHK ka kërkuar të kryhen plan rilevimet, Agjencia ka publikuar njoftimin në faqen zyrtare të internetit të saj në datën 30.10.2023 ku ka kërkuar topograf të licencuar për të kryer plan rilevimet por nuk ka patur aplikime. Kjo procedurë do të kryhet përsëri.*

Referuar gjetjes nr. 11 të RPA, Shpenzimet e gjyqit janë çelur në sistemin e kreditit në datën 01.01.2004 sipas procesverbaleve të transferimit nga ish-bankat shtetërore BTA, BK, BKT dhe Insig dhe ato të kryera në Agjenci deri në vitin 01.01.2004 në mënyrë jo analitike, por me shumën totale për secilin debitor (pavarësisht natyrës së shpenzimeve), prandaj është e pamundur nga ana e Institucionit që këto detyrime të paraqiten në mënyrë analitike. Nga viti 2004 e në vazhdim nëse kërkohet nga debitori informacion i detajuar në lidhje me shpenzimet e gjyqit që i janë ngarkuar, Institucioni mund ta gjejë këtë informacion të statements bankare. Ndërsa nga viti 2016 e në vazhdim me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 50, datë 01.12.2017 “Për përpilimin dhe përmirësimin e pasqyrave financiare”, është marrë një ekspert kontabël i licencuar i jashtëm për asistim dhe bashkëpunim në hartimin e bilancit 2016 dhe dhënien e rekomandimeve për korrigjim. Audituesi i jashtëm z. I.C shprehet se duke qenë se ne çelje të veprimtarisë së ATK-së të gjitha huatë e dhëna klientëve janë trajtuar si të humbura dhe si të tilla janë provigjonuar në masën 100%, mbajtja e tyre brenda grupit të drejtave të arkëtueshme nga ana e ATK denatyrën dhe nuk paraqet me vërtetësi dhe në mënyrë besnike pasqyrat e pozicionit financiar detyrimet e kredimarrësve dhe fondi i provigjonimit i llogaritur, bazuar edhe në praktikën dhe legjislacionin bankar, u trajtuan si llogari në ndjekje, por jashtë bilancit. Pra Institucioni që nga viti 2016 e në vazhdim e ka mbajtur këtë llogari jashtë bilancit, por të evidentuar në mënyrë analitike sipas debitorëve. Kur debitori paraqet kërkesë për likuidim të menjëhershëm të detyrimit, strukturat përkatëse të ATK-së llogaritin principalin e transferuar ose të mbetur duke i zbritur arkëtimet e bëra në ATK dhe duke i shtuar shpenzimet gjyqësore, përmbaramore apo të tjera.

Referuar gjetjes nr. 12, detyrimi i KFW-së është mbajtur në kontabilitet si një detyrim afatshkurtër për arsye se në bilanc nuk paraqitet huaja shumëvjeçare që është marrë ndaj KFW-së, por detyrimi i institucionit ndaj Ministrisë së Financave që paguan KFW-në. Ky zë ndryshon cdo vit, sepse kemi një rritje të detyrimit sipas shkresave vjetore që dërgon Ministria e Financave dhe pagesa sipas gjendjes financiare të institucionit. Në vitet në vijim në zbatim të SNK detyrimi ndaj KFW-së do të ndahet në detyrime afatshkurtra për detyrimin brenda vitit dhe në detyrime afatgjata për detyrimet e pashlyera ato mbi një vit. Gjithashtu në vijim cdo arkëtim i debitorëve do të derdhet në buxhetin e shtetit për KFW-në, pasi nga data 01.01.2024 institucioni vepron me ligjin e ri nr.55/2023, si një institucion buxhetor në varësi të Ministrisë së Financave.

Referuar gjetjes nr. 13, ky konstatim është lënë edhe në rekomadimet e ekspertëve kontabël për pasqyrat financiare të vitit 2021, e cila është korrigjuar në pasqyrat financiare të viteve 2022 dhe 2023. Në pasqyrat financiare të viteve 2022 dhe 2023 është pasqyruar lëvizja e kapitalit, ndryshim i të cilit ka ardhur nga zvogëlimi i pronës kaluar te AMF me VKM nr.49, datë 26.01.2022 si dhe nga efekti i rezultatit financiar.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

- Në lidhje me komentet tuaja mbi gjetjen nr. 7 mbi aktivet e mbajtura në shitje, ju shpreheni se sa u përket pasurive të cilat nuk disponohen dokumentacion pronësie janë bërë aplikimet pranë ASHK, për rrjedhojë rekomandimi i lënë nga ana e Grupit të Auditimit në PRA, është pranuar dhe është duke u zbatuar nga ana juaj.

- Në lidhje me komentet tuaja mbi gjetjen nr. 11, në PRA mbi klasën e të drejtave të arkëtueshme, nga ana e Grupit të Auditimit në PRA është hartuar rekomandimi përkatës ku të evidentohen dhe pasqyrohen në mënyrë të plotë si dhe të kryhet regjistrimi kontabël i të gjithë debitorëve mbi të cilët ka lindur detyrimi ndaj AMGKP-së duke përmbushur pohimet e “saktësisë”, “plotësisë” dhe “klasifikimit dhe identifikimit” si dhe të jenë të përshkruar në mënyrë të detajuar, principali i detyrimit, interesat e akumuluar përgjatë viteve si edhe çdo shpenzim tjetër të kryer nga Institucioni për mbledhjen e këtyre detyrimeve që i shtohen vlerës së detyrimit në total (principal + interesa), kjo në zbatim të kuadrit ligjor mbi raportimin financiar si një institucion buxhetor në varësi të MFE me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr.55/2023, për rrjedhojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

- Në lidhje me komentin tuaj mbi gjetjen nr. 12 detyrimin që Institucioni ka ndaj KFŴ, Grupi i Auditimit sqaron se janë analizuar të gjitha marrëveshjet si edhe rakordimet përkatëse që AMGKP ka bërë me MFE, nga ku ka rezultuar se gjendja në fund e detyrimit ndaj KFŴ, nga viti 2021 deri në vitin 2023 ka pësuar rritje të konsiderueshme përkatësisht, në vitin 2021 paraqitet në shumën 1,809,242 Euro, në vitin 2022 paraqitet në shumën 2,013,983 Euro dhe në vitin 2023 paraqitet në shumën 2,210,455 Euro. Nga ana e grupit të auditimit në PRA është konstatuar se kjo rritje e vazhdueshme vjen si rezultat i mos shlyerjes së kësteve 6 mujore për çdo vit bazuar në rakordimet ndërmjet MFE-së dhe AMGKP, si edhe kontabilizimi i detyrimit nuk është kryer në klasën e detyrimeve afatgjata. Gjithashtu nëpërmjet komentit tuaj ju shpreheni se në vitet në vijim do të kryhet edhe kontabilizimi i këtij detyrimi si afatgjatë për pjesën mbi 1 vit që institucioni ka kundrejt MFE, sipas rekomandimit të lënë nga ana e Grupit të Auditimit, për rrjedhojë nga ana juaj është pranuar rekomandimi përkatës.

- Në lidhje me komentin tuaj mbi gjetjen nr. 13, mbi analizën e kapitalit, Grupi i Auditimit sqaron se edhe pse ky konstatim është lënë në rekomandimet e ekspertëve kontabël, nga ana e Institucionit pasqyra e lëvizjes së kapitalit duhej të ishte e shoqëruar me dokumentacion të plotë në lidhje me vlerën fillestare dhe ndryshimet përkatëse gjatë periudhave, për rrjedhojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

2.7 Zbatimi i procedurave të inventarizimit nga AMGKP.

Nga auditimi u konstatua se AMGKP ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...” dhe neni 31, citohet “ ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...”.

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2021-2023.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi, është realizuar procesi i inventarizimit sipas parashikimeve të Paragrafit nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar që sanksionin se:

“Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”

Më konkretisht:

a) Inventarizimi fizik

Nga auditimi i procesit të inventarizimit u konstatua se:

Procesi i inventarizimit të aktiveve për vitin 2022 është kryer nga komisioni i ngritur sipas urdhrorit të Drejtorit të Përgjithshëm “Për kryerjen e inventarit të mjeteve kryesore dhe inventarit të imët” me nr.5/1, datë 04.01.2023 dhe me përbërje të:

- zj. O.S, Kryetar;
- zj. I.K, anëtar;
- zj. E.I, anëtar.

Nga grupi i auditimit u konstatua se për vitin 2022, Kryetari i komisionit të inventarizimit ka qenë specialiste në Sektorin e Financës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 82 ku citohet se “Komisioni nuk duhet te jete më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet te kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka ne ngarkim/ përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet

inventarizimi ...” si dhe ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 22 “veprimtaria e kontrollit” pika 3. b “ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin”.

Para fillimit të inventarit, nga komisioni i inventarizimit nuk është mbajtur procesverbal, ku të fiksohej numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, sipas përcaktimit të paragrafit 82 të UMFE nr. 30/2011, i ndryshuar.

Në dosje janë depozituar kartelat/ fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkruara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe persona materialisht përgjegjës.

Nga komisioni i inventarizimit në fund të procesit është hartuar vetëm një informacion me drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, ku janë konstatuar diferencat si vijon:

Në ish zyrën rajonale Korçë, komisioni i inventarizimit ka konstatuar diferenca e 18 artikujve të vjedhur sipas procesverbalit të datës 24.10.2013 me vlerë 663,779 lekë.

Në ish zyrën rajonale Pogradec, komisioni i inventarizimit ka konstatuar se kjo zyrë është tjetërsuar në një subjekt privat.

Në ish zyrën rajonale Kukës, komisioni i inventarizimit ka konstatuar se kjo zyrë ka patur në pronësi një automjet tip “Isuzi” me targa TR...M me vlerë 765,000 lekë, dhe nga inspektimi ka rezultuar se mjeti nuk ndodhej më në këtë zyrë, ku është mbajtur procesverbal mbi kallëzimin e veprës penale në datë 27 Maj 2021.

Nga auditimi i dosjes së inventarizimit u konstatua se gjatë vitit 2022, nga Titullari i Institucionit të AMGKP-së nëpërmjet Urdhrit me nr.5/1, datë 04.01.2023 “Për kryerjen e inventarit të mjeteve kryesore dhe inventarit të imët”, është kryer procedura e inventarizimit si edhe janë hartuar relacionet përkatëse. Nëpërmjet urdhrin me nr.3298, datë 03.05.2023 të Titullarit është autorizuar ngritja e komisionit të vlerësimit të aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit, ku nga komisioni janë evidentuar materialet e dëmtuara dhe të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi nëpërmjet procesverbaleve përkatëse. Me urdhrin e brendshëm me nr. 3298/2, datë 17.08.2023, është ngritur komisioni i asgjësimit për aktivet e nxjerra jashtë përdorimi.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

1. Ish Drejtori i ATK-së, për procedurën e inventarizimit.

2. Komisioni i Inventarizimit për vitin 2022.

2.8 Të tjera

Mbi shqyrtimin e procedurës së ndryshimeve ligjore

Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera është person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrit Përgjegjës për Financat dhe ushtron kompetencat bazuar në ligjin nr. 55/2023, datë 13.07.2023, “Për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyera”. Aktualisht kjo Agjenci përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe ka si funksion:

a) menaxhimin e skemave të veçanta të garancive të huas;

b) kthimin e garancive shtetërore të huas;

c) kthimin e huave dhe nënhuave të garantuara nga ministri përgjegjës për financat;

ç) verifikimin e aftësisë paguese të subjekteve huamarrëse për të cilat është kryer pagesa e garancisë në secilën prej skemave të garancive të miratuara, huave dhe nënhuave, të garantuara nga ministri përgjegjës për financat;

d) trajtimin e kredive të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror pas privatizimit të tyre;

dh) trajtimin e portofolit të investimeve të kryera në banesa nga shoqëria I SHA., para privatizimit të saj.

Nga auditimi i përcaktimeve ligjore të këtij ligji konstatohet se:

1. Pika 3, neni 17 të ligjit nr. 55/2023 *“Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyerë”*, miratuar në datën 13.07.2023, e cila përcakton se Agjencia do të vijojë të organizohet dhe të funksionojë sipas ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 *“Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”*, i ndryshuar, deri në ristrukturimin e saj që duhet të përfundojë brenda datës 01.01.2024, bie në kundërshtim me nenin 19 i cili shfuqizon ligjin nr. 8894, datë 14.05.2002, i ndryshuar dhe nenin 20 i cili parashikon se ligji nr. 55/2023 hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren Zyrtare. Rezulton se botimi i këtij ligji është bërë me nr. 113, datë 01.08.2023.

2. Në datën 16.11.2023 nga ana e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, është miratuar Udhëzimi nr. 21087 *“Për bashkëpunimin ndërmjet Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive shtetërore si edhe kthimin e garancive shtetërore të huasë dhe nënhuasë”*, në përputhje me pikën 2, neni 18 ku citohet se: *“Ngarkohet Ministri përgjegjës për financat që brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerr aktet nënligjore sipas pikës 4 të nenit 7 të këtij ligji”*. Pika 4, neni 7 citon: *“Rregullat për bashkëpunimin e Agjencisë me ministrinë përgjegjëse për financat për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, si dhe për mbajtjen e dokumentacionit dhe të të dhënave, sipas këtij neni, përcaktohen me udhëzim të Ministrit Përgjegjës për Financat”*.

Ky Udhëzim është përcjellë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 21087/1 prot., datë 16.11.2023.

3. VKM nr. 723, datë 13.12.2023 *“Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së menaxhimit të garancive dhe kredive të pakthyerë”*, është miratuar rreth 1 muaj jashtë afatit të përcaktuar në pikën 1, neni 18, të ligjit nr. 55/2023, ku citohet se: *“Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerr aktet nënligjore sipas nenit 3, pika 3...”*

4. Këshilli i Ministrave nuk ka vepruar për miratimin e një sistemi për bazat e të dhënave shtetërore dhe as ka miratuar procedurë të detajuar për kthimin e garancive, huave, nënhuave dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit e shitjes së këtyre pasurive, veprim ky në kundërshtim me pikën 3 të nenit 7 të ligjit nr. 55/2023, ku citohet se: *“Të dhënat sipas pikës 1 të këtij neni administrohen në Regjistrin për Kthimin e Garancive Shtetërore. Ky sistem krijohet me Vendim të Këshillit të Ministrave...”* dhe pikën 2 të nenit 10 e cila citon se: *“Procedura e detajuar për kthimin e garancive, huave dhe nënhuave dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit e shitjes së këtyre pasurive të marra sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave”*.

Nga auditimi i veprimtarisë së Agjencisë konstatohet se:

Me shkresën nr. 17962 prot., datë 30.09.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, është nxjerr Urdhri nr. 226 datë 30.09.2022 *“Për ngritjen e grupit të punës pranë Agjencisë së Trajtimit të Kredive për ndjekjen dhe administrimin e të dhënave të garancisë shtetërore të huasë me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve që tregtojnë me shumicë, produkte ushqimore bazë, për të siguruar financimin e nevojshëm për mbajtjen e rezervave, me qëllim përballimin e situatës së veçantë të krijuar në treg”*, me përbërje si në vijim:

-E.S, përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Operacional

-O.S, përgjegjëse e Sektorit të Riskut

-H.I, specialiste Finance

Detyrat e grupit të punës:

-mbajtja, përllogaritja dhe rakordimi me bankat i të dhënave të kësaj garancie shtetërore;

-monitorimi i zbatimit të garancisë shtetërore nga bankat tregtare të përfshira në këtë garanci shtetërore dhe verifikimi i rasteve të thirrjes së garancisë;

-dërgimi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit i detyrimit që MFE duhet të paguajë (në rastet e konfirmuara nga ATK).

-rakordimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit i principalit të paguar nga MFE.

-raportimi i stokut të garancisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit, brenda datës 15 të çdo muaji.

-krahas sa më sipër grupi i punës do të kryejë edhe detyra të tjera që burojnë nga marrëveshjet me bankat.

Po kështu me shkresën nr. 17962/2 prot., datë 13.02.2023 është mbajtur procesverbal dorëzimi midis Agjencisë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj, në zbatim të Urdhrit nr. 226, datë 30.09.2022 të Ministrit të MFE.

Ky veprim ka ardhur në vijim të VKM-së nr. 349, datë 26.05.2022 *“Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve, që tregtojnë me shumicë produkte ushqimore bazë për të mundësuar financimin e nevojshëm për mbajtjen e rezervave, me qëllim përballimin e situatës së veçantë të krijuar në treg, si dhe për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”.*

Nga auditimi i përcaktimeve të VKM nr. 349 datë 26.05.2022, miratuar në vlerën 3,000,000,000 lekë, në favor të bankës B..., C..., R..., O..., botuar në fletoren Zyrtare nr. 81 datë 31.05.2022 konstatohet se:

-mungon argumentimi dhe arsyet e përzgjedhjes së 4 bankave ku është lëshuar garancia shtetërore, në kushtet kur në treg operojnë 12 banka të nivelit të dytë, krahasuar edhe me Garancinë sovrane 1 dhe 2.

-parashikimi i pikës 8 e cila citon se “Ministri i Financave dhe Ekonomisë, me urdhër të posaçëm, mund të ngarkojë ndjekjen dhe administrimin e të dhënave të kësaj skeme garancie, duke përfshirë mbajtjen, përlllogaritjen, rakordimin dhe raportimin e të dhënave nga punonjës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive”, është kundërshtim si me ligjin nr. 8894, datë 14.05.2002 i ndryshuar, ashtu dhe me ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, i ndryshuar.

Nga auditimi i marrëveshjes tip të integruar si aneks në vijim të miratimit të VKM-së nr. 349, datë 26.05.2022, u konstatua se:

-pika 2 e nenit 2 të marrëveshjes, ku parashikohet se “MFE merr përsipër të garantojë 60% të çdo huaje që Huadhënësi do tu lëvrojë Huamarrësve sipas kushteve që pasojnë në këtë marrëveshje” dhe pika 4 e nenit 2 ku parashikohet se “Në asnjë rast MFE nuk merr përsipër garantimin e interesave, kamatëvonesave, penaliteteve apo çdolloj detyrimi tjetër monetar që mund të burojë nga huatë që Huadhënësi do ti lëvrojë huamarrësve” janë në kundërshtim me nenin 34 të ligjit të Huamarrjes i cili citon se: “Garancia shtetërore e huasë nuk përbën detyrim të drejtpërdrejtë për shtetin, por përfaqëson një detyrim të mundshëm. Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtpërdrejtë kur përfituesi i drejtpërdrejtë nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë”. Sipas këtij përcaktimi në ligjin e huamarrjes nuk ka parashikim për mospagimin e interesave ose penaliteteve të cilat në fakt janë pjesë të detyrimit, në rast se përfituesi i drejtpërdrejtë nuk arrin të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë.

Po kështu, pika 4 e nenit 2 bie në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 ku citohet se: *“Kur huamarrësi nuk ka mundur të kryej pagesën e detyrimeve në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë....huadhënësi rezervon të drejtën për t’i dërguar MFE-s kërkesën me shkrim për pagesën e detyrimeve” dhe pikën 2 e cila citon se “...Kërkesa për pagesë që Huadhënësi do t’i drejtojë MFE-s duhet të përmbajë: a) Një përshkrim të detajuar*

të shumës që kërkohet, duke përcaktuar në mënyrë analitike, principalin, interesat e akumuluar, penaltitetet, si dhe çdo detyrim tjetër të kryer në zbatim të marrëveshjes së huasë që është në ngarkim të Huamarrësit, pavarësisht faktit që garancia mbulon vetëm në masën 60%”.

Për sa më sipër dhe neni 2 dhe neni 6 i marrëveshjeve janë në kundërshtim me njëri tjetrin.

-pika 1 e nenit 3 të marrëveshjes e cila citon se: “Huadhënësi do të jap hua të garantuar vetëm huamarrësve që plotësojnë kriteret si në vijim...” duke ia kaluar në këtë mënyrë kompetencën bankat, është në kundërshtim me nenet 36-38 të ligjit nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar, sipas të cilit këtë kompetencë e ka MFE, ku konkretisht citohet si në vijim:

Neni 36 “...kur dokumentacioni mbështetës i kërkesës për garanci është i plotë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, është i detyruar që brenda 60 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, të shpallë vendimin për dhënien e garancisë”.

Neni 37 “...analiza ekonomike-financiare sipas nenit 36, përfshin një përcaktim të riskut që merr përsipër shteti, në rast se jepet garancia. Ministri i Financave mund të kërkojë asistencën e Bankës së Shqipërisë për të përcaktuar dhe vlerësuar riskun”.

Neni 38 “Dhënia e garancisë shtetërore të huasë”: “...Ministri i Financave dhe Ekonomisë miraton dhënien e garancisë shtetërore të huasë pasi shqyrton dokumentet e mëposhtme:

d) Projekt-marrëveshjen e huasë ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit;

e) Projektmarrëveshjen e garancisë ndërmjet institucionit huadhënës dhe shtetit;

f) Marrëveshjen e mirëkuptimit, të nënshkruar nga huamarrësi”.

Nga ana e KLSH vlerësohet një risk të lartë në lidhje me këtë pikë të marrëveshjes duke qenë se nga ana e bankave të nivelit të dytë ekziston mundësia e mosvlerësimit të drejtë të aktivitetit dhe aftësisë paguese të subjekteve që kanë aplikuar për kredi, në kushtet e ofrimit të një garancie nga shteti.

-neni 7 i marrëveshjes ku parashikohet se “...nëse pas 2 vitesh nga data e kryerjes së Pagesës së Garancisë, Huadhënësi nuk ka mundur të rikuperojë detyrimet e Huamarrësit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë zotëron të drejtën që të ndjekë vet procedurat ligjore” është në kundërshtim me nenin 42 të ligjit nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar, i cili citon se “Me kryerjen e pagesës në llogarinë e garancisë shtetërore të huasë institucionit huadhënës, Ministri i Financave merr në dorëzim të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, që zotëronte institucioni huadhënës ndaj huamarrësit, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë...”, pasi ky i fundit nuk parashikon afat kohor, por i jep të drejtën Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për të vepruar vet dhe direkt me qëllim rikuperimin e detyrimeve.

-pika 2 e nenit 7 ku parashikohet se “...Përfshirë, palët, me marrëveshje të veçantë, mund të bien dakord që të heqin dorë nga ndjekja e procedurave për ekzekutimin e detyrimit, në rastet kur vlerësojnë se kostot e këtyre procedurave tejkalojnë masën e të gjithë detyrimit” bie në kundërshtim me nenin 43 të ligjit nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar ku citohet se “Ministri i Financave ndërmerr të gjitha masat e paracaktuara në këtë ligj, në ligje të tjera në fuqi dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për të përfutur nga huamarrësi çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë edhe kostot që lidhen me të”.

Përveç problematikave të sipërtrajtuara në lidhje me përcaktimet në marrëveshjen tip me bankat e nivelit të dytë, kalimi i kompetencave për ndjekjen dhe administrimin e të dhënave të kësaj garancie shtetërore paraqet jo vetëm një risk të shtuar në lidhje me përgjegjësinë e monitorimit të garancive shtetërore përgjatë periudhës tetor 2022-shkurt 2023, por është edhe në kundërshtim me nenin 40 të ligjit nr. 9665 datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku citohet se: “Ministria e Financave kryen mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marr garanci shtetërore të Huasë...” dhe nenin 2 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar, i cili citon se: “Objekti i Agjencisë së Trajtimit të Kredive është trajtimi i kredive dhe i asetëve të tjera, të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror, te kjo agjenci, që më poshtë

do të quhet “Agjencia”. Agjencia e Trajtimit të Kredive, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë ligj, trajton edhe portofolin e investimeve të kryera në banesa nga shoqëria I sha, si dhe të aseteve të tjera, të transferuara me ligje të veçanta.”

Ky veprim konstatohet se është legjitimuar rreth 1 vit më vonë VKM-së nr. 349, datë 26.05.2022 dhe rreth 6 muaj më vonë nga procesverbali i dorëzimit në Agjenci të të dhënave të kësaj garancisë shtetërore, me miratimin e ligjit të ri nr. 55/2023 “Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera”, ku i janë kaluar gjithë kompetencat e garancive Agjencisë”.

Me emailin e datës 02.05.2024 ATK ka konfirmuar se: “Sa i përket Garancisë sovrane nr. 3, ju informojmë se nga momenti i marrjes në dorëzim nga ATK e deri më tani nuk ka patur asnjë rast në vonesë. Gjithashtu, është shlyer kredia e subjektit “E.....” shpk pranë Bankës BKT si dhe kredia e subjektit “B.....” shpk pranë Bankës R..... Në lidhje me 2 garancitë e tjera sovrane 1 dhe 2, janë dorëzuar sipas procesverbalit nr. 2098 datë 05.03.2024”.

Për problematikat e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Këshilli i Ministrave.

Përsa trajtuar më sipër nga përfaqësuesit e subjektit, znj. R.Xh në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm aktual të AMGKP-së, deleguar në muajin prill 2024 (konceptuar nga znj. Xh.K në cilësinë e Arkivistës në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, znj. V.S në cilësinë e specialistes së Sektorit të Financës dhe Buxhetit, znj. A.Xh në cilësinë e specialistes në Sektorin e Ndjekjes së Procedurave të Ekzekutimit Përmbarrimor, znj. E.Z në cilësinë e Përgjegjëses së Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Skemave të veçanta të Garancisë, znj. A.H në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, znj. K.T në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Financës dhe Buxhetit), është paraqitur observacion me shkresën nr. 2041/2 prot., datë 01.07.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 185/11 datë 03.07.2024.

Pretendimi i subjektit: Referuar gjetjes nr. 15, ku citohet se: “Për ngritjen e grupit të punës pranë Agjencisë për ndjekjen dhe administrimin e të dhënave të garancisë shtetërore të huasë me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve që tregtojnë me shumicë produkte ushqimore bazë për të mundësuar financimin e nevojshëm për mbajtjen e rezervave, me qëllim përballimin e situatës së veçantë në treg...sqarojmë se “Është dërguar informacion Ministrit në lidhje me problematikat e VKM-së nr. 349, datë 26.05.2022 në lidhje me mospërputhjen që ka kjo VKM me ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore në RSH. Për të shmangur këto problematika në të ardhmen në hartimin e garancive shtetërore.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Përsa më sipër nga ana e subjektit nuk observohet në lidhje me gjetjen dhe rekomandimin nr. 15. Subjekti është angazhuar në marrjen e masave me qëllim shmangien e problematikave në të ardhmen në lidhje me hartimin e garancive shtetërore.

IV. REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës, për periudhën objekt auditimi, rezultoi se:

- Katër nga pesë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës (përveç Kryetarit) kanë ushtruar këtë funksion 7 vite në tejkalim të afatit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 12, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar. Nga ana e MFE-së nuk ka pasur përgjigje edhe pas njoftimit të Drejtorit të Përgjithshëm më datë 18.07.2018.

- Për vitin 2023, prej datës 10 prill ka pasur katër anëtarë, kjo në kundërshtim me pikën 1, të nenit 12 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, i cili parashikon përbërjen e tij me 5 anëtarë.

-Gjatë vitit 2023, nuk është mbledhur të paktën një herë në muaj pasi sipas procesverbaleve rezultoi të jenë zhvilluar 11 mbledhje, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 13, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar. .

- Të gjitha mbledhjet e Këshillit për periudhën objekt auditimi janë mbajtur në ambientet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, kjo në kundërshtim me pikën 1 të nenit 13, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar, sipas së cilës ato duhet të mbaheshin në selinë e Agjencisë.

- Nuk janë bërë përpjekje për të përmbyllur procesin e kontrollit të llogarive vjetore të Agjencisë, por është mjaftuar vetëm me miratimin e zërit të shpenzimeve për audituesit të pavarur, në kundërshtim me pikën “e” të nenit 14, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar. Për periudhën objekt auditimi rezultoi se llogaritë financiare janë audituar me vonesë si dhe prej tyre është refuzuar dhënia e opinionit. Për rekomandimet e tyre, Këshilli nuk ka marrë masa për të kërkuar nga Agjencisë zbatimin e tyre më qëllim të përmirësimit të situatës, që ka çuar në refuzim opinionit të pasqyrave disa vite radhazi.

- Nuk ka mbikëqyruar e kontrolluar përdorimin e fondeve financiare për shpenzimet operative, në kundërshtim me pikën “f” të nenit 14, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar .

- Nuk ka raportuar asnjëherë pranë Këshillit të Ministrave, në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, të ndryshuar.

Këto problematika të evidentuara nga auditimi janë tregues se Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë nuk ka monitoruar në mënyrë efektive dhe as nuk ka vlerësuar risqet në lidhje me veprimtarinë e Agjencisë, veprim ky në kundërshtim me pikën 2/c neni 14, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, i ndryshuar, pasi ai është përgjegjës për drejtimin e Agjencisë, duke sjellë për pasojë mangësi në funksionimin e Agjencisë.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Agjencisë, për të cilën sipas pikës 2/c të nenit 14 të ligjit nr. 8894/2002, të ndryshuar është përgjegjës Këshilli Mbikëqyrës, rezultoi se:

- Në të tre vitet objekt auditimi nuk janë realizuar planet e arkëtimeve, konkretisht për vitin 2021 arkëtimet janë realizuar në vlerën 77,643,154 lekë ose 86.3%; për vitin 2022 arkëtimet janë realizuar në vlerën 62,219,255 lekë ose 69% dhe për vitin 2023 arkëtimet janë realizuar në vlerën 80,624,585 lekë ose 90% e planit;

- Në të tre vitet objekt auditimi Agjencia nuk ka zbatuar nenin 22, pika 2 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2022 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar, pasi ka mbajtur në llogaritë e veta fonde më shumë se ¼ e buxhetit operativ vjetor të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës;

- Për të tre vitet objekt auditimi rezultoi se nga Agjencia është mbajtur për përdorim më shumë se ¼ e buxhetit vjetor operativ, kjo në kundërshtim me pikën 2 të nenit 22 të ligjit nr. 8894/2022, të ndryshuar, konkretisht për vitin 2021 Agjencia ka derdhur në buxhetin e shtetit vlerën prej 20,457 mijë lekë dhe ka mbajtur për përdorim 74% të arkëtimeve vjetore; për vitin 2022 ka derdhur në buxhetin e shtetit vlerën prej 31,871 mijë lekë dhe ka mbajtur për përdorim 49%, si dhe për vitin 2023 ka derdhur në buxhetin e shtetit vlerën prej 29,835 mijë lekë dhe ka

mbajtur për përdorim 62%. Këshillit Mbikëqyrës dhe Drejtoria nuk e kanë marrë në konsideratë zbatimi i këtij kriteri ligjor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë, në kuadër të ndryshimeve ligjore që ka pësuar Agjencia, të vlerësohen problematikat e evidentuara dhe të merren masa me qëllim shmangien e këtyre mangësive, në funksion të përmirësimit të punës në vijimësi.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i të dhënave të ofruara nga Sistemi Elektronik i Kreditit, ku janë kryer çeljet në vitin 2004, i cili shërben si bazë për trajtimin e debitorëve, rezultoi se më 31.12.2023 në sistem paraqiten 18,136 debitorë në total, përkatësisht: 16,752 debitorë në monedhën ALL me vlerë principali të mbetur 4,157,858.2 mijë lekë dhe interesa 10,396,921.1 mijë lekë; 425 debitorë në monedhën EUR me vlerë principali 5,316.6 mijë Euro dhe interesa 2,235.1 mijë Euro dhe 959 debitorë në monedhën USD me vlerë principali 11,235.9 mijë dollarë dhe interesa 11,360.4 mijë dollarë.

Grupi i auditimit ka kryer një sërë testimesh për kryqëzimin e të dhënave të ofruara nga sistemi, nga ku rezultoi se:

-Ka pasaktësi në datëlindjet e plotësuara të kredimarrësve: Me supozimin se deri në vitin 1997 të jetë marrë kredia përkatëse dhe debitori të ketë qenë minimalisht 18 vjeç në momentin e marrjes së kredisë, moshë aktuale e debitorit sot në vitin 2024 nuk mund të jetë më e vogël se 45 vjeç. Ndërkohë, nga testimet e datëlindjes së klientëve të çelur (regjistruar në sistem) rezultojnë 28 klientë të moshës 25-45 vjeç, ku për më tepër 22 klientë i përkasin datëlindjes 1990 - 1999. Gjithashtu ka 1 rekord klienti me datëlindje të regjistruar vitin 2056 dhe 3 rekorde klienti të regjistruar me moshë mbi 1,000 vjeç;

- Sipas inventarizimit të vitit 2014 rezultojnë 19,074 dosje debitorësh transferuar nga bankat e nivelit të dytë dhe 5,853 dosje nga Banka Bujqësore për Zhvillim. Ndërkohë, sipas çeljes së klientëve rezultojnë 19,243 rekorde dhe sipas çelje kredie rezultojnë 19,126 rekorde, pra mospërputhje të të dhënave në të tri rastet;

-Duke përdorur si variabël fiks “Kod Klienti” rezultojnë 116 rekorde më shumë të çelura me të dhënat e klientëve krahasimisht me kreditë e çelura;

-Duke përdorur si variabël fiks “Kod Klienti”, rezultojnë 1,109 rekorde më shumë të çelura me të dhënat e klientëve krahasimisht me të listën e gjendjes së kredive. Për më tepër, nga përpunimi i të dhënave në Excel evidentohen 2,177 kode klienti që nuk janë pjesë e gjendjes së kredisë në datën 01.01.2021 (fillimi i periudhës objekt auditimi);

-Duke përdorur si variabël krahasues Kodin e Kredisë, rezultojnë 992 kode të cilat janë pjesë e kredive të çelura, por nuk janë pjesë e gjendjes së kredive në datën 01.01.2021. Nga këto rekorde, 16 paraqiten si kredi me vlerë fillestare zero dhe 976 rekorde kanë vlerë fillestare pozitive për kredinë. Për më tepër, nga totali prej 992 rekorde që diferencojnë mes listave, 989 rekorde paraqiten me principal të mbetur zero, 1 me principal në vlerë negative dhe 2 me principal në vlerë pozitive;

-Duke përdorur si variabël krahasues “Emërtimi”, rezulton se për 952 rekorde janë çelur kreditë, por nuk janë pjesë e gjendjes së kredive në datën 01.01.2021. Nga to, rezulton se 16 paraqiten me vlerë fillestare zero. Gjithashtu, vetëm 16 rekorde nga kreditë e çelura nuk janë pjesë e gjendjes së kredisë në 31.12.2021. Pra, evidentohen raste me trajtim të dyfishtë sa i takon paraqitjes së tyre në gjendjen e kredisë në një datë të caktuar;

-Nga ndërthurja e testeve (i) bazuar në “Kodi i Kredisë” dhe (ii) bazuar në “Emërtimi”, për të njëjtat lista: Kredi të Çelura dhe Gjendje e Kredive në datën 01.01.2021, konstatohet se ekzistojnë diferenca në paraqitjen e të dhënave në sistemin elektronik të kredive të Agjencisë. Vlerat e paraqitura si vlerë fillestare/principal/interes paraqiten në tre mënyra: pozitive, negative dhe vlerë zero. Në 40 raste, emri i debitorit (klientit) është i njëjtë në dy listat Kredi të Çelura dhe Gjendje e Kredive në datën 01.01.2021, ndërsa Kodi i Kredisë është i ndryshëm. Në të gjitha këto 40 raste, principali i mbetur dhe interesi paraqiten me vlerë zero. Për 950

raste, Klienti i paraqitur në Kredi të Çelura nuk ndodhet në Gjendje Kredie as sipas “Kodi i Kredisë”, as sipas “Emërtimi”;

-Në gjendjet e kredisë për vitet 2021, 2022 dhe 2023 paraqiten respektivisht 18,143 rekorde për vitet 2021-2022 dhe 18,145 rekorde për vitin 2023, pra evidentohen 2 rekorde më shumë. Pra, konstatohet se Sistemi Elektronik i Kreditit nuk ofron një pasqyrim të saktë të kredive të trajtuara nga Agjencia, për shkak të mangësive në të dhëna të plotësuara ndër vite, si dhe prej mospërputhjeve të konstatuara me inventarizimin e vitit 2014 dhe mospërputhjeve në numër dhe vlerë të kredive; mangësi të trashëguara ndër vite nisur që nga momenti i marrjes në dorëzim. Këto magësi potencialisht riskojnë kryqëzimin e të dhënave të sakta e të plota dhe rrjedhimisht mund të sjellin pasoja në rikuperimin e huasë.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune i cili të analizojë mospërputhjet e evidentuara në Sistemin e Kreditit, si dhe të saktësojë këto të dhëna, duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse si ASHK/Gjendja Civile dhe kryqëzuar me dosjet fizike, me qëllim pasqyrimin e të dhënave të plota dhe të sakta, në funksion të përmirësimit të punës në vjeljen e kredive.

Brenda vitit 2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të pasqyruara mbi klientët dhe kreditë në Sistemin e Kreditit të Agjencisë janë konstatuar:

-Të dhëna që nuk rezultojnë të plotësuara për të gjithë klientët në seksionin “Klientë të Çelur”, ku evidentohen 7,167 rekorde klienti pa asnjë të dhënë përveç emrit në fushën “Emërtimi” dhe Kodit të Klientit, pra rrjedhimisht pa asnjë të dhënë identifikuese (vendlindje, datëlindje dhe adresë), me pasoja në mundësinë e rikuperimit të huasë për këto raste;

-Sistemi nuk ofron një pasqyrë të kolateraleve të debitorëve, me qëllim analizimin e tyre dhe marrjen e masave përkatëse nga Agjencia. Sistemi i Kreditit ka të shënuar në kartelat përkatëse të debitorëve faktin nëse kredia ka kolateral, por jo vlerën e saj, pasi nga komunikimet elektronike me Agjencinë, nga kjo e fundit deklarohet se këto kolaterale nuk kanë pasur vlerë të përcaktuar në treg në momentin e marrjes së kredisë, si dhe përgjatë viteve nuk janë kryer vlerësime të tyre, duke minimizuar mundësinë e marrjes së masave shtrënguese për huatë e pashlyera;

-Veprimet dhe rezultatet lidhur me arkëtimet e debitorëve përpara vendosjes në punë të Sistemit, nuk janë të reflektuara në Sistem, por janë mbajtur në një dokument Excel. Kjo çënon gjurmën audituese pasi vështirëson mundësimin e një linje të qartë në arkëtime apo veprime të tjera të kryera nga debitorët përpara dhe pas implementimit të Sistemit, duke humbur qartësinë dhe saktësinë e vlerave, me pasoja në veprimtarinë e Agjencisë;

-Kreditë e transferuara nga Banka Bujqësore për Zhvillim nuk rezultojnë të pasqyruara në Sistemin e Kreditit, por mbahen në llogari më vete në format Excel ku evidentohen 1,462 raste kredie në vlerën 16,382,187 lekë;

-Databaza e dërguar në Bankën e Shqipërisë është për 3,744 debitorë të identifikuar me ID. Ndërsa, nga të dhënat mbi klientë të çelur, evidentohen 6,547 rekorde me të dhëna të plotësuara për fushat “Emër klienti”, “datëlindje”, “vendlindje”, “adresë”, duke paraqitur një diferencë të lartë prej 2,803 klientësh të paidentifikuar dhe rrjedhimisht të padërguar në BSH për marrjen e masave të mëtejshme për arkëtimin e detyrimit të tyre, me pasoja për vjeljen e detyrimeve të huasë nga ana e Agjencisë.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, i cili të konfirmojë dhe plotësojë të dhënat e munguara në Sistemin e Kreditit, përfshirë dhe ato që mbahen jashtë sistemit, duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse si ASHK/Gjendja Civile/Banka e Shqipërisë etj., me qëllim pasqyrimin e të dhënave të plota dhe të sakta, në funksion të rritjes së efektivitetit të saj në vjeljen e detyrimeve debitore.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasurive të lëna kolateral nga debitorët, ka rezultuar se Agjencia nuk disponon një listë me të dhëna për pasuritë e lëna si kolateral në momentin e marrjes së kredisë, për të evidentuar vlerën e tyre dhe ndryshimet gjatë viteve. Vlera e identifikuar në Sistemin e Kreditit pasqyron vlerën totale të detyrimeve të debitorëve me kolateral (5,230 debitorë me kolateral) dhe jo vlerën e pasurisë së lënë si kolateral. Në këto kushte, për këto kolaterale nuk disponohet një pasqyrim real i vlerës së tyre, me qëllim marrjen e masave të mëtejshme shtrënguese nga ana e Agjencisë për debitorë që nuk kanë shlyer ndër vite detyrimet. Për më tepër, nuk rezulton që Agjencia të ketë zhvilluar minimalisht analiza krahasimore kosto-përfitim mbi çështjen e vlerësimit të këtyre pasurive të lëna si kolateral (për debitorë që nuk kanë shlyer detyrimet ndër vite), për të evidentuar më pas nëse është ekonomikisht efektive të ndiqen procedurat e vlerësimit të këtyre pasurive. Rrjedhimisht, mosveprimi nga ana e Agjencisë për vlerësimin e këtyre kolateraleve ka sjellë mos kalimin e këtyre pasurive në emër të Agjencisë e më pas pamundësinë e shitjes së tyre në ankand, duke rrezikuar mundësinë e mbledhjes së huave, si dhe duke mos gjeneruar të ardhura referuar përcaktimeve të Kreut III të Udhëzimit nr. 33/2010.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 57-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim (i) evidentimin e pasurive të lëna si kolateral përmes informacionit që disponon Agjencia ndër vite dhe bashkëpunimit institucional me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, si dhe (ii) zhvillimin e një analize kosto-përfitim për vlerësimin e këtyre kolateraleve, me qëllim rritjen e nivelit të rikuperimit të kredive.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Referuar listës me 5 pasuri të luajtshme të sekuestruara nga Agjencia, konstatohet se pavarësisht se vlera kontabël e regjistruar e tyre është 7,215,459 lekë, dokument pronësie disponohet vetëm për një pasuri të llojit “Automjet” me vlerë 1,100,000 lekë. Për 4 pasuritë e tjera, ndër vite nuk disponohet dokument pronësie. Për më tepër, këto pasuri të luajtshme janë lënë për ruajtje tek debitorët përkatës në momentin e inventarizimit që i përket një periudhe të deri 20 viteve më parë, duke nënshkruar procesverbalet e inventarizimit dhe duke ua lënë përgjegjësi debitorëve të ruajnë këto sende, pavarësisht përcaktimeve të pikës 6 të Kreut III të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 33, datë 24.09.2010. Në këto kushte, 5 pasuritë e luajtshme, duke u lënë në ruajtje tek debitorët, paraqesin risk për përdorim dhe amortizim të mëtejshëm të tyre për shkak të përdorimit të mundshëm nga debitori, apo qoftë edhe risk për tjetërsimin e tyre duke qenë se për 4 prej tyre nuk disponohet as dokument pronësie në emër të Agjencisë. Këto pasuri të luajtshme janë pasqyruar në llogarinë “Aktive të mbajtura për shitje” me vlerë kontabël 7,215,459 lekë, vlerë e përcaktuar nga vendimet e kalimit në pronësi që u përkasin viteve të mëparshme, duke mos pasqyruar në mënyrë të drejtë dhe të saktë vlerën reale të këtyre pasurive, në kundërshtim me përcaktimet e SKK nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo-Materiale”. Edhe pse këto pasuri janë klasifikuar në llogarinë “Aktive të mbajtura për shitje” dhe për to nuk është përllogaritur amortizim gjatë viteve referuar përcaktimeve të UMF nr. 8/2018, vlera reale e tyre më 31.12.2023 sipas përllogaritjeve të grupit të auditimit rezulton 2,038,218 lekë. Të gjitha problematikat e sipërcituara (mungesa e dokumentit të pronësisë, mungesa e kontrollit fizik për ekzistencën e pasurive të luajtshme, mos pasqyrimi i saktë i vlerës reale të tyre) riskojnë tjetërsimin e këtyre pasurive, zhvlerësimin e tyre në kohë për shkak të amortizimit dhe si rrjedhojë dhe mungesën e përfitimit të të ardhurave nga mos-shitja e tyre përmes procedurave të ankandit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 57-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera të marrë masa për ngritjen e një grupi pune i cili të (i) vlerësojë ekzistencën fizike të pasurive të

luajtshme të sekuestruara ndër vite, (ii) të inventarizojë këto pasuri dhe (iii) të përcaktojë vlerën e saktë të tyre, me qëllim pasqyrimin e saktë të këtyre pasurive në llogaritë e pasqyrave financiare dhe më pas mbledhjen e huave të pakthyera.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se referuar vendimeve të kalimit në pronësi nga përmbaruesit për pasuritë e paluajtshme gjatë vitit 2021, ekzistojnë së paku 12 pasuri të paluajtshme¹⁶ për të cilat mungon certifikata e pronësisë, si dhe urdhri i kontabilizimit, rrjedhimisht përfaqësojnë pasuri të paluajtshme të pakontabilizuara, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4 dhe 5 të Kreut III të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 33, datë 24.09.2010. Referuar të dhënave për pasuri të paluajtshme për të cilat është vënë në dispozicion të grupit të auditimit vendimi i kalimit të pronësisë, vlera e pa kontabilizuar e këtyre pasurive përlllogaritet në 6,284,800 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 57-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera të marrë masa për nxjerrjen e certifikatave të pronësisë në ASHK dhe të urdhrave të kontabilizimit për 12 pasuritë e paluajtshme të cituara në këtë auditim, me qëllim pasqyrimin e tyre në llogaritë e pasqyrave financiare të Agjencisë dhe më pas ndjekjen e procedurave të mundshme të ankandit.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasurive të paluajtshme të kontabilizuara dhe regjistruara në llogarinë “Aktive të mbajtura për shitje” rezulton se kjo llogari e paraqitur në klasën e aktiveve afatgjata financiare në pasqyrën e pozicionit financiar në analitikun e vënë në dispozicion nga Sektori i Financës, në 31.12.2022, ka të regjistruar 77 prona me vlerë kontabël 125,731,740 lekë, vlera e këtyre pronave nga viti në vit ka ngelur e pa ndryshuar, dhe në regjistrin analitik të paraqitur janë përshkruar vetëm emri dhe mbiemri i debitorit, lloji i pronës edhe vlera kontabël e regjistrimit. Nga verifikimi i regjistrimit analitik rezulton se nuk është i paraqitur në mënyrë të detajuar ku përveç të dhënave të debitorit, të ish-in të përshkruar lloji i pronës, sipërfaqja respektive, vendndodhja e pronës, statusi i regjistrimit në ASHK etj. Gjithashtu bazuar në SNK dhe SKK, në klasën e aktiveve financiare nga ana e Agjencisë duhej të kryhej vlerësimi i drejtë dhe real i vlerës së aktiveve duke përmblusur pohimet e “saktësisë së vlerës”, “plotësisë” dhe “klasifikimit dhe identifikimit real”, Për rrjedhojë nga ana e Institucionit nuk është kryer vlerësimi për të nxjerrë vlerën reale kontabël të aktiveve financiare, veprime në kundërshtim me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jo-Materiale”). Nga ana tjetër, lista e pasurive të paluajtshme të formës truall, nuk pasqyron vlerën e tregut të pronave (treg i cili ka pësuar rritje të çmimeve gjatë viteve), pasi nuk janë kryer rivlerësime të pasurive pavarësisht përcaktimeve të pikës 10 të Kreut III të Udhëzimit 33/2010 “Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfiteozë të këtyre pasurive”. Për më tepër, më 31.12.2023, për 21 prona të kontabilizuara nuk disponohet certifikatë pronësie nga Agjencia, duke ndikuar potencialisht në tjetërsimin e pronës dhe duke pamundësuar shitjen e pronës në ankand, sipas përcaktimeve të pikës 1 të Kreut III të Udhëzimit nr. 33/2010.

(Më hollësisht trajtuar në pikat 2.3;2.6, faqe 53-78;105-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Nga ana e Sektorit të Financës në AMGKP në bashkëpunim me strukturat përkatëse, të merren masa për verifikimin e gjendjes reale dhe statusin e pronave dhe asetëve

¹⁶ Për 9 pasuri të paluajtshme disponohet Vendimi i Kalimit të Pronësisë duke përcaktuar dhe vlerë të pronës referuar ankandit të fundit, ndërsa për 3 prona të tjera, nuk disponohet Vendimi apo vlera e tyre.

të mbajtura për shitje, të kryejë inventarizimin si edhe regjistrimin e të gjitha pronave në ASHK, duke përgatitur të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor, më pas vlerësimin e tyre, kontabilizimin në vlerë të plotë dhe pasqyrimin në aktivet e pasqyrave financiare.

Brenda vitit 2024

8. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi u konstatuan se janë likuiduar në total 560 kredi, konkretisht:

- Për vitin 2021 janë likuiduar 131 kredi në monedhën lekë në vlerën 50,079 mijë lekë, 2 kredi në monedhën euro në vlerën 2,000 euro dhe 4 kredi në monedhën usd në vlerën 1,758 usd.

- Për vitin 2022 janë likuiduar 130 kredi në monedhën lekë në vlerën 35,104 mijë lekë, 7 kredi në monedhën euro në vlerën 64,917 euro dhe 4 kredi në monedhën usd në vlerën 29,256 usd.

- Për vitin 2023 janë likuiduar 269 kredi në monedhën lekë në vlerën 39,655 mijë lekë, 4 kredi në monedhën euro në vlerën 39,758 euro dhe 9 kredi në monedhën usd në vlerën 97,726 usd.

Me qëllim vlerësimin e saktësisë dhe plotësisë së dokumentimit të dosjeve të kredive, inventarizimit dhe arkivimit të tyre, u përzgjodhën 9 dosje-kredi të mbyllura, *konkretisht:*

Nga auditimi i dosjeve të mbyllura në lidhje me saktësinë e paraqitjes së pagesave të kryera, në sistemin e kreditit, konkretisht në menunë “Kartelë krediti”, u konstatua se pagesat e kryera nga debitorët janë të reflektuara sipas datave dhe shumave përkatëse. Këto të dhëna të paraqitura në sistem u verifikuan edhe me dokumentacionin fizik të pagesave, të cilat u vendosën në dispozicion nga sektori i financës duke qenë se nuk rezultojn pjesë e dosjeve të arkivuara.

Në kuadër të dokumentacionit fizik, fleta e inventarit nuk është hartuar sipas përcaktimeve të nenit 30 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, pasi nuk disponon të listuara dhe numerizuara dokumentacionin e plotë të dosjes, konkretisht:

-mungon procesverbali i transferimit dhe mandat pagesat fizike;

-dokumentacioni i listuar në kartelën shoqëruese të dosjes nuk përputhet me dokumentacionin, që ndodhet në dosje;

-praktika dhe shkresat për mbylljen e kredisë nuk janë pjesë e listës së inventarit të brendshëm të dosjes.

Gjithashtu është konstatuar se:

-Në kundërshtim me nenin 32 të “Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, nuk është ngritur komisioni i ekspertizës për ekspertizën e vlerës së ruajtjes të dokumenteve.

-Në kundërshtim me nenin 41 nuk janë siguruar kushtet teknike dhe fizike të ruajtjes së dokumenteve.

-Në kundërshtim me nenin 43 nga sekretaria dhe arkivi apo sekretari-arkivi nuk është realizuar kontroll fizik i dokumentacioneve.

Përpos dosjeve të mbyllura të kredive, mangësi u konstatuan edhe në dosjet e procedurave të ankandeve, ku specifikisht rezultoi:

-Dosjet e procedurave të ankandeve nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara si një praktikë e plotë me qëllim ruajtjen e gjurmës audituese për të gjithë procesin e ndjekur;

-Në dosje ka mangësi të dokumentacioneve si: Urdhri i ngritjes së Komisionit të Ankandeve, propozimi për kthimin e pronës tek debitori, procesverbali për hartimin e dokumenteve të ankandit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerat të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim vlerësimin e të gjithë problematikave, të rezultuara nga auditimi për të siguruar garantimin e saktësisë dhe plotësisë në dokumentimin e dosjeve të kredive, duke bërë inventarizimin, numerizimin dhe arkivimin për çdo dosje.

Brenda vitit 2024

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në lidhje me zbatimin e procedurave për ndjekjen dhe mbledhjen e kredive, si dhe aplikimit të masave shtrënguese konstatohet se nga ana e Agjencisë nuk janë zbatuar të gjitha procedurat dhe nuk janë marrë të gjitha masat shtrënguese pasi:

-66 SHPK, konkretisht: 61 në monedhën lekë në vlerën 270,146 mijë lekë, 2 në monedhën euro në vlerën 104,014 euro dhe 2 në monedhën usd në vlerën 86,025 usd, për të cilat Agjencia nuk i është drejtuar Gjykatës për shpallje falimenti dhe caktim likuidatori, në kundërshtim me pikën 1, neni 6, ligji nr. 8894, datë 14.05.2002, “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar, .
-Nuk është vepruar me çelje trashëgimie për asnjë debitor, që ka ndërruar jetë, në kundërshtim me pikën 1/a, seksioni B, kreu I, Udhëzimi nr. 33, datë 24.9.2010, i cili parashikon se për debitorët e vdekur, pavarësisht nga shuma e kredisë, , u kërkohet trashëgimtarëve të tyre të likuidojnë vetëm shumën e principalit të mbetur në momentin e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit të Garancive Shtetërore, huave dhe nënhuave dhe trajtimit të kredive të marrë masa për përditësimin e të dhënave mbi SHPK që rezultojnë debitore, për personat që kanë ndërruar jetë dhe vlerësimin rast pas rasti mbi mundësitë e arkëtimit nga shpallja e falimentit dhe çelja e trashëgimisë.

Brenda vitit 2024

10. Gjetje nga auditimi: Agjencia ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, që prej vitit 2014; Zyrën Qendrore të Pasurive të Paluajtshme, që prej vitit 2018; Bankën e Shqipërisë që prej viti 2020, për të cilat nga auditimi konstatohet se, përcaktimet e klauzolave të tyre nuk janë ezauruar plotësisht dhe si rrjedhojë nuk kanë dhënë efektet pozitive të pritshme. Konkretisht:

- Nga Agjencia është vënë në dispozicion databaza e dërguar Bankës së Shqipërisë për 3,744 debitorë të identifikuar me të dhëna të plota. Megjithatë, nga sistemi i kreditit, evidentohen 6,547 rekorde me të dhëna të plotësuara duke paraqitur një diferencë të lartë prej 2,803 klientësh të paidentifikuar dhe rrjedhimisht të padërguar drejt BSH për marrjen e masave të mëtejshme për arkëtimin e detyrimit të tyre.

-Në marrëveshje me Zyrën Qendrore të Pasurive të Paluajtshme, nisur nga problematikat e konstatuara në dosjet e audituara evidentohet një zvarritje procesesh, në evidentimin e rasteve dhe në kthim përgjigje. Nga Agjencia nuk disponohet relacion, memo, analizë në lidhje me rezultate konkrete të këtyre marrëveshje, për të evidentuar sesa efektive ose jo kanë rezultuar këto masa.

-Nga Agjencia nuk janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera në kundërshtim me pikën 1, neni 10, ligji nr. 8894, datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar, sipas së cilës Agjencia u dërgon, drejtorive rajonale të shërbimit të transportit rrugor, zyrave të gjendjes civile, ALUIZN-it, organeve të pushtetit vendor, bankave të nivelit të dytë, fondacioneve kredi dhënëse dhe institucioneve të tjera informacion për detyrimet, që persona të ndryshëm mund të kenë ndaj shtetit. Procedurat e shkëmbimit të informacionit përcaktohen në marrëveshjet e bashkëpunimit, të nënshkruara nga Agjencia dhe institucioni përkatës”. Konkretisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile ka pasur një iniciativë të një marrëveshje, por ende e pa finalizuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera të marr masa për rishikimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve ekzistuese si dhe me të gjitha institucionet e tjera që lehtësojnë marrjen e informacionit, me qëllim rritjen e bashkëpunimit në menaxhimin e garancive dhe rritjen e arkëtimit nga kreditë e pakthyera.

Brenda vitit 2024

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer në lidhje me klasën e llogarive “të drejta të arkëtueshme”, rezulton se ato nuk paraqiten në mënyrë analitike, ku të jenë specifikuar të gjithë

debitorët mbi të cilët ka lindur detyrimi ndaj Agjencisë, si dhe të jenë të përshkruar në mënyrë të detajuar, principli i detyrimit, interesat e akumuluar përgjatë viteve si edhe çdo shpenzim tjetër të kryer nga Institucioni për mbledhjen e këtyre detyrimeve që i shtohen vlerës së detyrimit në total (principal + interesa), për rrjedhojë paraqitja e të drejtave të arkëtueshme në kontabilitet është jo i plotë dhe nuk përmbush pohimet e “saktësisë”, “plotësisë”, “klasifikimit dhe identifikimit”, veprime në kundërshtim me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK nr.3 “Instrumentet Financiare”).

Gjithashtu, nga auditimi rezulton se, për këto të drejta të arkëtueshme, nga ana e Agjencisë, nuk është vepruar me njohjen fillimisht me vlerën e drejtë të “të drejtave të arkëtueshme” dhe më pas me koston e amortizuar të tyre duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi, ku provigjoni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna objektive se Agjencia, nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet, si edhe vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose hapja e çështjeve gjyqësore në ngarkim të klientit konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme duhet të zhvlerësohen.

Veprime në kundërshtim me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK nr.3 “Instrumentet Financiare”).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 105-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1. Rekomandimi: Nga ana e Sektorit të Financës, të merren masa për evidentimin dhe pasqyrimin e plotë dhe regjistrimin kontabël të të gjithë debitorëve mbi të cilët ka lindur detyrimi ndaj AMGKP-së, ku të përshkruhen në mënyrë të detajuar, principli i detyrimit, interesat e akumuluar përgjatë viteve si edhe çdo shpenzim tjetër, në mënyrë të tillë që të plotësohen parimet e saktësisë, plotësisë, klasifikimit dhe identifikimit.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i klasës së detyrimeve që Institucioni ka ndaj të tretëve të paraqitura në pasiv të pasqyrave financiare, rezulton se llogaria detyrimet ndaj KFŴ zë 99% të totalit, dhe se gjendja në fund e detyrimit ndaj MFE-së për KFŴ-në, nga viti 2021 deri në vitin 2023 ka pësuar rritje të konsiderueshme përkatësisht prej 401,213 euro (nga 1,809,242 euro, në shumën 2,210,455 Euro). Konstatohet se kjo rritje e vazhdueshme vjen si rezultat i mos shlyerjes së kësteve 6 mujore për çdo vit bazuar në rakordimet ndërmjet MFE-së dhe Agjencisë.

Gjithashtu, detyrimi i Agjencisë ndaj MFE-së për KFŴ-në, është regjistruar në kontabilitet si një Detyrim Afatshkurtër, ndërkohë që kemi të bëjmë me një keqklasifikim, pasi ky Detyrim duhej të njihej në klasën e Detyrimeve Afatgjata, duke qenë se Huaja është disa vjeçare, duke mos përmbushur pohimet e “saktësisë”, “klasifikimit dhe identifikimit”.

Veprime në kundërshtim me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK nr.3 “Instrumentet Financiare”).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 105-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1. Rekomandimi: -Nga ana e Sektorit të Financës në AMGKP, të merren masa për riklasifikimin e detyrimit që ka Agjencia ndaj KFŴ si detyrim afatgjatë në Pasqyrat Financiare si dhe të merren masa që shuma e plotë e detyrimit ndaj KFŴ të regjistrohet në Klasën e Pasiveve Afatgjata llogaria “Huatë Afatgjata”.

-Nga ana e Sektorit të Financës dhe Strukturave Drejtuese në AMGKP, të merren masat e nevojshme për shlyerjen e detyrimit ndaj MFE-së sipas kushteve dhe afateve të marrëveshjeve me KFŴ-në, duke paguar principlin dhe interesat në kohën e maturimit të tyre me qëllim shmangien e fenomenit të pagesave pjesore të detyrimit.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Llogaria “Kapitali i nënshkruar”, në çelje të vitit ushtrimor 2021, ka qenë në shumën 187,151,601 lekë, si dhe gjatë vitit Agjencia ka rezultuar me humbje në shumën (53,737,963) lekë, çka ka sjellë që humbja e vitit të zbritet nga kapitali i nënshkruar i cili në fund të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 133,413,638 lekë.

Gjithashtu, përgjatë vitit ushtrimor 2022 ka pasur pakësim të kapitalit të nënshkruar në vlerën (7,447,595) lekë që përfaqëson kalim kapitali të objektit tek AMF, dhe për rrjedhojë kapitali i nënshkruar në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 125,966,043 lekë.

Humbja e vitit ushtrimor 2022, në vlerën (49,394,225) lekë, në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të Agjencisë është regjistruar në llogarinë “Fitim/Humbje e pashpërndarë”.

Nga auditimi rezulton se, Pasqyra e lëvizjes së Kapitalit, nuk është e shoqëruar me dokumentacion të plotë në lidhje me vlerën fillestare të Kapitalit dhe ndryshimet e akumuluar gjatë viteve periudhë auditimi duke mos përmbushur pohimet e “saktësisë”, “klasifikimit dhe identifikimit”, *veprime në kundërshtim me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK nr.2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”)*.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 105-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1. Rekomandimi: Nga ana e Sektorit të Financës në AMGKP, të merren masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë dhe të saktë të Kapitalit, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ndryshimeve të kuadrit ligjor në fuqi është konstatuar se në ligjin nr. 55/2023 *“Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera”*, ka disa problematika:

- Pika 3, neni 17 të ligjit nr. 55/2023 përcakton se Agjencia do të vijojë të organizohet dhe të funksionojë sipas ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 *“Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”*, i ndryshuar, deri në ristrukturimin e saj që duhet të përfundojë brenda datës 01.01.2024, e cila bie në kundërshtim me nenin 19 që e shfuqizon ligjin nr. 8894, datë 14.05.2002, i ndryshuar dhe nenin 20 i cili parashikon se ligji nr. 55/2023 hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, pra më 15.08.2023. Pra rezulton se Agjencia për një periudhë rreth 4 mujore ka vijuar të veprojë sipas një ligji të shfuqizuar.

- VKM nr. 723, datë 13.12.2023 *“Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së menaxhimit të garancive dhe kredive të pakthyera”*, është miratuar rreth 1 muaj jashtë afatit të përcaktuar në pikën 1, neni 18, të ligjit nr. 55/2023.

- Këshilli i Ministrave nuk ka vepruar për miratimin e një sistemi për bazat e të dhënave shtetërore dhe as ka miratuar procedurë të detajuar për kthimin e garancive, huave, nënhuave dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit e shitjes së këtyre pasurive, veprim ky në kundërshtim me pikën 3 të nenit 7 dhe pikën 2 të nenit 10 të ligjit nr. 55/2023.

Mangësitë e mësipërme janë me pasoja negative në efektivitetin e veprimtarisë së Agjencisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 122-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1. Rekomandimi: Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe nëpërmjet saj t’i kërkojnë Këshillit të Ministrave miratimin e një sistemi për bazat e të dhënave shtetërore dhe të procedurave të detajuara për kthimin e garancive, huave, nënhuave dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit e shitjes së këtyre pasurive, me qëllim përmirësimit e efektivitetit të veprimtarisë së saj në mbledhjen e huave të pakthyera.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Agjencisë u konstatua se: Nga ana e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë ka dalë Urdhri nr. 226 datë 30.09.2022 *“Për ngritjen e grupit të punës pranë Agjencisë së Trajtimit të Kredive për ndjekjen dhe administrimin e të dhënave të garancisë shtetërore të huasë me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve që tregtojnë me shumicë produkte ushqimore bazë për të mundësuar financimin e nevojshme për mbajtjen e rezervave, me qëllim përballimin e situatës së veçantë të krijuar në treg, si dhe për përcaktimin e kushteve dhe kritereve të marrëveshjes së garancisë dhe*

marrëveshjes së mirëkuptimit”, konkretisht administrimin e garancisë shtetërore të miratuar me VKM nr. 349, datë 26.05.2022 dhe botuar në Fletoren Zyrtare me nr. 81 datë 31.05.2022, në vlerën 3,000,000,000 lekë, në favor të bankës B....., C....., R..... dhe O.....

Pavarësisht se Urdhri për ndjekjen dhe administrimin e të dhënave të kësaj garancie ka dalë që në datën 30.09.2022, kalimi me procesverbal dorëzimi midis Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj, është bërë me shkresën nr. 17962/2 prot., datë 13.02.2023, pra rreth 5 muaj më vonë sesa dalja e urdhrin për ngritjen e grupit të punës dhe rreth 9 muaj më vonë nga akordimi i garancisë shtetërore. Ky veprim me vonesë paraqet jo vetëm një risk të shtuar në lidhje me përgjegjësinë e monitorimit të garancive shtetërore përgjatë periudhës tetor 2022 - shkurt 2023, por njëkohësisht kalimi i kompetencave të Agjencia është në kundërshtim me nenin 40 të ligjit nr. 9665 datë 18.12.2006, *“Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, sipas të cilit kompetencën e administrimit dhe mbikëqyrjes e ka vetëm MFE dhe nenin 2 të ligjit nr. 8894 datë 14.05.2002 i ndryshuar sipas të cilit objekt i këtij ligji është trajtimi i kredive dhe i aseteve të tjera, të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror, të kjo agjenci, si dhe trajtimi i portofolit të investimeve të kryera në banesa nga shoqëria I SHA, si dhe të aseteve të tjera, të transferuara me ligje të veçanta.

Nga auditimi konstatohet se kalimi i kompetencave të ndjekjes dhe administrimit të të dhënave të garancisë shtetërore të Agjencia në kundërshtim me dispozitat ligjore është legjitimuar rreth 1 vit më vonë VKM-së nr. 349, datë 26.05.2022 dhe rreth 6 muaj më vonë nga procesverbali i dorëzimit në Agjenci të të dhënave të kësaj garancisë shtetërore, me miratimin e ligjit të ri nr. 55/2023 *“Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera”*, ku i janë kaluar gjithë kompetencat e garancive shtetërore kësaj Agjencie

Gjithashtu, nga auditimi i marrëveshjes së garancisë, e cila përmban kushtet dhe kriteret sipas marrëveshjes, miratuar me VKM-së nr. 349, datë 26.05.2022, u konstatua se:

Pika 2 e nenit 2 të marrëveshjes, ku parashikohet se MFE merr përsipër të garantojë 60% të çdo huaje që Huadhënësi do t’u lëvrojë Huamarrësve dhe pika 4 e nenit 2 ku parashikohet se MFE nuk merr në asnjë rast përsipër garantimin e interesave, kamatëvonesave, penaliteteve apo çdo lloj detyrimi tjetër monetar që mund të burojë nga huatë që Huadhënësi do t’i lëvrojë huamarrësve, janë në kundërshtim me nenin 34 të Ligjit e Huamarrjes pasi në këtë ligj nuk ka parashikim për mospagimin e interesave ose penaliteteve të cilat në fakt janë pjesë të detyrimit, në rast se përfituesi i drejtpërdrejtë nuk arrin të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë.

Po kështu, pika 4 e nenit 2 bie në kundërshtim me pikën 1 të Nenit 6 ku parashikohet se kur huamarrësi nuk ka mundur të kryej pagesën e detyrimeve në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë, huadhënësi rezervon të drejtën për t’i dërguar MFE-s kërkesën me shkrim për pagesën e detyrimeve dhe pikën 2 ku përcaktohet se kërkesa dërgohet me një përshkrim të detajuar të shumës që kërkohet, duke përcaktuar në mënyrë analitike, principalin, interesat e akumuluar, penalitetet, si dhe çdo detyrim tjetër të kryer në zbatim të marrëveshjes së huasë që është në ngarkim të Huamarrësit. Për sa më sipër dhe neni 2 dhe neni 6 i marrëveshjeve janë në kundërshtim përputhje me njëri tjetrin.

Pika 1 e nenit 3 të marrëveshjes sipas së cilës kompetencën për vlerësimin e plotësimit të kriterëve e kanë bankat, është në kundërshtim me nenet 36-38 të ligjit nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar, sipas të cilit këtë kompetencë e ka MFE. Nga ana e KLSH vlerësohet një risk të lartë në lidhje me këtë pikë të marrëveshjes duke qenë se nga ana e bankave të nivelit të dytë ekziston mundësia e mosvlerësimit të drejtë të aktivitetit dhe aftësisë paguese të subjekteve që kanë aplikuar për kredi, në kushtet e ofrimit të një garancie nga shteti.

Neni 7 i marrëveshjes ku parashikohet se, nëse pas 2 vitesh nga data e kryerjes së Pagesës së Garancisë, Huadhënësi nuk ka mundur të rikuperojë detyrimet e Huamarrësit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë zotëron të drejtën që të ndjekë vet procedurat ligjore, është në kundërshtim me nenin 42 të ligjit nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar, i cili nuk parashikon

afat kohor, por i jep të drejtën Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë për të vepruar vetë dhe direkt me qëllim rikuperimin e detyrimeve.

Pika 2 e nenit 7 ku parashikohet se, palët, me marrëveshje të veçantë, mund të bien dakord që të heqin dorë nga ndjekja e procedurave për ekzekutimin e detyrimit, në rastet kur vlerësojnë se kostot e këtyre procedurave tejkalojnë masën e të gjithë detyrimit, bie në kundërshtim me nenin 43 të ligjit nr. 9665 datë 18.12.2006, i ndryshuar sipas të cilit, Ministri i Financave ndërmerr të gjitha masat e paracaktuara në këtë ligj, në ligje të tjera në fuqi dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për të përfutur nga huamarrësi çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë edhe kostot që lidhen me të.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 122-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1. Rekomandim: -Ministria e Financave, të marrë masa për vlerësimin e problematikave të konstatuara në lidhje me VKM nr. 349, datë 26.05.2022 dhe kalimin e kompetencave Agjencisë, me qëllim shmangien e riskut për detyrime të mundshme në të ardhmen.

-Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të marrin masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim identifikimin dhe raportimin e përfituesve të garancisë që rezultojnë jo të rregullt në likuidimin e detyrimeve.

Brenda vitit 2024

16. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i masave të marra për vjeljen e kredive, nga grupi i auditimit u përzgjedhën 9 dosje, të cilat kanë vlerë të lartë të detyrimit të mbetur dhe rezultojnë pa arkëtime, në periudhën objekt auditimi. Nga verifikimi i dosjeve ka rezultuar se:

-Në dy nga dosjet e përzgjedhura, duke kryqëzuar informacionin mes dokumentacionit fizik dhe të dhënave të paraqitura në Sistemin Elektronik, u konstatua se ka pasaktësi në plotësimin e rekordeve në sistemin e kreditit, konkretisht “data e llogaritjes së interesave ” dhe “data e bllokimit të interesave” dhe në dy raste rekordi “monedha” nuk është e plotësuar saktë.

-Masat e marra nga ATK dhe komunikimet me institucionet e tjera nuk kanë qenë të mjaftueshme, ezauruese dhe të trajtuara në kohë me qëllim evidentimin, parandalimin e tjetërsimit të pasurive dhe uljen e riskut të pamundësisë për vjeljen e detyrimit, largimit të debitorëve jashtë vendit, ndërrimit të jetës për shkak të moshës etj.

-Dokumentacioni në dosje nuk është i plotë, ka mangësi në dokumente si shkresa në kthim përgjigje, shkresa përcjellëse, raporte të vlerësimit të ekspertit, certifikatë pronësie, vendime të gjykatave, etj që mundësojnë dhënien e një pamje të plotë të veprimeve të ndërmarra nga Agjencia për vjeljen e detyrimeve përkatëse;

-Dokumentacionet pjesë e dosjeve, për 7 nga 9 dosje janë deri në vitet 2015-2016 pas kësaj periudhe në dosje nuk disponohet asnjë dokumentacion tjetër në lidhje me masat e marra nga Agjencia dhe vetëm për dy dosje dokumentacioni shkon përtej këtyre datave, në njërin prej dosjeve dokumentacioni sipas fletës së inventarit është deri në vitin 2010, por brenda në dosje ka dokumentacion deri në vitin 2016.

-Fletët e inventarit nuk janë hartuar sipas nenit 30 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, nuk disponohen të listuara dhe numerizuara dokumentacionet e plota të dosjeve.

-Një nga dosjet e përzgjedhura (me kod kredie 62419) rezulton e klasifikuar si e humbur dhe nuk disponon asnjë dokumentacion bashkëlidhur përveç procesverbalit të transferimit. Nga ana e Agjencisë nuk është marr asnjë masë me qëllim arkëtim në kundërshtim me nenin 10, të ligjit nr. 8894, datë 15.04.2002, të ndryshuar, i cili e njeh këtë procesverbal si titull ekzekutiv dhe zbatohet nga përmbaruesi gjyqësor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1. Rekomandimi: Nga Sektori i Arkivës të merren masa, për të reflektuar në fletën shoqëruese të dosjeve të gjitha dokumentacionet, pjesë e saj dhe çdo shkresë hyrëse dhe dalëse në lidhje me një dosje t’i bashkëngjitet dosjes, për të mundësuar një historik të plotë të saj.

Nga personat e autorizuar me akses në përdorimin e sistemit të kreditit, të merren masa, për saktësimin e të dhënave në të gjitha rekordet që lidhen me të dhënat e kredisë, si valuta, data e plotësimit/bllokimit të interesave, kolaterale etj.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Evidentohet mosrealizim i planit të arkëtimeve të miratuara me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës për të tre vitet objekt auditimi. Konkretisht për vitin 2021 arkëtimet janë realizuar në vlerën 77,643,154 lekë ose 86.3%; për vitin 2022 arkëtimet janë realizuar në vlerën 62,219,255 lekë ose 69% dhe për vitin 2023 arkëtimet janë realizuar në vlerën 80,624,585 lekë ose 90% e planit.

Gjatë aktivitetit të saj për tre vitet objekt auditimi Agjencia nuk ka zbatuar nenin 22, pika 2 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2022 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar, pasi ka mbajtur në llogaritë e veta fonde më shumë se $\frac{1}{4}$ e buxhetit operativ vjetor të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës. Nga të dhënat rezultojnë se për vitin 2021 Agjencia ka derdhur në buxhetin e shtetit vlerën prej 20,457 mijë lekë dhe ka mbajtur për përdorim 74% të arkëtimeve vjetore; për vitin 2022 ka derdhur në buxhetin e shtetit vlerën prej 31,871 mijë lekë dhe ka mbajtur për përdorim 49%, si dhe për vitin 2023 ka derdhur në buxhetin e shtetit vlerën prej 29,835 mijë lekë dhe ka mbajtur për përdorim 62%. Pra, referuar nenit 22, pika 2 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2022, i ndryshuar Agjencia ka mbajtur më shumë se 25% ($\frac{1}{4}$) të buxhetit operativ vjetor, duke ndikuar ndjeshëm në nivelin e arkëtimeve në buxhet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 89-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1. Rekomandimi: Nga Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerat të analizohen dhe të nxirren përgjegjësitë për mos realizimin e të ardhurave përgjatë tre viteve si dhe mos derdhjen e tyre në Buxhetin e Shtetit në masën e përcaktuar në ligj.

Brenda vitit 2024

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Rregullores së funksionimit të brendshëm të Agjencisë, miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 83 datë 01.10.2019, e ndryshuar me Vendimin nr. 873, datë 08.03.2022, u konstatua se:

- pika 4 e seksionit “Detyra jashtë strukturës organizative” bie në kundërshtim me pikën 8 të kreut “Sektori juridik, operacional dhe menaxhimit të riskut” dhe për periudhën objekt auditimi urdhrat e brendshëm për ngritjen e komisionit teknik janë ngritur sipas përcaktimit të pikës nr. 4 të Rregullores, pra pa përfshirjen në komisionin teknik të zv. Drejtorit të Përgjithshëm.

- detyrat e përcaktuara në pikën 1 të kreut “Komisioni Teknik”, të Rregullores nuk janë në përputhje me pikën 7 të Rregullores, duke krijuar paqartësi në detyrat dhe funksionin e këtij Komisioni;

- nuk është parashikuar një seksion i veçantë për funksionimin dhe detyrat e Komisionit të Ankandeve. Detyrat dhe përbërja e Komisionit të Ankandeve përcaktohen në pikat 9-39 të Kreut III të Udhëzimit nr. 33/2010, i cili nuk përputhet me strukturën e Agjencisë për vitet 2021-2023, dhe nuk rezultojnë që Agjencia të ketë ndërmarrë hapa për miratimin e një rregullore specifike për zhvillimin e ankandeve;

-Detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm janë të kufizuara dhe mungojnë kritere të mirëpërcaktuara në lidhje me procedurat e lirimimit dhe emërimit nga detyra.

(Më hollësisht trajtuar në pikat 2.3 dhe 2.4, faqe 57-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerat, në kuadër të mospërputhjes së përcaktimeve të Rregullores së funksionimit të brendshëm, ndryshimeve ligjore dhe ristrukturimit, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të harmonizuar me kuadrin ligjor në fuqi dhe strukturën aktuale të Agjencisë, me qëllim përmirësimin e performancës së veprimtarisë së kësaj Agjencie.

Brenda vitit 2024

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se aktualisht ka një akumulim të risqeve potenciale për shkak të mangësive të veprimtarisë së Agjencisë që nga krijimi i saj me pasoja potenciale në rikuperimin e kredisë, si në vijim:

- *Numri në rritje i proceseve gjyqësore me objekt padie “Pavlefshmëria e titujve ekzekutivë”* duke qenë se kreditë e trajtuara nga Agjencia janë kredi të cilat janë alokuar afro 30 vite më parë dhe nuk janë ezuaruar në vijimësi dhe në kohë të gjitha procedurat për kthimin e kredisë dhe për të gjithë kreditorët;

- Gjithashtu gjatë periudhës 2021-2023 janë depozituar pranë Gjykatave përkatëse 42 kërkesa për lëshimin e dublikatave të Urdhrave të Ekzekutimeve (UE), të cilët gjatë shqyrtimit të dosjeve dhe nevojës për të vazhduar procedurat e mëtejshme për vënien në ekzekutim është vënë re që këto UE origjinale nuk gjendeshin në dosjet e arkivuara pranë Agjencisë, si dhe as në Zyrat Përmbartimore Private dhe Shtetërore, për rrjedhojë pretendohet të kenë humbur. Nga 42 Kërkesa të depozituara, është bërë lëshimi i dublikatës së Urdhrit të Ekzekutimit për detyrimin e 1 debitori ndërsa pjesa tjetër rezultojnë në proces të hapur, duke shfaqur mungesë përgjegjësie në veprimtarinë e saj Agjencia;

- *Cilësia e borxhit* - nga ana e Agjencisë nuk ka pasur mjaftueshëm zbatim të masave shtrënguese dhe përditësim të ndryshimeve ligjore në vite, në përputhje me zhvillimin e vendit në funksion të kthimit të kredive, duke vështirësuar rikuperimin e tyre;

- *Mungesa e të dhënave thelbësore të debitorëve* – mungesa e gjeneraliteteve të 7,167 debitorëve si numër identifikimi, atësi, datëlindje, shoqëruar me neglizhencën në plotësimin e tyre që në vitet e para të krijimit të Agjencisë;

- *3,230 Dosje të djegura ose me mungesë dokumentacioni* - ekziston vetëm procesverbal transferimi, për të cilat nuk ka pasur asnjë përpjekje për mundësinë e rikuperimit të tyre nga burime zyrtare të tërthorta;

- *Mosha e debitorëve* - me kalimin e viteve shumë nga kredimarrësit kanë dalë në pension ose kanë ndërruar jetë. Në lidhje me debitorët që kanë ndërruar jetë sipas të dhënave të Agjencisë rezultojnë se janë identifikuar 92 debitorë, me detyrime: 57,748 mijë lekë *principal i mbetur*, 165,029 mijë lekë *interes i mbetur dhe* 2,506 mijë lekë *shpenzime gjyqësore*. Nga auditimi konstatohet se kjo databazë nuk është e saktë pasi janë konstatuar minimalisht edhe 3 debitorë që kanë ndërruar jetë të cilët nuk gjenden në të dhënat e raportuara të Agjencisë, duke shfaqur neglizhencë dhe pa përgjegjshmëri të Agjencisë në zbutjen dhe eliminimin e këtij risku;

- *Mungesa e bashkëpunimit ndërinstucional* – mungesa e krijimit të lehtësirave për shkëmbimin e informacioneve nga institucionet e tjera, gjë e cila tregon mungese vullneti institucional, si dhe moszbatim të detyrimeve ligjore

- *Mungesa e bashkëpunimit me zyrat përmbartimore private dhe monitorimit të veprimtarisë së tyre, gjë e cila* ka vështirësuar punën e institucionit, si edhe ka sjellë mungesën e efekteve frytdhënëse të punës në kthimin e huave të marra. Gjatë periudhës objekt auditimi, Agjencia ka pasur bashkëpunim me 22 Zyra Përmbartimore Private, për të cilat mungon gjurma e auditimit në lidhje me përzgjedhjen dhe një analizë e detajuar mbi performancën e tyre. Në vlerësimin e grupit të auditimit, bazuar në dosjet e audituara, rezulton jo efektive ndër vite.

- *Mungesa e dokumentacionit tekniko-ligjor të pasurive në pronësi të Agjencisë* - nga ana e Agjencisë nuk është bërë asnjë përpjekje për zgjidhjen e kësaj çështjeje, mangësi e cila ka bërë të pamundur vijimin e procedurave të nxjerrjes në ankand të pronave, dhe arkëtimin e detyrimeve përkatëse..

- *Mungesa e regjistrimit në QKB të SHPK-ve* huamarrëse duke sjellë për pasojë mungesën e Numrit Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) të vlefshëm, rrjedhimisht statusi i tyre nuk është aktiv.

Mangësitë e mësipërme si dhe mos-marrja e masave në kohë nga Agjencia ndër vite, që nga momenti i krijimit, ka sjellë që vitet e fundit niveli i mbledhjes së kredive dhe realizimit të të ardhurave, të jetë konsiderueshëm i ulët dhe në kufijtë e riskut për të mbuluar shpenzimet e veta. Nga Agjencia përveç pagesës së një pjesë detyrimi kundrejt KFW-së, nuk ka asnjë

arkëtim tjetër në buxhetin e shtetit. Madje dhe detyrimi kundrejt KFW-së, ka ardhur duke u rritur si pasojë e gjenerimit të interesat nga mos-pagimi në kohë dhe në vlerë të plotë.

Masat e marra nga Agjencia dhe komunikimet me institucionet e tjera nuk kanë qenë të mjaftueshme, ezauruese dhe të trajtuara në kohë me qëllim evidentimin, parandalimin e tjetërsimit të pasurive dhe uljen e riskut të pamundësisë për vjeljen e detyrimit, largimit të debitorëve jashtë vendit, ndërrimit të jetës për shkak të moshës etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer në bashkëpunim me strukturat e veta përkatëse, të marrin masa për analizimin e problematikave të konstatuara me qëllim uljen e nivelit të ekspozimit ndaj rrisqeve potenciale, duke konkluduar rast pas rasti për masat që duhen marr në vijim me qëllim arkëtimin e detyrimeve, duke ezauruar plotësisht procedurat ligjore për secilin prej kredimarrësve që nuk kanë shlyer detyrimet e huasë së marrë.

Brenda vitit 2024

20. Gjetje nga auditimi: Lidhur me procedurat e prokurimit të audituara për vitet 2021 dhe 2023 sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se nuk është kërkuar deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore, si dhe nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues. Në dosjen e procedurës së prokurimit “Blerje Pajisje Elektronike” nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit, si dhe nuk administrohet formulari i ofertës. Në dosjen e procedurës së prokurimit “Shërbime për riparimin e automjeteve” nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit.

Për procedurat e prokurimit të vitit 2022 “Lyerje dhe punime të brendshme gipsi” dhe “FV kondicionerë” ka tejkallim të kriterëve lidhur me specifikimet teknike:

-Kapaciteti financiar: Xhiro vjetore për të paktën tre nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë jo më e vogël se 40%. Ky kriter rezulton në kundërshtim me pikën 2, gërma c të nenit 43 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 ku citohet: “2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulencë”.

-Kapaciteti teknik profesional: Dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Ky kriter rezulton në kundërshtim me pikën 3 të nenit 41 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

Si dhe dosjet e procedurave të prokurimit nuk janë të arkivuara, inventarizuara dhe numerizuara me numër fletësh, veprim i cili është në kundërshtim me nenin 30 “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 89-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor së bashku me strukturat përgjegjëse të prokurimit publik të marrin masa për përcaktimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike, përcaktimin e kapacitetit financiar dhe teknik në përputhje me kuadrin ligjor dhe objektin e madhësinë e prokurimit për të siguruar përdorimin me efektivitet të fondeve publike. Gjithashtu, të merren masa për inventarizimin e dosjeve në përputhje me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor .

Në vijimësi

B. MASA DISIPLINORE

B.1 Mbështetur në nenin 3, të ligjit nr. 55/2023 “Për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive Shtetërore të Pakthyer”, pika 1, i rekomandojmë Ministrit të Financave analizimin në mënyrë të thelluar të problematikave të evidentuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, nxjerrjen e

përgjegjësi dhe marrjen e masave të nevojshme me qëllim mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera.

B.2 Mbështetur në nenin 5, të ligjit nr. 55/2023 “Për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive Shtetërore të Pakthyera”, si dhe VKM nr. 723, datë 13.12.2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera”, pikat 3 dhe 5 të kreut të tretë i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë vlerësimin e shkeljeve dhe gjykimin përfundimtar në lidhje me masat disiplinore sipas problematikave të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në referencë të Kodit të Punës, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, i ndryshuar, neni 21, pika 3, germa “h”.

Për shkak të ndryshimeve ligjore të fundit, problematikave të evidentuara dhe origjinës së tyre, përgjegjësi të mbartura ndër vite dhe numrit të lartë të punonjësve që kanë shkëputur marrëdhëniet e punës me këtë institucion, Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka të pamundur adresimin institucional të rekomandimeve për masa disiplinore. Konkretisht:

1. Për periudhën objekt auditimi kjo Agjenci ka vepruar si person juridik publik, në varësi të Ministrisë të Financave, në zbatim të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar, periudhë gjatë së cilës organet drejtuese të Agjencisë kanë qenë Këshilli Mbikëqyrjes dhe Drejtoria. Aktualisht Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera është person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrisë Përgjegjëse për Financat dhe ushtron kompetencat bazuar në ligjin nr. 55/2023, datë 13.07.2023. Këto ndryshime ligjore janë shoqëruar me ndryshime në funksione, kompetenca dhe mënyrën e organizimit të kësaj Agjencie. Përpos ndryshimit të organizimit të Agjencisë, gjatë periudhës objekt auditimi ka patur një numër të konsiderueshëm shkëputje të marrëdhënieve të punës, ku konkretisht për vitin 2021 rezultojnë 15 shkëputje të marrëdhënieve të punës nga 27 punonjës sipas strukturës së miratuar, për vitin 2022 rezultojnë 9 nga 28 punonjës dhe për vitin 2023 rezultojnë 8 nga 30 punonjës.

2. Pavarësisht periudhës objekt auditimi 2021-2023, problematikave dhe shkeljet e konstatuara në të gjitha drejtimit e auditimit kanë rezultuar të shtrira në kohë dhe të trashëguara ndër vite, si rrjedhojë edhe përgjegjësitë për to, trajtuar më hollësisht në këtë Raport Auditimi.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT